

UNIVERSITETI I TETOVËS
FAKULTETI FILOZOFIK
Programi studimor: Histori
Cikli i tretë i studimeve



Disertacion doktrature

**KOSOVA NË SFONDIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-
JUGOSLLAVE 1974-1989**

Mentori:

Prof. Dr. Nebi Dervishi

Kandidati:

MA. Sedat Sahitaj

Tetovë, 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky studim është veper origjinale e imja e hartuar në bazë të punës disa vjeçare . Në çdo rast janë respektuar të gjithë standartet e citimit dhe referencave në respekt të të drejtave morale të autorit dhe legjislacionit në fuqi për përdorimin e materialeve dhe literaturës së përfshirë në këtë disertacion.

Ndalohet çdo përdorim dhe riprodhim, botim dhe shpërndarje, kopjim dhe shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar pa pëlqimin paraprak me shkrim të autorit.

UNIVERSITETIT I TETOVËS-UT



Tezë në kërkim të gradës shkencore “DOKTOR”

Fusha: Histori

Specialiteti: Histori bashkëkohore

Tema:

KOSOVA NË SFONDIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-JUGOSLLAVE
1974-1989

Kandidati:

Sedat Sahitaj

Mentori:

Pof.dr. Nebi Derivishi

Mbrohet me datën: ____ / ____ / 2020, para komisionit

1. _____ - Kryetar
2. _____ - Oponent
3. _____ - Oponent
4. _____ - Anëtar
5. _____ - Mentori

Tetovë, 2020

Përmbajtja

Tabelat.....VII

HyrjaXI

Kreu i parë

GJENDJA POLITIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE NË KOSOVË 1945-1974.....2

- 1.1 Kosova statusi i saj politik dhe juridik-kushtetues 1945-1948.....2
- 1.2 Aksioni i “ tepricave” dhe aksioni i armëve si mjete të politikës jugosllave ndaj Kosovës.....9
- 1.3 Marrëdhëniet e shtetit shqiptar, me ish-Jugosllavinë, 1948-1966.....15
- 1.4 Rënia e Aleksandër Rankoviçit një mundësi për hapje ndaj Shqipërisë.....27
- 1.5 Qëndrimi i Shqipërisë ndaj lëvizjes politike në Kosovë në vitet 1945-1968.....32

Kreu i dytë

MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE 1970-1981.....42

- 2.1 Kërkesa e Kosovës për të drejta kombëtare, pas vitit 1970 dhe mbështetja e shtetit shqiptar.....42
- 2.2 Kushtetuta e vitit 1974.....44
- 2.3 Reagimi i nacionalizmit serb ndaj ndryshimeve kushtetuese.....55

2.4 Marrëveshjet e ndërshtetërore për këmbimet arsimore dhe kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë 1970-1981.....	61
---	----

Kreu i tretë

DEMONSTRATAT E VITIT 1981 DHE NDIKIMI I TYRE NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE.....	94
3.1 Ndikimi i vdekjes së Titos në politikën e brendshme të Jugosllavisë.....	94
3.2 Demonstratat e vitit 1981 dhe qëndrimi i shtetit shqiptar.....	101
3.3 Jehona e demonstratave të vitit 1981 në arenën ndërkombëtare.....	133
3.4 Goditja e elitës intelektuale dhe kombëtare nga regjimi jugosllav pas demonstratave të viti 1981.....	143
3.5 Ndikimi i demonstratave në zgjimin kombëtar të shqiptarëve në ish- Jugosllavi.....	146
3.6 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1981-1989.....	150
3.7 Suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe qëndrimi i shtetit shqiptar	156
Përfundimet.....	165
Burimet dhe literatura.....	172

TABELAT

Tabela.1: Statistikat, ku paraqesin zonat ku popullsia shqiptare përbën shumicën.....	49-50
Tabela. 2 : Zonat ku popullsia shqiptare përbente pakicën.....	51
Tabela.3: Gjendja e shkollave fillore e 8 vjeçare 1952-1958.....	53
Tabela. 4: Gjendja e arsimit të mesëm 1952-1958.....	53
Tabela. 5: Lista e sjellë nga studiuesi serb Orbadoviq për kolonizimin e Kosovës pas LDB-së.....	76
Tabela. 6: Lista e kuadrit arsimor si pas fushave shkencore që kishin ardhur në Kosovë gjatë vitit 1975.	98
Tabela.7: Lista e kuadrove që UT-ja pret nga UP-ja për shkëmbim përvoje, specializim, përgatitje të magjistraturës dhe të doktoraturës.....	100
Tabela.8: Numri i kundrove që kanë shkuar nga UP-ja në UT.....	105

FALËNDERIM

Realizimi i një pune studimore disavjeçare, është e pamundur të realizohet pa ndihmën e shumë miqve në forma të ndryshme.

Fillimisht shpreh konsideratën time të veçantë për udhëheqësin shkencor të tezës së doktoraturës prof. Dr. Nebi Dervishi, i cili më ka drejtuar, këshilluar dhe mbështetur në të gjitha fazat e punës sime studimore. E falënderoj edhe për mënyrën e veçantë që më ka stimuluar interesimin tim të vazhdueshëm në fushën e historiografisë, konkretisht për temën që kemi marrë për studim.

Respekt dhe falënderim për stafin punonjës në Arkivin Shtetëror të Tiranës, Agjencisë së Arkivave të Kosovës, Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Budi” në Prishtinë.

Shpreh mirënjohjen time për kolegët e mi historianë që jam këshilluar në mënyrë të vazhdueshme, nga të cilët kam marrë sugjerime miqësore.

Falënderim i zemrës shkon për familjen time, që më ka qëndruar pranë, gjatë gjithë kohës së punës studimore.

Abstrakti

Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave 1974-1989 janë tejet specifike për faktin se në shtetin jugosllav jetonin afërsisht 2 milionë shqiptarë. Ishin pikërisht shqiptarët në Jugosllavi që kanë determinuar edhe marrëdhëniet midis shtetit shqiptar dhe ish-Jugosllavisë. Prandaj studimi **“Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989”** kishte si objektiv shkencor të shtjellojë zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, me Kosovën në qendër, nga një prizëm krejt tjetër. Pra synon që këto marrëdhënie t’i trajtojë nga prizmi i tri palëve, Jugosllavisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Pikërisht këtu qëndron edhe e veçanta e këtij studimi, duke trajtuar, analizuar marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1974-1989, me fokus të veçantë Kosovën në këtë mes. Këto marrëdhënie janë trajtuar në shumë aspekte, si: politik, diplomatik, ekonomik, kulturor, arsimor etj., çdoherë nga prizmi trekëndësh Shqipëri, Kosovë dhe Jugosllavi. Më pastaj është shtjelluar edhe determinizmi i këtyre marrëdhënieve në politikën rajonale dhe më gjerë.

Në këtë studim janë trajtuar të gjitha ngjarjet që kanë kulmuar gjatë kësaj periudhe 1974-1989. Studimi tenton të shtjellojë edhe rolin e shtetit shqiptar në shumë procese që ka kaluar Kosova, gjatë periudhës në fjalë. Si në këmbimet kulturore, avancimet kushtetuese të Kosovës, demonstratat e vitit 1981, suprimimin e autonomisë etj..

FJALËT KYÇE: Kosova, Shqipëria, Jugosllavia, Marrëdhëniet, Këmbimet Kulturore, Demonstratat, Kushtetuta, Suprimim, Greva, Enver Hoxha, Tito etj..

Abstract

The relations between Albania and Yugoslavia during the years 1974-1989 were an extremely specific issue due to the fact that around 2 million Albanians lived in Yugoslavia. The Albanians living in Yugoslavia were a key element that determined the relations between the two states mentioned above. Therefore, the thesis **“Kosovo in the contexts of Albanian-Yugoslav relations 1974-1989”** aims to elaborate the development of relations between Albania and Yugoslavia, with Kosovo as its core, from an entirely different angle. It aims to elaborate those relations through the angle of three elements: Albania, Kosovo and Yugoslavia. So, here lies the specificity of this thesis: elaboration and analyses of Albanian-Yugoslav relations during 1974-1989 with Kosovo as a core of it. Several elements have been elaborated: political, diplomatic, economic, cultural, educational, etc., always from a triangular view – Albania, Kosovo and Yugoslavia. In addition, the thesis also elaborates the extension of such relations in the regional or international politics.

The thesis elaborates all peak events and circumstances in Kosovo encompassing the period 1974-1989, including the role of the Albanian state in it, respectively: cultural exchanges, constitutional upgrade in Kosovo, Demonstrations of 1981, revocation of Kosovo’s autonomy, etc.

Key words: Kosovo, Albania, Yugoslavia, relations, cultural exchange, demonstrations, constitution, revocation, strike, Enver Hoxha, Tito, etc.

Hyrja

Tema “Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989 ” është marrë për studim, pas një interesimi bukur të gjatë që kam pasur, për këtë periudhë të historisë të cilën e karakterizon një dinamizëm i madh me ngjarje të rëndësishme, si në nivelin global në përgjithësi, si dhe për popullin shqiptar në veçanti. Po ashtu të veçantë e kanë bërë raportet të cilat kanë dominuar në mes të tri vendeve thuajse për katër dekada. Margjinat kronologjike të temës që kemi marrë në studim është miratimi i Kushtetutës së Kosovës 1974 dhe suprimimi i saj më 1989. Po ashtu kemi pasur parasysh, se raportet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës 1974-1989 paraqet një nga problemet më të rëndësishme historike dhe politike për Kosovën, për arsye të shumë ngjarjeve të rëndësishme të madhe politike, juridike, ekonomike, kulturore, arsimore dhe nacionale që janë zhvilluar në periudhën 1974-1989. Për arsyet e sipërthëna, kjo periudhë ka zgjuar kureshtjen e shumë studiuesve si vendorë dhe atyre ndërkombëtarë, që të trajtojnë shumë segmente të saj. Për shkak të dinamizmit dhe lidhshmërisë së ngjarjeve që karakterizon këtë periudhë, ne për ta shtjelluar këtë temë jemi nisur nga deduktivja tek induktivja, (nga e përgjithshmeja te e veçanta) që të arrijmë në konkludime sa më të sakta. Objektivi kryesor i kësaj teme është analiza e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave me Kosovën në qendër, rreth 15 vjet.

“Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989” është, në një aspekt, sa komplekse aq edhe interesante për politikën e jashtme shqiptare në këtë periudhë që kemi marrë për trajtim. Tema në fjalë ndërthet në vete shumë elemente si politike, diplomatike, ekonomike, sociale dhe kulturore, arsimore etj. Përveç kësaj ka edhe shumë arsye tjera që e bëjnë bukur specifike si temë për studim, si për faktin se shumë antagonizma midis paleve vijnë nga thellësia e historisë, e që janë trashëguar deri në fund të shek. XX. Pastaj në rrethana të reja politike e ekonomike të krijuara, kompleksiteti në kontekstin e marrëdhënieve trepalëshe, Shqipëri- Kosovë- Jugosllavi, si dhe nevojës për stabilitet në këtë areal politik. Edhe përkundër që pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria dhe Jugosllavia bënë pjesë nën ombrellën komuniste, këto ishin vendet që përbenin elementin e mosqëndrueshmërisë politike në Ballkanin Perëndimor.

Vitet 1974-1989 për shqiptarët nuk ishte një periudhë shumë e gjatë historike në kuptimin kalendarik, por ishte mjaft dinamike, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, po ashtu ishte edhe mjaft me rëndësi për qenien e tyre. Në Kosovë gjatë viteve të 70-ta shqiptarët fillojnë

të kenë disa të drejta, të cilat iu kishin mohuar që në krye të herës. Këto të drejta i fituan me kushtetutën e vitit 1974. Pastaj vitet e 80-ta janë karakteristikë e një terrori sistematik që kanë përjetuar shqiptarët e Kosovës, sidomos pas demonstratave të fuqishme studentore të vitit 1981. Aq larg shkoi dhuna dhe terrori i shtetit jugosllav ndaj shqiptarëve sa që, ato pak të drejta që kishin fituar me kushtetutën e vitit 1974, iu mohuan në vitin 1989. Jugosllavia e bëri edhe hapin final politiko-juridik, eliminimin e statusit kushtetues të Krahinës Autonome të Kosovës, nga ana e Kuvendit të Serbisë, më 28 mars 1989. Pra iu suprimua Kushtetuta e Kosovës përmes aparatit policor dhe ushtarak. Në të njëjtën formë si ishte aneksuar Kosova në Kuvendin e Prizrenit të vitit 1945.

Edhe Shqipëria përjetoj kriza të vazhdueshme edhe pse ishte shtet me të gjitha të drejtat dhe njihej ndërkombëtarisht. Por fatkeqësisht shteti shqiptar kishte ndjekur një politikë izolacioniste, çka do t'i kushtonte jashtëzakonisht shumë në të gjitha aspektet. Ky izolim i shtetit shqiptar do të shndërrojë Shqipërinë në një shtet autarkik, të parin në Evropë.

Jugosllavia pikërisht në këtë periudhë kohore (1974-1989) arrin të shndërrohet një ndër shtetet më të fuqishme në rajon. Por duhet të theksohet edhe fakti tjetër, se është pikërisht perudha në fjalë, që ka filluar dekadencia e Jugosllavisë. Edhe përkundër se shteti shqiptar nuk arriti nivelin e zhvillimit, siç kishte arritur Jugosllavia, ajo kishte mjaft impakt politik në shtetin jugosllav sepse kishte një popullsi afërsisht tre milion banorë që kishin mbetur në kuadër të Jugosllavisë. E kur dihet mirëfilli se kishte shtete (republika) që përbënin e Jugosllavinë dhe nuk kishin kaq banorë, sa kishte shqiptarë në ish-Jugosllavi, ku vetëm në Kosovë pas vitit 1980 kishte mbërritur numri afër 2 milionë banorë. Prandaj, deshëm apo nuk deshëm ta pranojmë, stabiliteti politik i Jugosllavisë është varur edhe nga “minoriteti” shqiptar në ish-Jugosllavi. Për këtë arsye asnjëherë Titoja nuk shkoi deri në atë masë sa që prishja e raporteve shqiptaro – jugosllave, të ishte e pariparueshme.

Jo vetëm periudhën në fjalë, por përgjatë gjithë shekullit XX, marrëdhëniet shqiptaro –jugosllave (serbe) kanë zgjuar një interesim për shumë studiues, sepse raportet mes këtyre dy shteteve kanë determinuar edhe stabilitetin politik në rajon. Sa i përket periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave kanë pasur ngritje dhe ulje të vazhdueshme

Dihet pra se në këtë periudhë Shqipëria fillon të vetizohet hermetikisht. Kurse Kosova nga vitet e 70-ta filloi që sado pak të këndellet pas një periudhe të vështirë siç ishte periudha e Aleksandër Rankoviçit 1955-1966. Kjo periudhë e historisë se shek. XX është një hapësirë

kohore me rëndësi edhe për historiografinë evropiane. Pikërisht në këtë kohë bota ishte në kulmin e Luftës së Ftohtë, por edhe nga mesi i viteve të 80-ta kishte filluar të shihej në horizont fundi i Luftës së Ftohtë.

Në fillim të viteve të 70-ta Kosova kishte filluar të ketë raporte mjaft të ngjeshura me shtetin amë, me Shqipërinë. Sidomos në fushën e arsimit dhe kulturës. Kjo është edhe periudha kur Shqipëria me shtetin jugosllav fillon t'i relaksojë marrëdhëniet, pas një periudhe acarimi, që nga koha e prishjes së raporteve të Titos me Stalinin dhe daljes së Jugosllavisë nga Informbyroja.

Do të dëshironim të vinim një theks të veçantë në periudhën që kemi marrë për studim 1974-1989, se është një periudhë historike mjaft me rëndësi për shqiptarët në përgjithësi edhe përkundër shumë peripecive të shqiptarëve andej dhe këndej kufirit, megjithatë pikërisht kjo është koha kur çështja shqiptare fillon të kristalizohet, shqiptarët shndërrohen në një faktor jo pa ndikim në rajon. Pas kësaj periudhe shumë studiues dhe analistë të ndryshëm të gjeopolitikës kanë ardhur në përfundim se për shqiptarët është duke punuar koha.

Në historiografinë shqiptare, kjo periudhë historike është shumë e ngjeshur me ngjarje të rëndësishme për shqiptarët në Kosovë. Edhe përkundër dinamikës së ngjarjeve nuk mund të thuhet se nuk është trajtuar nga studiues vendorë dhe të huaj. Por nuk është trajtuar nga ky kënd nga i cili ne e kemi trajtuar, pra nga prizmi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, ku si kufi kohor siç kemi theksuar edhe më lart kemi marrë miratimin e Kushtetutës së Kosovës 1974 deri në suprimimin e saj 1989.

Prandaj vitet e 70-ta dhe 80-ta për Kosovën ishin vite kur fillon ajo që përfundon në vitin 1999. Kjo periudhë që ne kemi trajtuar nga prizmi i trekëndëshit, Kosovë, Shqipëri dhe Jugosllavi, besoj se do të jetë një kontribut shumë modest për historiografinë tonë.

Punimi ka si objektiv të japë një tablo më të plotë dhe më të qartë të marrëdhënieve diplomatike dypalëshe, midis Republikës së Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë për periudhën 1974-1989, me një fokus të veçantë Kosovën në mes të këtyre marrëdhënieve. Ky studim i trajton marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, si në fushat: politike, institucionale, ekonomike, ashtu dhe në atë të edukimit, kulturës, arsimit etj.. Me një theks të veçantë studimi është përqendruar që të evidentojë acarimet, bashkëpunimet dhe prishjet diplomatike dypalëshe midis Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë gjatë periudhës 1974-1989. Për shkak të rëndësisë dhe impaktit në çështjen shqiptare në ish-Jugosllavi, një hapësirë të madhe studimi i kemi dhënë

këmbimeve kulturore midis Shqipërisë dhe Kosovës gjatë viteve të 70-ta, kryesisht duke u bazuar në dokumenteve arkivore. Po ashtu kemi trajtuar me një interes specifik demonstratat studentore të vitit 1981. Shkaqet e shpërthimit të tyre, pastaj rolin e tyre në afrimin e çështjes shqiptare, ndikimi i shtetit shqiptar në këto demonstrata etj.. Kryesisht duke shfrytëzuar dokumente arkivore të proveniencës shqiptare, por me një masë më të kufizuar edhe dokumentet e proveniencës serbe, si dhe studimet e autorëve më të spikatur të huaj dhe vendor. Trajtim të tillë i kemi bërë edhe dy ngjarjeve me rëndësi, si Grevës së Minatorëve dhe Suprimimit të autonomisë së Kosovës 1989.

Një trajtim kaq dimensional është mundësuar nga vjelja e një materiali burimor arkivor dhe të një literature mjaft të përzgjedhur, çdo herë duke përdorur silogjizmat si metodë, më qëllimin e vetëm që të bëhet analizë sa më e saktë e ngjarjeve. Kemi shfrytëzuar fondet arkivore të Arkivit Qendror të Shteti Shqiptar, fondet e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtëm të Shqipërisë (AMPJ), fondet e Agjencisë së Arkivave të Kosovës, fondet e Arkivit të Lublanës (Arhiv Republike Slovenije, fondi: Централни комитет Комунистичке лиге, Škatla 872-KOSOVO), si dhe mjaft vëllime të dokumenteve të botuara të arkivave të huaja dhe vendore, shtypin e kohës, memoaret etj., njëkohësisht ky është edhe bazamenti i këtij punimi të doktoratës. Sa i përket literaturës që kemi shfrytëzuar për këtë studim doktrate, është një gamë bukur e gjerë. Literaturën që kemi përdorur kryesisht është ajo që flet për segmente të veçanta të temës, në një formë ose tjetër, si dhe shkrime të kohës për temën që kemi pasur në shqyrtim, të autorëve të huaj dhe atyre vendorë. Me një kujdes të veçantë kemi shfrytëzuar edhe burimet nga interneti, kryesisht libra të autorëve të huaj. Krejt ky gërshetim është bërë duke pasur si objektiv të vetëm për të qenë sa më afër të vërtetës historike për periudhën 1974-1989.

Metodologjia me të cilën jam shërbyer në këtë studim është ajo e qasjes tematike. Por duke mos lënë anash asnjë moment metodat tjera të kërkimit shkencor, metoda e krahasimit, hulumtimit dhe përshkrimet tematike multidisiplinare. Qëllimi i përdorimit të këtyre metodave ishte çdoherë për të ruajtur kohezionin, semantikën dhe aspektin kronologjik të punimit. Por, parimi bazë metodologjik ka qenë që të ruajmë paanshmërinë në interpretimin e dokumenteve arkivore dhe në krahasimin e literaturës.

Studimi është ndërtuar sipas një skeme të përbërë nga hyrja, krerët dhe përfundimi. Punimi është strukturuar në tre krerë, ku përfshihet e gjithë shtrirja e temës, ku në vete ndërthehen kriteri kronologjik me atë tematik. Në të gjithë krerët ndiqet rrjedha kronologjike,

ndërsa nëntitujt brenda çdo kapitulli, janë përcaktuar duke u mbështetur kryesisht në kriterin tematik e problemor.

Punimi paraprihet nga hyrja, në të cilën jepet një tablo në vija të trasha për periudhën historike që nga Lufta e Dytë Botërore deri në vitin 1990, me një theks të veçantë periudha 1974-1989, vitet në të cilin janë vendosur marrëdhëniet diplomatike midis shtetit shqiptar dhe shtetit jugosllav. Janë paraqitur faktorët që kanë quar në afrimin dhe prishjen e marrëdhënieve midis dy shteteve. Pastaj riafrimi i tyre, fushat e bashkëpunimit midis dy vendeve, Kosova në sfondin e këtyre marrëdhënieve, demonstratat e vitit 1981 dhe ndikimi i tyre në marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, miratimi i Kushtetutës së Kosovës më 1974 dhe suprimimi i saj më 1989.

KREU I *Gjendja politike dhe socio-ekonomike në Kosovë 1945-1974. Trajtohen të gjitha zhvillimet dramatike në Kosovë, që nga viti 1945 deri më 1974. Ky kapitull është jashtë kornizave kronologjike të temës që kemi për studim, por ashtu siç dihet botërisht asnjë periudhë historike nuk mund të studiohet mirëfilli pa dalë jashtë këtyre kornizave. Sepse asnjë fenomen shoqëror nuk ndodh aty për aty, por ekzistojnë faktorët që ndikojnë në të. Në këtë kapitull një vend të veçantë zë pasqyrimi konkret gjendja politiko-juridike e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore dhe aneksimi i Kosovës nga shteti komunist jugosllav. Për të bërë një trajtim sa më të hollësishëm të temës në fjalë ky kapitull ndahet në disa pjesë, apo nënkapituj. Në pjesën e parë trajtohet statusi politik dhe juridik-kushtetues i Kosovës në vitet 1945-1948. Pra çfarë pozite kishte Kosova në aspektin juridiko-kushtetues pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, pse dhe si e vendosi administrimin ushtarak mbi Kosovë shteti jugosllav, si mbeti Kosova pjesë përbërës e Serbisë etj..*

Në pjesën e dytë të këtij kreu trajtohen dy mekanizmat që kishte përdorur shteti jugosllav si mjete të politikës ndaj shqiptarëve të Kosovës, si aksioni i “tepricave” 1947-1949 dhe aksioni i armëve.

Aksioni i “tepricave” që proklamohej si një nevojë imediate e ushtrisë jugosllave, por realisht qëllimi kryesor ishte që të bëhet sa më shumë presion ndaj etnisë shqiptare për të lëshuar tokat e tyre. Aksioni i armëve 1955-1956, ky aksion proklamohej nga organet shtetërore si masë preventive ndaj organizmit të mundshëm të një kryengritjeje nacionaliste shqiptare, por kjo ishte kryekëput si një arsyetim që të terrorizoheshin shqiptarët që sa më shumë të lëshonin

vendin e tyre. Po ashtu trajtohet edhe gjendja sociale dhe ekonomike në Kosovë gjatë dhe pas këtyre aksioneve.

Në pjesën e tretë, një hapësirë bukur e gjerë i jepet prishjes së marrëdhënieve në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, 1948-1966. Trajtohen faktorët që kanë qar drejt afrimit të këtyre dy vendeve si dhe faktorët që quan drejt prishjes së raporteve midis këtyre dy vendeve. Cilët ishin faktorët që kishin bërë që shteti shqiptar të ketë një afërsi shumë të madhe pas LDB-së 1945-1948 me shtetin jugosllav, pastaj faktori që ndikoi në prishjen e këtyre marrëdhënieve thuajse “vëllazërore” 1948. Po ashtu çka kishte ndikuar që të fillonin të relaksonin raportet këto dy vende.

Në pjesën e katërt të këtij kreu një fokus të veçantë i jepet rënies së Aleksandër Rankoviçit, 1966, si një mundësi për hapje ndaj Shqipërisë, pra trajtohen arsyet e dhunës së përdorur nga Aleksandër Rankoviçiqi ndaj shqiptarëve, shkaqet që quan në rënien e tij. Pasojat politike që barti shteti jugosllav pas rënies së A. Rankoviçit. Ndikimi që pati rënia e tij në çështjen shqiptare etj..

Pjesën e pestë dhe të fundit të këtij kapitulli bëhet një trajtim qëndrimit të Shqipërisë ndaj lëvizjes politike në Kosovë në vitet 1945-1968. Pra se sa kishte ndikim shteti shqiptar në grupet ilegale të asaj kohe në Kosovë, sa arriti shteti shqiptar t'i ndihmojë në emancipimin arsimor, kulturor dhe kombëtar shqiptarët në ish-Jugosllavi gjatë kësaj periudhe etj.. Pra në të gjithë kreun e parë trajtohen ato ngjarje që kanë pasur një lidhshmëri ose që kanë ndikim në ngjarjet e mëvonshme të viteve 1974-1989. Edhe pse ne kemi pasur për studim periudhën 1974-1989, nuk do kishim mundur të interpretonim ngjarjet që kanë karakterizuar periudhën në fjalë si duhet pa u kthyer në aspektin retrospektiv më thellë në histori.

KREU II Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1970-1981 trajton përpjekjet e kosovarëve për të drejtat e tyre në kuadër të shtetit jugosllav. Edhe pse në shikim të parë duket një periudhë e shkurtër kohore, është mjaft e ngjeshur me shumë ngjarje të rëndësisë së veçantë. Në këtë kuadër një trajtim i veçantë i jepet Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974. Faktorët që quan në ndryshimet kushtetuese, të drejtat e shqiptarëve të fituara me Kushtetutën 1974 në kuadër të shtetit jugosllav. Pozicioni i Krahinës Autonome të Kosovës në aspektin politik, ekonomik, juridik, ushtarak sipas Kushtetutës 1974. Trajtohet edhe reagimi i qarqeve nacionaliste serbe

ndaj të drejtave të shqiptarëve të fituara me Kushtetutën e vitit 1974. Impakti i ndryshimeve kushtetuese në zhvillimet e mëvonshme politike në ish-Jugosllavi.

Një hapësirë bukur të madhe, në pjesën e dytë të këtij kapitull, iu jepet këmbimeve kulturore, arsimore dhe shkencore midis Shqipërisë dhe Kosovës, për shkak të rëndësisë së madhe dhe ndikimit të tyre në ngritjen kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Në këtë punim shkencor identifikohen dhe interpretohen të gjitha projekt-protokollet e bashkëpunimit kulturor dhe arsimor midis Shqipërisë dhe Kosovës. Po ashtu trajtohet interesimi dhe masat e ndërmarra nga ana e shtetit shqiptar për t'i ndihmuar shqiptarët në ish-Jugosllavi. Pra, krejt kjo vjen duke u dëshmuar me nënshkrimet e memorandumeve të bashkëpunimeve midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës, nënshkrimi midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës për bashkëpunim në shumë fusha shkencore, nënshkrimi i shumë bashkëpunimeve tjera midis institucioneve kulturore, arsimore, sportive midis dy vendeve etj..

Këto bashkëpunime midis dy vendeve që prezantohen në këtë punim shkencor, trajtohen në detaje, duke trajtuar me kujdes të veçantë të gjitha memorandumet e bashkëpunimit në fushën e kulturës, arsimit, dhe shkencës midis Shqipërisë dhe Kosovës (në kuadër të shtetit jugosllav). Pra këmbimet kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë trajtohen kryekëput duke u mbështetur në dokumente autentike arkivore të proveniencës shqiptare. Duke filluar që nga viti 1970-71, deri në fillim të vitit 1980-1981, kur edhe ndërprehet ky bashkëpunim midis dy vendeve për shkak të shpërthimit të demonstratave studentore. Për më tepër këto këmbime trajtohen në mënyrë shumëdimensionale, për faktin e rëndësisë dhe ndikimit që kanë pasur në ngritjen e çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi.

KREU III *Demonstratat e vitit 1981 dhe ndikimi i tyre në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave - Për të pasur sa më të lehtë trajtimin dhe për të pasur rezultate sa më të mira shkencore, ne i kemi ndarë në disa nënkapituj. Pjesa e parë e këtij kreu trajton ndikimin e vdekjes së Titos në politikën e brendshme të Jugosllavisë. Më pastaj një hapësirë e madhe i jepet shpërthimit të demonstratave studentore 1981 si dhe qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj këtyre demonstratave. Trajtohen shkaqet që quan në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981, ndikimin e tyre në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare, mekanizmat e përdorura nga*

pushteti jugosllav për neutralizimin e këtyre demonstratave. Po ashtu trajtohet edhe ndikimi që kishin demonstratat studentore në shfaqjen e nacionalizmit shqiptar në Kosovë. Paraqesim interesimin e palës shqiptare për demonstratat studentore, përpjekjet e shtetit shqiptar për të argumentuar në arenën ndërkombëtare se nuk janë të implikuar në këto demonstrata. Gjithashtu paraqitet edhe jehona e këtyre demonstratave në arenën ndërkombëtare.

Në ndarjen e dytë të këtij kreu trajtohen marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave para vdekjes së Enver Hoxhës dhe pas vdekjes së tij. Është marrë në shqyrtim në këtë punim burgosja dhe dënimet dhe izolimi (metodë e papërdorur më parë) i shumë intelektualëve të Kosovës. Analizohet shfaqja e agresivitetit të nacionalizmit serb në Kosovë, metodat politike që kishte përdorur ky nacionalizëm deri në arritjet e qëllimi të tyre.

Një hapësirë të madhe në pjesën e fundi të këtij kreu i jepet Grevës së Minatorëve dhe suprimimit të Autonomisë së Kosovës dhe qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj këtij akti të dhunshëm të ndërmarrë nga shteti jugosllav më 1989. Pra shkaqet që quan në shpërthimin e Grevës së Minatorëve, ndikim i kësaj greve në sensibilizimin e çështjes shqiptare brenda arealit shqiptar dhe në arenën ndërkombëtare. Pastaj arsyet që shtyn shtetin jugosllav në suprimimin e Autonomisë së Kosovës, pasojat e këtij akti në aspektin politik, ekonomik në Kosovës.

Në fund të këtyre krerëve kemi hartuar një përfundim ku tentojmë të sjellim në mënyrë të përmbledhur një tablo të përgjithshme të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, me Kosovën në qendër.

Në fund të punimit kemi vendosur bibliografinë e cila është e përbërë nga burime arkivore të pabotuara dhe të botuara, literatura të autorëve vendorë dhe të huaj, revista shkencore, ditar të personaliteteve që kanë qenë protagonistë gjatë asaj periudhe që ne kemi marrë në shqyrtim, shtypin e kohës si dhe burime të përzgjedhura nga interneti.

KREU I PARË

I. GJENDJA POLITIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE NË KOSOVË, 1945-1974

1.1 Kosova statusi i saj politik dhe juridik-kushtetues, 1945-1948

Problemet politike të Kosovës, që do ta përcjellin deri në çlirimin përfundimtar, zanafillën e kanë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Historiografia botërore është e mbushur me mjaft vuajtje të popujve të ndryshëm gjatë historisë. Por për shumë popuj pas Luftës së Dytë Botërore filloi një epokë e re e zhvillimit, në të gjitha sferat e jetës, sidomos në Evropë. Për popullin shqiptar, si në Shqipëri e sidomos në ish-Jugosllavi, konkretisht në Kosovë, vazhdoi e njëjta gjendje e vështirë politike dhe socio-ekonomike. Prandaj për të arritur në konkluzione sa më të qarta për periudhën 1974-1989, ne do të paraqesim në mënyrë telegrafike gjendjen e Kosovës gjatë LDB-së.

Si të gjitha vendet e Ballkanit edhe Kosovën, e përfshiu Lufta e Dytë Botërore. Kosova gjatë LDB-së u nda në tri zona interesi, në mes të gjermanëve, italianëve dhe bullgarëve. Qarku i Mitrovicës mbeti nën kontrollin e drejtpërdrejtë gjerman, për shkak të rëndësisë së minierave të Trepçës.¹ Është interesant se pushtimi italian i Kosovës për shqiptarët ishte një frymëmarrje e thellë. Kjo për arsye se italianët lejuan hapjen e shkollave në gjuhën shqipe; lejimin e përdorimit të flamurit kombëtar; si dhe shpëtuan nga një dhunë sistematike nga serbët. Këto masa ishin tërheqëse për shqiptarët dhe fituan mbështetjen e kosovarëve.² Pak para fillimit të Luftës së

¹ Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve, një histori e Kosovës*, Tiranë, 2004, fq. 155.

² Po aty, fq.156.

Dytë Botërore në territorin e Kosovës ishin të dislokuar afërsisht 170.000 ushtarë.³ Kjo dëshmon se serbët edhe pse ishin para një rreziku të madh, ata edhe në atë situatë të krijuar kishin frikë për humbjen e Kosovës. Shqiptarët edhe më shumë filluan të alarmohen për faktin se edhe pretenduesit e pushtetit në Jugosllavi, komunistët në krye me Titon kishin krijuar një afërsi me Rusinë edhe pse rusët kishin maturi në raport me Titon.⁴ Çerçilli kishte pranë Josip Broz Titos* një mision ushtarak të kryesuar nga gjeneral brigade Ficroj Meklin, i cili këshilloi kryeministrin britanik, që t'ua jepte të gjithë përkrahjen partizanëve.⁵ Në tetor të vitit 1944 Titoja viziton Moskën, kjo merret edhe si një forcim i marrëdhënieve të tij me Rusinë.⁶ Kështu Titoja krijoi marrëdhënie shumë të mira me Stalinin dhe Çerçillin. Për të shuar kureshtjen se si mundi Titoja të afrohej edhe me Çerçillin, për këtë dëshmon më së miri një perifrazimi i hershëm i Çerçillit: “Ajo që na intereson më shumë neve, është kush prej tyre po u sjell më shumë dëme gjermanëve,” e kriteri i pasluftës ishte kush prej tyre po u sjell më shumë dëme sovjetikëve.⁷

Për shqiptarët, kësaj radhe si në shumicën e rasteve gjatë historisë, rrethanat në politikën ndërkombëtare nuk ishin duke u zhvilluar në favor të tyre. Kjo për faktin se jo vetëm serbet por, të gjitha shtetet sllave edhe satelitët e tyre ishin aleat të koalicionit antifashist (amerikan, anglez, francez).⁸ Në kohën e ekspansionit të forcave italiane dhe gjermane në Kosovë dhe vise tjera shqiptare, ushtria serbo-jugosllave, në vend që të angazhohet në mbrojtjen e vendit nga pushtuesit, e drejtoi forcën e saj goditëse mbi shqiptarët dhe vazhdoi politikën e gjenocidit ndaj tyre. Si në Mitrovicë, Pejë, Vushtrri, Gjakovë, Prizren etj.. Pastaj në fshatrat Krajë afër kufirit me Shqipërinë po ashtu edhe në fshatrat Bec, Ujz, Gërkoc, Gjinoc etj..⁹

³Malcom, Noel, vep. e cit., fq. 301.

⁴Jean-Baptiste DUROSELLE, Andre KASPI, *Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare*, Nga viti 1919 deri më 1945, Vëllimi I, fq. 455-456.

* Josip Broz Tito, I lindur më 7 maj 1892 prej prindërve të përzier, kroat dhe slloven, në një krahinë të Jugosllavisë që asokohe i takonte Austrohungarisë. Titoja u radikalizua në Rusi dhe u caktua anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë nga Kominterni. Ai kishte për të qenë udhëheqësi më i suksesshëm i rezistencës gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më pas kryeministër në Jugosllavinë e mëkëmbur në vitin 1945. Në kohën që u shpall president i përjetshëm i vendit në vitin 1974, Titoja ishte shndërruar në një personalitet botëror. Pra ka qenë udhëheqës i pa kontestuar që nga përfundimi i LDB-së deri më 1981. Shih më gjerësisht John V.A.Fine, CRasti i jashtëzakonshëm i Jospi Broz Titos, Tiranë, 2010.

⁵ Georges Castellan, *Historia e Ballkanit*, Tiranë, fq. 477. Që nga viti 1943 shërbimi Special Operation Executive SOE(Ky shërbim ndryshe është quajtur edhe ushtria e fshehtë e Çurçilli)britanik kishte dërguar oficer pranë partizanëve shqiptarë, shih më gjerësisht Regnald Hebbert, vep. e cit., fq. 86-106.

⁶Po aty, fq. 456.

⁷ Maria Todorova, *Ballkani imagjinar, Ballkani si altar ego I Europës*,Tiranë, 2006, fq. 204.

⁸Azem Hajdini-Xani, *Shaban Polluzha (Dëshmi dhe kujtime të kronistit të luftës I*, Rilindja, Prishtinë, 2001, fq.13.

⁹Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Institutit I Historisë,Prishtinë, 1997, fq. 17-18.

Kosova edhe pas Luftës së Dytë Botërore mbeti “pjesë përbërëse” e Serbisë.¹⁰ Skepticizmi dhe frika gjatë okupimit italian dhe gjerman se mbas largimit të këtyre ushtrive, Serbia do të mësyj përsëri Kosovën duke përdorur metoda dhe mjete të dhunës shtetërore, u dëshmuua të jetë njëqind për qind e vërtetë.¹¹

Kosovës iu ndërpre kontinuiteti i ngjarjeve që çonin drejt zgjidhjes së drejtë të çështjes së shqiptarëve në ish-Jugosllavi, konkretisht në Kosovë. Presione politike ndaj shqiptarëve të Kosovës kishte akoma pa përfunduar LDB-ja, pra kishin filluar menjëherë pas Rezolutës së Konferencës së Bujanit,¹² krejt ky presion politik nga ana e komunistëve jugosllavë kishte vetëm një qëllim, krijimin e rrethanave politike, në të cilat kjo rezolutë do të diskualifikohej dhe do të krijoheshin kushtet e përshtatshme për aneksimin e dhunshëm të Kosovës nën sovranitetin e Jugosllavisë.¹³

Demagogjia premtuese e komunistëve jugosllavë për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës, është kuptuar shpejt se ishte një farsë.¹⁴ Një premtim të tillë ia kishte bërë Titoja edhe vet Enver Hoxhës, kur ky i fundit kishte kërkuar nga ai që populli shqiptar i Kosovës të vetëvendoste për fatin e vet. Titoja ishte përgjigjur: “*Jam dakord me pikëpamjet tua, por tash për tash nuk mund ta bëjmë këtë gjë, sepse serbët nuk do ta kuptojnë*”.¹⁵ Ky ishte një mashtrim tipik, duke shfrytëzuar më shumë naivitetin politik të Hoxhës, ose edhe pa përvojën e tij politike.¹⁶

Titoja një gjë të tillë e bënte me një prapavijë largpamëse. Duke i lënë Kosovën dhe Vojvodinën Serbisë, Titoja e dinte në fakt se i kishte instaluar Serbisë minë me sahat (sidomos Kosovën) të cilat Titoja mund ta përdorte kundër Serbisë sa herë që kjo e fundit të ngre krye kundër kroato-slllovenëve apo kundër pushtetit personal të Titos.¹⁷ Prandaj partizanët nisën një fushatë ushtarake në shkallë të gjerë në Kosovë me qëllim fuqizimin e pushtetit të tyre dhe për të larë hesapet me elementet “*destabilizuese*”.¹⁸

¹⁰ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001, fq. 329.

¹¹ Ibrahim Berisha, *Vdekja e Kolonisë*, Prishtinë, 2016, fq. 95.

¹² Konferenca e Bujanit është mbajtur 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, fshatin Bujan të Shqipërisë.

¹³ Arsim Bajrami, *Historia e Konstitucionalizmit shqiptar 1912-2012*, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2014, fq. 181.

¹⁴ Historia e Popullit Shqiptar IV, shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990, Botimet Toena, Tiranë, 2008, fq. 339.

¹⁵ Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vetizolimit rasti i Shqipërisë 1961-1989*, Tiranë, 2005, fq. 597.

¹⁶ Ekziston edhe mendim tjetër se Enver Hoxha jo që nuk e ka kuptuar lojën e Titos, por në atë periudhë ishte mjaft i varur nga jugosllavët.

¹⁷ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare*, vep e cit., fq. 151.

¹⁸ M. Vickers, vep. cit., fq. 178.

Propaganda e komunistëve jugosllavë shkoi aq larg, sa që shqiptarët e Kosovës i akuzuan si bashkëpunëtorë të fashistëve italianë dhe nazistëve gjermanë, për pushtimin e Jugosllavisë.¹⁹ U ndërmorën të gjitha masat nga shteti jugosllav (meqenëse akoma nuk ishte konsoliduar si shtet) që të gjitha pakënaqësitë, apo revoltat që u shfaqen te shqiptarët, të shtypen në mënyrë sistematike, deri në arritje të qëllimit.

Veprimet ushtarake dhe paraushtarake të komunistëve jugosllavë ishin jashtëzakonisht të ashpra, sa që popullata shqiptare ishte detyruar që t'u shpëtonin dhunës dhe persekutimeve, i boshatisen shumë fshatra dhe vendbanime ku dolën në male. Por edhe përkundër gjithë këtyre shtypjeve dhe dhunës së përdorur nga komunistët jugosllavë, popullsia shqiptare shpërtheu në revolta të fuqishme në shumë qytete të Kosovës, si në: Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe në Drenicë.²⁰ Prandaj për këtë arsye komunistët jugosllavë më 8 shkurt, deri më 5 korrik 1945 vendosën administratën ushtarake në Kosovë, kuptohet e gjithë kjo është bërë me urdhër të Titos.²¹

Një fakt i pamohueshëm është edhe ajo se për dallim nga viset tjera të Jugosllavisë, lëvizja komuniste në Kosovë nuk gëzonte përkrahje të madhe, posaçërisht nga popullsia shqiptare.²²

Sikur të mos kishte mjaftuar kjo shtypje dhe kjo dhunë e pushtetit jugosllav ndaj popullit shqiptar të Kosovës, por shteti jugosllav ndërmori edhe një sipërmarrje jashtëzakonisht të rëndë dhe të parën pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë. Pra komunistët jugosllavë e orkestruan masakrën e Tivarit. Arsyeja pse është organizuar kjo masakër e përmasave të tilla nga shteti jugosllav, është e thjeshtë, vetëm që të hegjemonizohej Kosova dhe të dominonte nacionaliteti serb dhe malazez.

Nëse kthehemi pak më thellë në histori, do të vërehet se të gjitha pushtetet jugosllave u përpoqën që çështjen e Kosovës ta zgjidhnin me shpërnguljen masive të shqiptarëve dhe

¹⁹ Димитрије Богдановић, *КЊИГА О КОСОВУ, СРПСКА АКАДЕМИЈА НАУКА И УМЕТНОСТИ ПОСЕБНА ИЗДАЊА*, Уредник: академик АНТОНИЈЕ ИСАКОВИЋ, БЕОГРАД, 1986, fq. 157. Marrë në http://novi.uciteljneznalica.org/PDF/arhiva%20autora/991_Bogdanovi%C4%87,%20Dimitrije%20-%20Knjiga%20o%20Kosovu.pdf me 16.10.2018.

²⁰ По ату, fq. 341.

²¹ По ату.

²² Abetarja e Pushtetit, *Libërth mbi politiken, njerëzit dhe partitë politike në Kosovë*, dhjetor, 2011, fq. 12. Marrë në : <http://iksweb.org/wp-content/uploads/2011/12/Abetarja-e-Pushtetit-Liberth-mbi-Politiken-Njerezit-dhe-Pushtetin-ne-Kosove.pdf>. 18.12.2018.

kolonizimin me serbë.²³ Është rasti i vetëm mbas Luftës së Dytë Botërore, që një aparat shtetëror të ndërmerr masakra të tilla, ndaj një krahine dhe popullate që e konsideronte të sajën, siç ishte maskara e Tivarit.²⁴

Politika jugosllave në krye me Titon, duke e ditur se opinioni ndërkombëtar mund të shfaqte ndonjë pakënaqësi, rreth këtij aneksimi si dhe opinioni i brendshëm duhej të mbahej nën kontroll, ndërmorën veprimin për të kamufluar dhe për ta legjitimuar okupimin e sërishëm të Kosovës duke thirrë kuvendin e famshëm në Prizren, ku u vendos bashkimi i Kosovës me Serbinë.

Kuvendi i Prizrenit nuk ishte as i pari, as i fundit, i cili mori vendimin që Kosova të aneksohej nga Serbia - Jugosllavia. Kuvendi i Prizrenit, që u mbajt më 10 korrik 1945, ka ardhur pas disa takimeve të nivelit të lartë të KQ-së të PKJ-së. Kështu në shkurt të vitit 1945 nga KQ-ja e PKJ-së u organizua një mbledhje, ku veç debateve tjera u fol edhe për Kosovën dhe statusin e saj të ardhshëm. Nga kjo doli si përfundim se “*Kosova dhe Metohija*” më mirë është t’i bashkohej Shqipërisë, e Shqipëria të hyjë në federatën jugosllave. Por mbasi rrethanat ndërkombëtare nuk ishin të favorshme për një veprim të tillë politik, zgjidhja më e mirë do të ishte “*Kosova dhe Metohija*” t’i bashkohej Serbisë.²⁵ Kjo dëshmon më shumë se çdo gjë se çfarë politike të sofistikuar kanë përdorur komunistët jugosllavë.

Në Kuvendin Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, që u mbajt më 7-9 prill 1945 në Beograd, Kosovën e përfaqëson Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha, të cilët sipas dokumenteve të këtij kuvendi, del se këta kanë shprehur “*dëshirën*” e popullit shqiptar të Kosovës, se kinse dëshirojnë që “*Kosova të jetë nën Serbinë federative*”.²⁶ Ajo që dihet mirëfilli ishte se në mënyrë më arbitrare të mundshme Kosova iu bashkua Serbisë.

Shteti jugosllav e kryen edhe një formalitet në një ambient frike, më 10 korrik 1945, në Prizren mbahet mbledhja e Këshillit Popullor të Kosovës. Takimi i të zgjedhurve nga udhëheqësit ushtarakë serbë, e jo të zgjedhur nga populli, ku morën pjesë 137 delegatë, ku vetëm 32 prej tyre ishin shqiptarë, nga kjo përbërja është nxjerrë rezoluta me të cilën “*Kosova i*

²³ Azem Hajdin – Xani, *Masakra e Tivarit*, Prishtinë, 1998, fq. 17; Hivzi Islami, *STUDIME DEMOGRAFIKE 100 VJET TË ZHVILLIMIT DEMOGRAFIK TË KOSOVËS*, Botimi i dytë i plotësuar, Redaktor: Ekrem Murtezai, AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS, Prishtinë, 2008, fq. 302.

²⁴ Më 31.03.1945, 4310 shqiptarë u masakruan nga serbët dhe malazezët, në Tivar. Djem dhe burra të përzgjedhur të gjitha viseve shqiptare nën Jugosllavinë. Prandaj është konsideruar më të drejt si varri më i madh shqiptar dhe varri më i madhi Ballkanit. Shih më gjerësisht Azem Hajdinin, *Vep e cit.*

²⁵ Sabile Keçmezi-Basha, *Kosova 1945-1990, vështrim historik-politik*, Prishtinë, 2017, fq. 49.

²⁶ Po aty.

aneksohet Serbisë federale në kuadër të Jugosllavisë".²⁷ Pra më këtë akt shteti jugosllav nuk përfilli parimin e ventëvendosjes, siç parashihej në Kartën e Atlantikut. Megjithatë, një rezolutë e arritur nën administrimin ushtarak nuk paraqet vendim demokratik, ku popullsia e krahinës së Kosovës njëzëri shpreh dëshirën për një bashkim me Serbinë në rrafshin federal".²⁸ Por ajo që është mjaft interesante dhe që nuk përputhet aspak me realitetin, ishte fakti se në rezolutën e dalë nga Kuvendi i Prizrenit, për bashkimin e Kosovës me Serbinë, midis tjerash thuhet se, popullata shqiptare gëzon "barazinë e vërtetë".²⁹

Kjo rezolutë thekson krejt të kundërtën çfarë shkruan në Rezolutën e Bujanit.³⁰ Dihet botërisht se çka është vendosur në këtë Kuvend, pra Kosova bëhet "de jure" pjesë përbërëse e Serbisë federale. Një e veçantë tjetër prej shumë të veçantave që e karakterizon këtë kuvend është edhe fakti se është mbajtur dy ditë pas heqjes së administratës ushtarake, që ishte vendosur në Kosovë.³¹ Kjo dëshmon se të gjitha veprimet politike dhe ushtarake të shtetit jugosllav në Kosovë kishin një kontinuitet.

Pra Kosova në periudhat e para të zhvillimit kushtetues të ish-Jugosllavisë është përcaktuar në tri akte kryesore: Kushtetutës së RFPJ-së, 31 janar 1946; Kushtetutës së RP-së të Serbisë, të janarit të vitit 1947 dhe statutin e KAKM-së të 23 majit 1948.³²

Kosova me kushtetutën e parë të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, miratuar më 31 janar 1946, u definua si njësi autonome territoriale-administrative brenda Serbisë. Kosova nuk kishte as statusin e krahinës, të cilën e kishte Vojvodina. Kosova në fillimet e veta pas LDB-së kur kishte filluar faza e parë e zhvillimit kushtetues të Kosovës (1946-1953) manifestoheshin dy rrafsh të diskriminimit kushtetues- juridik të saj. Së pari, në raport me pozitën kushtetuese- juridike të njërive federale dhe së dyti, në raport me pozitën kushtetuese-juridike të Krahinës Autonome të Vojvodinës, së cilës i garantohej një status më i

²⁷ Ibrahim Berisha, vep. e cit., fq. 96. Krahaso Srbija i Albanci, Pregled politike Srbije prema Albancima od 1944 do 1989 knjiga treca, casopis kritiko znanosti, Maribor, 1989. Marrë në: <https://www.dlib.si/stream/URN:NBN:SI:DOC-PIZ7X1QI/25d80e6e-77c5-459d-9554-8d883b9a89f9/PDF>. Shih dhe Sabile Keçmezi, Kosova 1948-1990, vep. e cit., fq. 50.

²⁸ Arben Hajrullahu, *Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritetit në BE*, përkthyes nga gjermanishtja në shqip: Rexhep Bajrami, botuar në Prishtinë, 2015, fq. 58-59.

²⁹ Dushan Janjiq, *Identiteti kombëtarë, lëvizja dhe nacionalizmi i serbëve dhe shqiptarëve, Konflikt apo dialog, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe dhe integriteti i Ballkanit*, Pejë, 1995, fq. 130.

³⁰ Arben Hajrullahu, vep. e cit., fq. 58-59.

³¹ Historia e Popullit Shqiptar IV, vep. e cit., fq. 342.

³² Arsim Bajrami, vep. e cit, fq. 184.

avancuar sesa Kosovës.³³ Kjo e ashtuquajtur “*zgjdhje shqiptarovogël*” mori “*karakterin zyrtar*” në janar të vitit 1945,³⁴ kur qeveritë komuniste jugosllave dhe shqiptare lidhën një marrëveshje për riintegrimin e Kosovës në federatën jugosllave. Kësisoj shqiptarët, në këtë rast shqiptarët e Kosovës, u detyruan të mbeteshin nën Jugosllavi. Publicisti Carl G. STRÖHM konstaton me të drejtë se: “shqiptarë të shumtë të Kosovës e shikonin sundimin jugosllav komunist si rivendosje të hegjemonisë serbe”³⁵

Sa i përket qëndrimit të shtetit shqiptar rreth kësaj situatë politike, apo më mirë të thuhet, qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj aneksimit të Kosovës, duhet shikuar nga prizmi i rrethanave politike të kohës, si dhe gjendjen, politike, ekonomike dhe sociale që mbretëronte në Shqipëri, pas Luftës së Dytë Botërore. Duke parë gjendjen e brendshme, por edhe të jashtme (qëndrimin e aleatëve ndaj Shqipërisë) të shtetit shqiptar, shteti jugosllav i shfrytëzoi mjaft mirë këto rrethana, në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, pra jugosllavët e bënë të qartë se nuk do të lejojnë që Kosova të mbetet e bashkuar me shtetin amë.³⁶

Shqipëria duke parë pafuqinë e vet dhe mospërkrahjen ndërkombëtare, ajo nuk e ngriti fare çështjen e Kosovës në konferencat ndërkombëtare, as në kancelaritë e Fuqive të Mëdha.³⁷ Kjo është një çështje mjaft e diskutuar në historiografinë shqiptare, se a ka patur mundësi shteti shqiptar të bëjë më shumë në raport me shqiptarët në ish-Jugosllavi, konkretisht me Kosovën, pas LDB-së.

Ka nga ata studiues që këtë qëndrim të shtetit shqiptar ndaj Jugosllavisë së Titos në raport me Kosovën ia atribuojnë ngarkesës ideologjike që kishte Enver Hoxha, se zgjidhjen e çështjes së Kosovës e ka parë vetëm përmes ideologjisë marksiste-leniniste, si dhe ndikimit të dy ideologëve komunistë nga Jugosllavia, Dushan Mugoshës dhe Miladin Popoviqit. Këto nuk janë aq të argumentuara, sa për t’u pranuar si një e vërtetë e pakontestueshme. Mund të jetë deri në njëfarë mase ajo se Enver Hoxha e ka përdorur Kosovën për qëllime strategjike, sepse ai ka qenë i vetëdijshëm se Shqipëria pas LDB-së ishte skajshmërisht e shkatërruar, dhe kishte nevojë imediate për ndihma në të gjitha sferat, dhe një ndihmë të tillë mund t’i ofronte vetëm Jugosllavia. Dhe ndoshta për këtë arsye E. Hoxha e ka shikuar problemin e Kosovës në mes gishtërinjve të dorës. Dhe krejt kjo mund të bazohet në reagimet e Hoxhës pas prishjes së

³³ <http://www.esat.stavileci.com/site/index.php/artikujt/194-evoluimi-kushtetues-i-kosoves-ne-periudhen-1946-1990>, marrë më 17.09.2018.

³⁴ ³⁴ Arben Hajrullahu, vep. e cit., fq. 59.

³⁵ Po aty.

³⁶ Historia e Popullit Shqiptar IV, Vep e cit., fq. 245.

³⁷ Po aty.

marrëdhënieve me jugosllavët në vitin 1949. Por edhe më vonë sa herë që shteti shqiptar kishte afërsi me shtetin jugosllav çështja e Kosovës ishte e heshtur, kurse sa herë që ishin marrëdhëniet e acaruar në mes të këtyre dy shteteve çështja e Kosovës ishte mjaft aktuale.

Por edhe përkundër të gjitha këtyre të lartcekurave, duke u bazuar në studimet që janë bërë për këtë periudhë edhe nga prizmi i sotëm, shteti shqiptar në ato rrethana nuk ka pasur mundësi të bëjë më tepër për Kosovën pas Luftës së Dytë Botërore. Çdoherë, për të gjitha këto zhvillime politike në mes të shtetit shqiptar dhe atij jugosllav për Kosovën në periudhën në fjalë, duhet pasur parasysh rrethanat e politikës ndërkombëtare, sidomos fuqinë e BRSS-së, e cila kishte një diktat të pakontestuar në politikën globale, si dhe fuqinë e Jugosllavisë në të gjitha pikëpamjet, por sidomos përkrahjen që kishte kjo e fundit në arenën ndërkombëtare.

1.2 “Aksioni i tepricave” dhe “aksioni i armëve” si mjete të politikës jugosllave ndaj Kosovës.

Të gjitha veprimet politike dhe ushtarake të Jugosllavisë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore kishin një shtytje nga elitat intelektuale serbe, në krye me Vaso Çubrilloviqin. Kjo dëshmohet në fjalimin e tij të paraqitur para udhëheqjes më të lartë LANÇI-së së Jugosllavisë, më 3 nëntor 1944. Pra Çubrilloviqi, midis shumë çështjeve tjera për të ardhmen e Jugosllavisë, shtroi edhe çështjen e pakicave të saj.³⁸ Sipas Çubrilloviqit serbët që nga krijimi i Jugosllavisë me 1918 mbajtën një qëndrim shumë zemërgjerë ndaj pakicave (shqiptarët, hungarezët, gjermanët, rumunët etj.), disa nga këto pakica për shkak të kaluarës nuk kanë merituar një qëndrim të tillë.³⁹ Përveç qëndrimeve jobesnike, ka edhe shkaqe tjera të thella shtetërore, të cilat na detyrojnë ta shfrytëzojmë këtë luftë (LDB) dhe ta zgjidhim çështjen e pakicave dhe

³⁸ E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Akademia e Shkencave e RPS-së të Shqipërisë, Tiranë, 1990, fq. 546.

³⁹ Po aty.

shpërnguljen e tyre. Sipas Çubrilloviçit⁴⁰ Jugosllavia Federative Demokratike mund të ketë paqe dhe një zhvillim të sigurt vetëm nëse etnikisht është e pastër dhe zgjidhja e pakicave të bëhet njëherë e përgjithmonë.⁴¹ Çubrilloviçi për këtë në vitin 1944 kishte hartuar edhe një program i cili ishte emërtuar “*Problemi i Pakicave në Jugosllavinë e Re*”.⁴² Në hyrje të këtij programi është bërë një vështrim historik, pra pozita gjeopolitike e territoreve jugosllave në kryqëzimin e qytetërimeve të lindjes dhe perëndimit, si dhe rëndësia e pozitës jugosllave në gjeopolitikën e kohës.⁴³ Ajo që vlen të theksohet, nga ky program nacionalist, është fakti se ana historike e këtij dokumenti përfundon me një trajtim të pakicave në Jugosllavi. “*Tri grupet kryesore të pakicave në jugosllavi, vet kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre qytetare. Duke dalë hapur dhe në mënyrë armiqësore kundër shtetit në të cilin jetojnë. Prandaj kanë humbur të drejtën të vazhdojnë të jenë qytetarë tanë. Ata duhet të largohen nga shteti ynë, sepse e meritojnë këtë*”.⁴⁴

Në vazhdim të këtij programi jepen edhe arsyet se pse duhet qeruar hesapet me pakicat. Pra fund e krye ky dokument është nacionalist, gjenocidial dhe kulturocid. Kishte edhe programe tjera kundërthënëse për çështjen e Kosovës, si ai i kryeçetnikut Drazha Mihajloviçit, i cili në programin e tij të skajshëm nacionalist, theksonte se shqiptarët duhet të shfarosen, e trojet e tyre të gllabërohen.⁴⁵ Pra kjo dëshmon se serbët pa marrë parasysh rrethanat politike si brenda ashtu edhe jashtë asnjëherë nuk kanë dalë jashtë kornizave politike të Ilia Garashaninit.⁴⁶

Pra është e pakontestueshme se politika serbe në raport me shqiptarët në përgjithësi dhe me Kosovën në veçanti, gjithmonë iu kanë përmbytur me përpikëri “Naçertanjes” së Ilia Garashaninit. Ky memorandum ka pasur dhe ka rëndësi të madhe për politikën serbe. Në historiografinë serbe vlerësohet se “Naçertanija” e Garashaninit ishte shkruar nën ndikimin e programit politik të Adam Çartoriskit (ministër i jashtëm i Ruisisë, në vitet 1803-1806) me titull

⁴⁰ Vaso Çubrilloviç, ishte historian, politikan dhe akademik jugosllav, i dekoruar me dekoratën e federatës jugosllave për praktikimin e Doktrinës së shenjtë serbe. Çubrilloviçi ishte njëri nga studiuesit jugosllav që kanë kryer studime për zhdukjen e shqiptarëve. Studimi i tij njihet me emërtimin Dëbimi i shqiptarëve (në origjinal depërtimi i arnautëve)

⁴¹E vërteta mbi Kosovën ... vep. e cit., fq. 547.

⁴² Shaban Braha, *Gjenocidi Serbomadh dhe Qëndresa Shqiptare 1844-1990*, Tiranë, 1992, fq. 425.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty, fq. 426.

⁴⁵ Shefqet Dinaj, *Statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës në vitet 1945-1966*, Tiranë, 2018, Akademia e Studimeve Albanologjike (tezë e doktoraturës e pa botuar), fq. 24. Marrë në : <https://drive.google.com/file/d/1P46ODu8Krc1QxN8zKTiNihHFFKADMdmk/view>, me 10.07.2018.

⁴⁶ Në këtë referat të mbajtur para udhëheqjes së LANÇI-së, Çubrilloviçi paraqet jo vetëm si ide politike problemin e pakicave por edhe planin konkret për ekzekutimin e kësaj politike shoveniste.

: “Këshillat sipas të cilave Serbia duhet udhërrëfyer”, të hartuar në janar të vitit 1843.⁴⁷ Aty Çartoriskit jepte këshilla të hollësishme mbi mënyrën se si Serbia mund të përgatiste bashkimin e “krahinave tjera serbe”, që kishin mbetur nën sundimin turk. Në mesin e shumë udhëzimeve tjera, jepej edhe ajo se Serbia duhet në vazhdimësi të tentonte të zgjerohej.⁴⁸ Duke pasur parasysh se një program i tillë politik duhet që të ketë edhe mekanizma të zbatimit gjatë viteve të 40-ta dhe 50-ta të shekullit XIX, Serbia vëmendjen kryesore i kishte kushtuar propagandës nacionale në ato zona ku ishin interes i shtetit serb. Kjo propagandë zhvillohej nëpërmjet organizatave sekrete prej të cilave Ilija Garashanini, si ministër i Punëve të Brendshme, krijoi një sistem të madh informativ-propagandistik.⁴⁹

Nga kjo del se programi politik serb i Garashaninit nuk ishte një dokument dosido, por një strategji afatgjate e hartuar nga qarqet ruse. Krejt këtë e theksuam që të qartësohet politika serbe si para Luftës së Dytë po ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore, e cila me disa modifikime të rastit ishte e njëjtë në raport me Kosovën. Madje edhe Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë kishte si bazë “Naçartanijan” e Garashaninit.

Në Kosovë ka vazhduar politika e ashpër jugosllave edhe pas LDB-së, ku shqiptarët e Kosovës janë përballë me disa reprezalje shumë të ashpra nga aparati shtetëror jugosllav, si me "aksionin e *tepricave*" dhe "aksionin e armëve", rikolonizimi dhe shpërngulja. Kolonizimi që nga qarqet politike serbe kamuflohej si reformë agrare ka pasur për qëllim socialo-politik dhe karakter eksploatues.⁵⁰

Që në muajt e parë të ripushtimit, organet shtetërore jugosllave nxorën ligjin mbi konfiskimin e përfitimeve të luftës. Në bazë të këtij ligji, pika e 13 e tij, një numër i madh i familjeve shqiptare iu konfiskua pasuria e tundshme dhe e patundshme.⁵¹ Kjo bëhej me arsyetimin e “*nevojave*” ushtarake që kishte Jugosllavia.⁵² Por, në të vërtetë përdorimi i këtij mekanizmi i quajtur “teprica” kishte për qëllim presionin ndaj shqiptarëve të Kosovës, që të lëshonin tokat e tyre dhe të emigronin për në Turqi. Aksioni i armëve ishte edhe më brutal se aksioni i “tepricave”, represioni i egër përfshiu çdo fshat të Kosovës, ku u keqtrajtuuan mbi 30.000 qytetarë shqiptarë, kurse u vranë ose u detyruan të vetëvriten mbi 100 të tjerë.⁵³

⁴⁷ Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800-1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, fq. 98.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty, fq. 102

⁵⁰ Jusuf Osmani, *Kolonizimi serb i Kosovës*, Prishtinë, 2010, fq. 95.

⁵¹ Mehmet Gjoshaj, *Mbledhja e “tepricave” në Kosovë, formë e plaçkitjes ekonomike dhe shtypjes politike 1946-1952*, Muzeu i Kosovës, Prishtinë, 2009, fq. 25.

⁵² Deli Thaçi, Sedat Sahitaj, *Krisma që pati jehonë*, monografi, Prizren, 2016, fq. 37.

⁵³ Mehmet Gjoshaj, *Aksioni i armëve në Kosovë më 1955-1956*, Muzeu i Kosovës, Prishtinë, 2012, fq. 9.

Qëllimi i vërtetë i aksionit për mbledhjen e armëve në Kosovë nuk ishte për të mbledhur armët në popull, kinse nga frika për ndonjë kryengritje të armatosur, por qëllimi i vetëm ishte krijim i rrethanave të padurueshme për shqiptarët e Kosovës, që të rifillonte procesi i shpërnguljes, të cilin proces e kishte ndërprerë Lufta e Dytë Botërore. Dhe më pastaj të krijohet një disproporcion në favor të popullsisë serbe.⁵⁴

Për të bërë një elaborim më të qartë të procesit të kolonizimit (që është mjaft komplekse) në Kosovë, duhet bërë një digresion kohor. Për arsye se kolonizimi i tokave të shqiptarëve në Kosovë ka filluar që nga viti 1913 dhe ka vazhduar gjatë tërë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë borgjeze, prej vitit 1918 deri në vitin 1941.⁵⁵

Gjatë Luftës së Dytë është ndërprerë kolonizimi, prandaj shumë historianë thonë se Lufta e Dytë Botërore ka qenë një fat për shqiptarët e Kosovës. Për këtë dëshmojnë edhe marrëveshjet ndërmjet SKS-së dhe Turqisë, që nga vitit 1933 e deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Këto marrëveshje ishin kryesisht për shpërnguljen e shqiptarëve të besimit mysliman që nga pala jugosllave konsideroheshin si "turq".⁵⁶ Sipas burimeve turke, marrëveshja ndërmjet Turqisë dhe Jugosllavisë, 1936-1937, parashihte shpërnguljen e 250,000 deri në 350,000 shqiptarëve nga Kosova.⁵⁷ Edhe Titoja fillimisht dëshironte t'i dëbonte disa pjesë të popullsisë shqiptare dhe për këtë qëllim ai aktualizoi planin e paraluftës për një marrëveshje me Turqinë.⁵⁸ Ky krim nuk figuron fare në analet historike evropiane, pra kolonizimi dhe shpërnguljet e popullit shqiptar nuk janë paraqitur fare para opinionit evropian.⁵⁹

Pra Kosova pas LDB-së ka përjetuar përsëri një valë të madhe të rikonizimit dhe shpërnguljes, që nga paslufta e Dytë Botërore e deri në fund të viteve 60-ta janë shpërngulur për në Turqi 283.000 shqiptarë, që i bie 13% popullsisë së atëhershme. ⁶⁰ Kjo shpërngulje kaq masive, nuk kishte ndodhur për asnjë arsye tjetër, por vetëm nga dhuna dhe presionet e ndryshme që kishte ndërmarrë shteti jugosllav.

⁵⁴ Po aty, fq. 8.

⁵⁵ Milovan Obradović, *Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë 1918-1941*, IHP, Prishtinë, 2005, fq. 159.

⁵⁶ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001, fq. 296.

⁵⁷ Jusuf Osmani, *Kolonizimi, Reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941*, dokumente: Shpërngulja, Prishtinë, fq. 398-399.

⁵⁸ Oliver Jens Schmitt, *Kosova historia e shkurtër e një treve qendror ballkanike*, Prishtinë, nëntor 2012, fq. 177.

⁵⁹ Deli Thaçi, Sedat Sahitaj, *Krisma që pati jehonë, monografi*, Prizren, 2016, fq. 11.

⁶⁰ Jusuf Osmani, *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941*, Dokumente: Kolonizimi, Prishtinë, 2016, fq. 114-115.

Edhe pse pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova siç dihet botërisht doli mjaft e shkatërruar në të gjitha segmentet. Në vitin 1945 ndodhi ajo që ishte pritur. Pra, aparati shtetëror jugosllav do të ndërmarrë veprime brutale ndaj elementit shqiptar. Dhe nuk vonoi shumë, një veprim i tillë nga aparati shtetëror jugosllav që në ditët e para të “çlirimit” partizanët filluan me vrasje dhe persekutime. Kryesisht personalitetet që mund të ishin pengesë e pushtuesit. Prandaj “aksioni i tepricave”,⁶¹ "aksioni i armëve", ishin mekanizma shumë të dhunshme dhe kanë lënë shumë pasoja në popullatën shqiptare të Kosovës.

Menjëherë pas ripushtimit të Kosovës nga ushtria serbo-jugosllave kuptohet pas LDB-së fillon edhe sekuestrimi i prodhimeve kryesore bujqësore dhe blegtorale që ishin jetike për banorët. Sipas dëshmitarëve të kohës, kjo bëhej me arsyetimin “*e nevojave*” ushtarake që ka Jugosllavia. Nën parullën “çarmatimin” e shqiptarëve dhe “spastrimin e terrenit nga bandat shqiptare”, formacionet pushtuese partizane serbo-jugosllave, pasi inkuadrohen edhe çetnikët e amnistuar, plaçkisnin çdo gjë që gjenin në shtëpitë shqiptare: veshmbathje, shtrojë e mbulojë, gjëra ushqimore, miell, tëlyen, kripë, pëlhura të pajes së nuseve dhe vajzave shqiptare, qerre, kuaj, shala, llampa, shkrepça, vajguri, batanie, patkonj kuajsh, fotoaparate, trasta, radioaparate, letra duhani, duhan, lopata kazma, jastëk, çilima, të gjitha llojet e armëve dhe municionit, qofshin edhe trofe antike. Të gjitha këto i konfiskonin si gjësende të armikut.⁶² Në shënjestër të pushtetit u gjetën familjet e shqiptarëve që u dalluan për veprimtari dhe luftë atdhetare gjatë viteve 1941 – 1944, apo kundër pushtimit serbo-jugosllav pas nëntorit të vitit 1944.⁶³ Pushteti jugosllav e shikonte këtë politikë (POLITIKA OTKUPA) - “tepricave” si politikë adekuate për një zhvillim sa më të shpejtë industrial.⁶⁴ Realisht ishte e gjitha një goditje fatale për ekonominë familjare, në shumë zona, por më së shumti në Kosovë.

Jugosllavia komuniste menjëherë pas aksionit të “tepricave”, filloi aksionin e grumbullimit të armëve 1955-1956. Aksioni i armëve ishte i orkestruar fund e krye nga Aleksandër Rankoviçi (nga viti 1946 deri më 1966 – ministër i Punëve të Brendshme të Jugosllavisë).⁶⁵ Qëllimi i vërtetë i aksionit për mbledhjen e armëve në Kosovë nuk ishte mbledhja e armëve, që mbaheshin të fshehura ne popull, as evitimi i rrezikut të shpërthimit të

⁶¹ “Tepricat” janë përdorur si një mjet për të goditur familjet e mëdha dhe më të pasura.

⁶² Mehmet Gjoshaj, *Mbledhja e tepricave në Kosovë, formë e plaçkitjes ekonomike dhe shtypjes politike 1946-1952*, Muzeu i Kosovës, Prishtinë, 2009, fq. 25.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Shih më gjerësisht : Branko Petranović, *ISTORIJA JUGOSLAVIJE 1918 - 1988 ,TREĆA KNJIGA SOCIJALISTIČKA JUGOSLAVIJA 1945—1988*, NOLIT' BEOGRAD, fq. 101-120.

⁶⁵ Rexhep Qosja, *Dëshmitar në kohë historike*, Ditari I, 1966-1974, Prishtinë, 2014, fq. 53-54.

ndonjë kryengritje të armatosur kundër shtetit jugosllav, por, ishte krijim i një alibie për keqtrajtimin legal, torturimin fizik dhe psikik të shqiptarëve.⁶⁶

Qëllimi tjetër i këtij aksioni ishte krijimi i rrethanave të padurueshme për shqiptarët në Kosovë e më gjerë, në mënyrë që të rifillonin procesin e shpërnguljes së shqiptarëve, proces ky i ndërprerë më 1941, me shkatërrimin e Jugosllavisë Mbretërore.⁶⁷ Kjo shpërngulje e shqiptarëve nga tokat e tyre është bërë në një formë tejet të sofistikuar, duke paraqitur para opinionit ndërkombëtar se të shpërngulurit janë turqë, që kanë mbetur nga koha e sundimit osman dhe po kthehen në vendlindjen e tyre. Këtë na paraqet edhe Geert-Hinrich Ahrens në librin e tij *“Diplomacia mbi tehun e thikës”* tregon një ngjarje që kishte përjetuar vet në Shkup: *“Më 1959, isha dy herë dhe kalova shumë muaj në Shkup duke qëndruar në një familje etnike maqedonase. Një mbrëmje, në dhjetor të 1958-ës, pranë stacionit të trenit në Shkup, vura re një tren të gjatë të mbushur me njerëz që ngjanin që po udhëtonin në një rrugë të gjatë. Më thanë se ata ishin ‘turqë’ që donin të ktheheshin në vendin e tyre të prejardhjes dhe se trena të tillë niseshin rregullisht. Kishte në të vërtetë shumë niseje të tilla”*.⁶⁸ Kam qenë realisht dëshmitar i vënies në jetë të traktatit jugosllavo-turk, të vitit 1953.⁶⁹

Aksionin e armëve në Kosovë 1955-1956, e karakterizon edhe komponenti racist sepse në asnjë pjesë tjetër të ish- Jugosllavisë nuk është zbatuar një aksion i tillë.⁷⁰ Pra, të gjitha këto dëshmojnë se cili ishte qëllimi i këtyre politikave kaq të ashpra ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Pasojat e këtij aksioni të armëve ishin të shumta, të ndryshme dhe shumë të rënda, sepse mbi 30.000 qytetarë shqiptarë janë keqtrajtuar nga organet e sigurimit të shtetit jugosllav.⁷¹ Në bazë të numrit të banorëve të Kosovës në këtë periudhë i bie se mbi 30% të popullsisë janë keqtrajtuar.

Vitet e 50-ta dhe fillimvitet e 60-ta, nga këndvështrimi shqiptar përbëjnë periudhën më të keqe të tërë sundimit të Titos.⁷² Përpjekjet e studiuesve ose ish-funksionarëve të paraqisnin Titon të painformuar për aksionin e armëve, është një diletantizëm, ose naivitet i skajshëm shkencor. Titoja sa herë kërkonte t’i sqaronin ndonjë problem ideologjik, thërriste Kardelin. Por sa herë që duhej t’i ndyente duart me gjak, thërriste Aleksandër Rankoviçin, *“Hajde, Marko!*

⁶⁶ Mehmet Gjoshaj, *Aksioni i Armëve në Kosovë më 1955-1956*, Prishtinë, 2012, fq. 8.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomacia mbi tehun e thikës*, Tiranë, 2010, fq. 304.

⁶⁹ Po aty, fq. 305.

⁷⁰ Mehmet Gjoshaj, *Aksioni i Armëve...Vep e cit*, fq. 8.

⁷¹ Po aty.

⁷² Noel Malcolm, *Vep e cit*, fq. 336.

Nisu!".⁷³ Titoja, Rankoviçin e kishte si një robot, ku me një sustë aktivizohej, më së shumti është përdorur për ato treva ku tradicionalisht ishin të panështruara, si Bosnja e mbi të gjitha Kosova.⁷⁴ Prandaj tentimi për të amnistuar Titon nga këto veprime të A. Rankoviçit janë të paargumentueshme.

1.3 Marrëdhëniet e shtetit shqiptar, me ish-Jugosllavinë, 1948-1966.

Është fakt i pamohueshëm se, pa marrë parasysh gjendjen politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë, Kosova ka qenë një faktor determinues në politiken e shtetit shqiptar, në raport me Jugosllavinë, prej vitit 1913 deri më 1999. Për të qenë sa më konciz në relacionet tri palëshe Jugosllavi, Shqipëri dhe Kosovë, në vitet 1948-1966 është e domosdoshme për të pasur parasysh edhe rrethanat gjeopolitike gjatë Luftës së Dytë Botërore, 1939-1945 dhe pas saj. Kur dihet mirëfilli se shumë vendime janë marrë nga Fuqitë e Mëdha, pa u pyetur shtetet ballkanike fare, pra politikëbërja e Fuqive të Mëdha është bazuar vetëm nga interesat e tyre gjeostrategjike.

Për të arritur në një përfundim sa më të saktë, sa i përket marrëdhënieve të Shqipërisë me ish-Jugosllavinë duhet të bëjmë një digresion kronologjik. Pas ikjes së Mbretit Zog nga Shqipëria dhe pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, në Shqipëri u krijua një zonë mjaft e përshtatshme për veprimtarinë e grupeve të ndryshme politike me ndikim nga jashtë.

Pas vakumit institucional që u krijua në Shqipëri pas ikjes së mbretit Zog, shtetet fqinje sidomos Jugosllavia dhe Greqia filluan të kenë ndikim në grupacionet politike, të sapokrijuara. Edhe pse veprimtaria marksiste-komuniste në Shqipëri nis që nga fillimi i viteve 1920 (partia komuniste shqiptare është krijuar më 1941) dhe që në ditët e saj të hershme ajo edhe është ndihmuar, edhe është penguar nga shkëputja e Kosovës prej Shqipërisë dhe përfshirja e saj në Jugosllavi.⁷⁵

⁷³ Misha Glenny, *Historia e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Tiranë, 2007, fq. 579.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Reginald Hibert, *Fitorja e Hidhur, lufta nacional çlirimtare e Shqipërisë*, Shtëpia Botuese "A. Z. Çajupi" Tiranë, 1993, përktheu Xhevat Lloshi, fq. 27.

Një veprim që ka qenë mjaft tërheqës për veprimtarët marksistë-leninistë gjatë viteve të 20-ta, ishte kërkesa Federatës Komuniste Ballkanike e cila kishte paraparë edhe rishikimin e kufijve të Ballkanit në përputhshmëri me parimin e vetëvendosjes së kombeve.⁷⁶

Partia Komuniste Shqiptare ka qenë që në zanafillë mjaft e ndikuar nga Partia Komuniste Jugosllave. Po ashtu ndikim pati PKJ-ja edhe mbi shqiptarët e Kosovës, nga fundi i vitit 1940 dhe fillimi i vitit 1941, kur u bënë kontaktet fillestare me disa celula të vogla komuniste që kishin vepruar në Shqipëri.⁷⁷ Nuk vonoi shumë dhe kjo u vërtetua se sa kishte Titoja ndikim në PSH-në, në vitin 1944 kur Titoja ua bëri të qartë Ramadan Çitakut dhe Bedri Spahiut, as që mund të mendohet që Jugosllavia të humbte territore, se "Kosmeti" do të jetë pjesë integrale e Jugosllavisë".⁷⁸ Edhe pas këtij veprimi të Titos, PKSH-ja nuk ndërmori asnjë kundërveprim, përkundrazi PKSH-ja do t'i porosiste e do t'i udhëzonte shqiptarët e Kosovës, që nëse duan të prosperojnë për t'i fituar të drejtat e tyre duhej të bashkoheshin me Frontin Nacionalçlirimtar.⁷⁹

Varësinë e PKSH-së ndaj Jugosllavisë, e konfirmojnë edhe vet jugosllavët, thujse se 40 vjet më vonë, kur marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë u tensionuan ashpër, kur akuzat e ndërsjella u bënë publike, jugosllavët qenë të parët që ia kujtuan E. Hoxhës se Partia Komuniste e Shqipërisë ishte krijuar nën kujdesin e tyre.⁸⁰

Rreth çështjes së themelimit të PKSH-së në historiografinë jugosllave, shqiptare por edhe në atë perëndimore, janë paraqitur pikëpamje dhe interpretime të ndryshme, kryesisht lidhur me rolin e komunistëve jugosllavë në formimin e PKSH-së.⁸¹

Historiani Agim Zogaj nuk pajtohet me atë se kanë pasur aq ndikim PKJ-ja në formimin e PKSH-së, kur ai në tezën e doktoratës së tij i quan fabrikime dhe gënjeshtër thujse të gjitha pretendimet e historiografisë jugosllave kur konstaton: "*Historiografia jugosllave duke i qëndruar besnik dhe shërbyese pretendimeve të hegjemonizmit serbomadh, nuk pushoi së propaganduari spekulimin politik dhe antishkencor, se gjoja PKJ-ja ishte themeluese e PKSH-së*".⁸²

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ M.Vickers, vep. e cit., fq. 158.

⁷⁸ S.Syla, vep. e cit., fq. 72.

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Blendi Fevziu, Enver Hoxha, Botimi i katër, Tiranë, 2011, fq. 68. Shih edhe Димитрије Богдановић, КЊИГА О КОСОВУ, СРПСКА АКАДЕМИЈА НАУКА И УМЕТНОСТИ ПОСЕБНА ИЗДАЊА, Vep e cit, fq. 184-185.

⁸¹ Agim Zogaj, *Marrëdhëniet shqiptaro- Jugosllave 1945-1948*, Prishtinë, 2002, (tezë e doktoratës, në dorëshkrim), marrë më 22. 01. 2018 në <http://fxm.uni-pr.edu/Punimet-e-Doktoratures/Filozofiku.aspx>, fq. 16.

⁸² Po aty, fq. 17.

Një konstatim krejt të kundërt me A. Zogajn ka studiuesi dhe ish- funksionari nga Shqipëria Lisen Bashkurti, i cili nuk e mohon faktin që PKJ-ja ka pasur ndikim në fillesat e PKSH-së. Z. Bashkurti vjen në përfundimin se: *“Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë i kishin rrënjët thellë në lëvizjen komuniste të dy vendeve. Partia Komuniste e Jugosllavisë ishte partia më e vjetër në Evropën Lindore, kishte një udhëheqje të aftë dhe me përvojë, kishte lidhje të shumta në botën komuniste dhe atë ndërkombëtare. Edhe në aktin themelues të PKSH-së përfaqësuesit komunistë jugosllavë ishin të pranishëm. Prania e tyre erdhi duke e rritur influencën gjithnjë e më shumë. Fillimisht jugosllavët ndikuan vetëm brenda lëvizjes komuniste, më tej ata rritën ndikimin në Ushtrinë Antifashiste Nacionale- Çlirimtare dhe në Organet e Këshillave Antifashistë Nacional-Çlirimtar”*.⁸³ Enver Hoxha për raportet me PKJ-në i quante: *“Vendimi i komunistëve shqiptarë në verën e vitit 1941 për të hyrë në lidhje internacionaliste me Partinë Komuniste të Jugosllavisë tregonte pjekurinë që kishte arritur lëvizja komuniste e asaj kohe në Shqipëri”*.⁸⁴

Pra, gradualisht prezenca dhe ndikimi i komunistëve jugosllavë ndikoi në përpunimin e të gjitha politikave gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore”.⁸⁵ PKSh-ja që në ditën e lindjes, më 8 nëntor 1941, lindi si parti jogjithëkombëtare, pasi nuk kishte në programin e saj zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare në tërësi.⁸⁶ Pra në një konstatim të tillë arrin studiuesi Shefqet Dinaj duke sjellë këtë argument: *“në mbledhjen themeluese të Partisë Komuniste Shqiptare, çështja e Kosovës as që është përmendur”*.⁸⁷ Opinioni im i formuar pas shumë hulumtimeve për këtë punim, është se nuk mund ta zvogëlojmë ndikimin e PKJ-së mbi PKSH-në, e aq më pak të mohosh një gjë të tillë. Kur ajo që dihet mirëfilli që deri në prishjen e Titos me Stalinin PKSH-ja ka qenë mjaft e ndikuar nga PKJ-ja, kjo tregon se ndikimi ishte që nga zanafilla.

Pra pas Luftës së Dytë Botërore Jugosllavia ka pasur një rol kyç në Ballkan për disa arsye: Për nga madhësia demografike, pozicioni gjeostrategjik, roli dhe pesha që mbajti gjatë LDB-së, ku ishte një nga shtetet më të rëndësishme në Ballkan.⁸⁸ Pastaj gjendja ishte mjaft e vështirë pas përfundimit të LDB-së në Shqipëri, në të gjitha aspektet, por mbi të gjitha Shqipëria kishte para vetes një detyrë mjaft jetike, njohja ndërkombëtare. Për shkak të mosnjohjes ndërkombëtare, politikisht nuk mund të zhvillonte politikë të jashtme të pavarur,

⁸³ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet luftës së ftohet*, vep. cit., fq. 74-80.

⁸⁴ Enver Hoxha, Titistet, *Shënime historike, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pran KQ të PPSH, SHTEPIA BOTUESE -8 NENTORI*, Tiranë, 1982, fq. 3.

⁸⁵ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet luftës së ftohet*, vep. cit., fq. 74-80.

⁸⁶ Shefqet Dinaj, vep. e cit., fq. 101.

⁸⁷ Po aty. Këtë studiuesi (Dinaj e mbështet në librin *biograf*in për Titon të autorit Vladimir Dedejer “Jugoslavensko Albanski odnosi”).

⁸⁸ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në Fillimet e Luftës së Ftohet*, Tiranë, 2003, fq. 98.

përfaqësimin e jashtëm të saj e mori përsipër Jugosllavia. Prandaj shteti shqiptar ra në varësi të Jugosllavisë në të gjitha sferat.⁸⁹ Prandaj nuk është krejt nga naiviteti politik që Shqipëria ka rënë nën ndikimin jugosllav.

Jugosllavia ishte aleati më i afërt i Shqipërisë midis viteve 1944 dhe 1948. Kjo afërsi ishte kryesisht për shkak të ndihmës së komunistëve jugosllavë që i kishte dhënë Partisë Komuniste Shqiptare vitet e saj formuese gjatë luftës. Jugosllavia ishte gjithashtu midis vendeve të para që e njihnin Enver Hoxhën dhe të vendoste marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë më 28 prill 1945.⁹⁰ Një e përbashkët që ka karakterizuar PKSH-në dhe PKJ-në janë të vetmet vende në Evropë, bashkë me Shqipërinë, ku marrja e pushtetit nga komunistët nuk është rezultat i drejtpërdrejtë i ndërhyrjes së Ushtrisë së Kuqe.⁹¹

Ndihma i është dhënë Shqipërisë nga Jugosllavia në dy fusha të rëndësishme: së pari, në Kombet Bashkuara dhe së dyti, në Konferencën e Paqes së Parisit. Eduard Kardeli, kreu i delegacionit jugosllav në Kombet e Bashkuara ka kërkuar nga të gjitha shtetet që të njihet Shqipëria si një vend prej të parëve që ka përjetuar pushtimin fashist.⁹² Shqipëria në këto relacione kishte më shumë interesa ekonomike, kurse Jugosllavia më shumë kishte interesa gjeostrategjike, si shfrytëzimi i pozitës gjeografike, resurset natyrore, po ashtu përfitoi nga tregu dhe lënda e parë minerale dhe bujqësore shqiptare etj.,⁹³ (ndoshta edhe duke përgatitur terrenin për aneksim ose bashkim të Shqipërisë me Jugosllavinë). Synimi përfundimtar i kësaj të fundit ishte përfshirja e Shqipërisë brenda Federatës Jugosllave.⁹⁴

Delegimi pothuajse i plotë i sovranitetit në Jugosllavi menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, bëri që Shqipëria të ndiqte për disa vite verbërisht rrugën që rrëfente Jugosllavia, si nga pikëpamja e zhvillimeve të brendshme, ashtu edhe në politikën rajonale dhe ndërkombëtare.⁹⁵ “*Në vitet në vazhdim pas LDB-së influenza jugosllave ishte e gjithanshme dhe e plotë edhe në fushën ushtarake, asgjë nuk mund të ndodhte në ushtri pa dijeninë dhe*

⁸⁹ Peter Bartl, *Shqipëria nga mesjeta deri sot, Prizren*, 1999, fq. 223.

⁹⁰ JAMES S. O'DONNELL, *A COMING OF AGE ALBANIA UNDER ENVER HOXHA, EAST EUROPEAN MONOGRAPHS*, BOULDER DISTRIBUTED BY COLUMBIA UNIVERSITY PRESS, NEW YORK 1999, fq. 17. Marrë në : <https://espressostalinist.files.wordpress.com/2010/12/a-coming-of-age.pdf>.

⁹¹ Bernard Lory, *Evropa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona*, Tiranë, 2007, fq. 55.

⁹² M. Vickers, vep. cit., fq. 178.

⁹³ Endrit MUSAJ, *MARRËDHËNIET SHQIPTARO – SOVJETIKE (1949 – 1961)*, Tiranë, 2017, fq. 64 (Tezë e doktoraturës në dorëshkrim), marrë në: http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/02/Endrit_Musaj.pdf, më 26.05.2018.

⁹⁴ Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë, 2014, fq. 235.

⁹⁵ Peter Bartl, fq. 112.

kontrollin jugosllav. Ky ndikim kaq i madh ia tërhoqi vëmendjen edhe perëndimit. Ata shprehen shqetësim se mos është ky një lloj aneksimi i Shqipërisë nga shteti jugosllav’.”⁹⁶

Se sa kanë qenë të varur ndaj Jugosllavisë, dëshmon edhe një dokument i shkruar nga vet dora e Enver Hoxhës, ku thuhej decidivisht: *“Populli shqiptar nuk mund të rrojë pa miqësinë me popujt jugosllavë”*.⁹⁷

Pra shihet qartë se Shqipëria komuniste në fillimet e saj ishte mjaft e varur nga shtetit jugosllav. Një ndër arsytet bazë, se pse nuk është ngritur çështja e Kosovë nga shteti shqiptar në qarqe të ndryshme ndërkombëtare, ishte pikërisht kjo afërsi me shtetin jugosllav.

Nexhmije Hoxha, bashkëshortja e Enver Hoxhës, në kujtimet e saj, mbetjen e Kosovës nën Jugosllavi ia atribuon rrethanave të politikës ndërkombëtare, jo mosgatishmërisë së Enverit. Ajo shpjegon: *“Enver Hoxha ka qenë i detyruar të ndjekë një politikë të ekuilibruar, të kujdesshme ndaj Jugosllavisë e ndaj çështjes së Kosovës. Kjo për disa arsye e rrethana të kohës. Një nga këto ishte se kështu e kërkonin interesat e larta të shtetit të ri shqiptar dhe në ato kushte nuk mund të bëhej më shumë nga ana jonë për çështjen e vetëvendosjes, po ashtu dhe për shkëputjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Zgjidhja e çështjes së Kosovës nuk varej, jo vetëm nga Enver Hoxha, por ajo nuk varej as nga vetë Titoja, i cili ishte kroat, por nuk mund t'u kundërvijë interesave të serbomëdhenjve”*.⁹⁸

Nëse e shikojmë këtë mendim të Nexhmije Hoxhës sipas rrjedhës logjike, qëndron deri në një farë mase, por nuk është e argumentueshme deri në atë nivel sa të pranohet si vërtetë e pakontestueshme. Kjo për arsye se kur jepen qëndrime për vendime politike me rëndësi aq të madhe, si dhe kur jeni vet pjesë e atyre vendimeve duhet të posedosh fakte dhe argumente të fuqishme, që mos të jenë të kontestueshme.

Por një varësi e tillë e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë nuk zgjati më shumë se tre vjet pas LDB-së, pra deri në vitin 1948. Kjo prishje erdhi më shumë si rezultat i prishjes midis BRSS-së dhe Jugosllavisë. Stalini që në krye të herës kishte një mosbesim në Titon, por ky mosbesim veç sa vinte e rritej. Në këtë aspekt kanë ndikuar disa faktorë. Revolucioni jugosllav si një kundërmudel me atë të sovjetikëve, krijoi mosmarrëveshjet midis Stalinit dhe Titos, të cilat u ngritën edhe lidhur me çështjet praktike të politikës rajonale. Jugosllavët nën udhëheqjen e Titos, kishin ambiciet e rrënjosura në historinë e mëparshme të Ballkanit, për të gllabëruar

⁹⁶ Ruzhdi Kuçi, *Mendimi ushtarak strategjik dhe organizimi I forcave të armatosura të shtetit shqiptar 1945-1990*, Tiranë, 2017, fq. 46 (Tezë e doktoraturës në dorëshkrim), marrë në : <https://drive.google.com/file/d/0Bz1NpApIa1A6ZGpKS0pHNVlwa0E/view> , më 10.01.2020.

⁹⁷ Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, dokumente, Tiranë, 1996. Marrë në http://new.albarchive.gov.al/?page_id=569, më 21.10.2018.

⁹⁸ Nexhmije Hoxha, *Jeta ime me Enverin, Kujtime*, Botuar nga Enti Botues “Liria”Tiranë, 1998, fq. 228-229.

Shqipërinë. ⁹⁹Sipas dyshimeve të Stalinit, Titoja kishte plan zgjerimi edhe në territore të Bullgarisë dhe pjesë të Greqisë për të krijuar një Jugosllavi të zgjeruar nën një federatë të re ballkanike. ¹⁰⁰ Është më se e qartë se për Stalinin kjo ambicie e Titos nuk ishte problem, sepse ai në këtë aspekt e dinte shumë mirë potencialin e tij, por shqetësim për Stalinin ishte afrimi i Titos me perëndimin. Kjo e shqetësonte pa masë Stalinin. Stalini shqetësim tjetër në këtë linjë kishte edhe inkurajimin e kryengritësve komunistë grek në anën e Titos, që mund të qonte në ngritje të tensioneve me anglo-amerikanë, kur dihet se Greqia kishte mbetur në sferën perëndimore. ¹⁰¹

Por Jugosllavia edhe pse prishi marrëdhëniet me BRSS-në, asaj nuk i mungoi aspak mbështetja e një superfuqie tjetër, siç ishte SHBA-ja. Për marrëdhëniet e shkëlqyera që ka pasur ish-Jugosllavia me SHBA-në, dëshmon në Beograd Keneth Hill, sekretar i Ambasadës së SHBA-së, më 19 mars 1975, i cili thekson: “*Marrëdhëniet mes RSFJ-së dhe SHBA-së, përkundër ndryshimeve në rregullimin e brendshëm, janë të mira që nga viti 1953 e këndej, të dy qeveritë konsultohen rregullisht.*”¹⁰² Mbështetja e Amerikës për Titon ishte gjeopolitike. Administratat e Trumanit (Harry S. Truman) dhe Eisenhower (Dwight D. Eisenhower) donin të tregonin se vendet mund të dilnin nga orbita sovjetike dhe të mbijetonin. Pavarësia e Jugosllavisë i hoqi Bashkimit Sovjetik një vend të mundshëm në Mesdhe, nga i cili mund të kishte kërcënuar Italinë, Greqinë dhe Francën.¹⁰³

Qeveritë e njëpasnjëshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës besonin se Jugosllavia mund të bëhej model për pavarësinë dhe për një sistem politik të Evropës Lindore, që megjithëse për fat të keq komunist mund të ishte më i hapur politikisht dhe më i decentralizuar ekonomikisht, sesa satelitët sovjetikë.¹⁰⁴ Por menjëherë pas prishjes së raporteve midis ish-Jugosllavisë dhe BRSS-së, shteti jugosllav përfitoi fuqishëm nga ndihmat që vinin nga shtetet perëndimore në shumë fusha.

⁹⁹Tony Judt, *Postwar A HISTORY OF EUROPE SINCE 1945*, T H E PENGUIN PRESS, New York, 2005, fq. 141. Marrë: [http://scienzepolitiche.unical.it/bacheca/archivio/materiale/2467/Materiale%20didattico%20per%20corso%20magistrale%20Storia%20Integrazione%20Europea/Tony%20Judt-Postwar_%20A%20History%20of%20Europe%20Since%201945-Penguin%20Press%20\(2005\).pdf](http://scienzepolitiche.unical.it/bacheca/archivio/materiale/2467/Materiale%20didattico%20per%20corso%20magistrale%20Storia%20Integrazione%20Europea/Tony%20Judt-Postwar_%20A%20History%20of%20Europe%20Since%201945-Penguin%20Press%20(2005).pdf)

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tutje ASHAK), Fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, viti 1968-1991, Lënda:1-200, Kutia: 7, fq. 1.

¹⁰³ WARREN ZIMMERMANN, *ORIGINS of a CATASTROPHE YUGOSLAVIA AND ITS DESTROYERS*, fq, marrë në : <https://www.scribd.com/document/64957263/Zimmerman-Origins-of-a-Catastrophe-Yugoslavia-and-Its-Destroyers-1999>, me 07. 07. 2018.

¹⁰⁴ Po aty, fq. 21.

Shtetet perëndimore këmbëngulën në një politikë të tillë investimi ndaj ish-Jugosllavisë që do të merrte parasysh fizibilitetin ekonomik dhe efikasitetin e investimeve, sesa realizimin e prioriteteve të përvijuara nga sistemi planifikues jugosllav.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Franca tani, në një mënyrë shumë më të mprehtë dhe më vendimtare, kanë bërë të gjitha përpjekjet e zgjerimit të tyre për të ndihmuar ristrukturimin e ekonomisë jugosllave.¹⁰⁵

Pas prishjes jugosllavo-sovjetike, shteti shqiptar dhe ai jugosllav u kthyen në kundërshtarë dhe ndoqën rrugë krejt të ndryshme. Shqipëria ndoqi një politikë të brendshme të rreptë staliniste, ndërsa Jugosllavia ndoqi atë që shteti shqiptar e quajti kurs “*revizionist*”, pra, politikën e brendshme të “*vetadministrimit*” dhe një politikë të jashtme asnjëse. Të dy vendet kishin gjithashtu pikëpamje të kundërta mbi çështjet më të rëndësishme me të cilat përballej sistemi komunist ndërkombëtar si edhe u angazhuan në polemika të ashpra.

Duhet pasur parasysh edhe faktin se këtë periudhë, pra vitet e 50-ta ish-Jugosllavia e shfrytëzoi mjaft mirë për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik me vendet e huaja, si në aspektin e strukturës dhe fushëveprimit të saj, ashtu edhe në aspektin e përfaqësimit të saj rajonal. Sa i përket numrit të vendeve me të cilat Jugosllavia ka vendosur marrëdhënie të ngushta ekonomike dhe shpërndarjen e tyre gjeografike, mund të thuhet se shteti jugosllav ka arritur në masë të madhe të realizojë objektivat më të rëndësishme të politikës së saj të jashtme dhe strategjisë ekonomike të jashtme.¹⁰⁶

Pra edhe pse Enver Hoxha ndoshta e ka shikuar si një avantazh të tij raportet e mira me BRSS-në, në momentet kur Titoja kishte prishur marrëdhëniet, por realisht ishte e kundërta, sepse Jugosllavinë, për shumë arsye siç i cekëm më lart, e favorizonte politika amerikane. Po ashtu Jugosllavia, që nga dalja e Informbyrosë, fitoi një rëndësi të madhe gjeostrategjike në kuadrin e përplasjeve midis dy blloqeve politike globale të kohës.¹⁰⁷ Për këtë të gjitha shtetet perëndimore i ofruan Titos mbrojtje të sovranitetit, dhe stabilitet në të gjitha fushat.¹⁰⁸

Rezultatet e Informbyrosë, të vitit 1948 mbi gjendjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, u bë vija kryesore ndarëse në marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë.¹⁰⁹ Zhvillimet e ndodhura në vitet 1949-1953 kanë si karakteristikë acarimin e

¹⁰⁵ Dr. Dragan BOGETIĆ, *JUGOSLAVIJA I SVETSKO TRŽIŠTE KAPITALA*. Američka finansijska podrška jugoslovenskim razvojnim programima krajem 50-tih godina, fq.91. Marrë në: https://www.inisbgd.co.rs/celo/2010_3.pdf, 03. 04. 2019.

¹⁰⁶ Po aty, fq. 90.

¹⁰⁷ Sylë Ukshini, *Kosova në politikën e jashtme të BE-së 1991-2007*, Prishtinë, 2008, fq. 67.

¹⁰⁸ Po aty.

¹⁰⁹ Ethem Çeku, *Kosova në sfondin e Diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, (Tezë doktorate, në dorëshkrim), Prishtinë, 2008, marrë më 21.01.2018, në <http://fxm.uni-pr.edu/Punimet-e-Doktoratures/Filozofiku.aspx>, fq. 58.

madh të BS-së me Jugosllavinë dhe aleatët e saj, por edhe të Shqipërisë me Jugosllavinë.¹¹⁰ Në ato vite marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u ndërpreën dhe u acaruan në kulm.

Një ndikim të madh në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ka pasur edhe Bashkimi Sovjetik.¹¹¹ Sipas historiografisë sovjetike ishte shprehur ideja se synimet hegjemoniste të Titos në Ballkan, dhe në veçanti për t'i bashkuar Shqipërinë Jugosllavisë si republikë e shtatë, ishin shkaqet kryesore të prishjes së Stalinit dhe Titos.¹¹² Por një gjë e tillë nuk qëndron, sepse Stalini nuk kishte frikë hegjemonizmin e Titos në Ballkan, e aq më pak pushtimin e Shqipërisë, sepse sipas Gjillasit, Stalini kishte dhënë dritën jeshile për pushtimin e Shqipërisë. Por një gjë e tillë e kanë përdorur qarqe të ndryshme në Shqipëri si justifikim të prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave.

Pas keqësimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, ndryshoi edhe qëndrimi i shtetit shqiptar karshi çështjes së Kosovës. Kjo periudhë shënon edhe një ndryshim në politikën shtetërore të Tiranës e cila foli hapur për Kosovën.¹¹³ Por edhe jugosllavët ndryshuan qasjen ndaj “pakicës” shqiptare në Jugosllavi. Nga gjithë ky acarim marrëdhëniesh dypalëshe më së shumti kishte pësuar populli shqiptar në ish-Jugosllavi. Sipas analizës së të dhënave, element kryesisht serb në nivelet e larta federale si dhe në nivelet me të larta të republikës serbe, brenda së cilës konstitucionalisht ishte përfshirë Kosova, shfrytëzuan konjunkturën e acaruar dypalëshe shqiptaro-jugosllave për të realizuar në Kosovë platformën e akademikut serb Vaso Çubriloviç.¹¹⁴ Sidoqoftë zgjidhja e problemit u pa sërish brenda kornizave ideologjike marksiste-leniniste dhe sigurimit të mbështetjes së Bashkimit Sovjetik.¹¹⁵

Pas prishjes së traktatit me jugosllavët, Tirana zyrtare filloi të akuzonte jugosllavët si “shovenistë, të cilët po shtypnin me dhunë pakicat nacionale dhe veçanërisht popullsinë shqiptare në Kosove”.¹¹⁶ Enver Hoxha prishjen me jugosllavët nuk e bëri për arsye se ata ishin duke shtypur “minoritetin” shqiptar në Jugosllavi por, nga kalkulimet e tij strategjike, që kishte llogaritur se afrimi me Stalinin do të favorizonte këtë në raport me Titon.¹¹⁷

¹¹⁰ S.Syla vep. e cit., fq. 109.

¹¹¹ Ethem Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*. Vep. e cituar, fq. 59.

¹¹² Sabit Syla, Vep. e cituar, fq. 109.

¹¹³ Po aty, fq. 110.

¹¹⁴ Lisen Bashkurti, *Diplomacia...* Vep. e cit., fq. 213.

¹¹⁵ Sabit Syla, Vep. e cit., fq. 109.

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Më vonë është vërtetuar se edhe në kohën kur BRSS-ja kishte raporte të ngrira me Jugosllavinë asnjëherë nuk është favorizuar Shqipëria në raport me Jugosllavinë.

Enver Hoxha duke menduar se një afrim me Stalinin do të ishte mjaft me rëndësi për të gjithë shqiptarët. Ai do të kërkoj nga shqiptarët e Kosovës në baza të shëndosha besimin dhe dashurinë e pakufishme për BRSS-n, Partinë Bolshevike dhe Stalinin.

Shqiptarët duhej të kuptonin mirë se pa këta të fundit nuk do kishte as Shqipëri të lirë, as Jugosllavi të lirë, as Kosovë të lirë, as që mund të përmbushen kurrë aspiratat e tyre.¹¹⁸ Kjo dëshmon se sa verbërisht E. Hoxha ka besuar në Stalinin dhe politiken e tij. Kurse Stalini në embrionin e politikës së tij kishte pansllavizmin. Henry Kissinger duke iu referuar Gjillasit thotë: *“Në qoftë se sllavët qëndrojnë të bashkuar dhe ruajnë solidaritetin, asnjëri nuk do të luaj dorë as gishtin në të ardhmën. As gishtin! përsëriti ai”*.¹¹⁹ Kurse Stalini nuk kishte as më të voglën njohuri për shqiptarët në përgjithësi e sidomos për shqiptarët në Jugosllavi. Këtë e dëshmon edhe gjatë takimit me Enver Hoxhën në mars të vitit 1949 në Moskë.¹²⁰ Aty Hoxha u skandalizua, sapo konstatoi paditurinë e Stalinit lidhur me Shqipërinë. Ky sekret apo mosnjohim u provua në takimin e Stalinit me Eduard Kardelin - këshilltar i Titos për çështje të politikës së jashtme, - që u realizua gati në të njëjtën kohë. Stalini i drejtoi Kardelit disa pyetje, por edhe atë lidhur me prejardhjen e shqiptarëve, duke shtuar se *“... paraqiten ndoshta njerëz prapanikë dhe primitivë”*; atëherë ambasadori jugosllav iu përgjigj: *“ndërkaq janë shumë trima dhe të besës”* - d.m.th. në një farë mënyre mbështeti mendimin e Stalinit për shqiptarët, pasi ky plotësoi: *“Po mund të jenë të besës si..., por dhe kjo është karakteristikë e primitivizmit”*.¹²¹ Këtë e vërtetojnë pyetjet që ia parashtron Stalini Enverit mbi besimin e shqiptarëve veçoritë dalluese, lidhja e tyre me sllavët, numrin e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi etj.¹²²

Por, përveç mosinformimit për shqiptarët Stalini nuk kishte asnjë interesim për Shqipërinë, këtë e dëshmon edhe në bisedë me Milovan Gjillasin në Moskë. Stalini i thotë Gjillasit *“Ne në Shqipëri nuk kemi kurrfarë interesa të veçanta. Ne jemi dakord që Jugosllavia ta gëlltisë Shqipërinë”*.¹²³

Pra nga gjithë kjo shihet qartë se Stalini nuk kishte problem me Jugosllavinë, por me Titon. Gjillasi rrëfen në një rast se si Stalini thumbonte Titon deri në kufi të ofendimit, se nga e ka zanafillën antipatia e tillë e Stalinit ndaj Titos nuk është dëshmuar deri më tani. Kjo vërtetohet edhe me vdekjen e Stalinit se nuk ishin marrëdhëniet e prishura në mes të BRSS-së dhe Jugosllavisë por vetëm mes Stalinit dhe Titos.

¹¹⁸ Ethem Çeku, *Kosova në sfondin e Diplomacisë... Vep. e cit., fq. 76.*

¹¹⁹ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999, fq. 438.

¹²⁰ S.Syla, Vep. e cit., fq.111.

¹²¹ Vebi Xhemaili, *Marrëdhëniet shqiptaro jugosllave 1945-1948 dhe e vërteta e Enver Hoxhës për Kosovën II*, marr <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=2346>, 15.07.2017.

¹²² Po aty.

¹²³ Milovan Gjilas, *Biseda me Stalinin*, Tiranë, 2000, fq. 123.

Duke pasur parasysh të gjitha këto të lartcekura dhe kur dihet mirëfilli se politika e Enver Hoxhës ka pasur shumë gabime dhe shumë të panjohura në brendi, të cilat i kemi cekur edhe në këtë punim, është akuzuar se asnjëherë nuk e ka ngritur çështjen e Kosovës apo bashkimin e saj më Shqipërinë. Por publikimi i dokumenteve tani kohën e fundit po dëshmojnë se nuk duhet të shikohet politika e Hoxhës në raport me Kosovën vetëm bardh dhe zi.

Një gjë e tillë hidhet poshtë nga letra e Enver Hoxhës dërguar KQ-së të Partisë Komuniste të Bashkimi Sovjetik (PKBS-së), në vitin 1949, ku në të thuhej: *“Kyç i zhvillimit me sukses të luftës në Kosovë është bashkimi i tyre me Shqipërinë. Asnjë zgjidhje tjetër e popullit shqiptar të Kosovës nuk pranon dhe e quan të padrejtë dhe në realitet ne mendojmë që është e padrejtë, ne mendojmë se Kosova dhe një pjesë e Maqedonisë kufitare me Shqipërinë, që banohet me shqiptarë duhet t’i bashkohen Shqipërisë, mbasi Jugosllavia duhet të lirohet nga kthetrat e Titos dhe imperializmit”*.¹²⁴

Ajo që është faktike, është se Enver Hoxha çështjen e Kosovës e ka ngritur në bazë të gjendjes politike në arenën ndërkombëtare. Nga letra e Enver Hoxhës dërguar Stalinit del qëndrimi i dyanshëm i shtetit shqiptar ndaj çështjes së Kosovës. Nga njëra anë i bëhet e ditur Stalinit se Republika Popullore e Shqipërisë do të ndihmojë me të gjitha forcat luftën kundër klikës së Jugosllavisë, deri në fitorën e plotë.¹²⁵ Nga ana tjetër ishte qëndrimi zyrtar, shtruarja në institucione ndërkombëtare e çështjes së Kosovës.¹²⁶

Për Enver Hoxhën kjo ishte një përpjekje prej të paktave që të shfrytëzohej gjendja që ishte krijuar në raportet sovjete-jugosllave. Sepse është fakt që Shqipëria për BRSS-në, në vitin 1949, ishte me rëndësi në këtë pjesë të Ballkanit, pas prishjes me Jugosllavinë. Dhe një gjë e tillë Enveri e kishte kuptuar. Këtë situatë në politikën ndërkombëtare tentoi ta shfrytëzojë Hoxha, për të ardhur deri te zgjidhja e çështjes së shqiptarëve në ish- Jugosllavi.¹²⁷

Vdekja e Stalinit ka si pikënisje përmirësimin e marrëdhënieve sovjetike-jugosllave dhe shqiptaro-jugosllave. Ky proces nisi me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Jugosllavinë në vitin 1953 dhe me disa zhvillime pozitive të ardhura pas kësaj.

Më 5 nëntor të vitit 1953 qeveria shqiptare propozon për fillimin e marrëdhënieve diplomatike me Jugosllavinë, të ndërprera me kërkesë të qeverisë jugosllave 4 vjet më parë.¹²⁸ Shteti jugosllav pranon që të hyjë në marrëdhënie diplomatike me shtetin shqiptar. Kjo dëshmon se ashtu shteti shqiptar nuk kishte prishur marrëdhëniet me Jugosllavinë për çështjen e *“pakicave”*

¹²⁴ Ethem Çeku, *Kosova në sfondin e Diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, Vep. e cit., fq. 77.

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Po aty.

¹²⁷ Ethem Çeku, *Kosova në sfondin...*, Vep. e cit, fq. 78.

¹²⁸ S.Syla, vep. e cit., fq. 124.

shqiptare në Jugosllavi por që të ketë raporte të mira me një shtet shumë më të fortë dhe të balancojë forcat me shtetet fqinje deri në njëfarë mase. Pra shteti shqiptar harroi thujtse të gjitha ato akuza ndaj Titos dhe vartësit të tij, Rankoviçit, dhe vuajtjet e popullit shqiptar në Kosovë.

Kryeministri shqiptar Mehmet Shehu kishte deklaruar se: “ *Shqiptarët ishin të gatshëm ta harronin të kaluarën dhe të shihnin vetëm përpara*”.¹²⁹ Kjo ishte një goditje shumë e madhe për aspiratat e shqiptarëve në Kosovë sepse u pa qartë se nuk kishin më se ku të shpresonin. Tani veç pritej përkeqësimi i gjendjes politike dhe socio-ekonomike në Kosovë.¹³⁰

Nuk ka vijuar shumë kohë edhe Enver Hoxha duke parë se afrimi i tepërt me Jugosllavinë është mjaft jo e favorshme për shqiptarët e Kosovës. Hoxha priste momentin që të gjente një pretekst që t'u kundërvihej jugosllavëve.

Në vitin 1956 Jugosllavia do të fajësohej për nxitje, besa edhe për organizim të trazirave në Hungari. Shteti shqiptar do të shfrytëzojë situatën e krijuar për t'iu kundërvënë Jugosllavisë. Duke parë reprezaljet që ndodhen ndaj kosovarëve në fund të vitit 1955 dhe fillim të vitit 1956, që kishin ndërmarrë organet shtetërore jugosllave nën udhëheqja e Rankoviçit, udhëheqja e lartë e shteti shqiptar do të kritikonte ashpër udhëheqjen jugosllave edhe për diskriminimin kombëtar, për shpërnguljen në Turqi si dhe aksionin e armëve.¹³¹

Këtë shqetësim Enver Hoxha do t'ia thoshte edhe ambasadorit rus në Tiranë L. I. Krillov. Hoxha do t'i shprehet në mënyrë shumë decisive: “*Para pak kohesh në Kosovë, ku banojnë deri në 800 mijë shqiptarë, filloj një proces i gjerë kundër një grupi shqiptarësh, të cilët në vitin 1948 kishin organizuar lëvizjen për bashkim të kësaj krahine me Shqipërinë. Ne nuk kishim asnjë marrëdhënie me këtë grup. Pse duhet filluar ky proces, shtronte pyetjen Hoxha ...*”¹³² Enveri është munduar që herë pas herë që ta ngriste çështjen e Kosovës, por jo në mënyrë të vazhdueshme.¹³³

E. Hoxha në fjalimet politike që iu drejtohej masës herë pas here fliste për Kosovën dhe shqiptarët me entuziazëm, por këtë e bënte më shumë për konsum të brendshëm. Sepse ato që i ka thënë në medie nuk përkonin me vendimet politike.

Në ditarin e tij politik Hoxha shkruan: “*Ne nuk kemi dashur të hyjmë dhe nuk do të hyjmë në konflikt të armatosur për çështjen e bashkimit me mëmëdheun, të trojeve shqiptare nën*

¹²⁹ Po aty, fq. 128.

¹³⁰ Pikërisht afrimi me Jugosllavinë në këtë kohë, i shtetit shqiptar, ishte “dhënie leje”e për të vepruar aparati shtetëror jugosllav me të gjithë mekanizmat e tij në krye me Aleksandër Rankoviçin.

¹³¹ S. Syla, po aty, fq. 134.

¹³² Po aty.

¹³³ Ka shumë nga ata që thonë se Hoxha ka ngritur çështjen e Kosovës vetëm kur iu ka nevojitur për konsum të brendshëm ose sipas rrethana të politikës ndërkombëtare.

*Jugosllavi. Në këto situata një veprim i tillë nuk mund të realizohet... ”.*¹³⁴ Dhe këtë e arsyeton me, si në vijim :“*Do të vijë koha kur kosovarët do të luftojnë akoma më mirë, më shumë e më fort për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin. Shqiptarët që banojnë në trojet e veta kombëtare në Jugosllavi, do të vendosin vetë me cilin shtet do të bashkohen, do të vijë koha që ata ta thonë fjalën e tyre.*”¹³⁵

Problemi i Kosovës zuri vend edhe në artikuj të ndryshëm të shtypit shqiptar, ashtu si në fjalimet e udhëheqësve me akuza të ashpra ndaj palës jugosllave. Kryesisht me tituj mjaft të ashpër. Si, “*Ne dënojmë qëndrimin shovenist kundër shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë dhe propagandës, shpifjeve kundër shtetit tonë*”.¹³⁶ Vitet e 50-ta dhe 60-ta, nga këndvështrimi i shqiptarëve, janë pika më e ulët e tërë sundimit të periudhës së Titos dhe e një pabarazie të madhe etnike, e cila nuk u përmirësua, kur dihet se serbët dhe malazezët të cilët nuk e përbënin as 17% të popullatës së Kosovës, në saje të regjistrimit të vitit 1953, e përbënin 70% të administratës dhe posteve udhëheqëse.¹³⁷

Raportet shqiptaro-jugosllave gjatë kësaj periudhe kanë pasur ulje-ngritje kryekëput sipas rrethanave më shumë të politikës ndërkombëtare. Një relaksim të marrëdhënieve shqiptaro- jugosllave, në kuptimin sa më të mirëfilltë nuk kemi deri në fillim të viteve të 70-ta, apo më mirë të thuhet deri pas rënies së Aleksandër Rankoviqit. Nga ky relaksim marrëdhëniesh përfitojnë edhe shqiptarët e Kosovës.

138

¹³⁴ Enver Hoxha , *Kosova është SHQIPËRI* - nga Ditari Politik, Përmbledhje dokumentesh Përgatitur nga Ilir Hoxha Redaktore, Teuta Hoxha , Tiranë -1999, http://ciml.250x.com/archive/hoxha/albanian/enver_hoxha_kosova-eshte-shqiperi.pdf, marrë me 16.07.2017.

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Po aty, fq. 137.

¹³⁷ Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 336.

¹³⁸ Gjatë kësaj periudhe fillojnë të vijnë shumë profesorë nga Tirana në Kosovë dhe anasjelltas si dhe fillon të depërtojë literatura nga Shqipëria në Kosovë, që deri para kësaj kohe ka qenë e pamundshme.

1.4 Rënia e Aleksandër Rankoviçit një mundësi për hapje ndaj Shqipërisë.

E gjithë periudha e viteve 1945-1966 në historiografinë e Kosovës por edhe në opinionin e gjerë njihet si “*koha e Rankoviçit*”. Periudha midis viteve 1948 deri në mes të viteve 1960, mund të karakterizohet si periudha kur pakica serbe në Kosovë dominonte krahinën, të mbështetur nga Aleksandër Rankoviçi dhe sigurimi i fuqishëm i udhëhequr nga ai, që shpesh e ka përdorur për shtypjen brutale të elementit shqiptar.¹³⁹ Gjatë këtyre viteve, ka pasur një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve që u larguan nga Kosova. Sipas Nurcani Özgür Baklaçi lu, “*pas vitit 1958 migrimet e shqiptarëve nga Kosova dhe Maqedonia ishin më të rëndësishmet në mesin e të gjitha migrimëve të tjera që ndodhën brenda ish-Jugosllavisë*”.¹⁴⁰ Gjatë këtyre viteve, shqiptarët janë trajtuar mbi bazën e elaboratit të V. Qubrilloviçit në vitet 1937 të ripërtërirë në vitet 1944. Deri në rrëzimin e Rankoviçit, korrik 1966, ai e qeverisi Kosovën me grusht të hekurt, duke u mbështetur në aparatit e sigurimit, i cili ishte nën komandën e tij.¹⁴¹ Në mesin e kësaj faze shtypëse të vitit 1956, ka qenë viti më i vështirë për shqiptarët.¹⁴² Edhe në konfliktin ideologjik në mes të Jugosllavisë dhe BRSS-së, në kohën e Informbyrosë (1949 - 50) shqiptarët do të jenë objekt i sulmeve të pamëshirshme me qëllim të dëbimit përfundimtar të tyre nga këto hapësira.¹⁴³ Gjatë kohës së “*qeverisjes*” së Rankoviçit, organet e sigurimit të brendshëm shtetëror, nuk kanë lejuar që në shkolla të mësohet për një varg shkrimtarësh, historianësh, dhe gjuhëtarësh shqiptarë nga Shqipëria.¹⁴⁴ Pra kthesë në politikën jugosllave ndaj Kosovës është Plenumin i Brionëve, 1966 dhe rrëzimi i ministrit të brendshëm Aleksandër Rankoviçit. Jugosllavia inicioi largimin nga modeli shtetëror *de facto* centralist dhe shënon fillimin e federalizmit të vërtetë të Jugosllavisë, i cili pikën kulmore e arrin me Kushtetutën e vitit 1974.¹⁴⁵

Është interesant se si shtypi jugosllav në të gjitha format mundohet që gjithë fajin për këtë reprezalje që kishte përjetuar populli shqiptar i Kosovës t'i vihej vetëm Aleksandër Rankoviçit (

¹³⁹ Momčilo Pavlović, *KOSOVO UNDER AUTONOMY 1974-1990*, fq.14-15. Viti dhe vendi ?, marr në: <https://www.cla.purdue.edu/si/Team1Reporte.pdf>, me 16.04.2018.

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Oliver Jens Schmitt, vep. e cit., fq. 176.

¹⁴² Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomacia mbi tehun e thikës*, Pengimi i konfliktit etnik dhe grupi i punës për minoritete i konferencës për Jugosllavinë, Tiranë, 2010, fq. 303.

¹⁴³ Këtë dëshmon rasti i Rifat Berishës.

¹⁴⁴ Rexhep Qosja, Vep. e cit., fq. 55.

¹⁴⁵ O. Schmitt, vep. e cit., fq. 179.

edhe pse ishte ekzekutuesi i kësaj politike) por, ky ka qenë zbatues i politikës së Titos. Për këtë dëshmojnë shumë historianë të huaj që janë marrë me Ballkanin, konkretisht me Jugosllavinë. Kur më 1957 shpërtheu greva e parë në Jugosllavi në minierën e Tërbovljes në Slloveni, Titoja e thirri Rankoviçin në telefon dhe i kërkoi që të shtyp punëtorët e pakënaqur me forcë.

Kur plaku (Tito) kërkon t'i sqarojnë ndonjë problem ideologjik, thirrte Kardelin. Por sa herë që i duhej ndonjë për të ndyrë duart, gjithmonë i thoshte Rankoviçit: "Hajde, Marko! Nisu!"¹⁴⁶ Siç e kemi cekur edhe më lart Rankoviçi ishte orkestruesi kryesor i aksionit të "tepricave" 1947-1949, aksionit të armëve 1955-1956. Ai kishte përgjegjësi të drejtpërdrejta për policinë e sigurimit, UDB-në, veprimet e tij kurrë nuk i nënshtroheshin mbikëqyrësit apo rishikimit për shkak të qëndrimit të tij politik. Ishte ithtar i serbocentrizmit në Jugosllavi.¹⁴⁷

Rënia e Aleksandër Rankoviçit erdhi si rezultat më shumë i frikës së Titos nga koncentrimi i pushtetit në duart e Rankoviçit dhe dalja në skenë e përgjimeve që i ishin bërë Titos nga sigurimi me urdhër të Rankoviçit se sa nga ndonjë arsye tjetër që shpesh e hasim dhe që janë naive. Ka qarkulluar ndër shqiptarë edhe miti se kinse Titoja e ka rrëzuar Rankoviçin për shkak të zullumit ndaj shqiptarëve. Kjo nuk qëndron aspak si e vërtetë sepse stenogramet e Plenumi të IV të Brionëve, të botuara në mediet serbe, askund nuk përmendet që është diskutuar për çështjen shqiptare, e aq më pak për reprezaljen ndaj shqiptarëve.¹⁴⁸ Në fillim të viteve të 60-ta, udhëheqja jugosllave ishte ndarë në dy grupe si reformist dhe dogmatist. Të parës i printe Eduard Kardeli, kurse të dytës Aleksandër Rankoviçi.¹⁴⁹ Pra, nuk qëndron ajo se për shkak të veprimeve të UDB-së, është "eliminuar" Rankoviçi, por më shumë për arsye politike, sepse Titoja donte që t'i jepte një kahje tjetër politikës jugosllave. Dhe Rankoviçi ishte bërë pengesë në shumë aspekte për Titon.

Por edhe përkundër gjithë kësaj dhune dhe reprezalje të përdorur nga shteti jugosllav në krye me Aleksandër Rankoviçin, në Kosovë asnjëherë nuk është shuar përpjeka për rezistencë, por vazhdoi rezistenca kundër pushtimit nëpërmjet organizimit të subjekteve kombëtare si, Organizata Nacional-Demokratike (1945), e drejtuar nga Ajet Gurguri, Gjon

¹⁴⁶ Misha Gleny, vep. e cit., fq. 579. Me gjerësisht shih: Barbara Jelavich, Historia e Ballkanit, Vep. e cit.

¹⁴⁷ Miranda Vickers, vep. e cit., fq. 202. Shih edhe Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 336-337.

¹⁴⁸ Milazim Krasniqi, Testamenti i Titos për shqiptarët, marrë në:

<http://www.gazetatema.net/2019/03/30/testamenti-i-titos-per-shqiptaret/?fbclid=IwAR0EC8OMYwLqvNfswgblc-throriTEMt4v6aTFIrgkME5F34x51g0hQrrhg;>
Qasur më 30.03.2019.

¹⁴⁹ Valentina Milković, Aleksandar Ranković i djelovanje Uprave državne bezbjednosti (UDB-e) od 1944. do 1966, Sveučilište Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku Filozofski fakultet Osijek, Osijek, 2016, fq. 26.

Serreqi, Halim Spahiu, Marie Shllaku etj., pastaj me përpjekjet e udhëhequra nga intelektualët, Adem Demaçi, Metush Krasniqi etj.¹⁵⁰ Në fillim të viteve të 60-ta lëvizja shqiptare filloi të kristalizohej. Më 1964, Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve me në krye Adem Demaçin, organizoi qindra veprimtarë në të gjitha trojet e pushtuara shqiptare për çlirimin e tyre dhe bashkimin, siç thoshin me nënën Shqipëri.¹⁵¹ Dhe nga kjo kohë në mënyrë të vazhdueshme ka evoluar lëvizja.

Titoja menjëherë mbas “eliminimit” të Rankoviçit përgatiti vizitën e parë në Kosovë. Kjo vizitë më shumë ishte si një shfajësim i Titos në raport me shqiptarët e Kosovës, kinse unë nuk kam asnjë mëkat, për ato vuajtje që keni përjetuar deri më tani, por fajtor është Aleksandër Rankoviçi. Të cilin për këtë arsye edhe e kam eliminuar politikisht. Edhe pse ishte jo më larg se gjashtë orë me tren, ai asnjëherë nuk e kishte vizituar.¹⁵² Nuk dihet kurrë arsyeja e vërtetë e mosvizitës së Kosovës. Ajo që më shumë ma mbush mendjen ka qenë arsyeja e frikës nga serbët se mos po konsiderohet i afërt me shqiptarët e Kosovës. Vendosija për ta vizituar Kosovën më shumë ishte një mesazh se ne jemi distancuar nga politika e Rankoviçit.

Titoja bëri edhe kritika publike gjatë kësaj vizite për kushtet në Kosovë : “ *Nuk mund të flitet për të drejta të barabarta*” deklaronte ai, “ *kur serbët kanë përparësi kudo nëpër fabrika... në raport me shqiptarët edhe pse këta të fundit kanë kualifikim të njëjtë apo edhe më të lartë*”.¹⁵³ Duke u bazuar në faktet e kohës të gjitha këto mund të merren si fraza boshe, sepse të gjitha krizat në Kosovë pas vitit 1968 do të vijnë si rezultat i mosgatishmërisë së PKJ-së për t'i dhënë popullatës shqiptare barazinë simbolike me nacionalitetet sllave, gjegjësisht statusin e republikës.¹⁵⁴

Rënia e Aleksandër Rankoviçit në shumë dimensione është një fillim i ri. Për shqiptarët e Kosovës fillon një frymëmarrje e thellë. Jugosllavia fillon të çlirohet nga makthi i nacionalizmit serb (së paku për një dekadë).¹⁵⁵ Raportet e shtetit shqiptar me Jugosllavinë relaksohen dhe nga ky relaksim përfituan shqiptarët në ish- Jugosllavi. Por rënia e Rankoviçit

¹⁵⁰ Mehmet Hajrizi, *Historia e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981*, Botimi Toena, Tiranë, 2008, fq. 30-31.

¹⁵¹ Po aty, fq. 32.

¹⁵² Po aty, fq. 204.

¹⁵³ Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 338. Shih Craig Nation, *WAR IN THE BALKANS, 1991-2002*, August, 2003, fq. 223-224. Marrë në : <https://ssi.armywarcollege.edu/pdffiles/PUB123.pdf>; Qasur më 10.01.2019.

¹⁵⁴ Momčilo Pavlović, *KOSOVO UNDER AUTONOMY 1974-1990*, vep. e cit., fq. 15.

¹⁵⁵ Këtu është fjala në aspektin publik sepse dihet mirëfilli se në vitin 1977, në Beograd klasa nacionaliste komuniste serbe hartoi “*Librin e Kaltër*”, në të cilin libër, në mënyrë të qartë, paraqitej politika mashtruese dhe nacionaliste sllave kundër shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

në korrik të vitit 1966 dhe pastrimi i aleatëve të tij në strukturat krahinore krijuan frikë se serbët tani do të ishin vetë nën presion dhe pa mbrojtje. Por kjo ishte më shumë iluzore se edhe në epokën e Rankoviçit, kisha ortodokse raportoi “*nivele shqetësuese të emigrimit*” të serbëve nga Kosova.¹⁵⁶

Pra menjëherë pas rënies së Rankoviçit filluan lidhjet më të gjera kulturore, arsimore me Shqipërinë. Është fakt se me rënien e Rankoviçit u hap rruga për nisjen e dialogut midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Edhe pse në vitet e 60-ta Shqipëria ishte në një pozitë jo të favorshme gjeostrategjike, sepse kishte prishur marrëdhëniet me BRSS-në. Udhëheqja shqiptare ndiqte me vëmendje të veçantë, zhvillimet ekonomike, shoqërore, politike, e kulturore-arsimore të shqiptarëve në Kosovë.¹⁵⁷ Një vëmendje të veçantë shteti shqiptar kishte edhe ndaj regjistrimit të popullsisë në Jugosllavi. Me regjistrimin e popullsisë në vitin 1961 në Jugosllavi shteti shqiptar shpreh shqetësimet për paraqitjen jo reale të statistikave. Lidhur më këtë MPJ-ja në një relacion e quan jo real këtë regjistrim pasi që në shpërndarjen e popullsisë shqiptare në Jugosllavi, nuk pasqyrohej shpërngulja e popullsisë shqiptare në republikat e ndryshme të Jugosllavisë që kishte shkuar për të punuar provizorisht që ishte një numër i konsideruar.¹⁵⁸

Ajo që është shumë relevante është se në fund të viteve të 60-ta udhëheqja komuniste e Shqipërisë u shpreh edhe për statusin politik të Kosovës. Gjatë viteve në fjalë ajo e parashihte zgjidhjen në bazë të alternativave të ndryshme si: pakicë kombëtare, bashkim kombëtar, autonomi, çështje që iu takon vetë kosovarëve të vendosnin vet ata. Më 1 gusht 1966 Enver Hoxha, do të theksonte: “*Pakicat kombëtare duhet të ndjekin rrugën e drejtë revolucionare, rrugën e luftës kundër klikës së Titos për çlirimin e popujve të Jugosllavisë.., kjo është rruga e çlirimit të tyre dhe vetëvendosjes*”.

Enver Hoxha edhe pse kishte filluar të ngriste çështjen e Kosovës ai, përsëri qëndronte në bindjet e tij se të luftohet që tani “*për një bashkim me Shqipërinë*”, kjo nuk të nxjerr në shteg. Për Bashkimin me Shqipërinë ka vetëm dy rrugë, rruga revolucionare dhe rruga reaksionare-shoveniste. E para, është rruga e luftës, tok me popujt e Jugosllavisë nën udhëheqjen e një partie marksiste-leniniste të vërtetë.., rrugë e cila e qon popullin shqiptar të

¹⁵⁶ Howard Clark ,Civil Resistance in Kosovo, Pluto PPress LONDON • STERLING, VIRGINIA, First published 2000 by Pluto Press, formë elektronike, fq. 12.

¹⁵⁷ S. Syla, vep. e cit., fq. 157.

¹⁵⁸ Po aty, fq. 157-158.

Kosovës në të drejtën e vetëvendosjes dhe deri me bashkimin me atdheun, Shqipërinë. Rruga tjetër, është aventurë”.¹⁵⁹

Kjo ide e Enver Hoxhës është njëri ndër faktorët kryesorë që pjesa dërmuese e ilegales sonë kanë qenë të ndikuar nga idetë marksiste-leniniste.¹⁶⁰

Duke parë interesimin e shtetit shqiptar për regjistrimin e popullsisë, serbët mundohen që këto statistika gjatë viteve të 60-ta, por edhe më vonë t'i paraqisnin se edhe serbët dhe malazezët po largohen nga Kosova nga presioni i shqiptarëve. Kjo ishte një farë revanshizmi apo kamuflimi të statistikave të regjistrimit të popullsisë. Një gjë të ngjashme do të ndodhë edhe më vonë në mesin e viteve të 80-ta, kur Akademia e Shkencave Serbe bëri një shqyrtim të 500 familjeve serbe që ishin larguar nga Kosova për në Serbi.¹⁶¹ Kjo “shpërngulje” më shumë është paraqitur si frikë pas rënies së Rankoviçit. Autoritetet serbe janë munduar t'i japin karakter politik këtyre largimeve të serbëve nga Kosova por një gjë e tillë nuk qëndron, sepse arsyet kryesore të largimit të serbëve ishin të karakterit ekonomik, social etj..¹⁶²

Pra që nga viti 1966 Kosova filloi një progres në të gjitha fushat që do të ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në ngritje kombëtare të brezit të ri. Kjo do të shihet shumë shpejt në demonstratat e vitit 1968, po ashtu në demonstratat e vitit 1981 dhe në demonstrata e vitit 1989. Fillimi i fundit të Jugosllavisë është pikërisht nga viti 1968, sepse nga kjo kohë shqiptarët e Kosovës as edhe një moment të vetëm nuk kanë reshtur së bëri përpjekje për lirinë e tyre.

¹⁵⁹ Po aty, fq. 165.

¹⁶⁰ Kjo formë e Enver Hoxhës që të ndodhë përmes rrugës revolucionare ishte një fantazi e tij se sa një realitet politik.

¹⁶¹ Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 345.

¹⁶² Po aty.

1.5 Qëndrimi i Shqipërisë ndaj lëvizjes politike në Kosovë në vitet 1945-1968.

Në bazë të dokumenteve të publikuara deri më tani shteti shqiptar gjatë viteve 1945-1966 interesimin për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi në përgjithësi nuk i kishte reshtur asnjëherë edhe atëherë kur kishte pasur marrëdhënie jo të mira me shtetin jugosllav, një gjë të tillë kishte bërë në mënyrë jopublike, pra përmes kanaleve jozyrtare. Edhe atëherë kur ka shfaqur interesim publik sado të vogël, një gjë të tillë ka bërë çdo herë duke ruajtur vijën e “miqësisë” që kishte me Jugosllavinë.

Është edhe një fakt tjetër mjaft interesant, se të dy shtetet si Shqipëria ashtu edhe Jugosllavia kanë përdorur Kosovën për taktizim ndaj njëra-tjetrës në raste të caktuara.

Bërthamat e para të grupeve ilegale nacionaliste në Kosovë i kemi që nga vitit 1945, por që nga vitit 1966 e këtej në lëvizjen ilegale atdhetare fillon një etapë e re e zhvillimit të tyre si në aspektin organizativ, po ashtu edhe në aspektin konceptual, e ky proces ka vazhduar deri në vitin 1990.¹⁶³

Zhvillimi i ilegales shqiptare në Kosovë ka pasur disa etapa, gjithsej, pesë: e para përfshin vitet 1944-1948, kjo kishte më shumë karakter politiko-ushtarak; e dyta 1949-1958, kjo është etapë kur formohen disa organizata ilegale, por jo me një koncept shumë të qartë politik; e treta 1959-1968, karakteristikë e kësaj faze ishte artikulimi i koncepteve të reja politike e kombëtare; e katërta 1969-1981 lirisht mund të thuhet se ishte një nga fazat me të bujshme të ilegales në Kosovë; dhe faza e pestë 1981-1990, karakteristikë e kësaj faze ishte grupet e vogla ilegale filluan të unifikoheshin dhe të artikulonin konceptet politike shumë më mirë.¹⁶⁴

Duke u mbështetur vazhdimisht në dokumente të publikuara deri më tani nga historianë shqiptarë dhe të huaj edhe pse politikisht nuk shfaqte ndonjë interesim të hapur për Kosovën, Shqipëria ndiqte me vëmendje të veçantë, zhvillimet ekonomike, shoqërore, politike e kulturore-arsimore në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare në ish- Jugosllavi.¹⁶⁵ Këtë përmes kanaleve operative ose edhe në forma tjera, shihet se ishte mjaft e informuar për gjendjen në Kosovë. Kjo vlen sidomos në fund të viteve të 60-ta. Pikërisht në këto vite shteti shqiptar fillon edhe haptazi të shprehet për statusin e shqiptarëve në Kosovë.

¹⁶³ Sabile Keçmezi Basha, *Kosova 1945-1990, vështrim historiko-politik*, Prishtinë, 2017, fq. 118-120.

¹⁶⁴ Po aty, fq. 121-125.

¹⁶⁵ S.Syla, vep. e cit., fq. 157.

Për interesimin e shtetit shqiptar ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve të 50-ta dhe të 60-ta na sjell të dhëna mjaft interesante historiani Sabit Syla. S. Syla na sjell statistika shumë me vlerë, ku pasqyrohen situatat demografike të popullsisë shqiptare në ish-Jugosllavi, në zonat ku popullsia shqiptare paraqiste shumicën.¹⁶⁶ Të gjitha këto statistika demografike janë të mbështetura në burime arkivore.

Më poshtë ju sjellim statistikat, ku paraqesin zonat ku popullsia shqiptare përbën shumicën

Tabela:1

	<i>RRETHET</i>	<i>SHQIPTART</i>	<i>SERB</i>	<i>MALAZEZ</i>	<i>MAQEDONAS</i>
	<i>Krahina Kosovë-Metohi (në Kosovë, s.s</i>				
	<i>Drenicë</i>	<i>31.010</i>	<i>3.078</i>	<i>875</i>	
	<i>Gjakovë</i>	<i>45.591</i>	<i>1.717</i>	<i>4.429</i>	
	<i>Gjilan</i>	<i>35.860</i>	<i>1.762</i>	<i>369</i>	
	<i>Gorë</i>	<i>12.048</i>	<i>8.075</i>	<i>-</i>	
	<i>Graçan (Graçanicë)</i>	<i>23.851</i>	<i>11.183</i>	<i>1.029</i>	
	<i>Istog</i>	<i>21.161</i>	<i>9.227</i>	<i>3.957</i>	
	<i>Kamenicë</i>	<i>24.355</i>	<i>15.321</i>	<i>-</i>	
	<i>Llap</i>	<i>35.028</i>	<i>7.538</i>	<i>1.959</i>	
	<i>Nerodime</i>	<i>40.605</i>	<i>15.721</i>	<i>427</i>	
	<i>Pejë</i>	<i>26.812</i>	<i>5.802</i>	<i>5.867</i>	
	<i>Podrime</i>	<i>36.504</i>	<i>4.945</i>	<i>1.077</i>	
	<i>Sitnicë (Lipjan, S.S)</i>	<i>27.356</i>	<i>11.562</i>	<i>768</i>	
	<i>Suvereç (Suharekë, S:S)</i>	<i>22.313</i>	<i>3.555</i>	<i>-</i>	

¹⁶⁶ Sabit Syla, vep. e cit., fq. 159.

	<i>Sharplanin</i>	<i>27.025</i>	<i>5.980</i>	<i>-</i>	
	<i>Vuçiternë</i>	<i>24.436</i>	<i>8.533</i>	<i>1.163</i>	
	<i>Mitrovicë (qytet)</i>	<i>7.491</i>	<i>4.724</i>	<i>830</i>	
	<i>Pejë (qytet)</i>	<i>10.608</i>	<i>2.785</i>	<i>3.185</i>	
	<i>Prishtinë (qytet)</i>	<i>11.442</i>	<i>5.119</i>	<i>1.142</i>	
	<i>Prizren(qytet)</i>	<i>15.499</i>	<i>4.291</i>	<i>727</i>	
	NËR.P. MAQEDONISIA				
	<i>Gostivar</i>	<i>39.345</i>	<i>180</i>	<i>-</i>	<i>13.091</i>
	<i>Gorçe Petrovski (Gjorgj Petrov, S.S)</i>	<i>14.295</i>	<i>472</i>	<i>-</i>	<i>5.521</i>
	<i>Tetovë</i>	<i>41.611</i>	<i>717</i>	<i>-</i>	<i>19.467</i>
	<i>Tetovë (qytet)</i>	<i>9.975</i>	<i>384</i>	<i>-</i>	<i>5.992</i>
	Ë SERBINË E NGUSH				
	<i>Bujanovc</i>	<i>27.174</i>	<i>25.143</i>		

Zonat ku popullsia shqiptare përbente pakicën

Tabela:2

	<i>RRETHET</i>	<i>SHQIPTAR</i>	<i>SERB</i>	<i>MALAZEZ</i>	<i>MAQEDONAS</i>
	<i>Në Kosovë-Metohi (në Kosovë, S.S)</i>				
	<i>Zveçan</i>	<i>15.247</i>	<i>23.826</i>	<i>-</i>	<i>-</i>
	<i>Në R:P: Maqedonisë</i>				
	<i>Dibër</i>	<i>7.485</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>14.516</i>
	<i>Kiçev (Kërçovë, S:S)</i>	<i>12.402</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>22.738</i>

	<i>Krushevë</i>	2.335	-	-	4.149
	<i>Kumanovë</i>	17.669	7835	-	31.544
	<i>Prilep</i>	4.518	-	-	45.531
	<i>Shkup</i>	16.123	5202	-	37.936
	<i>Strush (Strugë, S:S)</i>	11.380	-	-	20.637
	<i>Në R:P. Të Malit të Zi</i>				
	<i>Bar(Tivar,S.S)</i>	10.450	-	25.111	-
	<i>Titograd</i>	6.542	-	30.188	-

Jo vetëm në aspektin demografik, por shteti shqiptar përcillte me vëmendje edhe shtyllën kryesore të zhvillimit në Kosovë, siç ishte arsimiti. Edhe për këtë S. Sylva publikon për herë të parë disa tabela në të cilat pasqyrohet zhvillimi i arsimit në Kosovë, të dhëna të cilat shteti shqiptar i asaj kohe i ka siguruar nga burime të ndryshme informacioni.¹⁶⁷ Por, që në fund të fundit kanë rëndësinë historike dhe tregojnë interesimin dhe vëmendjen e veçantë që shteti shqiptar tregonte ndaj zhvillimit arsimor të popullsisë shqiptare në Kosovë.¹⁶⁸ Ky interesim vinte nga gjendja shumë e rëndë e arsimit shqip në Kosovë, si dhe nga frika sepse, pas presionit të vazhdueshëm gjatë gjithë viteve të 50-ta për shpërngulje në Turqi, serbët kishin filluar të hapnin shkolla turke, ku në mungesë të shkollave shqipe, shumë kosovarë do të detyrohen të dërgojnë fëmijët e tyre në këto shkolla.¹⁶⁹ Për këtë fenomen aspak të mirë për shqiptarët kishin reaguar shumë arsimtarë dhe intelektualë në mesin e tyre edhe Ziqirja Rexha dhe Mehmet Vokshi.¹⁷⁰ Gjendja në arsim ishte shumë e rëndë në të gjitha aspektet gjatë viteve të 50-ta dhe 60-ta. Rreth viteve të 60-ta krahina kishte vetëm 500 studentë.¹⁷¹

¹⁶⁷ Po aty, fq. 161

¹⁶⁸ Po aty.

¹⁶⁹ Shaban Braha, vep. e cit., fq. 489.

¹⁷⁰ Po aty.

¹⁷¹ Po aty, fq. 492.

Gjendja e shkollave fillore e 8 vjeçare 1952-1958

Tabela:3

<i>Nr. I</i>	<i>Shkolla</i>	<i>Klasë</i>	<i>Nxënës</i>	<i>Mësues</i>
<i>1952-1953</i>	<i>849</i>	<i>2729</i>	<i>107.350</i>	<i>2.231</i>
<i>1953-1954</i>	<i>898</i>	<i>2974</i>	<i>108.942</i>	<i>2.520</i>
<i>1954-1955</i>	<i>903</i>	<i>3115</i>	<i>112.100</i>	<i>2.777</i>
<i>1955-1956</i>	<i>891</i>	<i>3138</i>	<i>114.100</i>	<i>2.881</i>
<i>1956-1957</i>	<i>856</i>	<i>3164</i>	<i>113.584</i>	<i>2.867</i>
<i>1957-1958</i>	<i>847</i>	<i>3265</i>	<i>116.011</i>	<i>2.907</i>

Gjendja e arsimit të mesëm 1952-1958

Tabela: 4

<i>Nr. II</i>	<i>Shkolla</i>	<i>Klasë</i>	<i>Nxënës</i>	<i>Arsimtar</i>
<i>1952-1953</i>	<i>7</i>	<i>18</i>	<i>537</i>	<i>131</i>
<i>1953-1954</i>	<i>8</i>	<i>30</i>	<i>749</i>	<i>159</i>
<i>1954-1955</i>	<i>7</i>	<i>38</i>	<i>921</i>	<i>171</i>
<i>1955-1956</i>	<i>8</i>	<i>30</i>	<i>851</i>	<i>82</i>
<i>1956-1957</i>	<i>7</i>	<i>30</i>	<i>787</i>	<i>49</i>
<i>1957-1958</i>	<i>7</i>	<i>29</i>	<i>699</i>	<i>55</i>

*Sipas tabelës nr. 3 gjendja e shkollave fillore e 8 vjeçare, numri i shkollave është marrë me gjithë shkollat e përziera.*¹⁷²

Shqipëria në fillim të viteve të 60-ta bëhet më aktive rreth çështjes së Kosovës. Ajo tanimë kishte shtruar si platformë politike brenda institucioneve politike dhe shtetërore detyrat për t'u marrë me çështjen e Kosovës. Zhvillimet që po ndodhnin në Kosovë, kërkesat e vazhdueshme nga lëvizja ilegale drejtuar shtetit shqiptar për mbështetje të saj, e shtyn Shqipërinë që të ndërtojë një strategji të veprimit, e cila nuk dallohej shumë nga vitet e kaluara dhe nga fryma e veprimeve në baza ideologjike, por tani këtë mbështetje e gjejmë shumë më të sistemuar dhe të organizuar nga organet shtetërore.¹⁷³

Prandaj, kjo periudhë karakterizohet nga intensiteti i marrëdhënieve të PPSH-së me grupet politike shqiptare në emigracion dhe brenda në Kosovë. Megjithëse qëndrimi ndaj Kosovës në vitet 1960-1970 i Shqipërisë ishte më i qartë dhe jepte ndihma në forma të ndryshme, informacionet, udhëzimet ishin të karakterit “*tepër sekret*” dhe thuajse ilegale me grupet dhe organizatat politike shqiptare në mërgim, strukturat ndërlidhëse të shtetit shqiptar ishin zgjeruar dhe drejtimet e punës ishin të shumta.¹⁷⁴ Por një gjë e tillë nuk i kishte ikur as organeve të sigurisë së ish-Jugosllavisë. Për këtë na dëshmon një dokumentet autentik arkivor, i cili flet për emigracionin shqiptar dhe organizimin e tyre, kuptohet në kontekstin e emigracionit, kroat, slloven, maqedonas, por duke mos lenë anash edhe emigracionin serb. Dokumenti është një raport sekret i Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë dhe ka të bëjë me situatën e sigurisë dhe zbatimin e direktivave të kryetarit të Jugosllavisë. Në të flitet për emigracionin: “...emigracioni shqiptar në këtë periudhë po bën përpjekje për unifikimin e të gjitha grupeve. Në korrik të këtij viti u mbajt në Madrid një takim midis përfaqësuesve të këtyre grupeve me qëllim të unifikimit të programit. Këtë veprim siç duket e kanë nxitur amerikanët të cilët janë të pakënaqur me jounitetin e këtyre grupeve. Nuk kemi të dhëna se emigracioni shqiptar është duke përgatitur aksione diversante-terroriste, por ata kanë për qëllim të krijojnë struktura ushtarake dhe gjysmë-ushtarake prandaj edhe po i trajnojnë njerëzit e tyre në reparte ushtarake – që sipas përvojave tona një gjë e tillë çon në terrorizëm. Duhet theksuar se

¹⁷² Sabit Sylva, vep. e cit., fq. 161.

¹⁷³ Ethem Çeku, *Kosova në vitet 1960-1970 dhe qëndrimi i Shqipërisë*, Prishtinë, fq. 22, marr në, https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/11/02-2009-04_-_Ethem_Ceku.pdf, me 07.10.2017.

¹⁷⁴ Po aty.

*ekzistojnë kontakte midis emigracionit shqiptar dhe atij kroat për ndihmë reciproke kundër 'armikut të përbashkët'...*¹⁷⁵

Enver Hoxha, në këtë periudhë mendonte se çështja e Kosovës nuk është e lehtë dhe as nuk mund të zgjidhet aq shpejt, sa mendojnë disa kosovarë, me vullnet të mirë, ndërsa sa i përket realizimit të qëllimeve për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, ai thotë se *“ajo nuk mund të përcaktohet sepse nuk varet nga dëshirat”*. Lufta për çlirimin e Kosovës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi, sipas platformës politike të udhëheqjes së Shqipërisë në këtë kohë shikohej brenda hapësirës së shtetit jugosllav, sepse politika e udhëheqjes së Shqipërisë nuk ishte e gatshme të pranojë që lufta e Kosovës të shpërthejë kufijtë e Jugosllavisë.¹⁷⁶

Më 16 nëntor 1967, Enver Hoxha shkruan një artikull me titull: *“Demagogjia titiste nuk mund të mbulojë plagët e hapura të Kosovës”*. Synimet ishin demaskimi i demagogjisë titiste mbi gjendjen ekonomike politike dhe kulturore, duke bërë krahasime me gjendjen në republikat e tjera të Jugosllavisë.

Në vitin 1967 ishin thelluar edhe më shumë diferencat midis Kosovës dhe viseve tjera të zhvilluara të Jugosllavisë. Të ardhurat kombëtare për Slloveninë ishin 7588 dinarë të rinj, ndërsa në Kosovë ishin 730 dinarë aq sa mesatarja jugosllave e vitit. Këtë disproporcion Enver Hoxha e lidhte me vijën diskriminuese të politikës titiste dhe politikës shoviniste dhe të trajtimit të Kosovës vetëm si burim lëndësh të para, si një zonë e shtypjes koloniale për forcat e tepërta e të pakualifikuara të Serbisë dhe të Malit të Zi.¹⁷⁷ Enver Hoxha periudhën e asaj kohe e quan *“qetësi relative e imponuar nga krizat dhe koniunktura e brendshme që bënte regjimi titist, ndërsa “liberalizmin kulturor në Kosovë, si manovra mashtruese të rrezikshme që paralajmëronin se titistët po kurdin ndonjë tragjedi të re për shfarosjen e kombësisë shqiptare”*.¹⁷⁸

Kjo diskrepancë midis shqiptarëve të Kosovës dhe republikave tjera, avancimi i ilegales shqiptare quan në shpërthimin e demonstratave të vitit 1968. Më 27 nëntor 1968, në Prishtinë e në disa qytete të Kosovës, si dhe në disa qytete të Maqedonisë, për herë të parë u kërkua publikisht, nëpërmjet demonstratave të organizuara nga lëvizja kombëtare e kohës, që Kosova të bëhej republikë. Demonstratat e vitit 1968 të Kosovës ishin të motivuara edhe nga protestat e shumta që kishin shpërthyer në shumë vende të Evropës, si në Francë, Angli,

¹⁷⁵ Arhiv Republike Slovenije, fond: Централни комитет Комунистичке лиге, Škatla 872-KOSOVO, Savezni Sekretarijat za Unutarasnje Poslove, Bezbednosna Situacija i Sprovodjenje Direktive Presetnika Republika, Beograd, 16 setember 1972, fq. 6-7.

¹⁷⁶ Ethem Çeku, Kosova në vitet... vep. e cit., Shih edhe S. Syła, vep. e cit., fq. 166.

¹⁷⁷ Po aty.

¹⁷⁸ Po aty.

Gjermani etj.. Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë, arritën që të bëjnë jehonë në Evropë, si dhe të përcillnin mesazh të qartë në shumë vende evropiane, sidomos në Austri.¹⁷⁹ Shtypi austriak me një kujdes bukur të madh ka përcjellë demonstratat e vitit 1968. Gazeta “Wiener Zeitung”, shkruante se demonstratat në Kosovë shkaktuan dëme të mëdha.¹⁸⁰ Për këto demonstrata në mesin e shumë gazetave austriake shkruan edhe gazeta “Kleine Zeitung” me një artikull mjaft interesant “Demonstrata në vigjilje të 25 vjetorit të themelimit të Jugosllavisë së Avnojit”.¹⁸¹ Përveç gazetave të lartcekura edhe një gazetë tjetër austriake “Neue Zeit” ka bërë një analizë të thuktë dhe një parashikim profetik. Me titull “*Shqiptarët në Jugosllavi rebelohen kundër Beogradit zyrtar*”, ndër tjera konstaton “... në Krahinën Autonome të Kosovës ku banojnë mbi një milion banor të kombësisë shqiptare, të cilët zhvilluan demonstratë të ashpër, të cilat demonstrata kanë tronditur në themel paqen e brendshme të Jugosllavisë”.¹⁸²

Demonstratat e vitit 1968 shërbyen edhe si sensibilizim të çështjes së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Gjithë mediet më të rëndësishme ndërkombëtare kanë shkruar dhe kanë analizuar për demonstratat e vitit 1968. Këto demonstrata i kishte përcjellë me kujdes të madh edhe diplomacia amerikane. SHBA-ja edhe një herë u orientua nga Kosova, çështjen e të secilës nuk do t'i ndahej deri në lëvizjen përfundimtare kur edhe shkëputet Kosova nga ish-Jugosllavia.¹⁸³ Kjo e dëshmon atë se sa kanë pasur ndikim në perëndim dhe sa me interes janë përcjellë demonstratat e vitit 1968 në Kosovë nga shtypi perëndimor.

Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë nuk kishin karakter social, ashtu si janë munduar t'i paraqesin, kinse kanë pasur të njëjtat qëllime si demonstratat që kishin shpërthyer edhe në Evropë që njiheshin si lëvizje studentore, por demonstruesit evropianë kërkonin një rend më të mire shoqëror. Ndërsa lëvizja studentore e Kosovës kishte karakter kombëtar.

Demonstratat e nëntorit të vitit 1968 ishin një goditje shumë e madhe për gjithë ish-Jugosllavinë edhe pse ishin paqësore, shteti jugosllav ishte i dhunshëm, kjo dhunë kishte burimin nga frika. Pos kërkesës kryesore për Republikën e Kosovës, në ato demonstrata ishin shtruar edhe kërkesa të tjera, si: “*Duam vetëvendosje deri në shkëputje*”, “*Duam bashkimin e viseve të banuara me shqiptarë me Kosovën*”, “*Duam Kushtetutë*”, “*Duam Universitet*” etj.¹⁸⁴

¹⁷⁹ Eqerem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989*, Prishtinë, 2011, fq. 23.

¹⁸⁰ Po aty, fq. 24.

¹⁸¹ Po aty.

¹⁸² Po aty.

¹⁸³ Po aty, fq. 18.

¹⁸⁴ Ethem Çeku, vep. e cit., fq. 26. She edhe Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 53-54.

Këto demonstrata reflektojnë edhe në pozitën e shqiptarëve në Maqedoni.¹⁸⁵ Demonstratat e vitit 1968 ishin një ngjarje mjaft me rëndësi për Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi. Sepse për herë të parë shqiptarët e Kosovës hapazi në mënyrë të artikuluar i bënë edhe publike kërkesat e tyre politike. Demonstratat e vitit 1968 ndihmuan shumë në faktorizimin e shqiptarëve si etnitet politik në federatën jugosllave dhe përshpejtuan procesin politik të Kosovës.¹⁸⁶

Pastaj që nga këto demonstrata e deri me çlirimin e Kosovës për asnjë moment nuk janë ndërprerë përpjekjet së pari për republikë e me vonë edhe për çlirim. Demonstratat e vitit 1968 janë kulmi i një përpjekje disa dekadave të shqiptarëve, që nga viti 1945 deri më 1968. Më të drejtë Xhafer Shatri, veprimtar i lëvizjes, duke trajtuar demonstratat e vitit 1968 vlerëson se: *“Vetë shpërthimi i demonstratave ishte paralajmërim konkret i një rilindjeje të vërtetë kombëtare dhe fillim i një forme efektive të luftës politike, e cila me kohën do të marrë përmasat e një kryengritjeje të pandalshme të popullit shqiptar në Jugosllavi...”*¹⁸⁷

Sa i përket politikës së Shqipërisë rreth demonstratave të vitit 1968 dhe kërkesave të shtruarra në ato demonstrata, ajo nuk kishte arritur të krijonte dhe të shprehte ndonjë qëndrim konsekuent. Demonstratat e Kosovës shqetësuan edhe udhëheqjen politike të Tiranës.¹⁸⁸ Në këndvështrimin e Tiranës, kërkesa për Republikë bëri më vete shumë rreziqe.¹⁸⁹

Lufta për ruajtjen e identitetit kombëtar në Kosovë nuk mund të përkrahej nëse nuk kishte si fundament të saj ideologjinë marksiste-leniniste.¹⁹⁰ Por nuk duhet të harrohet fakti se Shqipëria ishte edhe e kushtëzuar *status quo*-ja e ruajtjes së kufijve të rivendosur pas LDB-së në Konferencën e Paqes në Paris, 1946.¹⁹¹ Ajo, në realitet, bënte propagandë të madhe në mbështetje të të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, në kuadër të të drejtave për gjuhë, për kulturë, për arsim, si të drejta njerëzore, kurse sa i përket çështjes që kishte të bënte me statusin e Kosovës, dukej paksa më e rezervuar, madje në disa raste me qëndrimet e saj shprehte një paqartësi, duke rënë edhe në pozita kundërshtuese.¹⁹²

Politika e shtetit shqiptar llogariste se ngjarjet e ndodhura në Kosovë, në këtë kohë do të përdorshin për destabilizimin e plotë të paqes në Ballkan dhe ndërhyrjeve të mundshme të

¹⁸⁵ Po aty.

¹⁸⁶ Ethem Çeku, *Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2009, fq. 9, marr në : <http://www.ethemceku.com/wp-content/uploads/2014/04/Demonstratat-e-vitit-68.pdf>. 20.09.2018.

¹⁸⁷ Mehmet Hajrizi, *Historia e një organizate politike*, vep. e cit., fq. 41.

¹⁸⁸ S.Syla, vep. e cit., fq. 173.

¹⁸⁹ Po aty.

¹⁹⁰ Po aty.

¹⁹¹ Po aty.

¹⁹² Ethem Çeku, *Kosova në vitet 1960-1970...* vep. e cit., fq. 28.

shteteve “imperialiste” dhe “social-imperialiste” në Jugosllavi dhe se kjo ndërhyrje do të sillte edhe reflektimet e saja në çështjet e sigurisë dhe të sovranitetit të Shqipërisë.¹⁹³

Udhëheqja politike e Shqipërisë i përmbahej parimit të mosndërhyrjes në punët e brendshme, respektimit të pavarësisë, sovranitetit moscenimit të integritetit tokësor të Jugosllavisë. Tirana i përmbahej politikës së ekzistencës së Kosovës brenda Federatës Jugosllave dhe çdo mbështetje ndaj saj do të behej në përputhshmëri me kushtetutën e RSFJ-së.¹⁹⁴

¹⁹³ Po aty.

¹⁹⁴ S. Syla, vep. e cit., fq 182-183.

KREU I DYTË

MARRËDHËNIET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE, 1970-1981

2.1 Kërkesa e Kosovës për të drejta kombëtare pas vitit 1970 dhe mbështetja e shtetit shqiptar

Ripushtimi i Kosovës në fund të Luftës së Dytë Botërore siç e kemi përmendur edhe në kreun e parë, u shoqërua me një dhunë brutale të ushtruar nga autoritetet jugosllave, të cilat nën maskën e “*administrimit ushtarak*” të Kosovës, pasi që përmes një terrori të papërmbajtur shtypën kryengritjen në Drenicë, vazhduan me aktet e tyre mizore për asgjësimin e popullatës faji i vetëm i të cilëve ishte të qenit shqiptar. Dëshmitarë dhe dokumente të shumta dëshmojnë se gjatë viteve 1944-1948 rreth 40.000 individë ishin eliminuar në rajonet e banuara me shqiptarë në Jugosllavi.¹⁹⁵

Në fakt, qëllimi i vërtetë, e i fshehtë, i qarqeve nacionaliste serbe ishte që të vazhdohej politika antishqiptare e dekadave paraprake, respektivisht të shfrytëzoheshin rrethanat për dëbimin e shqiptarëve dhe ndryshimin e mundshëm të strukturës etnike të popullsisë në Kosovë. Pra, të arrihej ajo çfarë nuk ishte arritur përmes programeve shoviniste serbe gjatë periudhës së Jugosllavisë monarkiste. Prandaj, në vazhden e tendencave të njëjta, nën pretekstin e aksioneve për “*spastrimit të terrenit nga bandat shqiptare*”, “*nevojave ushtarake jugosllave*” dhe “*çarmatimit të shqiptarëve*”, formacionet pushtuese serbo-jugosllave, në të cilat ishin inkuadruar edhe çetnikët e amnistuar, plaçkitnin çdo gjë në viset shqiptare, duke filluar nga ushqimi, bagëtia, mjetet shtëpiake, mjetet e punës e çdo gjë tjetër që u dilte para.¹⁹⁶

Terrori ndaj popullatës shqiptare vazhdoi edhe me veprime tjera sikurse që ishte miratimi i ligjit mbi përfitimet e luftës, që rezultoi me konfiskime të shumta të pasurive të

¹⁹⁵Lefter Nasi, “Eightmonths in the historyof the Albanianpopulation in Yugoslavia”, *The Truth on Kosova*, The AcademyofSciencesofRepublicofAlbania, EncyclopediaPublishingHouse, Tirana, 1993, fq. 229.

¹⁹⁶ Deli Thaçi & Sedat Sahitaj, *Krisma që pati jehonë*, Prizren, 2016, fq. 37.

tundshme dhe të patundshme të shqiptarëve, si dhe me “*Aksionin e armëve*” të vitit 1955/56, ku u keqtrajtuuan mbi 30.000 shqiptarë e mbi njëqind të tjerë u vranë apo u detyruan të vetëvriten.¹⁹⁷

Terrori dhe dhuna ndaj shqiptarëve, e zbatua në forma dhe metoda të ndryshme, kishte vazhduar deri në vitin 1966, kur Plenumi i Brioneve rezultoi me ndryshime në kreun politik dhe në politikën e brendshme jugosllave. Gjatë gjithë këtyre viteve, 1948-1966, Jugosllavia socialiste pretendonte barazinë e gjithë popujve që jetonin në të, por në praktikë kjo nuk vlente për shqiptarët. Pabarazia mbizotëronte në të gjitha sferat e jetës ekonomike-shoqërore, sidomos diskriminimi në përdorimin e gjuhës shqipe në arsim e kulturë, të cilën studiuesi Muhamedin Kullashi do ta emëronte: “*Si kohë të pushtimit të kujtesës historike*”.¹⁹⁸

Kthesa pozitive ndaj shqiptarëve në Jugosllavi u karakterizua apo ishte rezultat i gërshetimit të disa faktorëve brenda shteteve në fjalë dhe të rrethanave në skenën politike ndërkombëtare, sidomos nga zhvillimet në Evropën Qendrore dhe në bllokun e shteteve komuniste. Së pari, intervenimi ushtarak rus në Çekoslovaki, më 1968, kishte shkaktuar alarm në Beograd e në Tiranë. Këto dy qendra e panë të nevojshëm afrimin midis tyre për t’u shmangur nga rreziku rus. Jugosllavia, gjatë periudhave të caktuara pas Luftës së Dytë Botërore ishte përballur me kriza serioze politike, sikurse konflikti me Stalinin, Plenumi i Brioneve, ngjarjet në Kroaci e Serbi, *luftën kundër grupeve të armatosura kroate, etj.* Këto probleme u shoqëruan me presionin që buronte nga ballafaqimi i tendencave të blloqeve rivale, NATO – Pakti Varshavës, për ta dominuar botën, sidomos kur këto, për shkak të interesave të tyre që kishin në Jugosllavi që për bazë kishin vendimet nga Konferenca e Jaltës, nuk hezituan t’i dërgonin flotat e tyre në Adriatik.¹⁹⁹

Në këto rrethana, për ta ruajtur stabilitetin e brendshëm politik të Jugosllavisë, Titoja kishte qenë i detyruar të krijojë balanca të reja politike brenda vendit, sidomos pas Plenumit të Brioneve.²⁰⁰ Në këtë mënyrë, shqiptarët e Kosovës fituan një rol të rëndësishëm politik.

Qarqet e larta politike jugosllave kishin inkurajuar udhëheqësit shqiptarë të Kosovës që të jenë urë lidhëse e jo mollë sherri midis dy vendeve. Por, urë lidhëse nuk ishte vetëm Kosova, por trevat tjera të banuara me shqiptarë në Jugosllavi, si në Maqedoni dhe Mal të Zi. “*Duhet t’i hyni me guxim punës. Mos u frikësoni kaq shumë. Jepuni zemër shokëve shqiptarë të*

¹⁹⁷Mehmet Gjoshaj, *Mbledhja e “tepricave” në Kosovë, formë e plaçkitjes ekonomike dhe shtypjes politike 1946-1952*, Muzeu i Kosovës, Prishtinë, 2009, f. 9-25.

¹⁹⁸ Identiteti evropian i Kosovës, Simpozium Ndërkombëtar i mbajtur më 26-27 qershor 2007, <https://shtjello.files.wordpress.com/2011/05/identiteti21.pdf>, Qasur më 04.04.2019.

¹⁹⁹Ethem Çeku: Kosovoduring the tensesrelationsbetweenAlbaniaandYugoslaviaduringsixtiesandseventiesof the twentiethcentury, *International Relations Quarterly*, Vol. 5, No. 2(Summer 2014, fq. 13.

²⁰⁰Sabit Sylja, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Prishtinë, 2012, fq. 185.

Jugosllavisë”, u kishte thënë Titoja kryetarëve të Maqedonisë e Malit të Zi, kur këta dy kishin shkuar tek ai për konsultime lidhur me bashkëpunimin me Shqipërinë.²⁰¹

Sigurisht që Titoja kishte planet e veta lidhur me faktorizimin e shqiptarëve në Jugosllavi. Në planin e brendshëm ata do të përdreshin si pengesë për hegjemonizmin serb, kurse në planin e jashtëm si urë lidhëse me Shqipërinë, në mënyrë që ta parandalonte këtë të fundit nga ndonjë aderim të mundshëm në bllokun e Varshavës, e me këtë edhe ta hiqte rrezikun e intervenimit rus nga toka shqiptare.

Në këto rrethana edhe Shqipëria e shihte veten të rrezikuar, qoftë nga Rusia, apo edhe nga NATO-ja, prandaj interesat e saj lidheshin me Jugosllavinë. Një vështrim interesant rreth interesave të Shqipërisë për afrim me Jugosllavinë ofrohet nga studiuesi Ethem Çeku, i cili bazuar në dokumentet amerikane pohon frikën që Enver Hoxha kishte se shqiptarët që jetonin në Jugosllavi mund të nxiteshin nga Jugosllavia për të rrëzuar regjimin e tij, sidomos vihej në pah mosbesimi i tij tek gegët e aq më tepër kur shumica e kosovarëve ishin gegë.²⁰²

Nëse ndiqet ky vështrim, atëherë del se Shqipëria tek afrimi me Jugosllavinë shihte mundësinë e komunikimit me popullsinë shqiptare në këtë vend e me këtë edhe parandalimin e dyshimeve të cekura më lart.

Në këtë mënyrë, Shqipëria dhe Jugosllavia u detyruan të afrohen mes vete. Marrëdhëniet e shkëputura më 1948, ku një rivendosje të mirëfilltë të marrëdhënieve midis dy vendeve ndodhën në shkurt të vitit 1971, kur misionet e tyre diplomatike u avancuan në statusin e ambasadave duke shënuar kështu një etapë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve.

2. 2 Kushtetuta e vitit 1974

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova me Kushtetutën e parë të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, miratuar më 31 janar 1946, u definua si njësi autonome territoriale-administrative brenda Serbisë e quajtur “*Qarku Autonom i Kosovës dhe Metohisë (QAKM)*”. Kosova nuk kishte as statusin e krahinës, të cilën e kishte Vojvodina. Ky qe bashkim i dhunshëm i Kosovës me Serbinë. Kosova fitoi një lloj kushtetute më 1946, ndërsa shumica

²⁰¹ Veton Surroi, *Fadil Hoxha në veten e parë*, Koha, Prishtinë, 2010, fq. 324.

²⁰² E. Çeku: Kosovo during the tensesrelations..., fq. 3.

shqiptare fitoi statusin zyrtar të pakicës. Vitet e '50 dhe '60 shënuan rritjen e terrorit shtetëror mbi shqiptarët, duke prodhuar valë të mëdha shkombëtarizimesh e emigrimesh në Turqi.²⁰³ Kjo dhunë e orkestruar nga aparati shtetëror jugosllav ndikoi në shpërthimin e pakënaqësive të mëdha të shqiptarët e Kosovës. Rast konkret ishin demonstratat e vitit 1968, ku demonstrata ka pasur në shumë vende të Jugosllavisë edhe në Beograd, por dhunë është përdorur vetëm ndaj demonstruesve në Prishtinë e Tetovë.²⁰⁴

Me Kushtetutën e 7 prillit 1963, RFPJ-ja shndërrohet në Republikë Socialiste Federative të Jugosllavisë, ndërkaq Kosova shpallet Krahinë Autonome.²⁰⁵ Në po këtë vit aprovohet statuti i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë, si pjesë e ndryshimeve kushtetuese në kuadër të Jugosllavisë dhe Serbisë. Ky statut përkufizonte Kosovën si bashkësi shoqërore e politike në kuadër të Republikës së Serbisë, e themeluar si njësi autonome në vitin 1945 me vendimin e Kuvendit të Serbisë. Kosova nuk kishte status kushtetues në nivel federativ.²⁰⁶

Ligji Kushtetues për Kosovën i miratuar në shkurt të vitit 1969 nisi rrugën që Kosova të ketë një kushtetutë të saj. Këto ndryshime erdhën si rezultat i demonstratave popullore të vitit 1968, të cilat sollën në përmirësimin e statusit të shqiptarëve.

Në vitin 1969 gjuha shqipe u lejua me ligj gjuhë e dytë zyrtare, krahas gjuhës serbo-kroate; u legalizua përdorimi i flamurit kombëtar; ndërsa në nëntor 1969 Kuvendi i Kosovës shpalli ligjin për themelimin e Universitetit të Kosovës, i cili do të jetësohet më 15 shkurt 1970.²⁰⁷

Kushtetuta e vitit 1974, e ngriti Kosovën në element të federatës jugosllave, duke krijuar kështu jo vetëm një lidhje të drejtpërdrejtë me bashkësinë jugosllave, por duke e ngritur Kosovën në një entitet të fortë juridik.²⁰⁸ Studiuesi Enver Hoxhaj konstaton: “*Në sistemin politik të Jugosllavisë pas viteve 1970, Kosova ka pasur të gjitha institucionet dhe atributet e një njësie të barabartë federale me republikat tjera*”.²⁰⁹ Më tutje ai shpjegon “*Ato kanë përfshirë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, tërësinë territoriale dhe kufijtë e saj. Madje, ekzistonte edhe një institucion, i njohur si sekretariati për botën e jashtme, i cili në periudhën ndërmjet viteve 1972-1977 ishte nën*

²⁰³ <http://plisi.org/shtetligj/gjitha-kushtetutat-kosoves/marr> ; Qasja më 31.10.2017.

²⁰⁴ Jakup Krasniqi, Pranvera e Lirisë '81, Prishtinë, 2011, fq. 14.

²⁰⁵ <http://plisi.org/shtetligj/gjitha-kushtetutat-kosoves/marr> ; Qasja më 31.10.2017.

²⁰⁶ Po aty.

²⁰⁷ Po aty.

²⁰⁸ Po aty.

²⁰⁹ Enver Hoxhaj, *Ngritja e një shteti, politika e jashtme e Kosovës*, Tiranë, 2016, fq. 22.

*udhëheqjen e Ukshin Hotit.*²¹⁰ Edhe përkundër asaj që thekson studiuesi Hoxhaj që Kosova ka pasur atributin e të barabartit në mesin e të barabartëve, Kushtetuta e RSFJ-s e viti 1974 nuk kishte një kapitull të veçantë për krahinat autonome, por vetëm që ato organikisht e gjenin veten në mjaft prej neneve të saj, duke filluar, madje, që nga parimet themelore mbi të cilat ishte ndërtuar gjithë sistemi ekonomik, politik e shoqëror i Federatës.²¹¹

Punët e jashtme dhe mbrojtja kanë qenë në kuadër ekskluzivisht në nivel federativ.²¹² Për këtë dëshmon një bisedë e vitit 1975 midis z.Ukshin Hotit dhe sekretarit të Ambasadës së SHBA-së në Beograd z. Keneth Hill. Ku zoti Hoti çdo herë flet në kontekstin jugosllav për të gjitha problemet. Edhe atëherë kur sekretari i ambasadës amerikane interesohej për demonstratat e vitit 1968, për burgosjen e organizatorëve të tyre dhe për arrestimin e informbyroistëve.²¹³

Një ndër ish-funksionarët kryesorë të Kosovës, Fadil Hoxha, nxjerr një konstatim mjaft interesant, interesant për faktin që thuhet nga vet ai. Dhe mendoj që është një konstatim i drejtë, kur Fadil Hoxha konstaton: “ *E kam një bindje se me Kushtetutën e vitit 1974 është garantuar me plot kuptimin e fjalës barabarësia e plotë e shqiptarëve. Por është një gjë krejt tjetër ajo se sa është realizuar praktikisht kjo*”.²¹⁴

Kushtetuta e Kosovës e viti 1974 nuk është pritur mirë nga shumë qarqe serbe. Serbët pas rënies së Rankoviqit kishin filluar të ndihen si të pambrojtur, kjo frikë u shtua sidomos pas miratimit të kushtetutës jugosllave të vitit 1974, e cila iu dha pushtet më të madh republikave konstituive dhe i bëri më të vërtetë krahina autonome e Kosovës dhe Vojvodinës.²¹⁵ Pra miratimi i Kushtetutës së 1974-ës hasi në kundërshtime të ashpra në Serbi. Vazhdimisht u shfaqen ankesa se kushtetuta na qenka hapi i parë për shkëputjen e Kosovës dhe për bashkimin e saj me Shqipërinë.²¹⁶ Kështu Kosova u njoh si pjesë konstituive e Federatës Jugosllave dhe u bë me kushtetutë të veten. Sipas kushtetutës së vitit 1974, kuvendi shfaqet si organi vetëqeverisës dhe më i larti i pushtetit në Kosovë në kuadër të të drejtave dhe detyrave të tij. Kuvendi i Kosovës përbëhej nga tri dhoma: Dhoma e Punës së Bashkuar (90 delegatë), Dhoma

²¹⁰ Po aty.

²¹¹ Historia e Popullit shqiptar, IV, vep. e cit., fq. 352 .Shih : Ana Lalaj, *KOSOVA rruga e gjatë drejt vetëvendosjes*, Tiranë, 2000, fq. 224-225.

²¹² Memli Krasniqi, *Hysen Matoshi, Kujtesa Kolektive: Dëshmi dhe ngjarje 1944-1966*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016, fq. 21.

²¹³ ASHAK, fondi: Sekretariati Krahinore për Marrëdhëniet me Botën e Jashtme, viti 1968-1991, lënda 1-200, kutia 7, fq. 1.

²¹⁴ Fadil Hoxha në vetën e parë, me shënime dhe parathënie të Veton Surroit, Prishtinë, 2010, fq. 362.

²¹⁵ Branimir Anzuloviç, *Serbia Hyjnore nga miti te gjenocidi*, Prishtinë, 2017, fq. 172-173.

²¹⁶ Enver Hoxhaj, *Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës*, Pejë, 2008, fq. 10.

së Komunave (95 delegatë) dhe Dhoma Shoqërore-politike (50 delegatë).²¹⁷ Pra kjo ishte hera e parë, ku kushtetuta si aktin më të lartë juridik dhe politik, e fituan Kosova dhe Vojvodina.²¹⁸ Një vlerë e pakontestueshme kësaj kushtetute është fakti që në dallim nga sistemi kushtetues i vitit 1963, në sistemin e ri kushtetues të vitit 1974, barazia e gjuhëve të kombeve me ato të kombësive sanksionohej në të gjitha nivelet. KSA e Kosovës fitoi të drejtën që të përcaktonte me kushtetutën e saj gjuhën që të përdorej në organet shtetërore dhe në organizatat në territorin e krahinës.²¹⁹

Por, në dallim nga parimet themelore, në këto nene shihet se pjesëmarrja e republikave dhe krahinave nuk është plotësisht i barabartë. Pozita kushtetuese juridike e Kosovës, sipas kushtetutës së vitit 1974 të ish-Jugosllavisë në shumë sfera ishin të ngjashme, por jo krejtësisht të barabarta me pozitën e republikave socialiste.²²⁰ Në to sanksionohet përfaqësimi me numër të barabartë vetëm për republikat, ndërsa për krahinat autonome jo.²²¹

Kosova ishte e përfaqësuar në mënyrë të barabartë me republikat në kryesinë e RSFJ-së. Ky organ përbehej nga një anëtar prej secilës republikë dhe secilës krahinë autonome.²²² Ndërsa në Këshillin Ekzekutiv Federativ e në Gjykatën e Lartë Federative krahina përfaqësohej në mënyrë adekuate.²²³ Sipas studiuesit të jurisprudencës Arsim Bajrami: *“Gjyqësia në të gjitha instancat, që nga gjykata komunale deri në Gjykatën Supreme ka qenë në kompetencë të Kosovës”*.²²⁴ Por shumë shpejt është kuptuar se gjyqësori në Kosovë ka qenë i instrumentalizuar skajshmërisht nga organet federative dhe të republikës serbe.²²⁵ Parimi i përfaqësimit adekuat të krahinave ishte konkretizuar edhe në rastin e përcaktimit të përbërjes së komiteteve ndërrepublikane të Gjykatës Kushtetues të Jugosllavisë.²²⁶ Në këtë organ zgjidheshin nga dy anëtarë prej secilës republikë dhe nga një anëtar prej secilës krahinë autonome.²²⁷ Edhe pse pohimi i vazhdueshëm i elitës së shkencës dhe politikës serbe se *“Kosova ishte në përbërjen e Serbisë”*, por një gjë e tillë nuk ka mbështetjen e vet konstitucionale as nga pozita e përcaktuar e Kosovës me amendamentet e Kushtetutës të ish-Jugosllavisë së viteve 1968-1971, dhe sidomos jo me

²¹⁷ Jusuf Buxhovi, KOSOVA nga Konferenca e Londrës deri të protektorati ndërkombëtar, Prishtinë, 2012, fq. 367.

²¹⁸ Azem Vllasi, vep. e cit., fq. 195.

²¹⁹ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 233.

²²⁰ Arsim Bajrami, Historia e Konstitucionalizmit shqiptar 1912-2012, Prishtinë, 2014, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, fq. 192.

²²¹ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 226.

²²² Po aty, fq. 228.

²²³ Po aty.

²²⁴ Arsim Bajrami, vep. e cit., fq. 194.

²²⁵ Kjo është dëshmuar me dënimet drakonike ndaj demonstruesve të vitit 1981, që ishin kryekëput të ndikuar nga organet federative.

²²⁶ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 226..

²²⁷ Po aty.

Kushtetutën e ish-Jugosllavisë të vitit 1974, kur Kosova kishte në themel pozitë të ngjashme, ndonëse jo të barabartë me pozitën e republiko-shtetërore të njërive tjera”.²²⁸ Studiuesi i mirënjohur i fushës së jurisprudencës Esat Stavileci nuk pajtohet më atë që kanë përdorë serbët se “Kosova ishte në përbërje të Serbisë” për këtë sjell disa argumente historike-juridike si në vijim:

“E para, Kosova nuk ishte në përbërjen e shtetit sovran dhe të pavarur të Serbisë me subjektivitetin juridik ndërkombëtar të pranuar në Kongresin e Berlinit 1878;

E dyta, Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë në Kuvendin e dytë të AVNOJ-it 1943;

E treta, Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë gjatë konstituimit të saj si njësi federale në Këshillin Antifashist të Çlirimit Popullor 1944;

E katërta, Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë në strukturat e Asamblesë Kushtetutëdhënëse të Jugosllavisë me rastin e shpalljes së Republikës Federative të Jugosllavisë 1945;

E pesta, Kosova nuk ishte e inkuadruar në Serbinë sovrane dhe të pavarur, veçse në përbërje të “Serbisë Federale në kuadër të Jugosllavisë Federative” 1945.”²²⁹

Këtë që ka konstatuar Akademik Stavileci është dëshmuar më vonë, në fund të viteve 80-ta. Sepse është pikërisht konstatimi i Stavilecit, frika kryesore që ka qar serbët në periudhën e mëvonshme, pra gjatë krizës së ish-Jugosllavisë sidomos kur afrohej fundi i zhbërjes së saj, duke e ditur gjendjen faktike se Kosova juridikisht ka kontestime të mëdha, se kurrë nuk ka qenë pjesë e Serbisë, serbët erdhën në përfundimin se suprimimi i autonomisë do ishte një argument për diplomacinë serbe në arenën ndërkombëtare. Pra të paraqitet Kosova se ka qenë çdo herë pjesë përbërëse e Serbisë. Pra Serbia ka paraqitur kundërgjegje për këtë që theksuam më lart edhe në Komisionin e Badinterit për ish- Jugosllavinë në fillim të viteve 1990.²³⁰

Më zgjedhjet e reja kushtetuese, republikat dhe krahinat fituan shumë funksione shtetërore, kuptohet brendapërbrenda shtetit të përbashkët federativ.²³¹ Edhe krahinat (Kosova dhe Vojvodina) *de facto*, por në shumë aspekte edhe *de jure* u bënë elemente konstituive të federatës. Kushtetuta e katërt e Jugosllavisë 1974 kufizoi në masë të konsiderueshme

²²⁸ Esat Stavileci, Pajazit Nushi, Të vërteta për Kosovën, Prishtinë, 2000, fq. 52.

²²⁹ Po aty, fq. 52. Arsim Bajrami, vep. e cit., fq. 196-197.

²³⁰ Shih më gjerësisht, Enver Hasani, Shkëlzen Gashi, Enver Buçaj, Mendimet e Komisionit të Badinterit për ish-Jugosllavinë, shpërbërja, vetëvendosja dhe trashëgimi i shteteve, Prishtinë, 2006.

²³¹ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 197.

kompetencat e federatës, ndërsa i zgjeroi ato të republikave dhe krahinave autonome.²³² Ato përfaqësoheshin drejtpërdrejt në organet federative, jo nëpërmjet Serbisë.²³³

Dallimi fundamental në mes të republikave dhe krahinave qëndronte në faktin se këto të parat pranë definicionit “*bashkësi shoqërore dhe politike*” kishin edhe atributin e shtetit, kurse definicioni i krahinave nuk e përmbante këtë formulim.²³⁴ Decentralizimi u jep njësisve federale një autonomi shumë të madhe ekonomike dhe kulturore. Por Republika e Serbisë në këtë rast ishte më specifike përsëri, sepse kishte nën ombrellën e vet dy krahinat, Kosovën dhe Vojvodinën, pra këto dy të fundit kanë pasur një status më të ulët.²³⁵ Dallimi tjetër midis republikave dhe krahinave ishte se në nenin 1 të kushtetutës së RFSJ-së, ku radhiteshin gjashtë republikat dhe dy krahinat, të cilat përbënin shtetin federativ, për Kosovën dhe Vojvodinën pasonte shtesa “... të cilat janë edhe në përbërje të Serbisë”.²³⁶

Një element tjetër që kam hasur gjatë hulumtimit tim është edhe një fakt tjetër shumë me rëndësi që e bën Kosovën jo të barabartë me republikat, ky fakt është pamundësia që Kosova të ketë një qasje të lirë dhe të drejtpërdrejtë me shtetet tjera edhe pse ka ekzistuar sekretariati për botën e jashtme. Edhe pse Kosova më Kushtetutën e vitit 1974 kishte bërë disa arritje, në shumë sfera, përsëri Kosova nuk ishte plotësisht e lirë në politikën e jashtme, ishte mjaft e varur përsëri nga RS e Serbisë. Kontrolli dhe diktati i saj në këtë fushë ishte i ndjeshëm. Si fakt për këtë ishin marrëdhëniet e KSA-së të Kosovës me RPS-në e Shqipërisë.

Për çdo aktivitet kulturor ose shkencor në mes të shtetit shqiptar dhe Kosovës, do të lajmërohej qysh në fillim e do të merrej pëlqimi i organeve kompetente të RPS-së së Serbisë.²³⁷ Edhe pse në kushtetutë parashihen edhe fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare me botën e jashtme dhe i jepej mjaft të “drejtë”. Por kjo më shumë ka patur vlerë për marrëdhënie ekonomike, kulturore dhe arsimore deri diku.²³⁸ Kryesisht me ato vende ku Jugosllavie kishte marrëdhënie shumë të ngushta politike. Kosova në politikën e jashtme ishte në një shkallë të konsiderueshme e varur nga RS e Serbisë.²³⁹

Kjo është një dëshmi se Kosova nuk kishte elemente shtetërore, kur dihet se një ndër karakteristikat kryesore të një shteti është aftësia dhe mundësia për të hyrë në marrëdhënie diplomatike me shtetet tjera. Por, edhe përkundër shumë mangësive megjithatë Kushtetuta e re i

²³² Miranda Vickers, vep. e cit., fq. 219.

²³³ Po aty.

²³⁴ Po aty.

²³⁵ Bernard Lory, vep. e cit., fq. 146-147.

²³⁶ Po aty, fq. 197. Shih edhe N. Malcolm, vep. e cit., fq. 340-341.

²³⁷ Historia e Popullit Shqiptar IV, vep. e cit., fq. 353.

²³⁸ Arsim Bajrami, vep. e cit., fq. 194.

²³⁹ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 227-228.

dha mundësi Kosovës të dilte si një faktor i pavarur në federatën jugosllave, jo më nën tutelën e drejtpërdrejt të Serbisë.²⁴⁰ Pra nuk ishte Kosova si para vitit 1966.

Kosova kishte bankën e vet kombëtare, gjykatën e lartë dhe administratën e pavarur nën mbikëqyrjen e këshillit ekzekutiv. Në fusha tjera, përfshirë politikën ekonomike, taksat, arsimin dhe kulturën, Republika e Serbisë kishte të drejt të miratonte ligje të vlefshme për krejt republikën vetëm me miratimin paraprak të kuvendit të krahinës.²⁴¹

Aspekti tjetër që kushtetuta e vitit 1974 që ka kufizuar de facto dhe de jure krahinën e Kosovës, ishte fusha ushtarake. Ne kemi cekur edhe më lart se pikërisht ishin fusha e politikës së jashtme dhe ajo ushtarake që ishin në kudër Federatës (Republikës Serbe).

Kushtetuta e RS-së e Serbisë fushën e mbrojtjes popullore e ka saktësuar si fushë me interes të përbashkët për të gjitha kombet e kombësitë e republikës. Për rrjedhojë aktiviteti i KSA-së së Kosovës në këtë fushë ishte i kufizuar në maksimum.²⁴² Edhe pse me kushtetutën e '74-ës Kosova ka “gëzuar” një mëvetësi të ngjashme me republikat tjera,²⁴³ por de fakto një gjë e tillë as për së afërmi nuk ka ekzistuar. Kushtetuta e RSF-së së Jugosllavisë e vitit 1974, megjithëse proklamonte decentralizimin e mëtejshëm të federatës, nuk i siguroi krahinës asgjë më shumë se amendamentet e vitit 1968 -1972. Me kushtetutën e vitit 1974, në këtë fushë federata nuk ka bartur në krahinë kompetenca të reja, burimore.²⁴⁴

Jam i mendimit se Akademiku Gazmend Zajmi kishte të drejtë kur konstatonte për kushtetutën e vitit 1974: “ ... Kushtetuta e vitit 1974, synonte të amortizonte dhe të balanconte konfliktësinë shqiptaro-serbe që shkaktohej përmes tendencave konfliktore për status plotësisht të barabartë të Kosovës në Federatë.”²⁴⁵ Pikërisht nga ky synim balancimi, doli edhe pozita kushtetuese hibride e Kosovës në suaza të federalizmit multinacional.²⁴⁶ Por edhe për kundër këtij synimi kushtetuta e vitit 1974 nuk i arriti t’i zbusë kundërthëniet mes sferave të interesit të republikave dhe popujve që përbënin federatën jugosllave.²⁴⁷

Kjo kushtetutë, solli ndryshime të mëdha në strukturën organizative të shtetit jugosllav, por thelloi ndasitë, sidomos mes kroatëve dhe serbëve.²⁴⁸ Edhe për shqiptarët e Kosovës, nuk

²⁴⁰ M. Vickers, vep. e cit., fq. 220.

²⁴¹ M. Vickers, vep. e cit., fq. 220.

²⁴² Aana Lalaj, vep. e cit, fq. 228-229.

²⁴³ A. Bajrami, vep. e cit., fq. 195.

²⁴⁴ Po aty.

²⁴⁵ Esat Stavileci, Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit, Prishtinë, 1997, fq. 60.

²⁴⁶ Po aty.

²⁴⁷ Ethem Çeku, Raportet dhe kundërthëniet brenda federatës jugosllave, VJETARI, Arkivi Shtetëror i Kosovës, 41-42, Prishtinë, 2009, fq. 357.

²⁴⁸ Po aty.

ishite një zgjidhje e kënaqshme sepse statusi i Kosovës ishte i dyfishtë sepse ai u përkufizua ende si një provincë brenda Serbisë, si një gjest ngushëllues për Beogradin.²⁴⁹

Kushtetuta e vitit 1974 duhet parë si kompromis në debatin kushtetues të viteve të 1960-ta rreth pozitës juridike dhe politike të Kosovës në Jugosllavi, në të cilën kosovarët angazhoheshin për një republikë të Kosovës. Ndërkaq, sipas përfytyrimeve serbe, Kosova duhet të mbetej një rajon i Serbisë.

Josip Broz Tito përpigëj që ta krijonte një baraspeshë në politikën e pushtetit midis përbërësve konstitutivë të federatës, jo vetëm për ta zbutur *“konfliktin e kombësive”* mes centralizmit beogradas dhe njësisive të tjera të federatës që po e kërcënonte ekzistencën e shtetit jugosllav. Kushtetuta e federatës jugosllave e vitit 1974 ka shërbyer për këtë, pra për ngritje në mënyrë të ndjeshme pozitën e krahinave autonome por edhe atë të republikave brenda federatës.²⁵⁰

Por, edhe për kundër gjithë këtyre të lartcekurave, një fakt është i pamohueshëm, çka e ka dëshmuar koha, se kushtetuta e vitit 1974 përmbante farën e pakënaqësisë për të gjithë,²⁵¹sepse të gjithë ndiheshin ngapak humbës me këtë kushtetutë. Shqiptarët nuk ndiheshin të plotësuar pa një republikë dhe ajo që i irritonte më shumë shqiptarët ishte që nuk konsideroheshin si komb, por si kombësi. Sipas intelektualit të mirënjohur kroat Branko Harvat: *“Kushtetuta e vitit 1974 ishte një kompromis në mes forcave kosovare dhe atyre serbe”*.²⁵² Ka nga ata studiues që shkojnë edhe më larg për rëndësinë e ndryshimeve të kushtetutës që ndodhen në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1968-1974.

Ndryshimet kushtetuese në 1968 i dhanë fund mbizotërimit të Serbisë në Kosovë dhe Vojvodinë, deri në ngritjen e Millosheviqit në fund të viteve 1980-ta. Megjithatë kjo është tejet naive sepse asnjëherë nuk është kufizuar mbizotërimi serb në ish-Jugosllavi. Historiografia serbe këtë periudhë e paraqet si periudhë në të cilën Republika e Serbisë mbështeti me të gjitha potencialet e saj zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke tentuar t’i paraqes këto ndryshime si rrjedhojë e investimeve të saj.²⁵³

²⁴⁹ Yugoslavia from a Historical Perspective, Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, Belgrade, 2017, fq.

²⁸⁷ <http://www.yuhistorija.com/doc/yugoslavia%20from%20a%20historical%20perspective.pdf>; Qasur më 20.02.2019.

²⁵⁰ Arben Hajrullahu, Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE, Përkthyes nga gjermanishtja në shqip: Rexhep Bajrami, Botuar në Prishtinë, 2015, fq. 61.

²⁵¹ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 229.

²⁵² Cituar sipas Ethem Çeku, Kosova në sfondin e Diplomacisë... vep. e cit., fq. 123.

²⁵³ Spasoje Djakovic, Sukobi na Kosovu, (Narodna knjiga, Beograd, 1984); Millosh Mishovic; Dragoslav Draža Markovic, zviti u polici, 1967-1978, (RAD,Beograd, 1987. Cituar sipas Ethem Çekut

Edhe pse kjo periudhë konsiderohet nga shumë studiues si një qetësi relative e Kosovës, kjo qetësi mund të quhet për shumë fusha por jo edhe për atë politike. Kjo lëvizje e Titos ishte bërë pasi kishte nuhatur saktë se ëndrra prore e gjallë për Serbinë e madhe, e mbarsur me mbizotërimin serb në administratën federative dhe në forcat e armatosura, paraqiste hakërrimin më të rrezikshëm për të ardhmen e Jugosllavisë.²⁵⁴ Por këto reforma kushtetuese nuk sollën zgjidhje afatgjate, sepse Titoja duke ndjekur taktikën e tij të zakonshme të balancimit, decentralizimin e strukturës administrative dhe të partisë e nyjëzoi me një ricentralizim të forcave të armatosura dhe me një rritje të ndikimit dhe statusit të armatës.²⁵⁵ Pra Titoja centralizoi shumë më shumë pushtet në armatë. Por, për rrjedhojë, Titoja me këto veprime njëkohësisht rriti frikën e serbëve dhe bëri më tunduese për ta që t'i kanalizonin frikën e tyre kah agresioni i armatosur.²⁵⁶ Kjo frikë dëshmohet edhe me reagimin e shumë intelektualëve serbë në forma të ndryshme, menjëherë pas miratimit të kësaj kushtetute, ku u botua një poezi e Tanasije Mladoniviçit që shprehte frikën për zhdukjen e Serbisë...²⁵⁷ E njëjta drojë vërehet edhe në romanin e Milorad Paviçit, "*Fjalori i Hazarëve*" një roman që ka arritur suksese ndërkombëtare. Një kritik italian, ndër tjera, vë në dukje se prapa fabulës së romanit qëndron fshehur ankthi i serbëve, i një kombi të vogël e në rrethim, të tmerruar nga zhdukja.²⁵⁸ Një gjë e tillë është vërtetuar në fillim të viteve 90-ta.

Titoja pasi arriti të krijojë një stabilitet politik me kushtetutën e vitit 1974, që i kishte munguar që nga vitit 1966 pas rrëzimit të Aleksandër Rankoviçit. Tito do t'u kthehet fanatikëve të Lëvizjes për Bashkim Kombëtar në Kosovë. Adem Demaçi me grupin e tij më të ngushtë të përberë nga 19 veta do të arrestohen në vitin 1975, ndërsa gjykata e qarkut në Prishtinë, në shkurt të vitit 1976 do t'ua shqiptojë dënimin me burg të rëndë nga 15 deri në 4 vjet.²⁵⁹ Krahas Adem Demaçit që do të dënohet me 15 vjet burg (kjo ishte burgosja për herë të tretë), më të do të dënohet edhe Skënder Kastrati 12 vjet burg, Hetem Bajrami 7 vjet, Hasan Dërmaku 10 vjet, Osman Dumoshi 7 vjet, Rexhep Mala 9 vjet, Xhavit Dërmaku 9 vjet, Ilaz Pireva 7 vjet, Fatmir Salihu 7 vjet, Selatin Novosella 7 vjet, Sherif Masurica 7 vjet, Sami Dërmaku 6 vjet, Zijadin Spahiu 5 vjet, Isa Kastrati 6 vjet, Ahmet Hoti 6 vjet, Njazi Korça 6 vjet, Irfan Shaqiri 7 vjet,

"Raportet dhe Kundërthëniet brenda Federatës jugosllave, VJETARI, Arkivi Shtetëror i Kosovës, 41-42, Prishtinë, 2009, fq. 367.

²⁵⁴ Branimir Anzuloviç, vep. e cit., fq. 173.

²⁵⁵ Po aty.

²⁵⁶ Po aty.

²⁵⁷ Po aty, fq. 174.

²⁵⁸ Po aty, fq. 1974-1975.

²⁵⁹ Jusuf Buxhovi, KOSOVA, vep. e cituar, fq. 381.

Hilmi Ramadani 5 vjet, Nazmi Shurdhani 4 vjet.²⁶⁰ Adem Demaçi ngarkohet me akuzën për organizim “kundër popullit dhe shtetit”.

Kjo tregon qartë se në këtë rast nuk ishte rëndësi vepra, por ideja.²⁶¹ Ky veprim me organizimin siç njihet si Procesi i Prishtinës të vitit 1975, siç u thoshte eliminimin nga jeta politike të armikut numër një të tyre, Adem Demaçit, qëllim tjetër ishte edhe hakmarrja ndaj organizatorëve të demonstratave të vitit 1968.²⁶² Kjo është një dëshmi se stabiliteti më shumë ishte vizual se sa realisht si është proklamuar në atë kohë dhe si proklamohet edhe sot nga një numër i madh i studiuesve. Gjithashtu këta janë akuzuar edhe për bashkëpunëtor megjithatë të shërbimit informativ të shtetit shqiptar.

Nga një vëzhgues pa ngarkesë politike apo nacionale shihet qartë se të gjitha këto masa ishin një preventivë për mosshtrirjen e mëtutjeshme të organizatave nacionaliste ilegale në Kosovë, që tani veç kishin shtrirë rrënjët në shumë shtresa të shoqërisë sidomos te studentët.

Funksioni më i rëndësishëm unik mbeti roli prijësit të LKJ-së, si forca kryesore politike kohezive, që duhet të ruante unitetin e vendit. Funksioni i kryetarit të Jugosllavisë ishte paraparë vetëm për Titon.²⁶³ Kryetari i shtetit dhe LKJ-së, si parti në pushtet, Josip Broz Tito, i cili në kohën e miratimit të Kushtetutës së re të Jugosllavisë tashmë ishte 82 vje, më këto reforma u përpoq ta përgatiste vendin për një mbijetesë të mundshme edhe pas tij, por me njësi të barabarta federale dhe barazi etnike.²⁶⁴ Konstatimi Vllasit nuk qëndron shumë sa i përket barazisë etnike.²⁶⁵ Ky avancim gjysmak i statusit politik do të lë shumë probleme. Të gjithë ata që rezistonin në Kosovë dhe kërkonin të drejta të plota u përdoqën si më parë. Me këto ndryshime, edhe pse gjysmake, nacionalizmi serb nuk do të pajtohej.

Menjëherë pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974, nacionalizmi serb u hodh në ofensivë. Këtë e dëshmon ajo se nën udhëheqjen e Drazha Markoviçit, atëherë kryetar i Kuvendit të Serbisë, një grup punues ka përgatitur dhe ka botuar të ashtuquajturën Libri i Kaltër (Plava Knjiga), me titull “*Pozita e serbëve në Jugosllavi në Bazë të Kushtetutës së vitit 1974 duhet rishikuar ngase Serbinë e tkurr në Pashallëk të Beogradit.*”²⁶⁶ Pas reagimeve të shumta libri është hequr nga qarkullimi.

²⁶⁰ Po aty.

²⁶¹ Po aty.

²⁶² Selatin Novosella, 75 Kosova, Procesi Politik i Prishtinës, 2012, fq. 39.

²⁶³ Jusuf Buxhovi, vep. e cit., fq. 196.

²⁶⁴ Po aty, fq. 196.

²⁶⁵ Sepse as gjatë kohës së Titos as pas vdekjes së tij nuk ka pasur barazi etnike, por kanë qenë më të favorizuar shumë më shumë.

²⁶⁶ Fadil Hoxha në vetën e pare, vep. e cit., fq. 364.

Pavarësisht nga arritjet pozitive për autonominë e Kosovës, që bart sistemi kushtetues i vitit 1974, ai kishte edhe kufizimet e veta. Parimi kushtetues i barazisë kombëtare që sanksiononte Kushtetuta e RSF-së së Jugosllavisë për statusin politik të popullit shqiptar, respektivisht të KSA-së së Kosovës, nuk ishte konsekuent. Kjo shihej në gjithë përmbajtjen e Kushtetutës, po edhe me rastin e ngjarjeve të pas vitit 1981. Pra, viti 1974 për Kosovën ishte pika më e lartë e të arriturave që nga viti 1913 në shumë aspekte. Por, nuk ishte ashtu si është proklamuar dhe si mbrohet akoma sot nga historiografia më e re serbe. Megjithëse konsiderohet një arritje e madhe pas shumë përpjekjesh të shqiptarëve Kushtetuta e vitit 1974, megjithatë ka pasur mjaft kufizime për Kosovën.²⁶⁷

Serbët kanë reklamuar si parim bazë nenin 245, sipas të cilit *“Në RSJ të Jugosllavisë kombet dhe kombësitë janë të ‘barabarta’.*” Historiografia jugosllave përpiqet të lërë nën hije ato nene tjera të Kushtetutës së RSF-së së Jugosllavisë ku nënkuptonte dallime të shumta midis republikave e krahinave, gjë që lëkundet *“barazinë”* e shpallur nga vet Kushtetuta federative.²⁶⁸ Kushtetuta e vitit 1974 edhe pse ka anë edhe pozitive, por megjithëkëtë nuk zgjidhi problemin kombëtar të shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera nën Jugosllavi. Pra duke pasur parasysh se gjatë historisë shumë popuj apo kombe kanë jetuar në një shtet si në ato në formë të konfederatave edhe federatave, por për shqiptar e Kosovës ka qenë e pamundur një gjë e tillë duke pasur parasysh antagonizmat thuajse për një shekull në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Por edhe duke pasur parasysh dhunën dhe terrorin që kishin përdorur sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, si aksioni i *“tepricave”*, rikolonizimi dhe aksioni i armëve.

Shteti shqiptar edhe kësaj radhe shfaqti interesimin se çfarë është duke ndodhur më të vërtetë me Kushtetutën e vitit 1974. Pas aprovimit të saj udhëheqja politike e Tiranës filloi të studiojë atë për të nxjerrë gjendjen reale të pozitës së shqiptarëve të Kosovës.²⁶⁹ Në informacionet që jepte Ministria e Brendshme e Shqipërisë, me datë 20 prill 1974, shkruante: *“Aprovimi i Kushtetutës së Krahinës konsiderohet si hap përpara drejt konsolidimit të kombësisë shqiptare dhe të vet Kosovës si krahinë në kuadrin federativ.”*²⁷⁰ Ndërsa, më datë 6 shtator 1975 Ministria e Punëve të Brendshme posedonte informacione se çka synonte politika jugosllave:

²⁶⁷ Është fakt i pamohueshëm se Kushtetuta e vitit 1974 është përdorur si argument dhe kundërgument për Kosovën nga qarqe të ndryshme. Vlen të theksohet se edhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare për Pavarësinë e Kosovës (dihet që ishte në favor të Pavarësisë së Kosovës) ishte bazuar pikërisht në Kushtetutën e vitit 1974.

²⁶⁸ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 240.

²⁶⁹ Sabit Sylaj, vep. e cit., fq. 228.

²⁷⁰ Po aty.

- a. Të krijonte iluzione se shqiptarët në Jugosllavi kanë të drejta të barabarta me të gjitha kombet dhe kombësitë tjera;
- b. Të krijonte iluzione se shteti jugosllav përpiqet për zhvillim ekonomik të Kosovës. Dhe se në kuadër të Jugosllavisë do të ketë mirëqenie ekonomike dhe sociale;
- c. Përpunimi ideologjik i shqiptarëve me titizëm dhe kozmopolitizëm;
- d. Shfrytëzimin e marrëdhënieve aktuale shqiptaro – jugosllave për të krijuar përshtypjen e rreme se Shqipëria është pajtuar me pozitën aktuale të shqiptarëve në Jugosllavi.²⁷¹ Të gjitha këto të lartcekura dëshmojnë në një mënyrë ose tjetër se Shqipëria ishte shumë vigjilente ndaj gjendjes së shqiptarëve në Jugosllavi e shqiptarëve të Kosovës në veçanti.

Pra pas vitit 1974 në Kosovë filloi një periudhe tjetër për kosovarët, kjo mund të quhet periudha më e mirë në shumë aspekte por, vetëm duke krahasuar me periudhën para vitit 1966, kur dihet se gjatë periudhës 1945-1966 për shqiptaret ishte periudha më e vështirë gjatë gjithë kohës së Jugosllavisë komuniste. E themi këtë duke pasur parasysh se shumë historianëve, Serbia zyrtare por edhe Akademia serbe gjatë viteve 90-ta ka përdorur si argument në arenën ndërkombëtare se kinse shqiptaret pas vitit 1974 kanë pasur të drejta të barabarta me republikat. Është argumentuar dhe do të argumentohet në kapitullin e tretë se kjo nuk qëndron as nuk ka qëndruar asnjëherë.

2.3 Reagimi i nacionalizmit serb ndaj ndryshimeve kushtetuese

Shumë vende të Evropës Lindore kanë qenë të kërcënuara nga grindjet nacionale por, vetëm një rast u vu në pikëpyetje vet ekzistenca e shtetit pra, Jugosllavisë.²⁷² Por lirisht mund të thuhet se ishin pikërisht grindjet e brendshme nacionale që quan drejt shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Serbët edhe pse përbënin më pak se 40% të popullsisë së ish-Jugosllavisë,²⁷³ ata kanë shpërfaqur vazhdimisht nacionalizmin e tyre në raport me nacionalitete tjera në Jugosllavi, konkretisht ndaj shqiptarëve në Kosovë.

²⁷¹ Po aty.

²⁷² Uolltër Lakër, Evropa në kohën tonë histori e viteve 1945-1992, përkthyer nga Gëzim Arapi, Shtëpia Botues Dituria, Tiranë, 1996, fq. 436.

²⁷³ Po aty.

Një ndër “*argumentet*” e qarqeve të ndryshme të nacionalistëve serbë, ishte se kushtetuta e vitit 1974, është faktori kryesor që ka ndikuar në “*shpërnguljen*” serbe nga Kosova.

Zhvillimi demografik në Kosovë sidomos gjatë viteve 70-ta dhe 80-ta është një nga çështjet që ka zgjuar kureshtjen e shumë historianëve të huaj, (krejt kjo nga propaganda e qarqeve të ndryshme shkencore serbe), dhe njëkohësisht një nga pyetjet më delikate me të cilat ballafaqohen hulumtuesit. Kjo çështje është ngritur nga qarqet serbe më shumë për qëllime politike se sa për shkak të interesave shkencore.

Më të drejt studiuesi i mirënjohur Howard Clark konstaton: “*Problemi qendror për politikën serbe mbi Kosovën ishte se, ndërsa ata pretendonin që Kosovën ta paraqesin si serbe, shumë pak serbë donin të jetonin atje. Serbia e humbi betejën demografike. Tashmë në vitin 1981, serbët dhe malazezët në Kosovë ishin shumë më pak se në raportin i vitit 1961 dhe ende në rritje - ndoshta. Kjo betejë, megjithatë, nuk filloi në vitet 1960, por ishte në të vërtetë një tipar i historisë së Serbisë dhe Kosovës që prej asaj kohe kur edhe u arrit Pavarësia e Serbisë në vitin 1878 dhe aneksimi i Kosovës në vitin 1912*”.²⁷⁴

Mjaft fakt interesant që kam hasur gjatë hulumtimeve për këtë punim është se imigrimi i serbëve nga Kosova, nuk ka filluar pas rënies së Aleksandër Rankoviçit, por disa vite më herët sidomos pas vitit 1961.²⁷⁵ Ky është një kundërgument për pretendimet serbe. Sepse serbet janë munduar ta paraqesin si shkak të imigrimit të serbëve, rënien e Rankoviçit 1966 dhe miratimit të Kushtetutës së vitit 1974.

Prandaj serbët menjëherë pas rënies së Aleksandër Rankoviçit 1966 filluan ashtu si shpeshherë gjatë gjithë historisë së tyre të propagandojnë kinse shpërnguljen masive të serbëve nga Kosova.²⁷⁶ Ne kemi theksuar dhe argumentuar më lart se për shqiptarët e Kosovës 1945-1966, që ndryshe quhet edhe koha e Rankoviçit, ka qenë periudha më e vështirë gjatë gjithë kohës së ish- Jugosllavisë.

Rënia e Rankoviçit kishte krijuar një panik në qarqet nacionaliste serbe. Prandaj qarqet nacionaliste serbe krijuan një farsë siç ishte “*emigrimi masiv i serbëve nga Kosova*” si rezultat i

²⁷⁴ Howard Clark ,Civil Resistance in Kosovo, Pluto PPress LONDON • STERLING, VIRGINIA, First published 2000 by Pluto Press, fq,26. <http://balkanwitness.glypx.com/civil-resistance-in-kosovo.pdf>; Qasur më 04.04.2019.

²⁷⁵ Shih më gjerësisht: Димитрије Богдановић, КЊИГА О КОСОВУ, Веп e cit,fq. 200-201.

²⁷⁶ Serbët kanë ngritur edhe mitin e tyre për të drejtën e tyre historike mbi Kosovën , duket si rezultat i një gjoja ekzotik në vitin 1690, të quajtur “Dyndja e Madhe” në krye me patriarkun e Pejës Arsenije Çarnojeviq.

presionit të shqiptarëve të Kosovës. Ne në vazhdim do të argumentojmë se kjo ka qenë më të vërtetë një farsë që serbët të përdornin si mburojë dhe të luanin rolin e viktimës siç kanë bërë gjithmonë kur janë ndijerë të pafuqishëm politikisht. Që të jemi sa më objektiv në këtë punim shkencor, është e vërtetë që kanë ekzistuar disa emigrime serbe nga Kosova për në vende tjera të ish-Jugosllavisë kryesisht në Serbi dhe Mal të Zi etj. Por këto emigrime nuk ishin bërë në asnjë rast nga presioni i shqiptarëve, janë krejt tjera shkaqe që kanë quar në këto emigrime sporadike. Për t'u përgjigjur pyetjes se cilat më të vërtetë ishin shkaqet që emigruan disa familje serbe nga Kosova dhe për të ardhur deri në konkludimin sa më objektiv të kësaj çështje duhet të kthehemi në fillim të shekullit XX.

Dihet botërisht se menjëherë pas pushtimit të Kosovës në vitin 1913, pushteti serb e malazez filloi të realizojë qëllimet për ndryshimet e strukturës nacionale të Kosovës, përkatësisht serbizimin e saj, përmes politikës e kolonizuese, por një proces i filluar aq i menjëhershëm e ndërpreu shpërthimi i Luftës së Parë Botërore 1914-1918. Mirëpo, Kosova në vitin 1918 prapë u riokupua nga pushteti serb. U krijua shteti borgjez Serbo-Kroato-Slloven.²⁷⁷

Kolonizimi i Kosovës nuk është bërë nga ndonjë organ i thjeshtë apo lokal por, organet më të larta të pushteti serb siç ishin: Ministria e Reformës Agrare, përkatësisht Ministria e Bujqësisë.²⁷⁸ E gjithë periudha në mes të dy luftërave botërore për Kosovën është karakterizuar me një kolonizim të ashpër ndoshta të rrallë në Evropë në shekullin XX. Këtë fenomen dhe fatkeqësi për Kosovën dhe viset tjera në ish-Jugosllavi na paraqet më së miri deri më tani studiuesi serb Milovan Obradoviç, i cili në mënyrë shumë objektive argumenton se si është kolonizuar Kosova me nacionalitetin serb dhe malazez dhe si është konfiskuar toka punuese nacionalitetit shqiptar në Kosovë. Çka është rast shumë i rrallë që një studiues serb të jetë kaq objektiv në kërkimet shkencore. Sipas Milovan Obradoviçit kolonizimi i Kosovës ka kaluar nëpër tri faza.

Faza e parë përfshin kolonizimin që është bërë sipas dispozitave të mëparshme për zbatimin e reformës agrare, përkatësisht deri me nxjerrjen e dekretligjit për kolonizimin e viseve të reja jugore, viti 1920. Në këtë fazë secili kolonist fitonte aq tokë, të cilën, sipas deklaratës së

²⁷⁷ Jusuf Osmani, Kolonizimi, Reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941, Prishtinë, 2016, fq. 11.

²⁷⁸ Po aty.

tij, do të mund ta punonte me familjen e tij. Atëherë fitonin tokë të gjithë ata që pranonin të kolonizoheshin në Kosovë pa marrë parasysh a ishin bujq apo jo.²⁷⁹

Faza e dytë hyn kolonizimi prej vitit 1921 deri në vitin 1931, kur kolonistëve iu jepeshin meratë (djerrinat, kullotat), pyjet dhe tokat e braktisura përherë si dhe tokat e ekspropriuara për qëllime të reformës agrare. Në këtë kohë një numër i vogël i kolonistve ka fituar tokë të punueshme. Këto kanë qenë pasuri të braktisura përherë dhe pa pronar.²⁸⁰

Faza e tretë, prej vitit 1931 deri në vitin 1941, kolonistve u jepet edhe toka e punueshme që u takonte fshatarëve të kombësisë shqiptare.²⁸¹

Ky kolonizim ka qenë një gjë, thuajse e papërballueshme për shqiptarët e Kosovës, aq sa shumë kanë ikur nga Kosova, kryesisht në Turqi. Qëllimi i kolonizimit ishte pikërisht për t'u bërë presion shqiptarëve që t'i lëshonin tokat e tyre. Me këtë kolonizim në gjithë territorin e Kosovës pa përjashtim janë vendosur disa mijëra serbë dhe malazezë në tokat e shqiptarëve. Për këtë Obradoviç sjell në detaje për secilin fshat ose vendbanim të Kosovës nga sa kolon ishin vendosur.²⁸²

Më poshtë Lista e sjellë nga studiuesi serb Orbadoviç për kolonizimin e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, për secilin vendbanim veç e veç dhe sipas viteve.

Tabela nr.5

<i>Vitet</i>	<i>1948</i>	<i>1961</i>	<i>1971</i>	<i>1981</i>	<i>1991</i>	
<i>Totali</i>	<i>727.820</i>	<i>963.988</i>	<i>1.243.693</i>	<i>1.584.558</i>	<i>1.956.196</i>	
<i>Shqiptarët</i>	<i>68,4%</i>	<i>67,1%</i>	<i>73,7%</i>	<i>77,4%</i>	<i>81,59</i>	

²⁷⁹ Milovan Obradoviç, Reforma Agrare dhe Kolonizimi në Kosovë 1918-1941, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2005, fq. 12.

²⁸⁰ Po aty.

²⁸¹ Po aty.

²⁸² Po aty, fq. 277-429.

<i>Serbët</i>	23,6%	23,6%	18,3%	13,2%	10,97	
<i>Malazezët</i>	3,9%	3,9%	2,5%	1,7%		
<i>Të tjerët</i>	4,1%	5,4%	5,5%	9,2%		

Këto të dhëna të sjella nga Momčilo Pavlović tregojnë që ka pasur në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm në vitet 70-ta dhe 80-ta.²⁸³

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, kolonët serbë në Kosovë janë ndijerë të sigurt pa asnjë lloj frike. Por edhe përkundër që ndiheshin të sigurt që nga vitet e pas Luftës së Dytë Botërore kishte emigrime të serbëve, (shih më lartë tabelën nr. 5). Kjo siguri e tyre vazhdoi deri kur ndodhi rënia e Aleksandër Rankoviçit më 1966.

Pas kësaj ngjarje më rëndësi shumë të madhe politike, kolonët serb filluan të ndihen të rrezikuar sepse e dinin që ishin në toka të huaja, prandaj edhe filluan që tokat që kishin zaptuar t'ua shisnin atyre që iu kishin konfiskuar disa dekada më herët. Por, kjo nuk është bërë absolutisht për shkaqe të sigurisë së tyre. Por për arsye se në Kosovë nuk shihej perspektivë fare, sepse Kosova ishte vendi më i pazhvilluar në gjithë ish-Jugosllavinë dhe me shitjen e tokave që kishin marrë pa asnjë lloj pagese ata mund të blinin shtëpi në shtetet nga kishin ardhur më herët dhe t'u ofronin fëmijëve të tyre shkollim shumë më të mirë se sa në Krahinën e Kosovës.

Pra, shumë janë raste të rralla ku serb vendas emigronin nga Kosova por mbi 90% ishin serb kolon. Kjo është pra një dëshmi se ata këtë mosqëndrim të kolonëve serbë qarqe të

²⁸³ Momčilo Pavlović, vep. e cit., fq. 27-28.

ndryshme nacionaliste serbe donin ta paraqisnin në opinionin jugosllav dhe atë ndërkombëtar si shpërngulej të serbëve nga presioni i shqiptarëve të Kosovës.

Kjo nuk ishte absolutisht e vërtetë, sepse këtë e ka dëshmuar më vonë rasti i djegies së Patrikanës së Pejës në vitin 1981, ku u akuzuan shqiptarët e Kosovës, akoma pa përfunduar hetimet. Por në maj të vitit 1981, Prokuroria Publike bëri të dikur se janë kryer hetimet zyrtare dhe se “ka shumë të ngjarë” që zjarri është shkaktuar nga një qark i shkurtër që rezultonte nga instalime të dobëta elektrike dhe izolime të pamjaftueshme. Në mënyrë alternative zjarri mund të jetë shkaktuar edhe nga një oxhak me defekte.²⁸⁴

Më pastaj kemi edhe rastin i Martinoviqit 1985, se sa jehonë i dhanë mediat serbe kinse është dhunuar, e në realitet ishte një inskenim i serbëve për të krijuar përshtypjen në opinion se serbët po ikin nga dhuna dhe presioni i shqiptarëve.²⁸⁵

Arsye tjetër e rikthimit të serbëve në vendet e tyre nga kishin ardhur disa dekada më herët ishte gjendja e rëndë ekonomike e Kosovës, për këtë jo vetëm kolonët serbë por edhe shqiptarët filluan të emigronin në vendet perëndimore për të gjetur punë dhe perspektivë më të mirë. Ajo që duket jashtëzakonisht absurde ishte fakti se ky emigrim kinse bëhej nga dhuna shqiptare kur dihej mirëfilli se pushteti policor dhe ushtarak ishte në duart e serbëve. Kemi raste kur për vrasjen e një serbi nga një shqiptar në vetëmbrojtje, shqiptari është dënuar me vdekje.

Afër Vushtrrisë, në fshatin Samadrexhë, në qershor të vitit 1982 ndodhi një vrasje. Ndonëse tragjike, por si i tillë, ky rast do të përdoret politikisht jashtë mase. *Një ditë pensionisti Ferat Muja ishte nisur për në Vushtrri për të marrë pensionin. Ai vendos që t'i bie më shkurt një rrugë që kalonte përmes arës së familjes Milinçiq, nëna e Danillos thërret të birin Danillon dhe ai sulmon fizikisht Ferat Mujen. Ferati në vetëmbrojtje e nxjerr revolen dhe shkrepi vetëm një plumb, por fatal për Danillon.*²⁸⁶

Ky aksident fatal për të dy këta persona është keqpërdorur skajshmërisht nga qarqe të ndryshme në Beograd. Ato ditë në mediat beogradase ishte lajmi më sensacional. Menjëherë pas funeralit, emisarët nga Beogradi e morën nënën e pikëlluar, Danicën, e dërguan në Beograd dhe përgatitën versionin e rrëfimit të saj për televizionin shtetëror, ku me vonë u shpërnda në gjitha mediat e kohës. Ajo rrëfeu ngjarjen sipas versionit të përgatitur... Pas kësaj odiseje Ferat Muja dënohet me vdekje.

²⁸⁴ Sabit Sylja, Hamit Kaba, Demonstratat e Kosovës 1981 në Arkivin e Londrës, vep. e cit., fq. 177.

²⁸⁵ Noel Malcolm, vep. e cit., fq.

²⁸⁶ Azem Vllasi, vep. e cit., fq. 355.

Krejt ky lëshim i imi në detaje të këtij rastit edhe pse në shumicën e rastit i perifrazuar, ishte vetëm që të argumentohet se serbët nuk ishin duke përjetuar kurrëfarë presioni nga shqiptarët e Kosovës, por emigrimi i tyre kryekëput ishte për shkaqe ekonomike.

Serbët nga albanofobia edhe lindshmërinë e madhe të shqiptarëve e përdornin edhe më qesëndi se “nënat shqiptare janë vetëm makina prodhuese”.

Më pastaj mediat në Beograd sidomos pas vitit 1981, shpërnguljen e secilës familje serbe për në Serbi synohej të paraqitej si pasojë e presionit dhe kurrsesi si rast normal, çfarë kishte gjithmonë dhe gjithandej nga viset e pazhvilluara drejt atyre më të zhvilluara.²⁸⁷ Por ajo që e ka bërë të irrituar më shumë këtë emigracion është fakti tjetër se asnjëherë serbët shpërnguljen serbe nga Kosova nuk kanë dashur ta trajtojnë si një problem, socio-ekonomik, por çdoherë si një problem politik.²⁸⁸

2.4 Marrëveshjet e ndërshtetërore për këmbimet arsimore dhe kulturore midis Kosovës dhe Shqipërisë 1970-1981.

Në vitete '70-ta ishte një periudhë kur shteti shqiptar shfaq interesim më të madh për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi. Periudha në fjalë ishte mjaft dinamike në aspektin e bashkëpunimit midis dy vendeve, dhe jashtëzakonisht e rëndësishme për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi. Duhet të bëhet e qartë që në krye të herës se gjithë bashkëpunimi midis Kosovës dhe Shqipërisë janë zhvilluar në kuadër të marrëdhënieve të ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë.²⁸⁹

Hapjen e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë konkretisht ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi duhet parë nga shumë kënde. Pra këtë hapje duhet shikuar edhe nga këndi i zhvillimeve gjeopolitike. Sepse pas agresionit të Bashkimit Sovjetik ndaj Çekosllovakisë, e nga një agresion i ngjashëm kërcënohej sidomos ish- Jugosllavia, por edhe Shqipëria. Sipas teorive që kanë qarkulluar në atë kohë, hyrja e trupave sovjetike në Shqipëri do të bëhej nëpërmjet territorit të Kosovës. Duke ndier këtë rrezik, Enver Hoxha i dërgonte mesazhe Jugosllavisë, se populli shqiptar ishte gati të luftonte krah për krah me popujt e saj në rast të një agresioni sovjetik.

²⁸⁷ Po aty, fq. 353.

²⁸⁸ Po aty, fq. 353.

²⁸⁹ Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, vitit 1970, fq. 13.

Ndërkaq, Titoja, po kështu me mesazhe nëpërmjet ambasadorësh i përgjigjej atij: “*Rusët kanë kërkuar të kalojnë territorin jugosllav për të sulmuar Shqipërinë. Ne nuk do të lejojmë asnjë këmbë ushtari sovjetik në territorin jugosllav.*”²⁹⁰ Mesazhi i E. Hoxhës ishte sinjal i qarët për jugosllavët për një përmirësim të marrëdhënieve bilaterale. Më pastaj gjatë viteve të fundit të '70-ave Lufta e Ftohtë hyn në një fazë tjetër, pra fillon një farë relaksimi në mes të dy Superfuqive, SHBA-së dhe BRSS-së.²⁹¹ Gjithashtu thuhet se të gjitha shtetet rishikojnë pozicionet e tyre në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Por, për një afrim në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishin edhe interesat reciproke të këtyre dy vendeve, sepse të dy shtetet kishin interesa për një fqinjësi të mirë, edhe pse kishin mjaft dallime substanciale në sistemet politiko-qeverisëse.

Në këtë mënyrë, Shqipëria dhe Jugosllavia u detyruan të afrohen mes vete. Marrëdhëniet e shkëputura më 1949 u rivendosën në 1953, 1971 marrëdhëniet e tyre diplomatike u avancuan në nivelin e ambasadave duke shënuar kështu një etapë të re në marrëdhëniet midis dy vendeve.²⁹²

Në maj të vitit 1971 u nënshkrua për herë të parë marrëveshja për shkëmbimin e mallrave për vitet 1971-1975.²⁹³ Më pastaj edhe gjatë viteve në vazhdim ka pasur nënshkrime të marrëveshjeve në fusha të ndryshme, më 1974 është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e linjës hekurudhore Podgoricë-Shkodër.²⁹⁴

Në riafrimin mes Tiranës dhe Beogradit, përveç faktorëve të lartcekur, ka pasur edhe faktorë të tjerë që kanë nxitur në këtë përafrim, ishin edhe dy faktorë tjerë: a. fakti që të dyja palët perceptonin një rrezik në rritje nga ana e Bashkimit Sovjetik, menjëherë pas pushtimit të Çekosllovakisë më 1968. b. faktori i dytë që shpejtoi riafrimin e Tiranës me Beogradin ishte ndryshimi i favorshëm politik në Jugosllavi menjëherë pas rënies së Rankoviçit dhe përmirësimi i situatës së “*pakicës*” shqiptare në ish-Jugosllavi.²⁹⁵

Por, sipas historianes nga Shqipëria Ana Lalaj faktorët që kanë qar drejtë një bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe kulturës në këtë periudhë nuk duhet kërkuar edhe aq

²⁹⁰ Mehmet Hajrizi, *Historia e një organizate politike...vep. e cit., fq. 37-38.*

²⁹¹ Gabriel Partos, *Bota që erdhi pre të ftohtët*, Tiranë, 1995, fq. 188.

²⁹² STUDIME HISTORIKE, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2018(3-4) viti LXXII(LV), Tiranë, 2019, fq. 2018.

²⁹³ Grup autorësh, *HISTORIA E POPULLIT SHQIPETAR V*. Botuar Akademi e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Historisë, Tiranë, 2002, fq. 310.

²⁹⁴ Po aty.

²⁹⁵ Elez Biberaj, vep. e cit.

shumë jashtë orbitës shqiptare. Edhe përkundër se në një rast thotë: “ *Historia e sistemeve totalitare është e mbushur më kthesa të çuditshme. Edhe pse në vetvete ato nuk prekin thelbin e sistemit, pra nuk shënojnë kalime cilësore, gjithsesi mbesin interesante nga koha e mënyra si shfaqen dhe si realizohen*”.²⁹⁶ Për një kthesë të tillë aludonte në Plenumin e Brionit të vitit 1966.

Përmirësimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me Kosovën duhet parë edhe në aspektin e luftës së brendshme të klaneve në ish-Jugosllavi dhe përpjekjeve të Titos për të krijuar balanca brenda vendit, sidomos pas Plenumit të Brioneve 1966.²⁹⁷

Këto marrëdhënie kulturore, arsimore dhe shkencore në mes Kosovës dhe Shqipërisë, na ndriçojnë mjaft mirë dokumentet autentike arkivore të proveniencës shqiptare. Një gjë mund të thuhet lirisht se këto këmbime në mes të dy vendeve nuk ka qenë rastësi por një veprim i menduar mirë, sidomos nga ana e shtetit shqiptar. Këto marrëdhënie në mes të Kosovës dhe Shqipërisë i kanë paraprirë dhe kanë përciellë disa ngjarje shumë të rëndësishme kulturore, historike dhe shkencore. Këto ngjarje nuk ishin pa ndikim të shqiptarët në ish-Jugosllavi.

Ngjarja e parë me një rëndësi shumë të madhe kulturore dhe historike që i parapriu hapjes së këtyre marrëdhënieve ishte kremtimi i 500-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut 1968.²⁹⁸ Kjo ishte një ngjarje që ndezi shumë emocione jo vetëm në Shqipërinë Londineze, por në të gjitha tokat shqiptare, sepse dihet mirëfilli se Gjergj Kastrioti- Skënderbeu ishte dhe është ADN-ja e identitetit tonë kombëtar.

Gjatë gjithë kësaj kohe, që nga koha e tij e deri më sot, ka qenë pikë referuese e shqiptarëve. Më rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut zhvilloi punimet edhe Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike me temë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Epoka e Tij”.²⁹⁹

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë historianë, bashkëpunëtorë shkencorë, linguistë, pedagogë dhe arsimtarë, specialistë të institucioneve kërkimore-shkencore dhe rreth 200 studiues nga rrethe të ndryshme të vendit po ashtu kishte studiues edhe nga vende tjera të Evropës si nga Franca, Gjermania, Austria, Bullgaria etj.

²⁹⁶ Ana Lalaj, *Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981*, Tiranë, 2000, fq. 246.

²⁹⁷ S. Sylaj, *Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Prishtinë, 2012, fq. 185.

²⁹⁸ Tefta Cami, *Katër ditë vizitë në Kosovë tetor 1980*, Tiranë, 2012, fq. 15

²⁹⁹ Po aty, fq. 16.

Kanë marrë pjesë grupi i punonjësve të institucioneve shkencore dhe arsimore të Kosovës, të përbërë nga Mark Krasniqi, Fehmi Agani, Idriz Ajeti, Anton Çeta, Syrja Popvci, dhe Zef Mirdita.³⁰⁰

Nga kjo konferencë u arritën suksese mjaft mëdha mbi ndriçimin e figurës së Skënderbeut në shumë rrafshë, si në rrafshin ushtarak, diplomatik, kombëtar dhe atë personal.
301

Ngjarja tjetër po ashtu me shumë rëndësi kulturore dhe shkencore ishte mbajtja për herë të parë e Kongresit Drejtshkrimor të Gjuhës shqipe në vitin 1972. Kongrese për të njësuar gjuhën shqipe ka pasur edhe më herët, si ai i Shkodrës në vitin 1916 “*Komisia letrare shqipe*” etj.³⁰² Por jo të përmasave gjithëkombëtare si ky i vitit 1972.

Ky Kongres i drejtshkrimit u zhvillua si një aktivitet shkencor mbarëkombëtar.³⁰³ Në këtë Kongres kanë marrë pjesë 87 delegatë nga Shqipëria dhe nga shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe arbëreshët e Italisë. Në këtë Kongres të parin e këtij lloji të mbajtur në Shqipëri janë pasqyruar arritjet dhe prirjet e zhvillimit të gjuhës shqipe, si dhe janë përcaktuar mbi baza shkencore parimet dhe drejtimitet e kryesore të hartimit të drejtshkrimit për gjuhën letrare të njësuar, apo siç quhet gjuhën standarde.³⁰⁴

Pra si çdo gjuhë e zhvilluar në botë që pa marrë parasysh dialektet është njësuar dhe është zhvilluar ashtu edhe gjuha shqipe u shfaq nevoja për një standardizim të saj. Kjo ishte një arritje jashtëzakonisht e madhe për gjithë shqiptarët kudo që jetonin si brenda kufijve të Shqipërisë apo jashtë saj. Por përveç të arriturave që dolën nga ky Kongres ajo që e bën të veçantë, është pjesëmarrja e studiuesve nga të gjitha trojet shqiptare.

Është fakt i pamohueshëm se gjuhësia shqiptare njohu një zhvillim shumë të madh në gjysmën e dytë të shekullit XX, sepse u krijuan edhe institucionet shkencore të specializuara, si

³⁰⁰ Po aty.

³⁰¹ Për të qenë sa më objektiv, ndoshta këto zhvillimi duhet parë edhe në kontekstin ideologjik. Sepse regjimet komuniste gjatë viteve të 60-ta-70-ta i drejtohen gjithnjë e më shumë gjerësisht pasurisë identitare për të mëkëmbur krenarinë kombëtare dhe për t’u orvatur të krijonin një bashkëmarrëveshje nën mbrojtjen e partisë. Shih më gjerësisht Anne-Marie Thiesse, *Krijim i identiteteve kombëtare Evropa e shekujve XVIII-XX, përktheu nga frëngjishtja Etleva Shiroka, Dukagjin, Pejë, 2004.*

³⁰² Tefta Cami, *Katër ditë vizitë në Kosovë tetor 1980*, Tiranë, fq., 22.

³⁰³ Po aty.

³⁰⁴ Po aty.

Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Institutet gjuhësore e etj.³⁰⁵

Një ngjarje tjetër shkencore dhe historike që kishte rëndësi shumë të madhe shkencore, kulturore dhe historike ishte mbajtja e Kuvendit të Parë të studimeve ilire prej datës 15-20 Shtator të vitit 1972. Ky Kuvend zhvilloi punimet me një temë të përgjithshme *“Ilirët e Jugut dhe gjeneza e shqiptarëve.”*³⁰⁶

Në këtë kuvend të rëndësisë së veçantë shkencore dhe historike kanë marrë pjesë një numër i madh i studiuesve nga Evropa dhe Azia. Kanë marrë pjesë gjithashtu edhe studiues nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.³⁰⁷

Të arriturat shkencore historike dhe arkeologjike që janë prezantuar në këtë kuvend shkencor për ilirët dhe për origjinën ilire të shqiptarëve janë jashtëzakonisht brilante, këto të arritura edhe sot janë të pakontestueshme në aspektin shkencor.

Ngjarja me shumë rëndësi historike dhe kulturore që ka përcjellë marrëdhëniet Kosovë Shqipëri është kremtimi i 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit³⁰⁸ në Shqipëri dhe Kosovë 1878. Ky kremtim i 100-vjetorit të Lidhjes pati një ndikim të madh te të gjithë shqiptarët.

Shqipëria zyrtare ngriti një komision qeveritar dhe u hartuan të gjitha veprimtaritë politike, shkencore, kulturore e artistike, botuese e propagandistike, që do të zhvilloheshin gjatë gjithë viti në rrethe dhe zona, në shkallë rajonale dhe kombëtare si dhe në kryeqytet.³⁰⁹ Për kremtimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit përveç organizimeve kulturore u zhvillua edhe një konferencë shkencore në shkallë kombëtare, ku morën pjesë studiues nga gjitha trojet shqiptare dhe nga arbëreshët e Italisë.³¹⁰

³⁰⁵ Po aty, fq. 28.

³⁰⁶ Po aty, fq. 31.

³⁰⁷ Po aty.

³⁰⁸ Lidhja Shqiptare e Prizrenit 10 qershor vitit 1878. Është njëra prej ngjarjeve me më shumë rëndësi për gjithë shqiptarët. Kjo për shumë arsye por ajo kryesorja është se nga kjo ngjarje është kristalizuar vetëdija kombëtare të shqiptarët. Po ashtu ky organizim ishte mbarëkombëtar i pari pas Kuvendit të Lezhës, gjithashtu kjo organizatë hartoi edhe një platformë politike dhe kombëtare shumë të qartë. Si dhe gjithë mekanizmat që duhet të kishte një shtet, ushtrinë, financat, diplomacinë etj. Edhe pse dihet se nuk arriti objektivat kryesore Lidhja e Prizrenit siç ishte pavarësia ose së paku autonomia në kuadër të Perandorisë Osmane me gjithë atë këtu ishin fillesat e mirëfilltë e përpjekjeve për shtetin shqiptar.

³⁰⁹ Tefta Cami, vep. e cit., fq. 39.

³¹⁰ Po aty, fq. 42.

Në këtë 100-vjetor të Lidhjes së Prizrenit u sollën edhe eshtrat nga Turqia në Shqipëri të ideatorit dhe organizatorit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashërit.³¹¹

Pra janë të gjitha këto ngjarje më rëndësi shumë të madhe historike, kulturore dhe shkencore që janë zhvilluar pikërisht në intervalin kohor të marrëdhënieve të Shqipërisë dhe Kosovës 1968-1981.

Në këtë kohë në Kosovë fillojnë të vijnë edhe ligjëruet nga bota perëndimor si nga Anglia, ShBA-ja etj,(numër i kufizuar) por ishte një mundësi e mirë që të ndodhë ai ekulturimi që është bazë për shoqëritë e përparuar.³¹² Kjo ishte një arritje shumë e madhe që për shumë breza ishte veç një ëndërr që të kishin mundësi për të vizituar shtetin amë.

Edhe përkundër opinioneve pro dhe kontra, se cila palë kishte më shumë interes nga kjo hapje. Mendimi im është se megjithatë nga kjo hapje më së shumtë kishte interes shteti shqiptar se sa ish-Jugosllavia, këtë konstatim e nxjerrim edhe nga disa fakte të thjeshta, së pari kur dihej se sa shqiptarë kishte jashtë kufijve të Shqipërisë Londineze. Se a kishte një interes të veçantë për këtë bashkëpunim midis dy vendeve shteti shqiptar, na dëshmon udhëheqësi i shtetit shqiptar, Enver Hoxha, ku në ditarin e tij, Për çështje ndërkombëtare thekson: *“I tërë ky bashkëpunim është si të thuash një investim i madh ideologjik, politik, patriotik dhe kulturor nga ana jonë në shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi.”*³¹³ Një opinion të ngjashëm na sjellë edhe Nexhmije Hoxha në kujtimet e saj, Enveri vazhdimisht përmes emisarëve të vet përcillte porosinë : *“Shfrytëzoni në maksimum të drejtat që ju njihen nga Kushtetuta e 1974-s. Po kështu do të bëjmë edhe ne nga ana jonë.”*³¹⁴ Këmbimet kulturore në mes të dy vendeve ai i shikonte si shumë të rëndësishme : *“Njohja nga afër me njëri-tjetrin, arritja historike e unifikimit dhe e njësimin të folmes së përbashkët në gjuhën letrare, ecja në shina paralele në arsim, shkencë, art e kulturë, do të krijonin atë bashkim shpirtëror kombëtar, për të realizuar më vonë ëndrrën shekullore të bashkimit të kombit tonë.”*³¹⁵

Një mendim të tillë E. Hoxha ia kishte shfaqur në një takim ish-ministres së Arsimit të Shqipërisë në kohën kur kishin ndodhur këto këmbime *“... është Kosova, prandaj është edhe Shqipëria,*

³¹¹ Po aty, fq. 43.

³¹² Mary Motes, *Kosova Preludi i Luftës 1966-1999*, Prishtinë, 2017, fq. 140-141.

³¹³ Enver Hoxha, *DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (1970-1971)* 6, Tiranë, 1983, fq. 277.
Marrë në : http://ciml.250x.com/archive/hoxha/albanian/ditar/enver_hoxha_1970_1971_ditar_6.pdf.

³¹⁴ Nexhmije Hoxha, *JETA IME ME ENVERIN*, Kujtime, Botuar nga Enti Botues "LIRA" Tiranë 1998, fq. 253.

³¹⁵ Po aty.

shqiptarët e Kosovës që nga më i thjeshti e deri te politikanët janë shprehur hapur se vetëm kur të kalojnë mbi trupat e tyre mund të sulmohet Shqipëria amë".³¹⁶ Por edhe sikur të mos merrej si të vërteta këto të sipërthëna, logjikisht por edhe më vonë është vërtetuar se me të vërtetë shqiptarët në ish-Jugosllavi ishin në njëfarë forme mburojë e Shqipërisë. Për një arritje të tillë bashkëpunimi meritë kishin edhe vet shqiptarët.³¹⁷

Dëshmi për këtë mund të merret edhe fakti që ishte Enver Hoxha ai që filloi sinjalet e para për një afrim me Jugosllavinë, gjatë vizitave në rrethet e Kukës dhe Tropojë në pranverë të vitit 1970.³¹⁸ Fjalimi i Enver Hoxhës më 30 maj në Tropojë u parapri nga dy takimet e mbajtura prej tij të rrethit të Kukësit, pas këtij fjalimi do pasohet nga një periudhë përmirësimi në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

319

Përveç gatishmërisë së Enverit për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë edhe Tito në Ulqin, kishte shprehur një interesim të tillë me gjithë kundërtësitë që ekzistonin në mes të dy vendeve.³²⁰

Siç e kemi cekur edhe më lart, gjithë këto bashkëpunime midis Kosovës dhe Shqipërisë duhet shikuar nga prizmi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Pra përmirësimin e raporteve Shqipëri ish-Jugosllavi as që mund të bëhet fjalë për një bashkëpunim midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Por duhet të theksohet një fakt se midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë nuk ekzistonte një program i nënshkruar ndërshtetëror mbi bashkëpunimin kulturor, arsimor dhe shkencor deri më 1970. Prolongimi i nënshkrimit të marrëveshjeve midis dy vendeve ishte për shkak të hezitimit të palës jugosllave. Arsyeja që japin ata, ishte që emri i Kosovës të mos zihet asnjëherë në gojë në atë marrëveshje, në të cilën gati tri të katërtat e aktiviteteve bëhen në mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Krahinës së Kosovës.³²¹ Një hezitim të tillë pala jugosllave do të shfaqet edhe gjatë nënshkrimeve të protokolleve të bashkëpunimeve në vitet në vazhdim.

Shteti jugosllav e kishte hartuar në fund të vitit 1970 "*Programin e bashkëpunimit arsimor dhe kulturor midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë për vitin 1971-1972.*" Të cilin ambasada jugosllave në Shqipëri ua dorëzon organeve kompetente në Tiranë.³²² Duke parë më në fund një gatishmëri të shtetit jugosllav (edhe pse me rezervë) shteti shqiptar ndërmerr hapa konkret në këtë drejtim.

³¹⁶ Tefta Cami, vep. e cit., fq. 104.

³¹⁷ Po aty, fq. 292. Shih edhe Mary Motes, Kosova Prelud i Luftës 1966-1999, Prishtinë, 2017.

³¹⁸ Po aty.

³¹⁹ Sabit Sylva vep. e cit., fq. 186.

³²⁰ Po aty, fq. 187.

³²¹ Enver Hoxha, DITAR PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE (1970-1971) 7, Tiranë, 1983, fq. 51. http://ciml.250x.com/archive/hoxha/albanian/ditar/enver_hoxha_1972_1974_ditar_7.pdf; Qasur më 10.03.2019.

³²² Sabit Sylva, Vep e cit., fq. 190.

Po në të njëjtin vit, 1970, shteti shqiptar kishte hartuar një platformë prej dhjetëra pikash kryesore dhe disa anekse mbi marrëdhëniet kulturore me Kosovën, ku parashiheshin shkëmbime delegacionesh të përbërë nga pedagogë, intelektualë, arsimtarë, artistësh, sportistë, si dhe dhurimi i literaturës për fusha të ndryshme etj.³²³

Kjo platformë ishte bërë kryesisht në bazë të kërkesave të palës kosovare.³²⁴ Për arsye që ishte programi i parë i hartuar në fillim të bashkëpunimit e shoh të arsyeshme që të paraqesim në mënyrë më të hollësishme, platformën e bashkëpunimit në mes të dy vendeve:

1. Mund të dërgojmë dhe të presim delegacione të ndryshme për shkëmbim eksperiencash: pedagogë të shkollave të larta, punonjës shkencor etj..
2. Mund të presim dhe të dërgojmë delegacione të studentëve të shkollave të larta.
3. Mund të dërgohen dhe të presim delegacione për kinematografinë për të lidhur marrëveshje për blerje filmash nga të dy palët.
4. Mund të dërgojmë një grup pune për organizimin e muzeve.
5. Mund të pranojmë pedagog të shkollave të larta të Kosovës, për t'u specializuar në afat të shkurtër ose të gjatë pranë katedrave të shkencave albanologjike, mjekësi, biologji etj..
6. Mund të shkëmbejmë lektorë të kualifikuar për të mbajtur leksione në fusha të ndryshme shkencave gjuhësore, historike, pedagogjike, mjekësore, natyrore etj..
7. Nga Universiteti i ynë mund të dërgojmë pran institucioneve kërkimore albanologjike të Kosovës ose Maqedonisë, kuadro të përgatitur për të ndihmuar në organizimin e punës së këtyre institucioneve, për orientimin e tematikës.
8. Mund të dërgojmë dhe të presim ansamble të këngëve dhe valleve në Kosovë dhe Maqedoni.
9. Mund të dërgojmë dhe presim grupe sportive, ekipe futbollit, basketbollit, atletika etj..
10. Mund të dërgojmë dhe të ftojme në aktivitete të ndryshme shkencore e jubilarë, si në kongrese, përvjetorë, simpoziume shkencore etj..
11. Universiteti ynë mund të ftoj personalitete shkencore dhe arsimore të Universitetit të Prishtinës për të kaluar pushimet verore në vendin tonë.
12. Mund të pranojmë nxënës shkollash të moshës së pionierit për të kaluar pushimet verore në kampet e pushimit së bashku me fëmijët tanë (deri në 30-40 veta në vit).³²⁵

³²³ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, vitit 1970, fq. 2.

³²⁴ Enver Hoxha, DITAR PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE (1970-1971) 6, vep. e cit., fq. 234.

Shkëmbime në fushën e botimeve, të literaturës:

1. Mundë të bëhen shkëmbime teksteve të gjitha kategorive të shkollave, harta, diafilma, ose mjete të ndryshme mësimore që prodhojnë në vendin tonë.
2. Mund t'u dërgojmë sasira të librave për shkollat e mesme si dhuratë.
3. Mund të botojmë libra të fushave të ndryshme të autorëve kosovarë.
4. Mund të krijohen lidhje dhe marrëdhënie me bibliotekat e qyteteve të ndryshme të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Në mënyrë që të shkëmbehen literaturë e ndryshme.
5. Mund t'u dërgojmë ekspozita dhe foto-ekspozita të ndryshme etj..³²⁶

Fushat kryesore që pati ndikim të drejtpërdrejtë nga këto raporte ishin fusha e arsimit, kulturës, artit dhe sportit. Duhet të pranohet një fakt se kultura shqiptare në Kosovë kishte mbetur më e pazhvilluar në shumë aspekte, në krahasim me shtetin shqiptar, kryesisht për arsye se një zhvillim i tillë nuk i shkonte përshtati qarqeve të ndryshme në Jugosllavi konkretisht në Serbi.³²⁷Ndoshta edhe për këtë Prishtina zyrtare, apo institucionet më relevante arsimore dhe shkencore si Akademia Shkencës dhe Artit,³²⁸ Universiteti i Prishtinës, Instituti Albanologjik etj..

Duke qenë se ishin të sapokrijuara, apo disa në krijim e sipër, nuk kishin një platformë me objektiva konkrete, për bashkëpunim në mes të dy vendeve, ashtu si kishte shteti shqiptar. Ndoshta kjo edhe si rezultat i asaj se nuk kishin kompetenca për të hartuar një platformë bashkëpunimi, sepse ky bashkëpunim ishte i mbikëqyrur nga organet federative.

Në Kosovë në fillim të viteve 70-ta kishte jashtëzakonisht mungesë kuadri në shumë fusha. Më aq sa vërehet Prishtina zyrtare ishte nisur më shumë nga ajo se kemi nevojë për çdo gjë që vjen nga Shqipëria.³²⁹

Ndër institucionet shtetërore në Shqipëri, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, do të

³²⁵ Po aty, fq. 2-3.

³²⁶ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, vitit 1970, fq. 3-4.

³²⁷ Shih më gjerësisht, Aleks Buda, *Studime Historike*, Prishtinë, 2006, fq. 465-502.

³²⁸ Për themelimin e Akademisë së Shkencës dhe të Artit, ka pasur shumë kundërshtime të mëdha nga pala serbe. Serbet këmbëngulin me pretendimin se vetëm shtetet kanë të drejt të kenë Akademi të shkencës. Shih; Memli Krasniqi, Hysen Matoshi, Kujtesa kolektive...Vep e cit,fq. 35-36.

³²⁹ Së paku unë nuk kam hasur një platformë me objektiva për bashkëpunimin Kosovë-Shqipëri, të institucioneve arsimore dhe shkencore të Kosovës, as në arkivat e Shqipërisë, as në Arkivat e Kosovës.

luante një rol të rëndësishëm në drejtim të Kosovës. Ajo u ngarkua të përgatiste dhe zbatonte disa masa konkrete, të cilat do të kishin për qëllim që të ndihmonin popullsinë shqiptare në Jugosllavi, në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm arsimor e kulturor e për forcimin e dashurisë për atdheun mëmë, Shqipërinë.³³⁰

Masat e ndërmarra nga kjo ministri, duhej të plotësonin kërkesat e shqiptarëve nga Kosova për tekste dhe mjete mësimore. Kjo përveç cilësisë ndikoi edhe në shtimin e numrit të nxënësve në të gjitha shkollat e Kosovës. Në vitin 1971-1972 në shkollat fillore të Kosovës mësonin rreth 40.000 nxënës, në vitin 1976-1977 vetëm numri i nxënësve shqiptarë do të rritet 238.121 dhe në vitet 1980-1981 në 268.548.³³¹ Kjo ka bërë që patjetër të shtohet dhe të ngritet infrastruktura arsimore në gjithë Kosovën, që deri në këtë kohë ishte në gjendje shumë të vështirë. Po ashtu kjo ministri duhej të përpiqej, të dërgonin ansamblin e këngëve dhe valleve popullore, grupet teatrale e sportive, të pranonin studentë nga Kosova në Universitetin Shtetëror dhe shkollat e larta, të pranojnë pedagogë të ndryshëm si individë ose në grupe për praktikë, specializim, shkëmbim eksperience, shkëmbim dokumentesh historike me institucionet e interesuara, etj.³³²

Këshilli i Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, me vendimin e datës 24 qershor 1970 vendosi t'u jepte bursë për të vazhduar studimet e larta në Shqipëri për vitin akademik 1970-1971, 75 studentëve nga Kosova. Ndarja e bursave në shkollat e larta, duhej të bëhej në këtë mënyrë: a) Për histori-filologji 20 bursa,³³³ për mjekësi 15 bursa; për shkencë të natyrës (mësues për aritmetikë, fizikë, kimi dhe shkencë biologjike) 10 bursa; për inxhinieri (ndërtimi, mekanikë, elektrike) 10 bursa, Për agronomi veterinar 10 bursa.³³⁴ Në fund të listës së bursës jepen edhe disa sqarime. Për studentë kosovarë lëndët e marksizëm-leninizmit dhe histori e PPSH-së mund të jenë fakultative; përgatitjen ushtarake të mos e bëjnë, ndërsa gjitha lëndët tjera do të bëhen gjitha duke përfshirë edhe punën prodhuese.³³⁵

Gjithashtu sipas vendimit të Këshillit të Ministrave më 24.06.1970 u vendos që të jepeshin edhe 50 bursa për të vazhduar shkollat e mesme në profilin pedagogjik, industriale dhe mjekësore. Ishte planifikuar që nxënësit nga Kosova të dërgoheshin në këto shkolla: Shkolla e mesme pedagogjike, Elbasan 15; Shkolla e mesme mjekësore, Vlorë 5; Shkolla e mesme

³³⁰ Sabi Sylaj, vep. e cit., fq. 190

³³¹ Ana Lalaj, vep. e cit., fq. 259.

³³² Po aty.

³³³ Ndarja e bursave më shumë për histori dhe filologji, vet logjika të dërgon në përfundimin se cili ishte objektivi kryesor i Shqipërisë në këto raporte reciproke. Pra ngritja e nivelit sa më të lartë në aspektin kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve të Kosovës.

³³⁴ QASH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, viti 1970, fq. 6

³³⁵ Po aty.

industriale 7 nëntori 10; Shkolla e mesme Bujqësore Korçë 10; Shkolla e mesme Bujqësore Kavajë 10.³³⁶

Për vitet 1971- 1975 të rinjve dhe të rejave nga Kosova t'u akordoheshin çdo vit 75 deri në 100 bursa për të ndjekur shkollat e larta dhe 50 për vazhduar shkollat e mesme. Veç kësaj, Universiteti Shtetëror i Tiranës duhej të pranonte çdo vit gjer në 5 kuadro të larta nga Kosova, të cilët do të përgatishnin mbrojtjen e disertacioneve, për marrjen e gradës “*kandidat i shkencave*”.

Vendimi i lartpërmendur i ngarkonte Universitetit të Tiranës detyrimin, që gjatë vitit 1971 të pranonte, 20 studiues nga Kosova, për të përfituar eksperiencë apo për t'u specializuar në Shqipëri.³³⁷ Lidhur me këtë çështje, më datën 26 qershor 1970, Skënder Konica-Drejtor i Drejtorisë së IV-të, i dorëzoi në Tiranë Legatës së Jugosllavisë një notë me anën e secilës i bënte të ditur asaj rreth akordimit të bursave për studentët dhe nxënësit e Kosovës e që përmbajtja e saj t'u bëhej e njohur organeve kompetente të Kosovës.³³⁸

Ndihma nga shteti shqiptar kishte të bënte në shumë fusha si me veprimtaritë shkencore, mësimore, artistike, kulturore e në veçanti në drejtim të përgatitjes dhe kualifikimit të kuadrit nga Kosova. Ndër institucionet shtetërore në Shqipëri, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, do të luanin një rol të rëndësishëm në drejtim të Kosovës. Ajo u ngarkua të përgatiste dhe zbatonte disa masa konkrete, të cilat kishin për qëllim që të ndihmonin popullsinë shqiptare në Jugosllavi, në drejtim të zhvillimit të përgjithshëm arsimor e kulturor e për forcimin e atdhedashurisë.³³⁹

Me 27 tetor 1970, u nënshkrua në Tiranë protokollin midis Universitetit Shtetëror të Tiranës, me rektor prof. Jorgji Sota dhe Universitetit të Prishtinës, me rektor prof. Dervish Rozhaja. Nga të gjitha bashkëpunimet midis Shqipërisë dhe Kosovës një rëndësi të veçantë kanë pasur bashkëpunimi në mes të UT-së dhe UP-së.³⁴⁰ Dy janë fushat esenciale në të cilat është zhvilluar bashkëpunimi në mes të UT-së dhe UP-së: bashkëpunimi në lëminë e arsimit, respektivisht, mësimore-shkencore dhe ai në lëminë shkencore-mësimore.³⁴¹

Universiteti Shtetëror i Tiranës, USHT dhe Universiteti i Prishtinës, UP, të nisur nga dëshira për të zhvilluar e forcuar më tej lidhjet në lëminë mësimore e shkencore, pas bisedimeve miqësore të zhvilluara midis delegacioneve përkatëse në Prishtinë më 30 korrik -5 gusht 1970

³³⁶ Po aty, fq. 7.

³³⁷ S. Sylva vep. e cit., fq. 191.

³³⁸ Po aty.

³³⁹ Po aty.

³⁴⁰ Pajazit Nushi, Bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtinës e Universitetit të Tiranës, Prishtinë, 1977, fq. 30.

³⁴¹ Po aty, fq. 32.

dhe në Tiranë më 19-27 tetor 1970, u morën vesh të hartojnë këtë Protokoll Bashkëpunimi mësimor për vitin 1970-1971.³⁴²

Si pika kyçe ishin këto:

1. Universiteti shtetëror i Tiranës është i gatshëm që t'i mirëpres qëndrimin e 25 kuadrove të Universitetit të Prishtinës në Tiranë, për specializim në lëmitë e ndryshme, për fitim eksperience, për përgatitjen e disertacioneve etj..
2. Universiteti i Prishtinës është i gatshëm të organizojë qëndrimin e kuadrove te Universitetit të Tiranës me qëllim specializimi në Prishtinë dhe në Universitetet tjera në vend.
3. Universiteti i Tiranës do të dërgojë për fillim 23 pedagogë (profesorë) për mbajtjen e leksioneve në lëndët deficitare në fakultetet e Universitetit të Prishtinës: për fakultetin teknik 10 pedagogë, për fakultetin e medicinës 4, për fakultetin filozofik 6 dhe për atë juridik ekonomik 3.
4. 16 Profesorë nga Tirana do të mbajnë cikle ligjërates nga lëmitë e ndryshmet për dëgjuesit e shkallës së dytë dhe të tretë të Universitetit të Prishtinës, madje me rëndësi dhe vlerë tematike.
5. Gatishmëria e të dy universiteteve për hartimin e projekteve për hulumtimin e përbashkët në lëndët me interes për të dy palët, si në dialektologji, histori, folklor etj..
6. Kuadrot e Universitetit të Tiranës të jenë anëtarë të komisioneve për mbrojtjen e disertacioneve që do të mbrohen në Universitetin e Prishtinës.³⁴³
7. U vendos që në revistat e të dy universiteteve do të publikohen punime reciprokisht. Shkuarja e pedagogëve nga Tirana për në Universitetin e Prishtinës do të fillonte në muajin dhjetor të vitit 1970.³⁴⁴
8. Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Prishtinës do të shkëmbejnë literaturë mësimore dhe shkencore (pesë ekzemplar të detyrueshme), plane dhe programe mësimore sipas kërkesës si dhe fotokopje, mikrofilma dhe materiale arkivore të disponueshme të destinuara për qëllime shkencore.³⁴⁵
9. Në bazë të këtij protokollit institucionet vartëse të USHT-së si Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Instituti i Folklorit, biblioteka Shkencore, me ndërmjetësimin e UP-së mund të vendosin marrëdhënie të drejtpërdrejta me Institutin Albanologjik të Prishtinës, me Entin e Historisë së Kosovës, Muzeun e Prishtinës, etj. Për çështje konkrete që hynë në kompetencën e

³⁴² Tefta Cami, vep. e cit., fq. 264.

³⁴³ Tefta Cami, vep. e cit., fq. 265.

³⁴⁴ S.Syla, vep. e cit., fq. 271.

³⁴⁵ Tefta Cami, vep. e cit., fq. 265.

tyre.³⁴⁶

10. Gjatë zbatimit të këtij Protokollit USHT-ja dhe UP-ja në marrëveshje në mes tyre mund të mund të bëjnë ndryshime ose plotësime eventuale që janë në frymën e bashkëpunimit midis institucioneve.³⁴⁷

Ajo që është njaft me rëndësi në këtë protokoll bashkëpunimi të nënshkruar nga USHT-ja Prof. Jorgji Sota dhe nga UP-ja Prof. Dervish Rozhaja është fakti që kanë paraparë edhe koston e këtij bashkëpunimi. Shpenzimet e udhëtimeve vajtje-ardhje të kuadrove që respektivisht dërgohen në shërbim nga të dy institucionet në bazë të këtij protokollit, për eksperiencë, specializim, kualifikim, e marrje gradash shkencore, për të zhvilluar ligjërata etj. Obligimet financiare i merr përsipër pala dërguese, ndërsa pala pritëse u siguron atyre fjetjen, ushqimin, mjekimin dhe shpenzimet e transportit në brendi të shteti përkatës.³⁴⁸

Ky bashkëpunim intensiv ka vazhduar deri në vitin 1981, duke pasur parasysh rëndësinë historike të këtyre protokolleve, ne do të sjellim në mënyrë kronologjike të gjitha këto bashkëpunime në mes të Kosovës dhe Shqipërisë duke u bazuar kryesisht në dokumente të arkivore.

Menjëherë pas kësaj marrëveshje më 28.03.1971 një grup pedagogësh të njohur të USHT-së janë dërguar në një vizitë në Kosovë pranë Universitetit të Prishtinës: Kolë Popa, Mahir Domi, Alfred Uçi, Islam Zeko, Munir Karagjozi, Aleko Minga, Luan Voshtina, Pandeli Troja, Nadide Dinasi.³⁴⁹ Po ashtu gjatë gjithë vitit 1972 kishin vizituar Shqipërinë një numër shumë i madh i intelektualëve, pedagogëve, artistëve, sportistëve por edhe kolektivet e shumë shkollave të mesme dhe fillore nga shumë qytete të Kosovës. Ku janë pritur jashtëzakonisht mirë nga autoritetet shqiptare.³⁵⁰

Pas këtyre vizitave u pasua me ardhjen e shumë pedagogëve nga Tirana në Kosovë, gjatë gjithë kësaj periudhe të bashkëpunimit. Nga Shqipëria në Kosovë kanë ardhur ajka e inteligjencisë së Shqipërisë për të ligjëruar dhe për të dhënë kontribut në shumë fusha si Aleks Buda, Eqerem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Androkli Kostallari, Jup Kastrati, Stefanaq Pollo, Arben Puto, Bujar Hoxha, Ismail Lleshi, Xhemajl Frashëri, Sterjo Spase, Odhise Paskali, Skënder Anamali, Selim Islami, Vehbi Bala, Ethem Lika, Rahmi Memushaj, Jorgo Bulo, Vetore Ballvora, Eduard Sulstarova, Petraq Pilika, Aleko Minga, Skender Koja, Skender Gjinushi,

³⁴⁶ Po aty, fq. 265-266.

³⁴⁷ Po aty.

³⁴⁸ Po aty.

³⁴⁹ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 180, viti 1971, fq. 34.

³⁵⁰ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 234, viti 1972, fq. 264-383.

Stefo Kongjika, Osman Kraja, Agim Karçanaj, Rexhep Mejdani, Mina Naqo, Maqo Lakrori, Bardhyl Golemi, Arqile Teta, Bashkim Baholli, Marenglen Xhonaj, Xhemajl Xhata, Edmond Luqi, Sotir Guxho, Besnik Ostrosi, Haxhi Sauko, Kujtim Buzo, Tonin Harapi, Çesk Zadeja, Ferdinadn Deda, Odhise Paskali, Gaqo Çako, Avni Mula, Eno Koço, Abullah Grimci, Panajot Kanaçi, Zoica Haxho; Vaçe Zela, Kristaq Dhamo, Pirro Mano, Feim Ibrahimimi, Pali Kuke, Dhimitër Pecani, Agim Zajmi; Nasho Jorgaqi, Alfred Uqi, Vath Koreshi, Zihni Sako, Qemal Haxhihasani, Ramazan Bogdani, Abaz Dojaka, Gjovalin Shkurtaj, Muzafir Xhaxhiu, Enver Faja, Isuf Sukaj, Dalan Shaplllo, Aferdita Unuzi, Hëna Spahiu, Shpresa Gjongecaj; Selami Pulaha, Gazmend Shpuza, Bahri Beci, Xhovalin Shkurtaj, Ali Xhiku, Jorgji Gjinari, Anastas Dodi, Qemal Mandia, Hysen Devolli, Arben Baboqi, Alfred Paloka, Sefedin Xhemalçe, Dhimitraq Nikolla, Bardhyl Çako, hajredin Shtino, Mentar Belegu, Perikli Qiriazhi, Arqile Berxolli, Ismail Demneri, Florika Mondro, Andromaqi Muçko, Hajaredin Kumbaro, Maruf Haxhimusaj, Pandeli Troja, Elmaz Shehu, Vasil Mici, Jovan Zoto; Hekuran Mara, Nexhmednin Lohja, Astrit Kallfa, Astrit Halili, Ilaz Nako, Besim Daja, Muharrem Frashëris, Barajm Preza, Shyqyri Subashi, Jahja Pula, Gojart Cerga, Zejnullah Ballanca, Ksenofon Kristafi, Skender Begeja, Aleks Luarasi, Lefter Shqau, Tare -Çelo, Teki Kaltani, Nasip Jaço, e shumë e shumë të tjerë.³⁵¹ I gjithë ky numër i madh i intelektualëve erdhën për të kapërcyer vështirësitë Universiteti i Prishtinës,³⁵² i erdhi në ndihmë Universiteti i Tiranës.³⁵³

Nga këto marrëveshje një përfitim që duhet të vlerësohet maksimalisht ishte se nga Shqipëria filloi të hyjë në Kosovë literaturë thuaja për të gjitha fushat, që në Kosovë ishte mjaft deficitare. Për këtë dëshmon edhe një raport i shkruar me dorë i DQ Librit qysh në fillim të vitit 1970, që i dërgohet Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, ku paraqiten mundësitë se çka mund t'u ofrohet kosovarëve nga literatura. Ky dokument titullohet, *prodhimet që mund t'i ofrohen "Rilindjes"*, ku jepen në detaje se çka dhe sa mund t'i dhurohet Kosovës literaturë të fushave të ndryshme.³⁵⁴

Po ashtu me 20.12.1972 nënshkruhet një protokoll bashkëpunimi në mes të DQ-së Librit të Tiranës dhe NGBG "Rilindja" të Prishtinës, sipas kësaj marrëveshje DQ Libri pranon t'i shesë "Rilindjes" libra të ndryshëm me një vlerë të përgjithshme 35.000 dollar gjatë vitit 1973. DQ-ja e Librit për shitjen e librit i akordon "Rilindjes" së Prishtinës një zbritje prej 80% .³⁵⁵ Pra shihet

³⁵¹ Tefta Cami, vep. e cit., fq. 266.

³⁵² Duhet pasur parasysh faktin se Universiteti i Prishtinës ishte në krijim e sipër, prandaj çdo ndihmë nga Tirana ishte shumë më rëndësi, që ishte jetike për të gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi. Pikërisht UP-ja shumë shpejt u shndërrua në çerdhe të veprimtarive atdhetare të ilegales.

³⁵³ A. Lalaj, vep. e cit., fq. 270.

³⁵⁴ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, viti 1970, fq. 8-9.

³⁵⁵ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 203, viti 1973, fq. 3.

qartë se kjo më shumë ishte një dhuratë se sa një shitje.

Një ndër faktorët kryesorë në përhapjen e literaturës relevante për nevojat e studentëve dhe studiuesve të ndryshëm, ishte bashkëpunimi midis Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (me tej BK) dhe Bibliotekës (atëherë) Popullore dhe Universitare të Krahinës Autonome të Kosovës (më tej BPU).³⁵⁶ Ne do të sjellim pikat kryesor të marrëveshjes së bashkëpunimit 1980 midis dy bibliotekave:

- BK- do të shkëmbejnë materiale bibliotekare nga të gjitha fushat e veprimtarisë botuese me Bibliotekën Universitare të Kosovës (BPU).
- Materialet bibliotekare që do të shkëmbehen duhet të jenë: Librat nga pesë kopje kurse periodiket nga tri kopje.
- Dy palët do të shkëmbejnë të dhëna bibliotekare, informata shkencore nga lëmi i bibliotekarisë, informacionit dhe shkencës mbi librin.
- Të dy palët duke bërë kërkime në fushën e albanologjisë në botën e jashtme, do t'i këmbëjnë rezultatet e arritura.
- Pala pritëse merr përsipër shpenzimet e ushqimit, fjetjes, transportit të brendshëm dhe shpenzimet komunale.
- Të dy palët hartojnë një protokoll të përbashkët vjetor për zbatimin e kësaj marrëveshje.
- Kjo marrëveshje hyn në fuqi prej datës së nënshkrimit dhe është e vlefshme për pesë vjet. Në rast se asnjë nga palët nuk denoncon atë përgjatë muajve para mbarimit të afatit të saj marrëveshja mbetet në fuqi edhe për pesë vjet të tjera.³⁵⁷

Një kontribut të çmuar në fushën e shkencave humane sidomos në fushën e historisë dhe albanologjisë ka dhënë marrëveshja e bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit të RPSSH-së dhe Drejtorisë së Arkivave të Kosovës 1980.³⁵⁸ Të dy institucionet e lartcekura me qëllim që të forcojnë më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis tyre, u morën vesh për si vijon:

- Të dy palët do të zhvillojnë një bashkëpunim të gjithanshëm kërkimor-shkencor në fushën e arkivistikës dhe në drejtimet me interes të përbashkët.
- Të dy palët do t'i japin mundësinë njëra-tjetrës për zhvillimin e kërkimeve shkencore dhe mbledhjen e burimeve dokumentare në fushën me interes për secilën palë dhe që lidhën me historinë, gjuhën, letërsinë, folklorin, arsimin,, kulturën dhe artin e popullit shqiptar.

³⁵⁶ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej:A MPJ), vitit 1981, Dosja 1220, fq. 41.

³⁵⁷ Po aty, fq. 41-42.

³⁵⁸ A MPJ, fondi 1195, viti 1980, fq. 2.

- Të dy palët do të shkëmbejnë literaturë dhe informacion shkencor e materiale të ndryshme të kësaj natyre me interes të përbashkët.
- Të dy palët marrin përsipër të ndihmojnë për zhvillimin në fushën e arkivistikës dhe në ngritjen e kuadrove.
- Shpenzimet ardhje-kthim të punonjësve shkencor të arkivave që dërgohen në bazë të kësaj marrëveshje, mbulohen nga pala dërguese.
- Ndryshimet e kësaj marrëveshje që do të jenë të nevojshme do të bëhen mbi bazën e pëlqimit të dy palëve etj.³⁵⁹

Po ashtu nga ky bashkëpunim midis dy vendeve, kishte përfituar edhe sporti në përgjithësi, edhe atë thuaja në fillim të bashkëpunimit. Nga data 27. 02. 1972 deri më 03.03. 1972 qëndroi në Shqipëri një delegacion i Lidhjes Futbollistike të Kosovës. I përbërë nga Reshat Mustafa (nënkryetar i Lidhjes Futbollistike të Kosovës). Hamdi Vraniçi (zyrtar për marrëdhënie me jashtë pranë lidhjes futbollistike). Staniç Sllarko (inspektor futbollit pran lidhjes futbollistike).³⁶⁰ Qëllimi i kësaj ardhje ishte të vendosnin kontakte me Federatën e futbollit shqiptar, për t'u marrë vesh që në ditët në vazhdim të shkëmbejnë përvoja dhe të realizojnë vizita reciproke.³⁶¹ Bashkëpunimi midis dy federatave të futbollit ka vazhduar edhe në vitet në vazhdim. Në shkurt të vitit 1978 Shqipërinë e viziton ekipi futbollistik “Vllaznimi” i Gjakovës, i cili ishte i përbërë nga 29 veta, me përjashtim të trajnerit i cili ishte serb, të gjithë të tjerët ishin shqiptarë. Ekipi përveç vizitave që u kishin bërë qyteteve të ndryshme, ata zhvilluan edhe tri ndeshje miqësore, me ekipet “Labinoti” “Besa” dhe “Shpendia”.³⁶²

Gjatë vitit 1973 shteti shqiptar është vizituar jashtëzakonisht nga shumë shkolla fillore por edhe të mesme të Kosovës. Por ajo që më ka lanë përshtypje është programi dhe grafikët e përgatitjes së pritjes së gjithë kosovarëve me një konsideratë të lartë në Shqipëri.³⁶³

Bashkëpunimi midis shtetit shqiptar dhe Kosovës kishte arritur një shtrirje bukur të gjerë, mes institucioneve duke filluar nga Akademia e Universiteti e deri në shkollat e mesme të lartë dhe shkollat fillore. Vetëm gjatë vitit 1973 shtetin shqiptar kanë vizituar një numër i madh i shkollave të mesme dhe fillore: Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri” Deçan; Shkolla fillore “17 nëntori” Istog; Shkolla fillore “Migjeni” fshati Stanofc komuna e Vushtrrisë; Shkolla fillore e

³⁵⁹ Po aty, fq. 1-3.

³⁶⁰ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 234, viti 1972, fq.55. Shih: Sabit Syla, STUDIME HISTORIKE, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2018(3-4) viti LXXII(LV), Tiranë, 2019, fq. 269-270.

³⁶¹ Po aty.

³⁶² AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 242, viti 1978, fq. 15.

³⁶³ Po aty, fq. 85-88.

fshatit Loshan komuna e Podujevës etj.³⁶⁴

Bashkëpunim pati edhe në fushën e artit. Trupa e shumë teatrove të Kosovës kishin vizituar dhe kishin parë shumë shfaqje në shtetin shqiptar, por edhe anasjelltas. Një bashkëpunim midis teatrove kishte filluar qysh në vitin 1970, këtë bashkëpunim e kishte iniciuar ish-drejtori i Teatrit Kombëtar Azem Shkreli. I cili ishte ftuar nga shteti shqiptar për pushime në Shqipëri, por edhe kishte shfrytëzuar rastin për të vendosur relacione të ngushta midis teatrove të dy vendeve. Ku trupat e teatrove të dy vendeve morën pjesë në shumë turne.³⁶⁵ Bashkëpunimi kishte vazhduar gjatë gjithë viteve '70-ta. Në vitin 1978, Shqipërinë e viziton edhe Trupa e Teatrit të Gjakovës, me ftesë të shtetit shqiptar që të shfaqnin pjesën “Fisheku në pajë” të Fadil Krajës.³⁶⁶

Po ashtu në vitin 1973 Shqipërinë e viziton edhe Ansambli Artistik “Shota” nga Kosova, të përbërë nga 42 veta pre të cilave 9 femra. Gjatë vizitës 14 ditore në çdo qytet ishin pritur në mënyrë shumë miqësore.³⁶⁷ Ky grup i ansamblit “Shota” do të bënin 12 shfaqje në qytetet Tiranë, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastër, Tepelenë, Elbasan, Librazhd, Korçë.³⁶⁸

Në vazhden e këtyre bashkëpunimeve midis shtetit shqiptar dhe Kosovës është edhe bashkëpunimi midis Radiotelevizionit të Prishtinës dhe Radiotelevizionit shqiptar. Bashkëpunimi midis këtyre dy institucioneve në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të vitit 1978. Më këtë marrëveshje këto dy institucione radiotelevizive rregulluan bashkëpunimin në fushën e këmbimeve reciproke të programeve të radios dhe televizionit, të materialeve të xhiruara, filmave, muzikë të incizuar etj.³⁶⁹

Në janar të vitit 1973 me ftesë të Kinostudios “Shqipëria e Re” dhe shpenzimet e saj qëndron në Tiranë një delegacion i Kosova – filmit i kryesuar nga drejtori i saj Abdurrahman Shala. Gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri ata shikuan një numër të madh të filmave që ishin prodhim i Kinostudios “Shqipëria e Re”. Gjatë këtij qëndrimi ata arritën këtë marrëveshje.

- Të fillonin menjëherë punën për realizimin në bashkëprodhim të një filmi artistik me temë që do t’u përshtatej të dy palëve.
- Kosova-Filmi mori përsipër që t’u vijonë në ndihmë Kinostudios “Shqipëria e Re” me xhirimet e filmave dokumentarë. Po ashtu ishte arritur marrëveshja që të mundësohet filmimi i disa vendeve dhe objekteve historike për filmat dokumentar “ Kryengritjet në

³⁶⁴ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 203, viti 1973, fq. 80-81.

³⁶⁵ QASH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, viti 1970, fq. 38,39,40.

³⁶⁶ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 242, viti 1978, fq. 39, 65.

³⁶⁷ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 203, viti 1973, fq. 31.

³⁶⁸ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 203, viti 1973, fq. 109.

³⁶⁹ AQSH, Fondi 490, dosja nr. 726, viti 1979, fq. 240.

prag të Pavarësisë” dhe “ Gjuha Shqipe”.

- Dy ndërmarrjet filmike morën përsipër që të ndihmojnë njëra tjetrën për sigurimin e materialeve të Kino-arkivave.
- Kinostudio “Shqipëria e Re” mori përsipër që të pranoj nga Kosova-filmi kuadro të ndryshme për specializime nga dy deri në tre muaj.
- Kinostudio “Shqipëria e Re” e ndihmoi Kosova-filmin me kuadro regjisor, operator dhe specialist të tjerë sipas nevojës.
- Kinostudio “Shqipëria e Re” e ndihmoi Kosova-filmin me mjete teknike sipas mundësive që ajo do të ketë.
- Kosova-filmi kërkon që të organizohet në Shqipëri java e filmit jugosllav. Kino Studio “Shqipëria e Re” nuk e pranon.
- Dy ndërmarrjet ranë dakord që të këmbenin literaturë teknike.
- Kosova Filmi bleu disa filma me çmime shumë modeste për t’i shfaqur në Kosovë etj.³⁷⁰

Prej të gjitha institucioneve të arsimit, kulturës dhe shkencës, bashkëpunim më intensiv dhe më i gjithanshëm ishte ai midis UT-së dhe UP-së. Vetëm sipas protokollit të bashkëpunimit në mes të Universiteti të Prishtinës dhe atij të Tiranës, vetëm në vitin 1974-1975 në Kosovë kanë ardhur për të ligjëruar 26 profesorë.³⁷¹ Pedagogët e Universiteti të Tiranës kanë ligjëruar vetëm studentëve të UP-së të cilët ndiqnin studimet në gjuhën shqipe. Vetëm gjatë vitit akademik 1974-1975 përafërsisht 8% lëndëve mësimore në fakultete e UP-së janë angazhuar pedagogë nga UT-ja. Ligjërimi i tyre kryesisht ka qenë në Fakultetin Teknik, Fakultetin e Mjekësisë, Shkencave të Natyrës e më pak në atë Juridik dhe Ekonomik.³⁷²

Në ngritjen e kapacitetit akademik të Universitetit të Prishtinës një kontribut të pamohueshëm ka dhënë Universiteti i Tiranës. Kjo ka pasur impakt të drejtpërdrejt në shtimin e numrit të studenteve në UP. Kjo vërehet nëse nxjerrim një paralele të thjeshtë, në vitin shkollor 1970-1971 UP-ja ka pasur 10.368 student nga të cilët 5.707 kanë qenë të kombësisë shqiptare e 3.916 të kombësisë serbe, malazeze dhe maqedone 127 të kombësisë turke. Ndërsa gjatë vitit 1974-1975 ka pasur 22. 207 student nga të cilët 13. 945 ishin me kombësi shqiptare 6.424 të kombësive serbe, malazeze dhe maqedone 220 të kombësisë turke.³⁷³

Për një periudhë kohore 4 vjeçare është rritur numri 100% i studentëve, një meritë të

³⁷⁰ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 203, viti 1973, fq. 17-18.

³⁷¹ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 198, viti 1975, fq. 7-8.

³⁷² Pajazit Nushi, vep. e cit., fq. 34.

³⁷³ Po aty, fq. 34.

pamoheshme këtu kishte Universiteti i Tiranës. Shumica e ligjëruesve nga Universiteti i Tiranës ishin punëtorë të dalluar shkencor si brenda ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.³⁷⁴

Po ashtu edhe UT-ja, ka pritur nga UP-ja 34 kuadro për vitin 1974-1975, për shkëmbim përvoja thuajse në të gjitha fushat shkencore, për specializim, kërkim, përgatitje të magjistraturave dhe të doktoraturave.³⁷⁵

Duke u nisur nga vullneti i mirë nga të dyja palët që të arrihet niveli sa më i mirë i bashkëpunimit midis dy universiteteve UT-së dhe UP-së edhe gjatë vitit 1975-1976, kishin nënshkruar një protokoll bashkëpunimi, i përbërë nga 16 pika dhe disa anekse.³⁷⁶ Nga ky protokoll vërehet qartë se edhe nga Kosova në Shqipëri shkon një numër i madh i ekspertëve të fushave të ndryshme. Këto ishin fushat shkencore ku do të priteshin ekspertë të ardhur nga UP-ja në UT:

Tabela. 6

Fakulteti dhe dega	Fusha e specializimit	Numri i kuadrove
I. Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
1. Kimi	Kimi analitike	1
	Metodikë e Kimisë	1
2. Fizikë	Elektrodinamika	1
3. Matematikë	Analiza III .	1
4. Biologji	Sistemi i Bimëve të Ulëta	1
II. Fakulteti i Inxhinierisë		
1. Mekanizmat	Shkëmbim përvoja	1
2. Konstruksionet e Betonit	-----	1
II. Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike		
	Përvoja e Shqipërisë në fushën në zhvillimi kooperativave zejtare.	1
	Zhvillim ekonomik-shoqërorë i familjes	1

³⁷⁴ Po aty, fq. 36.

³⁷⁵ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 198, viti 1975, fq ,12. Këto të dhëna janë vetëm të aneksit I, të protokollit të bashkëpunimit të UT-së dhe UP-së. Janë gjithsej IV anekse . Secili draft ka thuar kaq të dërguar.

³⁷⁶ Po aty, fq. 9-10.

	shqiptare .	
	Organet lokale të pushtetit RPSH-së	1
IV. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë		
V. Gjuha dhe letërsia shqipe	Konsultim materialesh lidhur temën e doktoraturës “E folmja e Qytetit të Gjakovës”.	1
VI. Dega e letërsisë dhe gjuhës shqipe	Konsultime materialësh lidhur me temën doktoraturës “Jeta dhe veprimtaria e Çajup konsultim materialësh për magjistraturë në gjuha e sotme shqipe.	1
VII. Dega e Historisë	Konsultime materialësh për magjistraturë nga historia e letërsisë Shqipërisë.	4
	Konsultime materiale arkivore dhe bibliografike në fushën e historisë së Lidhjes Shqiptare Prizrenit.	1
	Për periudhën e mesjetës. Dhe për periudhën e kohës së re.	4
VIII. Dega e Pedagogjisë	Konsultime materialesh lidhur me arsimin rriturve pa shkëputje nga puna.	1

IX. Fakulteti i Mjekësisë	Fiziologjia	1
	Anatomia patologjike	1
	Kirurgjia	1
	Akusheria	1
	Medicina e punës	1
	Medicina interne	1
	Farmakologjia	1
X. Akademia e Artëve	Piktura	1

E gjithë kjo pasqyrë e dërgimi të specialisteve të Kosovës në Shqipëri në kuadër të planit

kulturor1975-1976, ishin të dhëna nga Aneksi i I. ³⁷⁷

Aneksi II i këtij protokoll bashkëpunimi parashihet të vinin nga Shqipëria në Kosovë ekspertë të fushave të ndryshme shkencore, sidomos aty ku kishte më shumë nevojë UP-ja:

Tabela. 7

FAKULTETI QË PRET	FUSHAT E SPECIALIZIMIT	NUMRI I KUADROVE Emrat e disa prej tyre
I. Fakulteti Filozofik	Kërkime arkivore dhe bibliotekare në fushën e historisë së Shqipërisë, në fushën e gjuhësisë dhe letërsisë shqipe etj.	9
1. Arkeologjia	Ilirologjia	Myzafer Korkuti Çesk Prendi Aleksandra Nano
II. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	Shkëmbim përvojë për problemet e hidrologjisë dhe metrologjisë (për atlasin klimatik).	2
1. Kimia	Kimia Fizike.	Veron Kola
	Kimia Analitike.	Feti Sazani
	Kimia e produkteve natyrore.	Theo Bisha
	Kimia Organike.	Kost Koci
2. Fizika		Petro Skenda
3. Biologjia	Sistematika e bimëve të ulëta	Emin Balza Ose Xhafer Qosja
III. Fakulteti Juridik	Kërkime mbi të drejtën zakonore shqiptare	2
	Mbi marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve	Ksanthipi Begaj
	Përvoja e Shqipërisë në luftën kundër pasojave të dëmshme të religjionit.	Petro Lalaj.
IV. Fakulteti i Bujqësisë	Shkëmbime mendimesh dhe marrje të dhënash mbi kompleksionin e Liqenit të Ohrit, Shkodrës dhe Lumit Drin, për temën qeveritare “ Hidrologjia Shqiptare”.	2
V. Akademia e Arteve		
1. Historia e artit		Dhorka Dhamo
2. Skulptura		Shaban Haderi

Pasqyrë e ardhjes së specialistëve nga Shqipëria në Kosovë për vitin akademik 1975-1976. ³⁷⁸

³⁷⁷ Po aty, fq. 12-13.

³⁷⁸ Po aty, fq.14,15,16.

Po ashtu sipas një projekt protokollit për bashkëpunim midis Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Shkupit për vitin 1975-1976, ishin paraparë të dërgojnë kuadro në Universitetin e Shkupit. Por ajo që për mendimin tim e bën të veçantë këtë projekt protokoll ishte fakti ku tregohen nga ana e shtetit shqiptar fushat për ligjërata të veçanta që mund të ligjëronin profesorët shqiptarë.

- Problemet e historisë së gjuhës shqipe.
- Problemet e gjuhës së sotme shqipe.
- Probleme e letërsisë shqipe.
- Mbi lëvizjen kombëtare shqiptare.
- Rruga e zhvillimit historik të folklorit shqiptar etj..³⁷⁹

Edhe pse pala shqiptare kërkon që edhe Universiteti i Shkupit të dërgojë ligjërues për gjuhën dhe historinë e Maqedonisë, kjo të jep vetvetiu të kuptojmë se qëllimi ishte që shqiptarët në Maqedoni të kenë mundësi më shumë ta njohin gjuhën, kulturën dhe historinë shqiptare.

Ajo që vlen të theksohet është edhe vizita në Shqipëri e rektorëve të tri universiteteve të ish-Jugosllavisë, si Rektori i Universitetit Beogradit, Dragisha Jovanović, Rektori i Universitetit të Shkupit, Kirilli Penushliski dhe Rektori i Universitetit të Prishtinës Dervish Rozhaja.³⁸⁰ Kjo ftesë që u është bërë rektorëve në fjalë nga autoritetet shqiptare, të jep të kuptosh që nuk është bërë rastësisht, por për të dëshmuar se ne jemi të hapur për të gjitha universitetet e ish-Jugosllavisë e jo vetëm për Universitetin e Prishtinës. Pra për të krijuar bindjen se prapa këtyre këmbimeve kulturore në mes Kosovës dhe Shqipërisë nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.

Nga ky bashkëpunim midis dy vendeve nuk kishte lënë anash edhe fushën e muzikologjisë. Në maj të vitit 1978, me ftesë të Tiranës zyrtare, Shqipërinë e vizitojnë kompozitorët më të njohur nga Kosova, Akil Koci, Rauf Dhimi, Vitomir Iliç. Krejt kjo ishte bërë që të arrinin një bashkëpunim sa më të mirë edhe në këtë fushë.³⁸¹

Kjo është një dëshmi se të dy palët dëshironin që të shfrytëzonin këtë bashkëpunim për të depërtuar elementet kulturore e mbi të gjitha vëllazërore reciprocisht në çdo zonë dhe

³⁷⁹ Po aty, fq. 66.

³⁸⁰ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 180, viti 1971, fq. 79-80.

³⁸¹ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 242, viti 1978, fq. 91-106.

segment të shoqërisë shqiptare. Duke mos përjashtuar asnjë fushë të kulturës, arsimit dhe shkencës.

Edhe vit 1974-1975-1976 vazhdonte të ishte dinamikë ashtu si vitet paraprake sa i përket bashkëpunimit reciprok midis dy vendeve në fushën e arsimit, kulturës etj.. Përsëri u nënshkruan protokolle bashkëpunimi midis UT-së dhe UP-së. Këto protokolle kishin edhe shumë anekse ku paraqiteshin në mënyrë të detajuar të gjitha sferat e bashkëpunimit.³⁸²

Edhe përkundër një bashkëpunimi kaq të ngjeshur, shteti shqiptar çdo vit tentonte që të rriste sa më shumë bashkëpunimin me shqiptarët në ish-Jugosllavi konkretisht me kosovarët. Për këtë dëshmon një dokument strategjik për objektivat e bashkëpunimit me shqiptarët në ish-Jugosllavi i datës 14.04.1978 i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës të Shqipërisë.³⁸³ Ku përfshiheshin 11 objektiva për këtë bashkëpunim me shqiptarët në ish-Jugosllavi. Objektivat ishin këto :

- Të përsëriten protokollet e bashkëpunimit mësimor dhe shkencor me Universitetin e Prishtinës dhe të Shkupit.
- Të shikohet mundësia për të përfunduar një protokoll bashkëpunimi edhe me Universitetin Velko Vllahoviç të Malit të Zi.
- Të mbahen marrëdhëniet e arritura verbalisht midis Institutit të Lartë Pedagogji të Shkodrës dhe Shkollës së Lartë Pedagogjike të Gjakovës.
- Të ruhen marrëdhëniet e deritanishme Kinostudios “Shqipëria e re” dhe “Kosovafilmit”.
- Të ruhen dhe të zhvillohen marrëdhëniet kontraktuale midis ndërmarrjes sonë të librit dhe ndërmarrjes “Rilindja” të Kosovës.
- Të ruhen si deri me tani marrëdhëniet midis Bibliotekës sonë Kombëtare dhe Bibliotekës së Prishtinës.
- Të dërgohen në Kosovë një delegacion i Bibliotekës Kombëtare, i përbërë prej 3-4 vetash, në përgjigje të ftesës së Bibliotekës së Prishtinës.
- Të ftohet një grup, deri në 10 veta, punonjës të bibliotekave të Kosovës, për shkëmbim të përvojave, literaturës etj..
- Biblioteka Kombëtare të zgjerojë marrëdhëniet e saj për dërgimin e librave jo vetëm për Bibliotekën e Prishtinës, por edhe të bibliotekave tjera në qytetet e Kosovës.
- Të ruhen marrëdhëniet si deri më tani në mes të Teatrit tonë Kombëtar dhe Teatrit të

³⁸² AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr.198, viti 1975, fq.1-2, 9-10.

³⁸³ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 242, viti 1978, fq. 82.

Protokolli i fundit i bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë, konkretisht Kosovës ishte ai i viteve 1980-1981. Ku u hartua një protokoll bashkëpunimi i përbërë nga 17 pika dhe pesë ankese, të nënshkuara nga Rektori i UT-së Prof. Petrit Radocika dhe Rektori i UP-së Prof. Gazmend Zajmi për vitin akademik 1980-1981. Protokolle parashihte këto pika të bashkëpunimit:

- UT-ja do të pranojë kuadro nga UP-ja kuadro për shkëmbim përvoja, specializim, kërkim dhe përgatitje temash të magjistraturës dhe të doktoraturës.
- UP-ja do të pranojë kuadro nga UT-ja kuadro për shkëmbim përvoja, specializim, kërkim dhe përgatitje temash të magjistraturës dhe të doktoraturës.
- UT-ja do të dërgojë kuadro mësimore dhe shkencore për të zhvilluar cikle ligjëratah për tema të veçanta në fakultetet e UP-së, me studentë, mësimdhënës.
- UP-ja do të dërgojë kuadro mësimore dhe shkencore për të zhvilluar cikle ligjëratah për tema të veçanta në fakultetet e UT-së, me studentë, mësimdhënës.
- UT-ja shprehet e gatshme, që sipas kërkesës së UP-së të pranojë pranë katedrave të veta deri ne 5 studentë për konsultim dhe udhëheqje të temave të diplomës.
- UT-ja me kërkesën e UP-së, sipas mundësisë, do të angazhojë kuadrot e veta mësimore –shkencore për recensimin e dispensave dhe të teksteve universitare.
- UP-ja me kërkesën e UT-së, sipas mundësisë, do të angazhojë kuadrot e veta mësimore –shkencore për recensimin e dispensave dhe të teksteve universitare.
- UT-ja dhe UP-ja, do të kryejnë kërkime të përbashkëta në fusha që paraqesin interes të dyanshëm.
- UT-ja dhe UP-ja do të përkrahin dhe do t'i ndihmojnë vizitat reciproke dhe ekskursionet mësimore të grupeve të studentëve.
- UT-ja shprehet e gatshme të marr masa të mëtejshme dhe të ndërmjetësojë pranë institucioneve përkatëse për të siguruar tekste universitare të botimeve më të reja si dhe veprat letrare në gjuhën shqipe që mund të jenë me interes për studentet e UP-së. Po ashtu edhe UP-ja shpreh gatishmëri që brenda mundësive të siguroj tekste universitare dhe vepra letrare për studentët e UT-së.
- UT-ja dhe UP-ja do të këmbëjnë literaturë mësimore dhe shkencore në pesë ekzemplarë, plane dhe programe mësimore sipas kërkesës, dhe fotokopje dhe

³⁸⁴ Po aty, fq. 83-84.

mikrofilmime materialesh arkivale për qëllime shkencore.

- UT-ja dhe UP-ja do të botojnë herë pas here, në organet përkatëse të secilës palë, artikuj shkencor, që konsiderohen të dobishme.
- UT-ja dhe UP-ja, sipas rastit, do të ftojme kuadro mësimore-shkencore të njëra tjetrës për shkëmbime përvojash në mbrojtje të disertacioneve , në konferenca, simpoziume, sesione shkencore të rëndësishme.
- Gjatë zbatimit të këtij protokollit të bashkëpunimit UT-së dhe UP-së, në marrëveshjen midis tyre, mund të bëjnë ndryshme dhe plotësime eventuale në pajtim me frymën e bashkëpunimit midis dy universiteteve.
- UT-ja dhe UP-ja u morën vesh që planet dhe programet e punës për kuadrot e tyre të dërgohen jo më vonë se një muaj para ardhjes.
- Për zbatimin e këtij protokoll bashkëpunimi misit UT-së dhe UP-së projektoj këto kushte financiare: Shpenzimet e udhëtimit vajtje-kthim, të kuadrove që dërgohen në shërbim nga të dy universitetet, në bazë të këtij protokollit i merr përsipër pala dërguese, ndërsa pala pritjes iu siguron, fjetjen, ushqimin, mjekimin dhe shpenzimet e transportit të brendshëm.
- Ky protokoll u hartua në dy kopje me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë në gjuhën shqipe dhe serbokroate.³⁸⁵

Për shkak të volumit të madh që kishin anekset e protokollit të bashkëpunimit ne do të sjellim vetëm aneksin e parë të këtij protokollit ku parashihej ardhja e kuadrove nga UP-ja në UT.

Tabela. 8

FAKULTETI DHE DEGA	FUSHA E SPECIALIZIMIT	NUMRI I KAUDIRIT
Akademia e Arteve	Muzikë-Klarinetë	
	Arti figurativ-Anatomi plastike	
Fakulteti i Mjekësisë	Neuropsikiatri	
	Internsit-Endokrinolog	
	Internsit - diabetolog	
	Kirurg-Ortoped	

³⁸⁵ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 272, viti 1980, fq. 24,25,26.

	Pediatër	
	Anatomi	
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Didaktika e Matematikës	
	Gjeografia	
	Fizika	
	Kimia Organike	
Fakulteti i Bujqësisë	Entomologjia	
	Pemëtaria e përgjithshme dhe speciale	
Fakulteti Juridik	Pasuria e përbashkët bashkëshortore Koncepti legjislativ dhe praktik i saj në RPSSH	
	Parimet e procedurës penale të KPP në RPSSH	
Fakulteti Teknik	Llogaritja mekanike konstruksioneve pranë katedrës së makinerisë	
	Katedra për përpunimin e materialit “ afati i qëndrueshmërisë instrumenteve prerëse më pllaka të materialit të fortë”.	
	Zgjedhjet kabllorike në rrjetet e tensionit të lartë.	
	Materialet elektrike	
	Zhvillimi i arkitekturës dhe artit	
Fakulteti i Inxhinierisë dhe Metalurgjisë	Kimia Organike	
	Elektro Kimia dhe elektrometalurgjia	
	Kimia e përgjithshme dhe inorganike	
Fakulteti Ekonomik	Financimi i konsumit të veprimtarive shoqërore(arsimit, kultura, shkenca dhe mbrojtja shëndetësore.	
Fakulteti Filozofik	Dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe	

	Autorët e vjetër të gjuhës shqipe	
	E folmja e Hasit	
	Gjymtyrimi i fjalisë në gramatikat midis dy luftërave.	
	Leksiku baritor i shqipes	
	Sistemi foljor i shqipes	
	Vështrim gjuhësor mbi veprat e Papa Kristo Negovanit.	
	Komisia Letrare e Shkodrës dhe roli i saj në formimin e gjuhës letrare.	
	Dega e Letërsisë dhe gjuhës shqipe	
	Letërsia e Rilindjes Kombëtare	
	Drama shqipe prej fillimi deri 1939	
	Tradita dhe novatorizmi në poezinë e sotme shqipe.	
	Dega e Pedagogjisë	
	Zhvillimi i teorisë dhe praktikës bashkëkohore pedagogjike në tërësi dhe zhvillimi i terminologjisë pedagogjike në veçanti.	
	Periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe 1945-1978.	
	Dega Filozofi-Sociologji	
	Humanizmi në veprat e rilindësve shqiptarë.	
	Dega e Gjuhës dhe letërsisë angleze	
	Sistemi i gabimeve dhe korigjimi i tyre te shqiptarët që mësojnë gjuhën angleze.	
	Dega e Historisë	
	Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave	
	Dardanët	
	Fakulteti i Kulturës fizike	

	Basketbolli	
--	-------------	--

Këto janë fushat ku UT-ja pret kuadrot nga UP-ja për shkëmbim përvoja, specializim, përgatitje të magistraturës dhe të doktoraturës.³⁸⁶

Depërtimi i literaturës nga Shqipëria nuk ishte e rëndësishme vetëm për shtresat intelektuale, për studentë dhe nxënës por edhe për të gjithë ata që ishin të interesuar për lexim. Përveç Kosovës, përmes ndërmarrjes u dërguan një sasi librash edhe në viset e tjera të Jugosllavisë si dhe në vende të tjera të botës, ku kishte emigracion kosovar si në Belgjikë, Australi, Zvicër, Gjermani, SHBA, Kanada etj.³⁸⁷ Veprimtaria e tyre në këtë drejtim ka synuar njohjen e gjithanshme dhe forcimin e lidhjeve me ta. Ato shpërndanë edhe materiale me përmbajtje të lidhur direkt me Kosovën sikurse kanë qenë libri *“Shote dhe Azem Galica”* e *“Isa Boletini”*.³⁸⁸ Kjo ishte më të vërtet një veprimtari jetike që do jep rezultate shumë të mëdha pak vite më vonë.

Që edhe mërgata shqiptare të jetë e lidhur me atdheun e tyre, që pikërisht është kjo mërgatë që do të ndihmojë vendlindjen në ditët më të vështira si gjatë kohës së apartheidit dhe gjatë luftës në Kosovë.

Prej të gjitha ambasadave shqiptare ajo ne Beograd, me detyrat e saja më të veçanta ndaj Kosovës, nga Drejtoria e IV, më 28 mars 1977, udhëzohej për riorganizimin e punës në seksionin e Kosovës. Sipas udhëzimit, Ambasada një rëndësi duhej t’i kushtonte masave për përmirësimin e mëtejshëm të punës në ndjekjen e çështjes së viseve shqiptare në Jugosllavi.

Çështje e cila duhej të ngrihej në shkallen e ndjekjes se plote e sistematike të aspekteve kryesore të gjendjes në Kosovë e mbi këtë bazë të arrihej edhe në një punë informative-operative dhe informative studimore të plotë, unike të gjithanshme e sistematike.³⁸⁹

Pas fillimit të marrëdhënieve Shqipëri-Kosovë, u shtuan detyrimet edhe nga përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë për çështjen e Kosovës, në vende të ndryshme të botës. Në radhë të parë duhet të shtojnë veprimtarinë dhe të bëheshin më aktivë ato përfaqësi të shtetit shqiptar, të cilat mbulonin vende dhe zona me një numër relativisht të madh shqiptarësh, të tillë si në Jugosllavi, Ankara, Vjenë, Paris, Berlin etj.³⁹⁰

Pra, si qëllim parimor i udhëheqjes politike të Shqipërisë shikohej shfrytëzimi i mundësive ekzistuese, duke u bërë të qartë shqiptarëve në Jugosllavi që lufta e tyre tani të

³⁸⁶ Po aty, fq. 59,60,61.

³⁸⁷ Sabit Syla, vep. e cit., fq. 206.

³⁸⁸ Po aty, fq. 207.

³⁸⁹ Po aty, fq. 208.

³⁹⁰ Sabit Syla, Shteti Shqiptar dhe çështja Kosovës 1939-1981, vep. e cit., fq. 193.

konsistojë në shfrytëzimin e situatës për të fituar sa më shumë të drejta në arsim, art, kulture, folklor, zhvillim ekonomik, ndalimit të emigrimit e asimilimit, rritjes së ndjenjave kombëtare patriotike në drejtim të strukturës nacionale, në zhdukjen e zakoneve prapanike etj.

Një dëshmi për interesimin e çdo gjëje në Kosovë dhe viset tjera shqiptarë në ish-Jugosllavi, xhirimi i mbi 40 qyteteve, fshatrave dhe lokaliteteve të ndryshme historike nga kineastët e Kinostudio “Shqipëria e re”.³⁹¹ Pastaj janë marrë në sinkron pesë pleq: Ramë Metushi 106 vjeçar, Koshare-Ferizaj; Qazim Idriz Seferi 88 vjeç, Zhegër-Gjilan; Ibrahim Hoxha- Junik; Ilaz Badiviku Vuçitërna (Vushtrri) dhe Beqir Hajredin Haxhi Beqir-Gjakovë.³⁹²

Kulminacioni i këtyre bashkëpunimeve ishte vizita në Shqipëri e sekretarit të arsimit dhe kulturës të Kosovës Ymer Jakës. Vizita e të parit të arsimit të Kosovës ishte e para e këtij niveli kuptohet me ftesë të ministres së arsimit të Shqipërisë Tefta Cami. Sekretari Jaka qëndroi në shtetin shqiptar nga data 25.12. 1979 deri më 30.12. 1979. Ku i bëhet një pritje jashtëzakonisht e mirë dhe viziton thuaja të gjitha institucionet më të rëndësishme të arsimit dhe kulturës së Shqipërisë.³⁹³

Gjatë kësaj vizite ishte konstatuar se marrëdhëniet bilaterale jugosllav-shqiptare viteve të fundit po zhvillohen me mjaft sukses, si në planin ekonomik ashtu edhe në planin arsimor, shkencor dhe kulturor. Ky si rezultat i këtij bashkëpunimi është arritur deri më tani të nënshkruhen pesë marrëveshje bashkëpunimi me rëndësi shumë të madhe, midis:

- Universiteti të Prishtinës dhe Universitetit Shtetëror të Tiranës.
- Redaksisë së Botimeve të Rilindjes me ndërmarrjen e Librit e të filmit të RPSSH-së.
- Radio- televizionit të Prishtinës me Radio-televizionin e Shqipërisë.
- Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës me Akademinë e Shkencave të RPSSH-së.
- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë dhe Shoqatës së shkrimtarëve të Kosovës.³⁹⁴

Një vit më vonë, pra 1980 edhe Kosovën e viziton ministria e Arsimit dhe Kulturës së Shqipërisë.³⁹⁵ Çka ishte më të vërtet një e gjë e jashtëzakonshme kur dihej se kishin marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë disa dekada më herët, ose dhe si në

³⁹¹ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 242, viti 1978, fq.15.

³⁹² Po aty.

³⁹³ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 246, viti 1979, fq. 4-5.

³⁹⁴ ASHAK, fondi: Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me Botën e Jashtme, vitit 1968-1991, lënda 1-200, kutia: 7, fq. 1-2.

³⁹⁵ Shih edhe: Tefta Cami, vep. e cit.

çfarë pike arrijnë marrëdhëniet në mes të dy shteteve fqinje thuaja pas një viti.

Bashkëpunimi vazhdoi më të njëjtin intensitet edhe gjatë viteve 1980 dhe fillim të vitit 1981, më së mirë këtë na argumentoi nënshkrimi i protokolleve të bashkëpunimit mes Rektorit të Universitetit të Tiranës prof. dr. Petrit Radovica dhe rektorit të Universitetit të Prishtinës prof. dr. Gazmend Zajmi.³⁹⁶ Si dhe nënshkrimi midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës. Protokollin e bashkëpunimit midis dy universiteteve ishte i përbërë nga 17 pikat dhe katër anekse për vitet 1980-1981. Ku parashiheshin këmbime kuadrosh thuaja në të gjitha fushat e shkencës dhe kulturës. Universiteti i Prishtinës si një institucion i sapo krijuar ishte ai i cili kishte përfituar më së shumti nga ky bashkëpunim.

Vlerat apo më mirë të thuhet profitet që ka përfituar UP-ja nga këto raporte ishin:

- Përgatitja e duhur pedagogjike e shkencore e personelit arsimor të UP-së.
- Niveli e kualiteti i duhur i veprimtarisë arsimore e shkencore ishte evident në të gjitha lëmitë shkencore.
- Shumë prej formave të vendosura me herët pas këtij bashkëpunim kishin arritur një zhvillim shumë të madh. Shkëmbime për literaturë universitare etj..
- Marrëdhëniet arsimore të zhvilluara mes Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës përmbante elemente të mirëfillta shkencore posaçërisht në pikëpamje për formimin sa më komplet të kuadrit të ri shkencor. Kjo kishte vlerë shumë të madhe për të gjitha lëmitë shkencore të UP-së.
- Një ndër gjërat më shumë vlerë që kishte përfituar UP-ja nga bashkëpunimi me UT-në ishte ngritja e kuadrit të ri arsimor etj.³⁹⁷

Nënshkrimi i protokollit të bashkëpunimit kërkimor shkencor midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës për vitet 1981-1982 përbëhej nga kryetari i Akademisë së Kosovës prof. Idriz Ajeti, sekretari i përgjithshëm i Akademisë, prof. Syrja Pupovci si dhe sekretarit teknik i Akademisë Zija Bylykbash. Në pritjen solemne në selinë e Akademisë së Shqipërisë u pritën nga kryetari i Akademisë prof. Aleks Buda.³⁹⁸ Gjatë qëndrimit të delegacionit të Akademisë së Kosovës në Shqipëri, janë diskutuar edhe shumë gjëra në mënyrë shumë më të hapur se përpara. Se në cilat fusha të fokusoheshin më shumë, cilat nuk shiheshin me sy të mirë nga qarqet jugosllave. Pastaj jepen sugjerime që të merren nisma nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë për të përkujtuar disa nga figurat me rëndësi

³⁹⁶ AQSH, Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 272, viti 1980, fq. 58-59.

³⁹⁷ P. Nushi, vep. e cit., fq. 42-43.

³⁹⁸ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, vitit 1981, Dosja 1229, fq. 124-129.

historike dhe kulturore si Pjetër Budi, Pjetër Bogdani., sepse po te merret një nismë nga ne do të keqkuptohet.³⁹⁹

Më 31.01.1981 u bë takimi përfundimtar i grupeve të punës për të hartuar projektin përfundimtar të protokollit. Në dallim nga protokollit i mëparshëm i vitit 1979-1980, ku do të bënin edhe ekspedita të përbashkëta shkencore, duke hulumtuar në arkivat e dy vendeve për fusha të ndryshme, si historike, në fushën e historisë së letërsisë, mbledhjen e materialeve leksikore, etj..⁴⁰⁰

Është e pakontestueshme se hapja e Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë gjithë viteve të 70-ta ka ndikuar në ngritjen kulturore, intelektuale dhe arsimore të popullatës shqiptare në Kosovë. Edhe përkundër se ky lloj komunikimi midis Shqipërisë dhe Kosovës ndodhi nën mbikëqyrjen e pushtetit komunist si në Shqipëri ashtu edhe në ish-Jugosllavi.

Hyrja e literaturës së shumtë nga Shqipëria në Kosovë, zhvillimi i marrëdhënieve kulturore, shkencore, arsimore e tregtare, fuqizimi i valëve të Radiotelevizionit Shqiptar, liberalizimi sado-kudo i kriterëve të kalimit të kufirit midis shqiptarëve, bënë kthesë shumë të rëndësishme në emancipimin e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe në ngritjen e ndërgjegjes së tyre kombëtare.⁴⁰¹

Thuaj të gjitha veprat e rilindësve tanë iu dhanë “Rilindjes” të ribotohen, që të mundet të lexohen edhe në Kosovë. Po ashtu edhe shumë studime të fushave të ndryshme.

Në Adresë të bibliotekave të Kosovës shteti shqiptar dërgoi 122 tituj të sapo botuar, krejt kjo vetëm për vitin 1977. Po ashtu vetëm gjatë vitit 1977 në Kosovë janë dërguar 20.022 copë libra tekniko-shkencore dhe 47.920 libra të letërsisë artistike.⁴⁰² Pra ishte një ndihmesë shumë e madhe për institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore të Kosovës. Pastaj shumica e filmave të Kino Studios “ Shqipëria e Re” u dhanë për t’u shfaqur në Kosovë.

Nga ky bashkëpunim midis dy vendeve përfituan edhe lëvizjet ilegale të cilat gjetën rrugën për të shkëmbyer informacione që do të ndihmonin sidomos Kosovën për të vazhduar përpjekjet për avancimin e të drejtave të saj në Jugosllavi.⁴⁰³

Ky bashkëpunim ka ngjallur edhe shumë më shumë ndërgjegjen kombëtare. U krijua një brez i intelektualëve që do t’u printe shumë proceseve në fusha të ndryshme. Po ashtu është e pakontestuar se janë pikërisht këto vite që kanë qenë bazament për të gjitha zhvillimet e fuqishme që kanë ndodhur në vitet në vazhdim si 1981, 1989, 1998-1999.

³⁹⁹ Po aty, fq. 125.

⁴⁰⁰ Po aty, fq. 106-107.

⁴⁰¹ Mehmet Hjarizi, vep. e cit., fq. 181.

⁴⁰² Sabit Sylva, vep. e cit., fq. 206.

⁴⁰³ Faruk Geci, vep. e cit., fq. 12.

Ndoshta pikërisht kjo hapje dhe ky bashkëpunim ka bërë që shteti jugosllav të parin që do të akuzonte për ndikim në demonstratat e vitit 1981 do të ishte pikërisht shteti shqiptar.

Prandaj një ndër ata protagonistët e këtyre ngjarjeve Rexhep Qosja më të drejtë konstaton: *“Roli i Shqipërisë në këtë periudhë është shumë i madh, Prandaj kontributi i shtetit shqiptar në ngritjen e vetëdijes kombëtare në Kosovë është i çmuar dhe përbën një kontribut të madh në krijimin e atij që sot quhet shteti i Kosovës”*.⁴⁰⁴

Çdo herë duke u bazuar në dokumentet autentike arkivore, por edhe në rrjedhën e ngjarjeve të mëvonshme, lirisht mund të vijmë në konkludimin se nuk do të kishin ndodhur ngjarjet e vitit 1981, po të mos kishte ndodhur ky bashkëpunim bilateral në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.

Nuk do kishte vlerën e vetë as rënia e Aleksandër Rankoviçit sikur të mos kishte ndodhur ky bashkëpunim për një dekadë. Pra pa dashur që t'i bije në kurthin e diletantizmit apo të ndonjë emocioni, ky bashkëpunim në mes të Shqipërisë dhe Kosovës ishte një mrekulli që ka mundur të ndodh shqiptarëve në ish-Jugosllavi në këtë periudhë.

Është fakt se ndërprerja e bashkëpunimit midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë erdhi si rezultat i shpërthimit të demonstratave studentore më 11 mars 1981, edhe pse ishte nënshkruar një protokoll bashkëpunimi disa muaj më herët për vitet 1981-1982. Por këtë duhet merret më shumë si shkas i ndërprerjes së bashkëpunimit, sepse pakënaqësi brenda federatës kishin shfaqur kaheerë qarqet serbe, ku çdo ditë e më shumë vinin duke u shtuar këto pakënaqësi. Për këtë arsye shteti jugosllav ishte ai i cili njëanshëm ndërpret bashkëpunimin. Ndërprerja e këtij bashkëpunimi kishte pasoja të mëdha për shqiptarët e Kosovës. Jo vetëm për faktin që nuk do kishte ndihma në shumë fusha nga shteti shqiptar, por sepse të gjithë ata që kishin vizituar Shqipërinë ose kishin qenë pjesë e bashkëpunimeve në mes të dy vendeve u shndërruan në armiq të shtetit jugosllav. Ku shumica prej tyre ishin arrestuar ose kishin kaluar në të ashtuquajtura biseda informative. Krejt kjo pasi organet më të larta jugosllave akuzonin shtetin shqiptar për nxitje në shpërthimin e demonstratave e viti 1981.

Organet më të larta jugosllave kërkuan nga profesorët dhe stafi udhëheqës i Universitetit të Prishtinës që të dilnin me një vlerësim sa më negativ mbi bashkëpunimin me UT-në, por jo vetëm që nuk dolën me një analizë kundër këtij bashkëpunimi, por në mbledhje Pleqësisë së UP-së e mbajtur në korrik 1981, nuk vërehet askund vlerësime negative për bashkëpunimin midis dy universiteteve.⁴⁰⁵ Për këtë vlerësim jo në favor të politikës jugosllave kishte reaguar

⁴⁰⁴ Po aty.

⁴⁰⁵ Kristaq Prifti, *Gjenocidi dhe komplotet antishqiptare të serbomëdhenjve*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2017, fq. 114.

edhe Kryesia e Bashkësisë së Universiteteve të Jugosllavisë, e cila e vlerësonte si: *“të papranueshëm bashkëpunimin e gjerë midis UP-së dhe UT-së, kinse shteti shqiptar ka keqpërdor këtë bashkëpunim. Po ashtu kritikuan edhe vlerësimet e Pleqësisë së UP-së mbi bashkëpunimin me UT-në”*.⁴⁰⁶

Gjithë profesorët, ekspertët e fushave nga Shqipëria që gjendeshin në Kosovë, u depërtuan për në shtetin e tyre. Me akuzën se kishin mbjellë dhe përhapur nacionalizmin shqiptar tek rinia shqiptare në Kosovë. Për këtë kishte reaguar edhe Enver Hoxha, i cili kishte kërkuar nga mediet e shtetit shqiptar që t’u kundërvihen këtyre akuzave jugosllave.⁴⁰⁷

Marrëdhëniet miqësore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë gjatë periudhës 1970-1981 u shfrytëzuan jashtëzakonisht mirë nga shteti shqiptar duke ngritur nivelin arsimor, kulturor e shkencor, e në veçanti për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare tek shqiptarët në Kosovë.

Bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe kulturës u reflektua në ndërtimin dhe formimin e kuadrit mësimor e shkencor në Kosovë, ngritjen dhe forcimin e institucioneve të larta arsimore e shkencore, e mbi të gjitha në formimin e një elite intelektuale që do të kontribuonin në të gjitha sferat e jetës në Kosovë si dhe në përpjekjet për avancimin e çështjes kombëtare.

Pra, me një emërues të përbashkët mund të thuhet lirisht se këto këmbime ishin një bazament për të gjitha proceset e mëvonshme arsimore, shkencore, kulturore dhe politike në Kosovë.

⁴⁰⁶ Po aty, fq. 115.

⁴⁰⁷ Enver Hoxha, DITAR, PËR ÇËSHTJE NURKOMBËTARE (1980 - 1981) 13, Tiranë, 1985, fq. 464.
Marrë në : http://ciml.250x.com/archive/hoxha/albanian/ditar/enver_hoxha_1980-1981_ditar_13.pdf.

KREU I TRETË

DEMONSTRATAT E VITIT 1981 DHE NDIKIMI I TYRE NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO JUGOSLLAVE

3.1 Ndikimi i vdekjes së Titos në politikën e brendshme të Jugosllavisë.

Shumë analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe gjeostrategjike, po ashtu edhe shumë shërbime të inteligjencës si ato perëndimore dhe lindore kishin paraparë se pas vdekjes së Titos, Jugosllavia ka shumë gjasa të shkojë drejt shkatërrimit.⁴⁰⁸ Një gjë të tillë është shkruar edhe në shumë artikuj të botuar në shtypin perëndimor ku parashihnin fundin e shpejtë të Jugosllavisë, madje parashikimi i shtypit perëndimor shkon aq larg sa që parashiheshin edhe luftë civile ndërmjet kombeve që përbënin Jugosllavinë.⁴⁰⁹ Këtë për një numër të madhe arsyesh. Edhe për kundër të gjithë këtyre paralajmërimeve, demonstratat e vitit 1981 ishin një “befasi” si për udhëheqjen politike, ashtu edhe për opinionin e gjerë brenda Jugosllavisë.⁴¹⁰

⁴⁰⁸ Uolltër Lakër, Evropa në kohën tonë histori e viteve 1945-1992, përkthyer nga Gëzim Arapi, Shtëpia Botues Dituria, Tiranë, 1996, fq. 436.

⁴⁰⁹ Misha Glenny, Historia e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmi, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha, fq. 623.

⁴¹⁰ Momčilo Pavlović, vep. e cit., fq. 22-23.

Dihej mirëfilli se Tito pas 1945-ës e pati ndaluar që të flitet për rrymat nacionaliste në radhët e veta në një formë ose tjetër ishte duke e mbajtur të karantinuar nacionalizmin serb, herë me politikë të butë, e herë duke treguar muskujt. Qysh herët, Titoja kishte menduar se si të eliminonte problemet etnike në brendi të Jugosllavisë. Por këtë me ose pa dashje nuk e arriti përfundimisht. Mos eliminimin e nacioanalizmave në ish-Jugosllavi edhe Tito vet e pranon.

Një profesor amerikan, i cili e kishte njohur Titon që nga koha e Luftës së Dytë Botërore, pati rastin të pyeste presidentin jugosllav, gjatë udhëtimit të tij të fundit në Amerikë (në vitin 1978), se çka konsiderohej të ishte dështimi i tij më i madh politik. Titoja u përgjigj se: “dështimi i tij më i madh ishte, se kishte dështuar për të bashkuar popujt e Jugosllavisë në një komunitet të vërtetë”.⁴¹¹ Titoja në këtë rast binte në kundërshtim më atë që kishte thënë disa vite më herët. Në vitin 1967 Titoja u intervistua nga "Der Spiegel" dhe ndër të tjera u pyet se, cila ishte arritja e tij më e madhe, Titoja u përgjigj: “zgjdhja e çështjes kombëtare në Jugosllavi”.⁴¹² Por Titoja tani ishte në fund të jetës së tij dhe nuk brengosej aq për jetëgjatësinë e Jugosllavisë.

Një përpjekje e tillë, për të unifikuar kombet brenda ish-Jugosllavisë, ishte edhe para ardhjes së Titos në pushtet. Në kohën kur mbreti Aleksandër kishte deklaruar: “*Ne nuk jemi më as serbë, as kroat e kështu më radhë, po vetëm jugosllavë.*” Pikërisht në këtë kohë iu ndryshua emri shtetit, i cili nuk quhej më Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, po Jugosllavi. Por, pavarësisht nga kjo shteti vazhdoi të ishte në duart e serbëve.⁴¹³

Lindja e Jugosllavisë nuk është e vitit 1919 në Versajë. Ideja për Jugosllavinë është shumë më e hershme. Për herë të parë kjo ide u hodh në vitin 1830 çuditërisht nga një studiues kroat i quajtur Ljudevit Gaj.⁴¹⁴

Duke qenë i vetëdijshëm për këto gjëra, Titoja iu shmang përpjekjes për të krijuar një super etni jugosllave dhe doli në krah të kombësive ekzistuese duke i premtuar çdonjëres prej tyre krijimin e republikave etnike (brenda sistemi federal) dhe bëri të vetin atë sloganin e famshëm “*Vëllazërim e Bashkim*” për të gjithë popujt e Jugosllavisë.⁴¹⁵ Pra Titoja kishte punuar shumë herët për një qetësi brenda Jugosllavisë, qysh nga viti 1945. Por sipas mendimit tim, nëse

⁴¹¹ Viktor, Meier, Yugoslavia A History of its Demise, London and New York , First published in English 1999. fq. 20. Marrë në:

https://athens.indymedia.org/media/old/yugoslavia_a_history_of_its_demise.pdf. Qasur me 10.02.2019

⁴¹² Howard Clark, vep. e cit., fq. 336.

⁴¹³ Bernd J. Fischer, Diktatorët e Ballkanit, Tiranë, 2008, fq. 301.

⁴¹⁴ Gjon Boriçi, Lufta për Paqen në ish-Jugosllavi 1987-1999, Tiranë, 2008, fq. 16.

⁴¹⁵ Po aty, fq. 3002. Krejt kjo është bërë të ruajtur balancën në mes të kombësive në Jugosllavi.

shikohet me vëmendje politikëbërja e Titos vërehet qartë se ai ishte i interesuar më shumë për qetësi vetëm sa të qeverisë ai me Jugosllavinë. Për këtë tregojnë disa elemente që në shikim të parë mund të duken jorelevante. Asnjëherë nuk iu ka shkuar deri në fund luftës për eliminimin e nacionalizmave, sidomos atij serb.⁴¹⁶ Ndoshta edhe ka të drejtë Tom Gallagher, kur thotë : “Tito mund të ketë qenë më shumë i frikësuar nga reforma liberale sesa nga nacionalizmi”.⁴¹⁷

Por mosimplementimin e reformave liberale nga ana e Titos, një bashkëpunëtor i ngushtë i Titos, slloveni Mitja Ribičič, konstaton në retrospektivë: “ Sa herë ndodhte një afrim i Titos me BRSS-në, procesit të reformës dhe demokratizimit në Jugosllavi i merreshin këmbët. Sipas tij kjo kishte ndodhur në vitin 1955, ishte përsëritur 1965, madje në mënyrë më pak dramatike edhe pas vitit 1971”.⁴¹⁸ Kjo dëshmon për balancat edhe në politikën ndërkombëtare që ka ndjekur Titoja.

Më pastaj moskrijim të një pasardhësi që mund të qeverisë pas vdekjes së tij dhe të vazhdojë politikën e tij. Më gjasë ai druhej se mos ndonjë pasardhës dinamik mund ta rrezikonte presidencën e tij. Përveç kësaj ai frikësohej edhe se mos ndonjë personalitet i fuqishëm (duhej të vihej nga një kombësi e caktuar) në mënyrë të pashmangshme do të kundërshtohet nga përfaqësuesit e kombësive tjera.⁴¹⁹ Për këtë arsye kishte zgjedhur një formë kolektive, një presidencë të shtetit më përbërjen e tetë anëtarëve, ku të gjithë zyrtarët zgjidheshin mbi bazën e përfaqësimit të barabartë nga gjashtë republikat dhe dy krahinat autonome.⁴²⁰

Pas vdekjes së Titos, presidenca u bë qarkulluese, secilit anëtar i vinte radha të bëhej president, për një vit.⁴²¹ Por edhe ky rrotacion nuk solli sukses, kjo më shumë ishte një fazë kalimtare drejt shpërbërjes së Jugosllavisë.

Për më tepër, Titoja vdiq duke lënë një ekonomi të dështuar dhe me serbët duke e trajtuar “Vëllazërim-Bashkimin” si një mashtrim. Për ta, viti 1974, Kushtetuta - në dhënien e dy

⁴¹⁶ Kjo ndoshta edhe nga frika se mos revoltoheshin serbët dhe ka ndjekur atë politikën “ngreh e mos k'put”. Ka nga ata historianë që rënie e Aleksandër Rankoviçit e shohin si luftim ndaj nacionalizmit serb. Kjo nuk qëndron, e kam cekur dhe argumentuar në kapitullin e parë. Sepse Tito nuk e “eliminon” Rankoviçin për nacionalizëm, por nga frika se ai mund të rrezikoj pozitën e tij.

⁴¹⁷ Tom Gallagher, *Outcast Europe THE BALKANS, 1789–1989 FROM THE OTTOMANS TO MILOSEVIC, LONDON AND NEW YORK*, first, 2001, fq. 232. Marrë në: https://www.academia.edu/33863786/Outcast_Europe_THE_BALKANS_1789_1989_FROM_THE_OTTOMANS_TO_MILOSEVIC_By_Tom_Gallagher; Qasur më 10.03.2019.

⁴¹⁸ Viktor Meier, *Fundi i Jugosllavisë Goditja në Kosovë, Shtëpia botuese "Liria" Lubjanë*, 2006, fq. 14.

⁴¹⁹ Bernd J. Fischer, vep. e cit., fq. 338

⁴²⁰ Miranda Vickers, vep. e cituar, fq. 238.

⁴²¹ Pierre Cabanes (ky libër ishte nën drejtimin e tij), Oliver Chaline, Berndard Doumerc, Alain Duceller, Michell Sivignon, *Historia e Adriatikut, Tiranë*, 2005, fq. 505.

provincave (Kosovës dhe Vojvodinës) përfaqësim të barabartë në presidencën federale në vetë republikën- përktheu qëndrimin e Titos: *“Serbia e dobët, Jugosllavia e fortë”*.

Nacionalizmin serb në vitet menjëherë pas vdekjes së Titos ishte një lëvizje opozitare, madje disidente. Reagimi serb u mobilizua rreth dy objektivave kryesore: kushtetuta 1974 si “anti-serbe” dhe mungesa e mbrojtjes për minoritetet serbe në fushatë e dominuar nga grupe të tjera etnike, veçanërisht në Kosovë.⁴²²

Edhe pse Titoja dy vite para vdekjes kishte deklaruar për mediet e huaja ishte shprehur i sigurt, se edhe pas vdekjes së tij, shteti të cilin e kishte udhëhequr ai, do të vazhdonte të ekzistonte pa pasur frikën se do të mund të pushtohej nga jashtë. Mirëpo Titoja e kishte huqur armikun e brendshëm, që mezi po priste vdekjen e tij. *“Ne të gjithë jemi duke punuar që të ndalim ndonjë presion mbi Jugosllavinë, pas vdekjes sime. Secili që mendon se Jugosllavia do të kollopsojë pas vdekjes sime dhe që është në rrezik nga invazioni i Bashkimit Sovjetik, unë ketë nuk e besoj”*.⁴²³ Titoja kishte arritur që me diplomaci mjeshtërore të mbante të bashkuar vendin kundër kërcënimit sovjetik, dhe duke mos lejuar shpërthimin e trazirave nacionaliste me krijimin e autonomive krahinore.⁴²⁴ Edhe pse Titoja në publik shfaqte një siguri që Jugosllavia do të mbijetojë edhe pas vdekjes së tij, ai në rrethe të ngushta kishte shfaqur dyshime për një gjë të tillë. Një natë vjeshte të vitit 1971, hipur në trenin e tij presidencial blu, në të cilën kthehej nga një vizitë në Rumani. Titoja filloi të diskutojë me delegacionin që e shoqëronte mbi trazirat në Universitetin e Zagrebit. Në mes të bisedës, Titoja iu kthye papritmas shokëve të tij dhe tha diçka profetike: *“Po të shihni edhe ju atë që shoh unë të e ardhmja e Jugosllavisë, do të tmerroheni për vdekje.”*⁴²⁵ Pra kjo është një dëshmi shumë e qartë se Tito kishte parandjeu një fund të Jugosllavisë.

Pra, Jugosllavia nga ana vizuale është dukur si një shtet mjaft i qetë deri me vdekjen e Titos por, realisht ka qenë një kazan që ka vluar vetëm është pritur heqja e kapakut. Elementi serb ishte fundamental, si për ekzistimin e Jugosllavisë, po ashtu edhe për rënien e saj.

Komunizmi në Jugosllavi pas LDB-së ishte shfaqur si mbrojtës i interesave kombëtare serbe. Edhe pse ka nga ata që e kundërshtojnë këtë fakt, sidomos historiografia serbe, e cila

⁴²² Howard Clark, vep. e cit., fq. 15.

⁴²³ Kjo deklaratë e Titos mund të merret si një deklaratë komplet politike, sepse gjitha dëshmitë tregojnë se ai ka pasur mjaft skepticizëm për qëndrueshmërinë e Jugosllavisë pas vdekjes së tij. Pra duke pasur parasysh përvojën e tij politike, kjo nuk mund të quhet naive por vetëm politike. Shih më gjerësisht Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve*.

⁴²⁴ M. Vickers, vep. e cit., fq. 238.

⁴²⁵ Jasminka Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi Etnik i Jugosllavisë*, Tiranë, 1998, fq. 67.

shkon edhe më larg duke konsideruar se gjatë komunizmit më shumë kishte ndodhur vazhdimësia e integritit kombëtar shqiptar se atij serb.⁴²⁶ Këtë ide nuk mund në asnjë formë të argumentohet, me fakte dhe argumente.

Sipas historiografisë serbe, viti 1918 ishte koha kur procesi i integritit dhe bashkimit kombëtar të popullit serb përfundoi me krijimin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene. Pra sipas tyre pikërisht atëherë serbët lëshuan ideologjinë e tyre kombëtare për hir të asaj me frymë jugosllave.⁴²⁷ Kjo dëshmon se pas vdekjes së Titos thajse e gjithë elita intelektuale serbe ishte duke bërë përpjekje për të sjellë “*argumente*”, kinse më së shumti në Jugosllavi kishin humbur serbët.

Pas vdekjes së Titos, në Serbi u vlerësua se kishte ardhur koha për ta rikthyer në tavolinë “*Analizën për funksionimin e marrëdhënieve kushtetuese në Serbi*”, të cilën e kishte bërë grupi i formuar në krye me Drazho Markoviçin, i titulluar si “*Libri i Kaltër*” (“*Plava knjiga*”).⁴²⁸ Në nivelin federativ nuk iu dorëzua askujt zyrtarisht. Në kohën e Titos kjo ishte hedhur poshtë kategorikisht, dhe nuk kishte askush kurajo që të riaktualizonte, këtu kryekëput diskutohej për pozitën kushtetuese të krahinave.⁴²⁹ Kjo për të krijuar një “*Jugosllavi të tretë*”, gjë e cila nuk ishte gjë tjetër veçse krijim i Serbisë së Madhe, ashtu si ishte ëndërruar nga ideologët serbomëdhenj, në krye me Dorica Qosiç i cili programoi memorandumun e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve.⁴³⁰

Stipe Mesiq si një njohës dhe dëshmitar i shumë ngjarjeve në ish-Jugosllavi, sidomos pas vdekjes së Titos thotë: “*Të gjitha konfliktet dhe trazirat kanë iniciuar qarqet serbomëdha, në mënyrë që Serbia të zgjerohet*”.⁴³¹

Pas vdekjes së Titos, më 4 maj 1980, pasardhësit e tij fillimisht ruajtën imazhin pozitiv, ndoshta edhe se besonin, por edhe shumica e shoqërisë jugosllave besonte tek ai njeri. Për më tepër postet dhe gjithçka të trashëguar e kishin prej tij. Por pa kaluar shumë kohë duke pasur parasysh se ekonomia ishte në një pikë kritike. Ekonomia jugosllave shënoi një rritje të lartë vetëm gjatë viteve 1960-1970. Përqindja e rritjes ekonomike qe mjaft e lartë gjatë viteve 70-ta 5,6% në vit. Por, në të njëjtën kohë edhe borxhi i jashtëm u rrit në mënyrë të konsiderueshme, duke kaluar nga 2.3 miliardë dollarë më 1970, në 11.8 më 1978, pastaj në 21.7

⁴²⁶ M. Vickers, vep. e cit., fq. 262.

⁴²⁷ Po aty.

⁴²⁸ A. Vllasi, vep. e cit., fq. 217.

⁴²⁹ Po aty.

⁴³⁰ Stipe Mesiq, *Si është shkatërruar Jugosllavia*, Zagreb, 1994?, fq. 24.

⁴³¹ Po aty.

më 1989.⁴³² Pra saktësisht vetëm në vitin 1980 borxhi i jashtëm i Jugosllavisë arriti shifrën 15 miliardë dollarë, kurse papunësia kalonte shifrën e 800 000 vetave.⁴³³ Prandaj për shembjen e përgjithshme të shtetit jugosllav, një rol vendimtar ka luajtur rrënimi i ekonomisë, rënia e vazhdueshme e nivelit të jetesës, e cila ndikoi edhe në strukturat sociale.⁴³⁴ Për këtë ata filluan të fajësonin Titon për gjendjen e rëndë në vend.⁴³⁵

Pra, Titoja nuk la një Jugosllavi ashtu siç pretendonte ai pak para vdekjes, apo ata të cilët e admironin. Sepse ai i la Jugosllavisë më shumë probleme, probleme të cilat do të jenë faktorët kryesorë për shpërbërjen e vet Jugosllavisë.⁴³⁶

Me vdekjen e Titos u shfaqën sërish konfliktet e vjetra. Nacionalistët serbë kishte mjaft kohë që prisnin momentin për të treguar supermacinë ndaj kombeve tjera në Jugosllavi. Kjo për arsye se serbët ndiheshin jo të plotfuqishëm edhe pse ishin kombi më i madh në Jugosllavi.

Ajo parulla e ngritur nga udhëheqja serbe e Beogradit, pas vdekjes së Titos “*Pas Titos, Tito*”, në varrimin e Titos, pasardhësit e tij mbajtën fjalime, u betuan se do ta ruajnë trashëgiminë e tij politike dhe do të udhëheqin vendin në rrugën, të cilën ai e traso. Bënin gara kush do të thurte slogane më të mira, për të shprehur besnikërinë ndaj tij dhe politikës së tij.

Mjaft interesant dhe paradoksal (koincidon me atë që thamë më lart) është fjalimi i ministrit të Mbrojtjes, gjenerali Nikolla Lubiçiq: “*Edhe pas Titos, Tito*”!. Po ky Lubiçiq, në kohën kur nacionalizmi serb e filloi avazin për shkatërrimin e përgjakshëm të Jugosllavisë, do t’i jepte mbështetjen vendimtare Slobodan Millosheviçit, për t’u forcuar në pushtet, ndërsa APJ-ja do të shndërrohej në instrumentin e nacionalizmit serbomad, për atë punë të përgjakshme.⁴³⁷

⁴³² Pierre Cabanes , vep. e cit., fq. 508.

⁴³³ Stefan Karastojanov, Kosova (një analizë gjeopolitike), Shkup, 2007, fq. 180.

⁴³⁴ Po aty, fq. 181.

⁴³⁵ B.Fischer, vep. e cit., fq. 346.

⁴³⁶ Për të qenë sa më realist, duke pasur parasysh se ishte Tito ai i cili ngriti me sukses një shtet shumëtnik për disa dekada, kjo mjafton si dëshmi si ai megjithatë ka qenë një burrështetas.

⁴³⁷ Azem Vllasi, vepër e cituar, fq. 211.

Pra slogane të tilla nuk ishte tjetër gjë, vetëm sa një paralajmërim cinik i qërimit të hesapeve më Titon dhe rrugën e tij, në mënyrë që ajo të zëvendësohet më të shpejtë me unitarizmin serb.⁴³⁸

Ky qërim hesapesh, tashmë i paralajmëruar, duhej të fillonte në Kosovë dhe me Kosovën. Sepse raporti i marrëdhënieve serbo-shqiptare ishte pika më neuralgjike dhe të një rëndësie të veçantë në të gjithë vazhden e krizave politike në ish-Jugosllavi.⁴³⁹ Prandaj sipas unitaristëve dhe nacionalistëve serbë të fshehur prapa kësaj dogme (nga Qosiçi e deri të hartuesit e “librit të kaltër”, aty gjendej formula e kthimit të Serbisë “*gjendje normale*”, një si parakusht edhe për “*shpëtimin*” e Jugosllavisë nga shpërbërja por edhe për “forcimin” e saj në përputhje me interesat e formuesve të saj, serbëve.⁴⁴⁰

Mendësia serbo-nacionaliste e cila ishte artikuluar në “*Memorandum*”, ishte krijuar gjatë një periudhë të gjatë kohore. Rrënjët e kësaj mendësie gjenden në lëvizjen nacionaliste të shekullit XIX.⁴⁴¹

Ishte zgjedhur pikërisht Kosova ku duhej të fillonte ndryshimi, sepse aty tash ishte çelësi i fatit të Jugosllavisë, për të cilën ishte folur edhe jashtë, duke e parashikuar edhe dimensionin e një krize të ardhshme ndërkombëtare.⁴⁴²

Pa dyshim se shpërbërja e Jugosllavisë është ngjarja më e rëndësishme pas rënies së Murit të Berlinit në fund të shek. XX, në Evropë. Gjendja politike në Jugosllavi pas vdekjes së Titos, e sidomos pas demonstratave të vitit 1981, ishte mjaft e brishtë dhe e paqëndrueshme. Çdo vëzhgues i vëmendshëm pas këtyre dy ngjarjeve, pra vdekjes së Titos dhe demonstratave të vitit 1981, e kishte të qartë se fundi i Jugosllavisë nuk ishte i largët. Dhe krejt kjo nga shfaqja në mënyrë më të vrazhdë të nacionalizmit serb, më në krye Slllobodan Millosheviçit. Gjendja e rëndë ekonomike, nuk duhet përjashtuar edhe një fakt që lidhet me politiken ndërkombëtare siç ishte rënia e Perdës së Hekurt.

Sa i përket gjendjes së Kosovës në aspektin kulturor dhe arsimor në prag të shpërthimit të demonstratave të vitit 1981, Branko Horvat e ka konsideruar Kosovën si një geto kulturore në

⁴³⁸ Jusuf Buxhovi, vep. e cit., fq. 385.

⁴³⁹ Dushan Janjiq, Identiteti kombëtar, lëvizja dhe nacionalizmi i serbëve dhe shqiptarëve, Konflikt apo dialog, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe dhe integrimi i Ballkanit, Pejë, 1995, fq. 113.

⁴⁴⁰ Jusuf Buxhovi, vep. e cit. fq. 385-386.

⁴⁴¹ Oliver Jens Schmitt, vep. e cit. fq. 238.

⁴⁴² Po aty, fq. 386.

ish-Jugosllavi.⁴⁴³ Pra ishte krijuar një klimë tjetër në arenën ndërkombëtare pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Ka edhe nga ata që si faktor relevant konsiderojnë shqiptarët e Kosovës por, një gjë e tillë nuk qëndron sepse nacionalizmit serb u vërsul më të njëjtën mënyrë edhe kundër sllovenëve, kroatëve, boshnjakëve etj..

3.2 Demonstratat e vitit 1981 dhe qëndrimi i shtetit shqiptar

Ajo që dihet botërisht, më 11 mars të vitit 1981, në mensën e Universitetit të Prishtinës, një student gjeti një papastërti në supën e tij. I nevrikosur deri në ekstrem, ai e hodhi në dysheme tabakun e tij të ushqimit. Edhe shokët dhe shoqet e tij aty përreth ndjenë të njëjtën neveri. Për disa orë në qendrën studentore u mbledhën 500-600 studentë dhe filluan të protestojnë më kërkesat e tyre fillestare “*Ushqim!*” “*Kushte!*” etj.. Ndonëse protesta e 11 marsit kishte qenë e veshur kryesisht me kërkesa sociale, dhe asaj nuk i ishte dhënë ndonjë publicitet i madh, megjithatë, jehona e saj ishte përhapur me të madhe. Protesta e 11 marsit ishte “*lexuar*” nga masat popullore e studentore si një “*protestë provë*” me “*karakter social*”, pas të cilës do të pasonin demonstrata të tjera me karakter politik.⁴⁴⁴

Policia filloi të merrej me ta, por kjo nuk e lokalizoi këtë gjendje, por acaroi shumë më shumë dhe ndikoi drejtpërdrejtë në masivizimin e këtyre demonstratave, e që ishin jashtëzakonisht të fuqishme.

⁴⁴³ Branko Horvat, Kosovsko Pitanje, GLOBUS / ZAGREB, 1989, fq. 17. Marr në: http://novi.uciteljneznalica.org/PDF/arhiva%20autora/475_Horvat%20Branko%20Kosovsko%20pitanje%202%20Globus%201989.pdf, më 13.05.2018.

⁴⁴⁴ Xhevat Hasani, Një jetë në shërbim të lirisë kushtuar Naser Hanit, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 77.

Pra, kështu realisht e paraqesin të gjithë fillimin i shpërthimit të demonstratave të pranverës së 1981. Demonstratat e 11 marsit, të vitit 1981, janë ngjarja më e rëndësishme pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878, për shqiptarët e Kosovës, apo është prej ngjarjeve më të rëndësishme të popullit shqiptar. Këtë duke u bazuar në shumë arsye.

Për shkak të ndikimit që kishin këto demonstrata, si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në arenën ndërkombëtare; për arsye të organizimit dhe masivizimit të tyre; për ndikimin e ngritjes së vetëdijes kombëtare thuajse të gjitha shtresat e popullatës shqiptare; demonstratat e vitit 1981 nuk ishin një rastësi por ato ishin një vazhdimësi e lëvizjes kombëtare që nga pas Lufta e Dytë Botërore. Lëvizja studentore e vitit 1981 është rezultat i gjithë luftës ilegale (klandestine) çlirimtare që nga mbas Lufta e Dytë Botërore, që në forma të ndryshme zhvilluan shqiptarët e Kosovës.⁴⁴⁵

Pikërisht ishin këto demonstrata që ndikuan dhe fuqizuan jashtëzakonisht shumë lëvizjen për çlirim të popullit shqiptar në Kosovë dhe viseve tjera shqiptare në ish Jugosllavi.

Këto demonstrata nuk ishin të rëndësishme vetëm për shqiptarët e Kosovës, por një rëndësi mjaft të madhe patën edhe për ish-Jugosllavinë. Sepse këto dëshmuar se Jugosllavia nuk ishte ashtu si proklamohej, por në të njëjtën kohë u dëshmuar se edhe shqiptarët e Kosovës kishin evoluar në shumë aspekte, sidomos në atë kombëtar. Përmasat e trazirave tejkaluan të gjitha trazirat e shfaqura deri atëherë në Jugosllavi, pas Luftës së Dytë Botërore, gjë që e qartëson edhe gjendja e jashtëzakonshme në Kosovë, e shpallur për më se gjashtë muaj.⁴⁴⁶

Demonstratat e vitit 1981 ishin një sinjal, jo vetëm për ish-Jugosllavinë, por për të gjithë arenën ndërkombëtare, e sidomos për Bllokun Lindor, se një frymë e re po fillonte, dhe fundi i Luftës së Ftohtë nuk ishte larg. Për demonstratat studentore e vitit 1981, nuk ka dilemë që shënonin fillimin e rënies së ish-Jugosllavisë, por edhe ringjalljen nacionalizmit serb.⁴⁴⁷

Për këtë dëshmon edhe rëndësia që i kanë dhënë mediet botërore, si ato të shkruara dhe ato vizuale, nga të gjitha kontinentet.⁴⁴⁸ Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre demonstratave jo vetëm për shqiptarët, prandaj edhe kanë zgjuar kureshtjen për shumë studiues të fushave të ndryshme nga shumë vende të botës. S'ka dyshim se për ngjarjet e vitit '81 kanë shkruar shumë studiues dhe shumica e atyre shkrimeve kanë qenë studime mjaft serioze, duke u bazuar në fakte

⁴⁴⁵ Jakup Krasniqi, Pranvera e Lirisë '81, Prishtinë, 2011, fq. 21.

⁴⁴⁶ Arben Hajrullahu, vep. e cit. fq. 64-65.

⁴⁴⁷ Sylë Ukshini, Kosova në Politikën... vep. e cit. fq. 67.

⁴⁴⁸ Më gjerësisht shih, Sabit Sylja, Dokumente diplomatike të qeverisë shqiptare për demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, Prishtinë, 2012.

dhe argumente, kanë sjellë ndriçimin e shumë segmenteve të këtyre ngjarjeve me rëndësi. Por, ka edhe nga ata që nuk kanë arritur objektivat shkencore dhe në disa raste janë tendencioze.

Pra, si nga historiografia shqiptare si edhe nga ajo e huaj janë arritur suksese në shumë segmente për këtë ngjarje. Por, edhe pas këtyre arritjeve akoma nuk është arritur që të ndriçohen mjaftueshëm disa segmente të kësaj ngjarje me rëndësi shumë të madhe. Kjo do të arrihet vetëm atëherë kur të shfrytëzohen burimet autentike arkivore të papublikuara si të arkivave vendore por edhe atyre të huaja, sidomos atyre serbe.

Çdo fenomen shoqëror që ka ndodhur gjatë historisë ka pasur faktorët që kanë quar në shpërthim të fenomeneve të ndryshme. Sepse asnjë ngjarje shoqërore e nivelit të tillë nuk ndodh "ad'hoc" por është e ndikuar nga shumë faktorë. Po ashtu edhe demonstratat e vitit 1981 nuk kanë ndodhur rastësisht por ka shumë faktorë si të brendshëm edhe të jashtëm që kanë ndikuar në shpërthimin e tyre.⁴⁴⁹

Një lëvizje aq popullore me kërkesa shumë të qarta politike nuk mund të bëhet spontanisht, e as në mënyrë instiktive. Këto demonstrata kanë dy rrënjë kryesore, një rrënjë të gjatë dhe të thellë që vazhdon prej shekujsh në rivalitetin dhe armiqësinë serbo-shqiptare, dhe një rrënjë relativisht më të re, të zhvillimit, gjendja ekonomike dhe sociale në Kosovën e Jugosllavisë së pas Luftës së Dytë Botërore.⁴⁵⁰

Siç dihet, udhëheqja politike jugosllave dhe ajo e shqiptarëve në Kosovë, vlerësuan ngjarjet zhvilluara në Kosovë më 1981 si kundërrevolucionare, nacionaliste, irredentiste etj.⁴⁵¹ Kuptohet në fillim janë bërë përpjekje nga mediumet serbe për minimizim të këtyre demonstratave, por pa sukses.

Shërbimi telegrafik i Jugosllavisë, Tanjug, raportoi më 12 mars 1981, se një demonstrim i vogël kishte ndodhur një natë më parë në universitet në Krahinën Autonominë Socialiste të Kosovës. Raporti deklaroi se kjo "*shkelje e rendit publik dhe pages*" kishte ndodhur pasi "*elementët e armikut individual u përpoqën të tërheqin pakënaqësinë e studentëve me ushqim në mensën e studenteve.*" Mediumi në fjalë vazhdoi të pohonte që pas ndërhyrjes së personelit mësimor të universitetit, "*aktivistët e mbetur*" u shpërndanë dhe u nisën në shtëpitë e

⁴⁴⁹ Një ndër objektivat e kësaj teme është studimi i faktorëve që kanë ndikuar në shpërthimin demonstratave të vitit 1981. Sepse pikërisht kjo ka qenë dhe është akoma se cilët ishin faktorët dhe a ishin të jashtëm apo të brendshëm, e ajo që ka zgjuar shumë kureshtje të studiues sidomos të huaj është se sa a ka pasur ndikim drejtpërdrejt Shteti Shqiptar në këto demonstrata.

⁴⁵⁰ Sabit Sylva, Hamit Kaba, Demonstratat e Kosovës në Arkivin Kombëtar të Londrës, Prishtinë, 2017, fq. 106.

⁴⁵¹ Sabit Sylva, Dokumentet diplomatike të qeverisë shqiptare... vep e cit. fq. 5.

tyre . U pretendua se studentët, punëtorët, universiteti dhe popullsia lokale "e dënuan" incidentin, dhe se puna në universitet ishte kthyer në një gjendje normaliteti.⁴⁵²

Për ngjarjet të tilla siç ishin demonstratat e vitit 1981 të gjitha shtetet pa përjashtim janë të prira që të akuzojnë faktorët e jashtëm (shtete të caktuara), sepse nuk donin të praninin si fakt se faktorët e brendshëm janë ata që kanë çuar në shpërthimin e ngjarjeve të tilla. Sepse një pranim i tillë, pra të faktorëve të brendshëm, si ndikuesit kryesorë në këto demonstrata dëshmonte brishtësinë e shtetit jugosllav. Edhe shteti jugosllav filloi të atribuojë faktorit të jashtëm shpërthimin e demonstratave, konkretisht akuzoi shtetin shqiptar se kishte dorë në organizimin e tyre. Duke hedhur një sërë akuzash ndaj Tiranës si influencuese e ngjarjeve të zhvilluara në Kosovë. Duke i quajtur demonstratat e vitit 1981 si vazhdimësi e "*kundërrevolucionit shqiptar*", udhëheqja jugosllave ishte duke mohuar problemet reale me të cilat ballafaqohet Kosova: gjendja e saj e pabarabartë politike, krizat socio-ekonomike që ndikuan në komunitete kombëtare dhe ndjenjat nacionaliste që u rritën dhe që quan në ngjarje të vitit 1981.⁴⁵³

Shteti shqiptar kishte kontakte edhe me grupe ilegale të Kosovës, për këtë na dëshmon edhe njëri ndër protagonistët e demonstratave të vitit 1981, Mehmet Hjarizi.

Një kontakt me autoritetet e shtetit shqiptar në emër të grupit realizohet vetëm diku në vitin 1976, kur kishte shkuar në Ambasadën e Shqipërisë në Paris Mehmet Hajrizi, duke i njoftuar diplomatët e saj për ekzistencën e organizatës.

Një takim tjetër ai kishte pasur më 1978 me Sadik Ibron, të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Shqipërisë, në Sofje të Bullgarisë, me ç'rast i kishte shkruar edhe një letër udhëheqjes së lartë të Shqipërisë.⁴⁵⁴ Ku në të mes tjerash thuhej: "*Populli ynë në Kosovë, i robëruar, i shtypur e i shfrytëzuar egërsisht nga revizionistët jugosllavë dhe nga një grusht tradhtarësh të vendit, kurrë nuk është pajtuar me sunduesit e tij... Luftën nuk e kemi pushuar*

⁴⁵² Adviser: Professor Maria Todorova, THE 1981 KOSOVAR UPRISING: NATION AND FACEWORK, Urbana, Illinois, fq. 25. Marr në https://www.ideals.illinois.edu/bitstream/handle/2142/44144/Zachariah_Claybaugh.pdf?sequence=1; Qasur më 07.07.2018.

⁴⁵³ Momčilo Pavlović, marrë në: <http://www.transconflict.com/2013/04/1981-demonstrations-in-kosovo-264/> me 09.05.2018.

⁴⁵⁴ Mehmet Hjarizi, vep. e cit. fq. 182.

*dhe nuk do ta pushojmë gjer në fitoren e plotë... Organizata jonë i mbledh bijtë dhe bijat më të mira të Kosovës, të cilët nuk kursejnë asgjë për lirinë e popullit tonë...*⁴⁵⁵

Ka pasur edhe takime të natyrës së tillë nga përfaqësuesit e organizatave ilegale të Kosovës edhe në ambasada tjera të Shqipërisë, si në Vjenë, Beograd etj., ku informoj shteti shqiptar për të gjitha format e organizimit që ishin duke ndodhur në Kosovë.

Në bazë të dokumenteve të shfrytëzuara, shteti shqiptar gjatë gjithë kohës që nga pas Lufta e Dytë Botërore, jo vetëm gjatë viteve të 70-ta ka përcjellë me vëmendje gjendjen në ish-Jugosllavi. Edhe atëherë kur kanë pasur marrëdhëniet e ngrira me shtetin jugosllav. Për këtë dëshmon edhe një raport i Komitetit të Partisë së Punës të Shqipërisë, më 20 mars 1981, ku vërehen njohuritë e thella rreth gjendjes në Kosovë, në të gjitha aspektet si ekonomike, politike, socio-kulturore dhe arsimore.⁴⁵⁶

Prandaj njohuri aq të thella nuk mund të kishte nëse nuk do ishte përcjellë me vëmendje gjendja që nga pas LDB-së.

Por nëse mund të merren si të sakta kujtimet e bashkëshortes së Enver Hoxhës, si çdo kujtim që mund të përshtatet kohës së cilës jetojmë, shteti shqiptar është zënë në befasi me demonstratat e vitit 1981. Enveri ishte në pushime në Jug të Shqipërisë dhe sipas Nexhmije Hoxhës, atje iu kumtua lajmi se kishin shpërthyer trazira të fuqishme.⁴⁵⁷ Sipas Nexhmije Hoxhës: *“Mund të duket e çuditshme, por të paktën Enveri nuk pati asnjë sinjalizim mbi çfarë po përgatitej në Kosovë. Të qenit kaq të shkëputura e të paafta disa nga organet tona të posaçme shtetërore, si ato të Ministrisë së Punëve të Brendshme e të Mbrojtjes, që duhet të dinë në çdo kohë se ç'bëhet rreth kufijve të vet, kur është fjala për shpërthime kaq masive, që nuk përgatiten brenda disa orëve?! Fakt është që Enveri nuk kishte asnjë të dhënë për gjendje të turbullt në Kosovë, sa që ai ishte me pushime”*.⁴⁵⁸ Kjo edhe mund të merret si e saktë, jo për faktin që thotë bashkëshortja e Hoxhës por, se më shumë do ta glorifikonte figurën e tij po të thoshte se ai kishte informacion, ose të thoshte se Enveri kishte ndikim në shpërthimin e këtyre demonstratave në Kosovë.

Një qëndrim të ngjashëm me Nexhmije Hoxhën ka edhe Ramiz Alia, njëra ndër figurat më të rëndësishme gjatë gjithë periudhës komuniste. Ramiz Alia në kujtimet e tija për

⁴⁵⁵ Po aty, fq. 182-183.

⁴⁵⁶ Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), Fondi:Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nr. 14 Vitit 20. mars 1981, lista nr. 37. dosja nr. 28. fq. 1-6.

⁴⁵⁷ Nexhmije Hoxha, vep. e cit. fq. 260.

⁴⁵⁸ Po aty.

shpërthimin e demonstratave në Kosovë në vitin 1981 thekson: “*Këto demonstrata, e zunë në befasi udhëheqjen shqiptare, e cila më parë nuk kishte asnjë të dhënë, as nga ana e organeve të Sigurimit të Shtetit, as nga vet Kosovarët*”.⁴⁵⁹ Këto të dhëna nga protagonistët e politikës shqiptare ngrehin shumë pikëpyetje, se a më të vërtetë nuk kishte asnjë informatë shteti shqiptar për demonstratat e vitit 1981. Logjikisht duket abstrakte se edhe mbas bashkëpunimeve të ngushta mes elitave nga Shqipëria dhe Kosova gjatë gjithë viteve të 70-ta, dhe të mos ketë asnjë informatë për përgatitjen e demonstratave të përmasave siç ishin demonstratat e vitit 1981.⁴⁶⁰

Një fakt tjetër që dëshmon se nuk ka pasur dorë shteti shqiptar direkt në organizimin e këtyre demonstratave është një raport dërguar Komitetit Qendror të PKSH-së nga ish-ambasadorit i Shqipërisë në Beograd Sokrat Plaka. Ambasadori Plaka raporti e titullon “... bisedë me një kosovar” është fjala për Xhavit Halitin, që në raport shkruhet Xhavit Halitaj. Në Bisedë me XH. Halitaj student i Fakultetit Filozofik, pretendon se ka qenë pjesëmarrës në demonstratat e studentëve më 11 e 26 marsi dhe 1 e 2 prilli 1981. Nga biseda dalin këto: “*Demonstratat e 11 marsit ishin spontane, nuk kishte parulla të shkruara, kërkesat ishin vetëm për kushtet e konviktëve të UP-së. Pas 11 marsit protestat filluan të organizohen nga një grup studentësh*”.⁴⁶¹ Nga ky raport mund të konstatohet lirisht, se shteti shqiptar nuk kishte dorë në shpërthimin e demonstratave.

Po të kishte dorë shteti shqiptar ambasadori nuk kishte pasur nevojë të raportonte për këtë bisedë me Xhavit Halitin, i cili ka qenë një ndër organizatorët, por që nuk ka pasur komunikim deri në këtë kohë me shtetin shqiptar. Për këtë është edhe një element tjetër i ambasadorit Plaka i cili thoshte se isha i rezervuar në bisedë me XH. Halitin, e si mund të interpretohet ndryshe kjo vetëm se organizatorët nuk kishin asnjë kontakt direkt me organet shtetërore shqiptare. Por nga një analizim i kujdesshëm i dokumenteve arkivore të arkivave shqiptare, mund të arrijmë lirisht në këtë konkludim, se shteti shqiptar kishte informata për një organizim të mundshëm të demonstratave në Kosovë, por shteti shqiptar nuk ishte i informuar për një shpërthim kaq shpejt dhe të përmasave të tilla.

Pra, sa i përket asaj se a ka qenë e involvuar drejtpërdrejtë Shqipëria zyrtare në demonstratat e vitit 1981 është mjaft interesant, se nuk mund të pohosh, por as të mohosh në

⁴⁵⁹ Ramiz Alia, Jeta Ime, Kujtime, Botimet Toena, Tiranë, 2010, fq. 288.

⁴⁶⁰ E kam theksuar edhe më lart se kujtimet e Nexhmije Hoxhës dhe Ramiz Alisë, duhet të merren si reale. Sepse po të deklaronin se për demonstratat kishte informata dhe kishte ndikim edhe shteti shqiptar, kjo do t'i jepte attribute nacionaliste Enver Hoxhës. Çka janë munduar dhe mundohen akoma shumë ithtarë të tij të paraqesin si një nacionalist të madh. Enver Hoxha në historiografinë më të re shqiptare nuk konsiderohet si një nacionalist.

⁴⁶¹ AQSH, Fondi: 14, dosja nr. 28, fq. 131.

mënyrë absolute një gjë të tillë. Për faktin se ka mjaft gjëra që të shtyn të beshosh se ka pasur, por ka edhe shumë rrethana tjera që na bëjnë të dyshojmë se nuk ka pasur. Se a kishte më të vërtetë ndikim Tirana zyrtare në demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, tash thuhet katër dekada ka qenë dhe vazhdon të jetë një gordiane për historiografinë më të re shqiptare dhe më gjerë.

Që nga ajo kohë e deri më tani është diskutuar në qarqe të ndryshme se a ka pasur shteti shqiptar një plan sekret se si t'i mbrojtë shqiptarët në ish-Jugosllavi, konkretisht Kosovën. Por edhe për kundër të gjitha dilemave, sipas Yll Mollës, po ka ekzistuar "*Plani sekret i shtetit shqiptar për Kosovën.*"⁴⁶²

Tani së fundi, Yll Molla ka sjellë një libër publicistik, "*Plani Sekret për Kosovën*", duke u bazuar në intervistat e personalitete kyçe që kanë qenë në hierarkinë ushtarake. Autori për një gjë të tillë mbështetet kryesisht në një intervistë që ka bërë me një ndër ushtarakët më të njohur të viteve 80-ta, Veli Llakaj, i cili e pranon që ka ekzistuar një plan i detajuar për mbrojtjen e Kosovës ose për ta mbështetur Kosovën.⁴⁶³

Ky plan mbeti vetëm në kuadrin e një tentative ushtarake strategjike që nuk u realizua dhe ky plan është zhdukur edhe fizikisht.⁴⁶⁴ Por duke pasur parasysh se autori është mbështetur vetëm në intervista të personaliteteve ushtarake të kohës dhe jo në dokumente autentike, përsëri mbesin dilema për këtë çështje. E themi këtë sepse është dëshmuar shumë herë se personalitetet kyçe në ngjarje me rëndësi shoqërore shpesh glorifikojnë gjëra që figura e tyre të ketë peshë historike.

Por, para se të elaborohet në detaje i gjithë ai material dhe faktet që janë për dhe kundër pasjes dorë të Shqipërisë në këto ngjarje shumë të rëndësishme për shqiptarët, duhet të sqarojmë një gjë në parim. A do të ishte paradoksale sikur shteti shqiptar të mos kishte shfaqur fare interesim për demonstratat e '81-shit, pa marrë parasysh akuzat që mund t'i bëheshin nga pala jugosllave, kur duke pasur parasysh faktin se gjysma e popullsisë shqiptare në Ballkan jetonin në shtetin jugosllav. Pra, bëhet fjalë për një popullsi afër tre milionë banorë. Pra, cili shtet nuk do të interesohej për minoritetin e vet në një shtet tjetër, e këtu nuk bëhet fjalë për një minoritet, por për një popull që ishte më i madh se shumë shtetet që përbënin Jugosllavinë. Prandaj nuk mundet në asnjë mënyrë që interesimin e Tiranës zyrtare për shqiptarët në ish-Jugosllavi të konsiderohet si implikim direkt në demonstrata. Ne do të mundohemi që të

⁴⁶² Yll Molla, *Plani Sekret për Kosovën dhe histori tjera*, Tiranë, 2006, fq. 61.

⁴⁶³ Po aty, fq. 62.

⁴⁶⁴ Po aty, fq. 64.

ballafaqojmë faktet dhe argumentet që posedojmë në mënyrë krahasimore për të ardhur në një përfundim sa më real dhe empirik.

Ajo që i ka bërë raportet politike mjaft të afërta në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, por edhe antagonizmat në mes tyre, që nga pas Lufta e Dytë Botërore, ka qenë çështja e shqiptarëve në të gjithë Jugosllavinë. Prandaj për të qenë sa më objektiv, në atë se a ka pasur ndikim Tirana zyrtare në demonstratat e '81-shes, duhet të nisemi nga deduktivja tek induktivja.

Shteti jugosllav edhe pse ishte në shumë aspekte më i zhvilluar se sa Shqipëria, ai vazhdimisht kishte frikë për atë se Shqipëria mund të kërkonte një bashkim me pjesë të saj të aneksuara nga Jugosllavia.

Politika e shteti shqiptar ndaj Kosovës dhe territoreve tjera shqiptare që ishin bërë padrejtësisht pjesë e Jugosllavisë, ka pasur si objektiv final bashkimin e tyre me shtetin shqiptar.⁴⁶⁵

Kërkesat politike të shtetit shqiptar kanë qenë të artikuluar në mënyra të ndryshme, në varësi të kushteve dhe rrethanave të kohës dhe gjendjes së vet shtetit shqiptar. Por pas LDB-së çështja e Kosovës është parë nga prizmi i zhvillimeve ideologjike në mes të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe Partisë Komuniste të Shqipërisë.⁴⁶⁶ Por kjo ka qenë deri në vitin 1948, kur ka ndodhur edhe prishja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave kur dihen arsyet e kësaj prishjeje. Pas prishjes së marrëdhënieve me jugosllavët, Enver Hoxha e ndryshoi kursin politik, sa i përket çështjes së Kosovës.

Enver Hoxha duke shfrytëzuar prishjen e marrëdhënieve të jugosllavëve me sovjetikët, apo më mirë të thuhet Stalinit dhe Titos, Hoxha u propozoi sovjetikëve që çështja e shqiptarëve në Jugosllavi të finalizohet me bashkimin e tyre me Shqipërinë.⁴⁶⁷ Kjo është shprehur në atë që kemi cekur edhe në kapitullin e parë, pra në letrën e dërguar KP-së të Partisë Komuniste Sovjetike Bolshevike në emër KQ-së të PKSH –së.

Kjo dëshmon se politika e shtetit shqiptar në raport me shqiptarët në ish- Jugosllavi ka qenë thujse çdo herë sipas rrethanave të politikës ndërkombëtare.

⁴⁶⁵ Ethem Çeku, Kosova në sfondin e Diplomacisë..., vep. e cit., fq. 271.

⁴⁶⁶ Po aty.

⁴⁶⁷ Po aty.

Një fakt interesant që tregon se Shqipëria nuk ishte e interesuar për trazira në Jugosllavi, në fillim të viteve 80-ta, është lidhja e disa marrëveshjeve madhore tregtare në mes të dy vendeve. Këto marrëveshje të një rëndësie të veçantë u nënshkruan në fillim të vitit 1980 në Beograd për pesëvjeçarin e ardhshëm, 1980-1985.⁴⁶⁸

Në prill të vitit 1980 në Prishtinë është nënshkruar një kontratë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës për të ndërtuar një linje tensioni, për distanca të gjata, për të bërë të mundur eksportimin më të madh të energjisë elektrike në Jugosllavi dhe më tej. ⁴⁶⁹ Më 27 janar, 2 shkurt 1981 shtetin shqiptar e viziton një delegacion ekonomik i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës. Kjo vizitë kishte për qëllim zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e tregtisë së mallrave. ⁴⁷⁰

Pastaj në janar të vitit 1981 Kosovën e viziton skulptori, artisti më i njohur shqiptar Odhise Paskali, për një ekspozitë të veprave të tij.⁴⁷¹

Po ashtu më 31.01.1981 nënshkruhet protokollin i bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës. Pas prishjes me Kinën, në vitin 1978, thuajse Jugosllavia ishte partneri më i madh tregtar i Shqipërisë. Kjo mund të quhet një alibi e shtetit shqiptar se nuk kishte ndonjë fokus të veçantë sa i përket asaj për të krijuar trazira në Jugosllavi, përmes Kosovës.

Nuk më duket bindëse ideja se pas vdekjes së Titos ka ndryshuar qëndrimi i politikës shqiptare në raport me Jugosllavinë. Kjo për faktin se nuk ndryshohet në mënyrë aq të shpejtë politika kaq sensitive brenda një kohe kaq të shkurtër. Së paku nuk kemi dokumente që vërtetojnë se shteti shqiptar ka pasur një strategji në sirtar, vetëm duke pritur vetëm vdekjen e Titos.

Për ndikimin e shtetit shqiptar në këto demonstrata ka të dhëna mjaft kontradiktore nga personat që kanë pasur pozita të larta shtetërore në Shqipëri. Kjo për faktin se është një fenomen që përcjell të gjithë njerëzit apo protagonistët kur rrëfohen për vendimet e marra në periudha të ndryshme të historisë. Rrëfime për vendimet e tyre i përshtatin me gjendjen e tanishme politike dhe historike. Prandaj rrëfimet e tilla duhet të merren me rezervë.

⁴⁶⁸ Miranda Vickers, vep. e cit., fq. 247.

⁴⁶⁹ Po aty.

⁴⁷⁰ ASHAK, Fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhëniet me Botën e Jashtëm, viti 1979-1988, Lënda:36, Kutia:3, fq. 5.

⁴⁷¹ AMPJ, viti 1981, dosja 1292, fq. 13.

Nexhmije Hoxha në një intervistë të vitit 2012, në të cilën mohoi se burri i saj ka luajtur ndonjë rol aktiv në nxitjen e trazirave në Kosovë.⁴⁷² Por kjo deklaratë e N. Hoxhës nuk është në përputhshmëri me deklaratën e ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, Veli Llakaj, i cili kishte deklaruar se në prill të vitit 1980 vetë Enver Hoxha e kishte ngarkuar të përgatiste një plan për të sulmuar Jugosllavinë (operacioni “ Shpërthimi”).⁴⁷³

Në një intervistë të dhënë në një të përditshme shqiptare, në janar të vitit 2006 Veli Llakaj, kur është pyetur për planin “Shpërthimi” ai ka deklaruar : “ *Po, ka ekzistuar një plan i tillë i hollësishëm dhe tepër sekret, i rëndësishëm së veçantë. Hartues jam unë me ish zëvendësministrin e Mbrojtjes, Maliq Sadushi, nën drejtimin e kryeministrit të vendit, Mehmet Shehu dhe me “OK”e porosinë e komandantit të përgjithshëm Enver Hoxha. Ky plan është hartuar në fund të vitit 1979*”.⁴⁷⁴

Në një intervistë të vitit 1992 Ramiz Alia, duke folur për demonstratat e vitit 1981 dhe rreth asaj se a ka pasur njohuri Shqipëria për to, Ramiz Alia deklaron: “ *Aspak! Bile mund të them që ngjarjet e vitit 1981 për neve kanë qenë krejtësisht të papritura, por shpesh herë edhe më pas, domëthënë në vitin 1982-'83, kur patëm hyrë në polemikë shumë të ashpër me jugosllavët, ne vrisnim mendjen se kujt i interesonin ngjarjet e vitit 1981. Sepse zhvillimet e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës ishin aq të favorshme për Shqiptarët, sa që këto ngjarje më tepër i shkuan përshtati dikujt tjetër, se sa vetë shqiptarëve. Unë vetë personalisht kam menduar disa herë se nga ato ngjarje nxorën përfitime më shumë serbët*”.⁴⁷⁵

Pra, kur këto figura, shumë të afërta me Enver Hoxhën, janë kaq kontradiktore, veç çka e komplikojnë misterin e asaj se më të vërtetë sa ka pasur ndikim shteti shqiptar në demonstratat e vitit 1981. Për deri sa nuk kemi dokumente autentike arkivore që dëshmojnë këtë që ka thënë Veli Llakaj, duhet të merret me rezervë, sepse për këtë mundet që Llakaj ka mundësi që një gjë kaq me rëndësi t'ia atribuojë vetes, pra si një hartues i një plani ushtarak, tanimë me kaq rëndësi historike (kuptohet nëse ka ekzistuar).

Të gjithë enveristët, si në Shqipëri por edhe në Kosovë, mbrojnë idenë se Enver Hoxha ka qenë i informuar dhe i përgatitur për demonstratat e vitit 1981. Krejt kjo për faktin që të paraqitet Enver Hoxha si një nationalist, sepse shumë herë është kontestuar ajo se Hoxha nuk

⁴⁷² Oliver Jens Schmitt, vep. e cit., fq. 232.

⁴⁷³ Po aty, fq. 233.

⁴⁷⁴ Agustin Gjinaj, Fejzli Lila, *Lidershipi I shqiptar përmes historiisë së ushtrisë*, vep. e cit. fq. 246.

⁴⁷⁵ Blerim Shala, Llukman Hallili, Hazir Reka, *Unë Ramiz Alia dëshmoj për historinë*, Prishtinë, 1992, Cituar sipas Jusuf Buxhovi, Kosova nga Konferenca Londrës deri në Proktektoratin nderkombëtar, Prishtinë, 2012, fq. 414 - 415.

ka shfaqur një interesim të veçantë për Kosovës. Por edhe nëse i referohemi ditarit politik të Enver Hoxhës, ai ka qenë mjaft i informuar kur më 15 tetor 1979, dy vite para shpërthimit të demonstratave në Kosovë, ai konstaton : *“Përse shkon Titoja në Kosovë? ... Pse Kosova përbën një shqetësim të vazhdueshëm për Jugosllavinë, aq më tepër tani që manifestimet atje kundër titistëve dhe pro nesh janë të shumta. Gjendja në Kosovë nuk është e qetë, e qëndrueshme, prandaj vetë Titoja atje, por këtë gjendje ai nuk do ta ndreqë dot me sorollatjet e tij poshtë e lart. Mundet që ta kenë ftuar edhe krerët titistë të Kosovës, sidomos tani që te ne në pesë muaj u likuiduan të gjitha dëmet e shkaktuara nga tërmeti i fortë i 15 prillit. Që të kundërbalancohet një çik pakënaqësia që është krijuar në popull, e kanë ftuar disa ditë Titon që t'i japë popullit disa premtje.”*⁴⁷⁶

Por një gjë të tillë nuk mund të thuhet për Ministrinë e Jashtme. Ish-diplomati i kohës Syrja Laze, ka treguar në një rast: *“ngjarjet e vitit 1981 në Ministrinë e Jashtme priteshin të ndodhnin, pasi strukturat zyrtare që merreshin me marrëdhëniet me Kosovën kishin kohë që funksiononin me rrjetin e tyre të informacionit, ndiqnin zhvillimet hap pas hapi që shteti të mos ndodhej para të papriturave dhe për qëndrimet që do të mbaheshin.”*⁴⁷⁷ Krahas kësaj punonin disa struktura të tjera zyrtare, sikurse ishin *“Sektori i Kosovës”* pranë KQ-së të PPSH – së (strukturuar plotësisht më 4 mars 1981) si qendër koordinimi mes strukturave të ndryshme që punonin për këtë problem.⁴⁷⁸

Pra, mund të thuhet se nuk ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë por, nuk mund të thuhet që nuk ka qenë e informuar me kohë se trazira të tilla mund të ndodhnin. Kjo dëshmohet edhe në ditarët e Enver Hoxhës për politikë të jashtme.

Shqipëria nuk është faktuar deri më tani që kishte dorë në organizimin e demonstratave në Kosovë, siç e akuzonin autoritetet e Beogradit dhe të Prishtinës, por ndikimi i saj për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare te shqiptarët nën Jugosllavi ishte shumë i madh.⁴⁷⁹

Por edhe përkundër të gjitha këtyre argumenteve dhe kundërgjendjeve, të cekura më lart, se a ka pasur shteti shqiptar ndikim të drejtpërdrejtë, në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981, shteti shqiptar nuk ka qëndruar indiferent, por ka shprehur haptazi qëndrimin e vet zyrtar. Por është një fakt, gjë që lypset një shpjegim, se pse shteti shqiptar një muaj pasi

⁴⁷⁶ Enver Hoxha, Kosova është Shqipëri, nga Ditari Politik, përmbledhje dokumentesh, Tiranë, 1999. Marr në : http://ciml.250x.com/archive/hoxha/albanian/enver_hoxha_kosova-eshte-shqiperi.pdf më 18.06.2018.

⁴⁷⁷ Afërdita Sokalaj, vep. e cit., fq. 5.

⁴⁷⁸ Po aty.

⁴⁷⁹ M. Hajrizi, vep. e cit., fq. 272.

shpërthyen demonstratat filloi shtypi shqiptar të informoj më në detaje opinionin e brendshëm. Është fjala për reagim të hapur, sepse shteti shqiptar menjëherë ka ndërmarrë masa qysh më 12 mars të vitit 1981, një ditë pas shpërthimit të demonstratave, duke kërkuar ambasadës së saj në Beograd, që të informonte se çka ishte duke ndodhur në Prishtinë dhe për komentet që bëheshin rreth tyre.⁴⁸⁰ Po ashtu më 16 mars, u njoftuan përfaqësitë diplomatike për demonstratat dhe u udhëzuan që të jenë të kujdesshme në prononcimet publike.⁴⁸¹

Vonesa e mosinformimit të opinionit të brendshëm nga shtypi në Shqipëri, më shumë lidhet me aspektin politik. Kur dihet se mediet në Shqipëri para shpërthimit të këtyre demonstratave kishin informuar vazhdimisht për gjendjen në Kosovë, kuptohet në kornizat e bashkëpunimit që kishte në atë kohë Shqipëria dhe ish-Jugosllavia.

Tematika kosovare në mjetet e informimit publik në Shqipëri në fund të vitit 1980 dhe në fillim të vitit 1981 kryesisht kishte në qendër të saj lajmin protokollar, i cili informonte shkurt opinionin publik vendas me konkretizimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në fusha të ndryshme mes Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH) dhe Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK).

Lajmi përmbante çfarë kishte ndodhur, ku, kur, si dhe pse kishte ndodhur. Ky lloj formati krijon përshtypjen se lajmi i përgjigjej kërkesave profesionale për formulimin e tij. Format i lajmit të publikuar më 10 shkurt 1981 në “Zëri i Popullit” bënte me dije se “u nënshkrua protokoll i bashkëpunimit fizkulturore e sportiv me Kosovën për vitin 1981.”⁴⁸²

Periudha e bashkëpunimit institucional kulturor dhe arsimor midis RPSSH-së dhe RSAK-së në vitet e 70-ta ishte shoqëruar dhe me njëfarë “*liberalizimi*” në marrëdhëniet njerëzore mes shqiptarëve në të dy anët e kufirit shtetëror. Ky proces kishte ofruar mundësi për një informacion më të gjerë për jetën në Kosovë. Periudha e intensifikimit të marrëdhënieve në mes të dy anëve të kufirit apo e zbutjes nuk ishte shfrytëzuar nga mjetet e informimit të Tiranës zyrtare për t’i dhënë jetë një tjetër standardi të tyre për trajtimin e tematikës së Kosovës.⁴⁸³ Kuptohet ka pasur cenzurë sa i përket këtij informimi.

⁴⁸⁰ Sabit Sylva, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës, 1939-1981...* vep. e cit., fq. 254.

⁴⁸¹ Po aty.

⁴⁸² Afërdita Sokolaj, ÇËSHTJA E KOSOVËS DHE MEDIA SHQIPTARE 1981-2000, Tiranë, 2014, fq. 3. (Tezë e Doktoraturës në dorëshkrim), marrë me 29.01.2018, në <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/09/Doktoratura-Aferdita-Sokolaj-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise.pdf>

⁴⁸³ Po aty, fq. 4.

Duke i pasur parasysh të gjitha ato që u thanë më lart është mjaft befasues heshtja e medias në Shqipëri, për demonstratat e vitit 1981, thuajse për një muaj. Mungesa e lajmit dhe mosreagimi i shtetit shqiptar, pra në mënyrë të menjëhershme, kishte rënë në sy edhe të qarqeve ndërkombëtare. Një fakt i tillë ishte regjistruar nga reporterët e huaj dhe i ishte nënshtruar këndvështrimeve të tyre.

Korrespondenti i radios "Free Europe" (RFE - RL), Stankoviç nga Beogradi e kishte perceptuar qëndrimin e medias fillimisht në Shqipëri si vetëdistancim të saj nga politikat. *"Media shqiptare në fakt - raportonte ai - ka qenë e kujdesshme që të mos e përfshinte veten në polemikat për çështjen në fjalë"*.⁴⁸⁴ Por e gjithë kjo vonesë në informimin e publikut për demonstratat e vitit 1981 nuk qëndronin në fushën mediatike, por në atë politike e ideologjike.

485

Krejt ai pak informim për ngjarjet e 11 marsit që kishte mbërritur andej kufirit ishte nga mediet e huaja. Por qarqet e ngushta mediatike dhe politike ishin mirë të informuara për ngjarjet në Kosovë. Për këtë një konstatim të logjikshëm e ka bërë historianja Afërdita Sokolaj: *"Arsyet e vonesës mediatike për ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë fare pranë kufijve shtetërorë veriorë e verilindorë janë komplekse dhe reflektojnë qëndrimet zyrtare të kohës, prioritetet e të cilave lëviznin në terrenin shumë të vështirë mes interesave shtetërore, që kushtëzonin edhe marrëdhëniet mes dy vendeve fqinje, Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe interesit shumë imediat të politikës zyrtare për ta marrë në mbrojtje çështjen e shqiptarëve në Kosovë"*.⁴⁸⁶

Pra, duke pasur parasysh se shteti shqiptar nuk kishte në këtë kohë ndonjë aleat strategjik, siç kishte më herët Kinën dhe BRSS, por tani aleat të vetëm strategjik kishte Jugosllavinë. Prandaj i kishin afruar raportet vetëm me Jugosllavinë, mendimi i Afërdita Sokolajt, i lartëcekur qëndron, se dilemat ishin për faktin që ishte një zgjedhje në mes të këndshmes dhe të dhimbshmes.

Mehmet Hajrizi ka një konstatim interesant për këtë vonesë të reagimit të shtetit shqiptar: *"Vonesa e reagimit zyrtar të Shqipërisë për shtypjen e demonstratave dhe ende nuk dihen të gjithë arsyet e brendshme e të jashtme të saj, por dihet që edhe atje janë befasuar, sepse nuk kishin informacion se do të ndodhnin pikërisht në atë kohë dhe në ato përmasa"*.⁴⁸⁷ Ky konstatim i Mehmet Hajrizit më shumë është si një shfajësim i shtetit shqiptar për vonesën e

⁴⁸⁴ Po aty.

⁴⁸⁵ Po aty, fq. 5.

⁴⁸⁶ Po aty.

⁴⁸⁷ M.Hajrizi, vep. e cit, fq. 254.

reagimit, por vonesa e reagimit nuk është ndonjë “*mëkat*”. Mëkat do të ishte mosreagimi ose reagimi në disfavor të interesave të kosovarëve.

Ne kemi thënë edhe më lart, se shteti shqiptar nuk ka qenë i informuar për kohën dhe fuqinë e shpërthimit të demonstratave, nuk mund të qendroj në asnjë formë konstatimi, se krejt të painformuar nuk kanë qenë organet e shtetit shqiptar. Se vonesa e reagimit të shtetit shqiptar ishte si rezultat i zënies në befasi nga shpërthimi i demonstratave të 11 marsit, 1981.

Por duhet të pranohet edhe një fakt se, jehona e madhe në mediet ndërkombëtare ka qenë një shtysë që shteti shqiptar të reagojë në medie dhe të kristalizojë një qëndrim zyrtar ndaj demonstratave të '81-shit. Media shqiptare, që nga momenti i reagimit të parë, u bë një burim informacioni, i cili nuk mund të neglizhohej për mediet ndërkombëtare.⁴⁸⁸ Por, duke u bazuar në të gjitha materialet e shfrytëzuara, Tirana zyrtare ishte duke vepruar me një kujdes shumë të madh në këtë rast. Për këtë dëshmon thirrja e mbledhjes së Byrosë Politike, ku është diskutuar për Kosovën dhe masat që duheshin ndërmarrë.⁴⁸⁹ Pra, kjo dëshmon që shteti shqiptar ishte duke analizuar të gjitha gjërat para se të ndërmerre hapin final. Sepse pas artikullit në “*Zëri të Popullit*” më 8 prill, më pastaj nuk i ka ndërprerë reagimet dhe të gjitha kanë qenë atakuese ndaj shtetit jugosllav.

Një gjë të tillë e dëshmon edhe Kongresi e 8 i PPSH-së, 1981. E veçanta e këtij Kongresi ishte deklarata e Enver Hoxhës në këtë Kongres: “*Shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë një etni, një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton*”.⁴⁹⁰ Ai analizoi historinë e shkëputjes së Kosovës që nga vitit 1913, kur e lanë padrejhtësisht jashtë territoreve shqiptare, për të cilën ai fajëson fuqitë imperialiste Evropiane të kohës. Ajo që e bëri edhe më të veçantë këtë deklaratë të tij ishte se ai në fund analizoi edhe raportet e tij me Titon për çështjen e Kosovës duke prekur këto etapa: Vendimet e Bujanit, ku u sanksionuan të drejtat e popullit të Kosovës për vetëvendosje; Takimi i tij më Titon , në Beograd, në vitin 1946, (ku Hoxha kërkoi bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, ndërsa Titoja arsyetoi se nuk do të pranonin serbët një gjë të tillë për momentin) etj..⁴⁹¹ Në përfundim të analizës së tij, Enver Hoxha, për herë të parë mbështet publikisht kërkesën e popullit të Kosovës

⁴⁸⁸ Po aty, fq. 14.

⁴⁸⁹ Sabit Syla, *Shteti shqiptar...*, vep. e cit., fq. 255.

⁴⁹⁰ Agustin Gjinaj, Fejzli Lila, *Lidershipi i shqiptarëve përmes historisë së ushtrisë*, GEER, 2012, fq. 245.

⁴⁹¹ Po aty.

gjatë lëvizjeve politike në vitin 1981: “ *Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës, brenda Federatës është një kërkesë e drejtë, ajo nuk cenon ekzistencën e Federatës*”.⁴⁹²

Çka ishte hera e parë që Enver Hoxha fliste hapur për çështjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, konkretisht për Kosovën. Kjo ishte mjaft befasuese. Cila ishte arsyeja që e shtyri për të bërë një hap të tillë, akoma nuk ka marrë përgjigje në historiografinë shqiptare. Një veprim i tillë i Hoxhës është mjaft abstrakt në kuptimin politik dhe strategjik, sepse dihet mirëfilli se Shqipëria në këtë periudhë ishte e izoluar thuajse tërësisht, pastaj ekonomikisht ishte në një gjendje mjaft të vështirë. Pra, Enver Hoxha nuk e kishte luksin të luante me kartën e nacionalizmit, apo ndoshta këtë e ka bërë për konsum të brendshëm, që të tërhiqet opinionin nga kriza reale ekonomike që kishte kapluar Shqipërinë e asaj kohe.

Duke u bazuar në veprimet e mëvonshme politike të Hoxhës dhe shtetit shqiptar pas vdekjes së tij, mendimi im është se këto deklarata ishin për konsum të brendshëm dhe për të përcjellë sinjale në arenën ndërkombëtare, kinse për ndonjë krizë të mundshme.

Përafërsisht një muaj pas shpërthimit të demonstratave, më 8 prill 1981, në gazetën “*Zëri i popullit*”, Tirana zyrtare shpreh qëndrimin e vet rreth këtyre ngjarjeve në Kosovë, me titullin mjaft interesant: “ *Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?* ”⁴⁹³

Ky artikull, apo më mirë të themi, ky qëndrim zyrtar i Tiranës, realisht ishte edhe qëndrim i vet Enver Hoxhës,⁴⁹⁴ prandaj është pritur me interesim të madh nga trupa diplomatike e akredituar në Tiranë, por edhe nga opinionin e brendshëm në Shqipëri, si dhe një pritje deri në padurim të reagimit të shteti shqiptar ishte nga rinia studentore kosovare.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë ishte mjaft i interesuar edhe për efektin që përcillte artikulli i “*Zërit të popullit*” në opinionin e brendshëm. Për këtë dëshmojnë disa raporte që bëhen në KQPPSH-ja, ku sjellin opinionin rreth artikullit të “*Zërit të popullit*” që kishte rinia, sindikatat e ndryshme, opinionin e banorëve që kishin prejardhje nga Kosova si dhe opinionin nga zonat afër kufirit me Kosovën.⁴⁹⁵ Në këto raporte vërehet edhe një element shumë interesant, pas disa konstatimeve një pjesë e rinisë nuk dinin mjaft për Kosovën dhe

⁴⁹² Enver Hoxha, raporti në Kongresin e VIII-të PPSH, 1981, cituar sipas Agustin Gjinaj dhe Fejzli Lila, Lidërshipi i shqiptarëve përmes historisë së ushtrisë, GEER, 2012, fq. 245.

⁴⁹³ Sabit Sylja, Dokumente diplomatike të Qeverisë Shqiptare për demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, vep. e cit., fq. 15.

⁴⁹⁴ Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 106.

⁴⁹⁵ AQSH, Fondi: 14, dosja nr. 28, fq. 41-74.

historinë e saj, për këtë Leka Shkurti i kërkon Ramiz Alisë që të shfrytëzojë sa më shumë shtypin në forma të ndryshme, të angazhojë mësues, pedagogë dhe njerëz me autoritet, për të shpjeguar sa më shumë për Kosovën dhe gjendjen e saj.⁴⁹⁶

Diplomatët e ambasadave të vendeve revizioniste, lidhur me ngjarjet e fundit në Kosovë, janë shprehur njëzëri se në to ka gisht Shqipëria.⁴⁹⁷ Kurse reagimet e diplomatëve të ambasadave të vendeve perëndimore, janë krejt të ndryshme nga ato revizioniste. Ata e kanë cilësuar reagimin e Shqipërisë në artikullin e 8 prillit si shumë të rëndësishëm dhe të argumentuar mjaft mirë.⁴⁹⁸ Gjithashtu ata kanë thënë se pavarësisht nga ngjyrat që mundohet t'u japë udhëheqja jugosllave ngjarjeve në Kosovë, faktet vërtetojnë të kundërtën.⁴⁹⁹

Mediet në ish-Jugosllavi kishin reaguar më 9 prill. “Zëri i popullit”, mohon vlerësimet tona dhe masat të cilat organet legjitime të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në bazë të kushtetutës dhe ligjit i përdorën për t’ia ndaluar hovin aksionit të armikut, i cili tentonte t’i cenonte frytet themelore të revolucionit tonë.⁵⁰⁰ Vlerësimet dhe masat tona “Zëri i popullit”, në mënyrë shoviniste ia vesh popullit serb me qëllim që të krijojë urrejtje dhe konfliktet ndërnacionale.⁵⁰¹

Beogradi bëri të gjitha përpjekjet për të zhvendosur vëmendjen e opinionit të brendshëm dhe atij botëror nga arsyet e vërteta të demonstratave të shqiptarëve në Kosovë, duke i quajtur ato armiqësore, irredentiste, e të nxitura nga jashtë, duke akuzuar Shqipërinë si nxitësin e tyre, më pretendime territoriale se ka ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë etj..⁵⁰²

Për këtë përplasje në distancë në mes të shtetit shqiptar dhe atij jugosllav kanë shkruar edhe mediet e ndryshme ndërkombëtare, si ajo austriake “Neue Zeit”, boton një shkrim me një titull mjaft interesant “Beogradi në konflikt me Shqipërinë”,⁵⁰³ kjo dëshmon se jugosllavët kishin arritur një farë forme ta bartnin vëmendjen tjetër kund, dhe jo në problemin real, në shpërthimin e demonstratave. Po ashtu edhe gazeta mjaft popullore në Kosovë “Rilindja” kishte bërë një shkrim si reagim ndaj artikullit të Gazetës shqiptare “Zëri i Popullit” ku vërehej fund e krye një reagim pa argumente, në disa raste edhe dalin qesharak. Gazeta “Rilindja” qysh në fillim të reagimit akuzon “Zërin e Popullit” mjaft ashpër: “Artikulli vlon më shumë të

⁴⁹⁶ Po aty, fq. 49.

⁴⁹⁷ Sabit Sylja, *Dokumentet diplomatike të Qeverisë së Shqipërisë...*, vep. e cit., fq. 15.

⁴⁹⁸ Po aty.

⁴⁹⁹ Po aty.

⁵⁰⁰ Po at, fq. 16.

⁵⁰¹ Po aty.

⁵⁰² Sabit Sylja, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës...* vep. e cit., fq. 297.

⁵⁰³ Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 117.

*pavërteta dhe vlerësime tendencioze, të cilat në esencë janë përzierje në punë të brendshme të vendit tonë që kanë për qëllim prishjen e harmonisë në mes të kombeve e kombësive në Jugosllavi. Me parullat demagogjike e armiqësore "Zëri i Popullit" po bëhet avokat dhe telall i forcave reaksionare dhe armiqësore të kombësisë shqiptare aq sa bënë të dyshosh se a thua mos janë vet kuzhinë, ku zihen dhe nxiten këso tendenca armiqësore...".*⁵⁰⁴

Por në krejt këtë reagim të gazetës "Rilindja" të bëjnë "përshtypje" vetëm dy gjëra. E para, kur mundohen ta mbrojnë popullin serb: *"Vlerësimet dhe masat "Zëri i Popullit" në mënyrë shoviniste ia vesh popullit serb me qëllim që të krijojë urrejtje dhe konflikte ndërnacionale. E vërteta është se populli serb, si të gjitha kombet dhe kombësitë tjera të vendit tonë kanë shprehur solidaritetin, përkrahjen vlerësimet tona dhe ndihmuan masat tona".*⁵⁰⁵

Fakti i dytë dhe që i bënë edhe më qesharak është kur thonë se populli shqiptar i Kosovës nuk ka qenë pjesëmarrës në demonstrata. "Zëri i Popullit" nuk ndalet me shpifje: *"spekulon në mënyrë të paskrupullt kinse populli i Kosovës ka dalë në demonstrata dhe kinse ka shprehur pakënaqësi. As populli i Kosovës, e as kombësia shqiptare nuk kanë dalë në demonstrata. Përkundrazi i kanë dënuar dhe i kanë shpartalluar si vepra të armikut dhe i kanë hedhur poshtë parullat me përmbajtje armiqësore, nacionaliste, irredentiste të armikut i cili mashtron një pjesë të vogël të rinisë dhe qytetarëve."*⁵⁰⁶

Pas mediumit më të njohur jugosllav, "Tanjug", nuk ka vonuar edhe shumë dhe ka reaguar edhe shteti jugosllav në mënyrë zyrtare për këtë shkrim, apo qëndrim të shtetit shqiptar. Por reagimi jugosllav ishte bërë në mënyrë mjaft të sofistikuar, duke e shtyrë njërin ndër figurat më të njohura të politikës kosovare për disa dekada, që të kundërvihet me një artikull në formë fjalimi. Kjo ishte bërë që të krijohej një perceptcion në arenën ndërkombëtare, se në Kosovë gjendja nuk ishte e tillë, që të shpërthenin trazira me karakter ekonomik e social por, kjo kishte ardhur nga ndikimet nga jashtë, konkretisht nga Tirana zyrtare. Fakti që ishte zgjedhur pikërisht Fadil Hoxha për t'iu përgjigjur gazetës "Zëri i Popullit" tregon seriozitetin më të cilin Jugosllavia shikonte kritikën e Shqipërisë.⁵⁰⁷

Më 27 prill të vitit 1981 në formën e një fjalimi të mbajtur nga Fadil Hoxha, anëtar i Kryesisë Federale të Kosovës, para një grupi aktivistësh të partisë në Prishtinë. Së pari, ai trajtoi

⁵⁰⁴ Gazeta "Rilindja" 09.04.1981, Prishtinë, fq. 2.

⁵⁰⁵ Po aty.

⁵⁰⁶ Po aty.

⁵⁰⁷ Sabit Sylja, Hamit Kaba, vep. e cit., fq. 119.

statusin e Kosovës brenda federatës; së dyti trajtoi kritikën e Tiranës për prapambetjen ekonomike të Kosovës, dhe së treti marrëdhëniet Jugosllavi-Shqipëri.⁵⁰⁸

Fadil Hoxha së pari bëri një shpjegim shumë mbrojtës të statusit të Kosovës ku pasqyrohej e gjithë palogjikshmëria e pozitës federative. Ai pohoi se forcimi dhe jo shpërbërja e Jugosllavisë kishte rëndësi jetësore për shqiptaret e Kosovës që të arrinin barazinë e tyre të plotë kombëtare...⁵⁰⁹

Duke justifikuar statusin e Kosovës si Krahinë Autonome, Fadil Hoxha tha se çdokush e dinte se ky status kishte ardhur si rezultat i “dëshirës” së të gjitha kombeve dhe kombësive tona përmes vendimeve të marra nga Krahina, Republikat dhe Federata 1945-1946...⁵¹⁰ Këtu Fadil Hoxha si duket nga presioni kishte pranuar që ta gëlltiste një të vërtetë të madhe. Sepse dihet mirëfilli se në vitin 1945 në Prizren është marrë një vendim në shtettrrethim që Kosova të mbetet nën Jugosllavi.

Fadil Hoxha nuk e la anash edhe një argument që posedonte, ta thumbonte Tiranën lidhur më zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ai pyeti me ironi: “*Nëse serbët supozohet që janë përgjegjës për prapambetjen e Kosovës, kush është përgjegjës për prapambetjen e Shqipërisë?!’*”. Ai theksoi se zhvillimi ekonomik i Shqipërisë ishte më i ulëti në Evropë.⁵¹¹ Pra nëse shikohet me vëmendje ky reagim, vërehet mospërputhshmëria në mes të asaj si e paraqet Shqipërinë Fadil Hoxha dhe më atë që e akuzon. Këtu mund të shtrohet edhe një pyetje logjike si ka mundësi një shtet kaq i varfër dhe i prapambetur, të ketë ambicie të tilla për destabilizim të një shteti fqinj?

Pra, sulmi i Fadil Hoxhës dhe Mahmut Bakallit ishte mjaft i ashpër ndaj Tiranës zyrtare kinse për implikimin në demonstrata.⁵¹² Kjo akoma pa u bërë një analizë e mirëfilltë e të gjitha rrethanave që quan më të vërtetë në këto demonstrata. Por ky reagim i udhëheqësve të Kosovës të asaj periudhe nëse shikohet nga perspektiva e sotme kuptohet lehtë se ishte më shumë si një shfajësim apo mos implikim të vet atyre në këto demonstrata të studentëve. Kjo dëshmohet edhe më turnin e tyre nëpër Kosovë, sidomos nëpër vende ku kishte mundësi që të bashkëngjiten demonstratave, si në uzinat e mëdha që kishte mijëra punëtorë.

⁵⁰⁸ Po aty.

⁵⁰⁹ Po aty, 117.

⁵¹⁰ Po aty.

⁵¹¹ Po aty, fq. 118.

⁵¹² Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 350.

Këtij karvani iu ishin bashkëngjitur Fadil Hoxha, Mahmut Bakalli, Xhavit Nimani, Asllan Fazliu etj..⁵¹³ Në të gjitha këto tubime para punëtorëve është folur haptazi dhe qartë kundër gjithë atyre që po organizonin demonstrata. Ju kërkohet punëtorëve që të jenë sa më syçelë dhe të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me forcat siç quheshin progresiste për eliminimin e veprimtarive armiqësore.⁵¹⁴

Duke mos iu mjaftuar kjo, këta të fundit improvizonin kinse po iu vijnë nga të gjitha qytetet telegrame mbështetëse.⁵¹⁵

Duke pasur parasysh faktin se shteti jugosllav akuzonte më së shumti mërgatën shqiptare, sidomos atë në Gjermani, Zvicër, SHBA etj., për këtë organet e rendit ndërmorën një ekspeditë në këto vende, kinse të informojnë mërgimtarët jugosllavë, konkretisht shqiptarët e Kosovës për atë se çka po ndodhë në Kosovë. Realisht qëllimi i këtyre takimeve me mërgimtarët përmes ambasadave dhe konsullatave ishte për të sabotuar organizimet e tyre për demonstratat që bënin në ato vende, por edhe për të dekonspiruar elementet organizative. Për këtë dëshmojnë edhe dokumentet arkivore.

Më 25 prill 1981, në Cyrih të Zvicrës, në orën 11:00 është mbajtur një takim në klubin e punëtorëve jugosllav- seksioni i punëtorëve shqiptarë “Përparimi”. Pjesëmarrja ishte afro 130 veta, kryesisht punëtorë shqiptarë. Diskutimet kryesisht kanë qenë mbi ngjarjet që po ndodhin në Kosovë.⁵¹⁶ Para se delegacioni nga Kosova të arrinte në Zvicër, ishin organizuar dy demonstrata para ambasadës jugosllave në Bern dhe para konsullatës në Cyrih. Numri i demonstruesve sillet (sipas këtij raporti) 200-250.⁵¹⁷

Siç shihet nga ky dokument nuk ishte rastësi përzgjedhja e Zvicrës për të sabotuar organizimet e mërgatës shqiptare. Asnjë mbledhje apo diskutim nuk është bërë pa prezencën e përfaqësuesit të ambasadës dhe konsullatës jugosllave në Zvicër.

Por, ajo që është mjaft interesante nga këto takime kryesisht me mërgatën shqiptare, janë pyetjet që kanë parashtruar ndaj përfaqësuesve të shteti jugosllav, ne do ti sjellim disa prej tyre:

- Pse është përdorur forca dhe policia serbe në shuarjen e demonstratave studentore?;
- Pse i kanë rrahur studentët pas hyrjes së tyre në konvikte të studentëve?;

⁵¹³ Gazeta “Rilindja” 08.04.1981, Prishtinë, fq. 1.

⁵¹⁴ Po aty.

⁵¹⁵ Gazeta “Rilindja” 05.04.1981, Prishtinë, fq. 1.

⁵¹⁶ AShAK, fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, viti 1979-1988, Lënda36, Kutia 3, fq. 2.

⁵¹⁷ Po aty, fq. 2-3.

- A ka në mesin e të burgosurve edhe të kombësive tjera?;
- A është vërtetë se të burgosurit janë dërguar jashtë Kosovës dhe pse?;
- Pse nuk ndërmerren masa të ngjashme kundër serbëve dhe malazezëve, të cilët po shprehin shovinizmin e tyre...?;
- Pse janë përdorur tanket dhe ushtria në shuarjen e demonstratave?;
- Pse nuk publikohen emrat e të vrarëve dhe të plagosurve?;
- Pse bursat dhe kreditë u jepen atyre që janë në gjendje të mirë ekonomike?;
- Pse nuk është furnizuar si duhet tregu dhe pse po rriten çmimet aq shumë?;
- Kush është fajtor për demonstratat që ndodhën në Kosovë?;
- Pse pagat janë më të larta në Slloveni?⁵¹⁸

Ajo që vërehet në parashtrimin e këtyre pyetjeve është fakti se në mesin e mërgimtarëve kishte persona mjaft të informuar me atë se çka po ndodhte në Kosovë. Por edhe konkludimi i shkruarit të këtij raporti mbi takimet e lartcekura, vë në pah elemente “destruktive” në mesin e të pranishmeve në këto takime, po ashtu ky konkludim shpërfaqte komplet qëllimin e këtyre takimeve, i cili ishte për të dekonspiruar këta elementë.

Krejt këto përpjekje të nomenklaturës udhëheqëse të kohës ishin më shumë për të dëshmuar si një përpjekje për qetësimin e situatës dhe për të shpëtuar lëkurën e tyre. Po ashtu në të gjitha mbledhjet e zgjeruara të kryesisë së KK-së të LSPP-së të Kosovës udhëheqësit shqiptarë të Krahinës së Kosovës shpreheshin thuajse njëzëri, i quanin demonstrata kundërrevolucionare, irredentiste, armiqësore, dhe të motivuara dhe të nxitura nga shteti shqiptar.

Mahmut Bakalli edhe pas shumë arrestimeve dhe diferencimeve politike që ishin bërë për protestat e marsit të vitit 1981, kishte reaguar përsëri me një ashpërsi, ku deklaronte: *“Forcat armiqësore nuk janë shuar tërësisht, gjë që është e mundur që këto forca të organizojnë edhe trazira tjera, por ne jemi vënë në gatishmëri të plotë dhe do t’i përdorim të gjitha mjetet e nevojshme për të shtypur nacionalizmin”*. Kështu shkruante në artikullin e gazetës “Wiener Zeitung”, i cili ishte marrë dhe bazuar në një informacion që vinte nga “Reuters”.⁵¹⁹

Duhet të pranohet një fakt si në kontekstin kur kanë ndodhur këto ngjarje si edhe në kontekstin e sotëm. Reagimi i udhëheqjes shqiptare në Kosovë ndaj demonstratave studentore të

⁵¹⁸ Po aty, fq. 5-8.

⁵¹⁹ Egerem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989*, vep e cit., fq. 101.

vitit 1981 ishte katastrofike. Në besimin e tyre të fortë në Jugosllavinë federale, socialiste dhe në pikëpamjen e tyre kategorike se e ardhmja e Kosovës ishte e lidhur pazgjidhshmërisht me Jugosllavinë socialiste, ata reagues ndaj kryengritjes së paarsyeshme të pjesëve të elitës së tyre të re kundër rrugës jugosllave me kundërsulm.

Krerët shqiptarë të asaj kohe besonin se ata mund të lajnë "njollën" e demonstratave nga rrobat e tyre, për t'u bashkuar përsëri me radhët e socialistëve jugosllavë.⁵²⁰

Në mbledhje e Komitetin Krahinor të LK-së të Kosovës për demonstratat e zhvilluara 1981, në vija të përgjithshme ishin këto diskutime:

- *“Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë janë rezultat i punës së organizuar shumëvjeçare nga pozitat e nacionalizmit e të irredentizmit shqiptar.*
- *Shqipëria në marrëdhëniet me vendet tona veproi kinse me gatishmërinë që të zhvillojë marrëdhënie të mira fqinjësore, ndonëse njëherësh intensivisht zbatoi jo vetë, veprimtarinë informative dhe propaganduese por edhe propagandë të hapur ideopolitike nga pozitat e nacionalizmit, irredentizmit dhe të stalinizmit.*
- *Parullat që udhëhoqën armiqtë, qëllimi themelor i të cilave është minimi i Jugosllavisë, dezinformimi për gjendjen në Kosovë dhe përpjekja që Kosova t'i bashkohet Shqipërisë. Pati edhe raste konkrete të nxitjes dhe të inicimit të drejtpërdrejtë të veprimtarisë irredentiste nga ana e përfaqësuesëve diplomatike konsullore shqiptare dhe të disa qytetarëve të Shqipërisë në vendin tonë dhe në botë.*
- *Ngjarjet e pranverës së vitit 1981 në krahinë dëshmuuan se udhëheqja e Shqipërisë vazhdimisht që nga viti 1948 është preokupuar me orientimin e antijugosllav dhe se për herë organizonte aksione subversive dhe nxit nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar në Kosovë.*
- *Shqipëria po përpiqet që me mjetet propaganduese të paraqitet si mbrojtësja e shqiptarëve në Jugosllavi, para së gjithash në Kosovë, duke propaganduar njëherësh edhe urrejtje shoviniste të verbër kundër popullit serb dhe kombeve dhe kombësive tjera në Kosovë dhe Jugosllavi.”⁵²¹*

Kjo dëshmon shumë qartë se udhëheqësit shqiptarë të Kosovës të asaj kohe ishin të njëjtës vijë me udhëheqësit jugosllavë. Një fakt tjetër interesant që kam hasur në procesverbalet e mbledhjes së Komiteti Krahinor i LK-së së Kosovës më 27 mars 1981, 16 ditë pas shpërthimit të demonstratave studentore, nuk është në rend të ditës për diskutim çështja e demonstratave

⁵²⁰ Viktor Meier, vep. e cit., fq. 30.

⁵²¹ Sabit Sylva, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, vep. e cit., fq. 310.

edhe pse ishte një çështje mjaft delikate.⁵²² Kjo në bazë të një logjike të shëndoshë dhe në bazë të deklaratave të mëvonshme të udhëheqësve shqiptarë të Kosovës, është bërë jo pa qëllim, që edhe pjesëmarrësit në mbledhje të nivelit të tillë të mos ishin të gjithë të informuar. Krejt kjo që të izohet dhe minimizohet gjendja politike në Kosovë. Një gjendje e tillë ka vazhduar deri më 5 prill, kur kryesia e KQ-së të LKJ-së në Beograd, më 5 prill, do të dalë me qëndrimin e prerë, duke i kualifikuar demonstratat “*ngjarje armiqësore me karakter kundërrevolucionar*”. Me këtë rast parulla “Kosova Republikë” ishte karakterizuar armiqësore dhe kundërrevolucionare, sepse një gjë e tillë çonte në shkatërrimin e Jugosllavisë.⁵²³ Pra derisa niveli qendror doli me qëndrim të prerë zyrtar udhëheqja shqiptare e Kosovës as në mbledhje të nivelit të tillë nuk kishin guxim të diskutonin haptazi për demonstratat.

Arsyeja se pse thujse gati pas një muaji reagoi hapur (akuzoi) shteti jugosllav Shqipërinë nuk është e rastit. Pra jugosllavët nuk e morën hapin të parët për një reagim apo akuzim duke pritur qëndrimin e shtetit shqiptar. Kjo për disa arsye, së pari për të përgatitur terrenin brenda dhe së dyti për të përgatitur opinionin ndërkombëtar. Sepse nëse i shohim deklaratat menjëherë pas shpërthimit të demonstratave janë shumë të matura dhe pa tendencë akuze ndaj asnjë faktori nga jashtë më emër të përveçëm.

Grikckov (ish anëtar i Kryesisë së Lidhjes Komuniste) deklaroi se demonstratat shpërthyen së pari nga kushtet sociale dhe ekonomike të cilat u shfaqën në një formë shumë më të mprehtë në Kosovë se tjetërkund. Megjithatë, situata kishte në vetvete një element të madh frymëzimi të jashtëm i cili ishte kryesisht irredentist.

Po ashtu një figurë mjaft e rëndësishme dhe një ndër bashkëpunëtorët më të rëndësishëm të Titos, anëtar i kryesisë së Jugosllavisë, Stane Dolanc paraqitet mjaft i matur në një konferencë për shtyp. Ai më shumë ka bërë një përshkrim të gjendjes në mënyrë të detajuar. Por edhe duke akuzuar në mënyrë indirekte shtetet perëndimore se emigracioni shqiptar i strehuar aty është një ndër faktorët që kanë ndikuar në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981.

Sipas Dolancit qendra e këtij reaksioni të jashtëm janë emigrantët shqiptarë në Shtutgart të Gjermanisë dhe ata në SHBA.⁵²⁴ Në këtë paraqitje Dolanci nuk e akuzoi direkt Shqipërinë, ishte mjaft i kujdesshëm.⁵²⁵ Por më vonë pala jugosllave ndërroi deklaratën sepse i duhej një fajtor i jashtëm, atëherë filloi të akuzohej Shqipëria për të gjitha. Sokrat Plaka, ish-ambasador i

⁵²² Arkivi i Kosovës, Fondi Komiteti Krahinor i Kosovës, vitit 1981, kutia 666, lënda 83.

⁵²³ Jusuf Buxhovi, vep. e cit., fq. 393.

⁵²⁴ Egerem Zenelaj, vep. e e cit., fq. 91.

⁵²⁵ Viktor Meier, *Fundi i Jugosllavisë Goditja në Kosovë*, Lubjanë, 2006, fq. 43.

Republikës së Shqipërisë në Jugosllavi (1975-1982), në një bashkëbisedim me historianin Agim Zogaj, ka theksuar se: “*Stane Dolanci – ministri i brendshëm jugosllav – kishte mohuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në organizimin e demonstratave. Por, më pas, kur serbët panë reagimet e trupit diplomatik dhe të opinionit ndërkombëtar, qeveria jugosllave ndërtoi akuza duke ia hedhur përgjegjësinë Shqipërisë*”.⁵²⁶

Dolanci i vendosi këto ngjarje në kontekstin e krizës ekonomike botërore dhe zhvillimit të shpejtë të Jugosllavisë që prej luftës për t’u futur në radhët e shteteve mesatarisht të zhvilluar...⁵²⁷ Ai vuri në dukje se në Kosovë kishte disa grupe nacionaliste që ishin të lidhura me qarqe të caktuar emigrantësh jashtë vendit, të cilat ai i përshkroi si profashiste dhe informbyroistë, që kishin për qëllim të sjellin trazira në zhvillimin socialist vetëqeverisës të Kosovës. Dolanci tha se ekzistimi i grupeve të tilla i është njohur qysh moti Jugosllavisë.⁵²⁸

Ai që binte në sy gjatë kësaj paraqitje dy orëshe para gazetarëve shumë pak, ose hiç fare, nuk e zuri në gojë demonstratën, si demonstratë por çdo kund “*incident që i dhanë dimensione politike*”.⁵²⁹

Dolanci duke e mbyllur fjalimin si një politikan me përvojë nuk lë dyshime mbi atë se pse kaq i vonuar është informimi i opinionit për gjendjen e krijuar në Kosovë, këtë e bëri pasi u përgjigj në pyetjen se pse kaq më vonesë janë dhënë informatat mbi ngjarjet në Kosovë. Ai e arsyeton një gjë të tillë me faktin se në fillim autoritetet nuk e kishin vlerësuar se demonstratat do të merrnin një intensitet të tillë dhe kishin menduar se nuk ishte nevoja të krijohesh ankth.⁵³⁰

Propaganda jugosllave nuk është ndalur për asnjë moment, përmes diplomatëve dhe ambasadave dhe të gjitha mënyrat, rrugët dhe metodat që të shtrembëronte të vërtetën mbi ngjarjet në Kosovë, të minimizonte vrasjet dhe reprezaljet që ata bënë, duke shpërndarë lloj-lloj materiali, të pavërteta kundër Shqipërisë, e kundër shqiptarëve të Kosovës.⁵³¹

Disa muaj më vonë edhe gjenerali jugosllav, Petkovski në një deklaratë që u transmetua nga “*Tanjugu*”, më 15 qershor 1981, kishte theksuar se: “*Shqiptarët synojnë të*

⁵²⁶ <https://telegrafi.com/dosja-1981-ngjarjet-qe-ndryshuan-rrjedhen-e-historise-foto/>, qasur më 20.09.2019.

⁵²⁷ Sabit Syla, Hamit Kaba, vep. e cit., fq. 61.

⁵²⁸ Gazeta “Rilindja”07.04.1981, Prishtinë.

⁵²⁹ Po aty.

⁵³⁰ Sabit Syla, Hamit Kaba, vep. e cit., fq. 61.

⁵³¹ Sabit Syla, Shteti shqiptar..., vep. e cit., fq. 302.

realizojnë krijimin e 'Shqipërisë së Madhe' në tri faza: Në fazën e parë të krijohet Republika e Kosovës, në të dytën Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë dhe në fazën e tretë krijimi i 'Shqipërisë së Madhe', duke përfshirë edhe territore greke".⁵³² Kjo tregon qartë se të gjitha organet e shtetit jugosllav ishin në funksion të propagandës serbe kundër shqiptarëve, çdo herë duke u munduar, sikur edhe kjo deklaratë e gjeneralit serb, që t'i paraqisnin shqiptarët si rrezik jo vetëm për Jugosllavinë por për të gjitha vendet ballkanike.

Qarqet jugosllave (serbe) si shkaktojnë të të gjitha këtyre trazirave e bënin nacionalizmin shqiptar, kurse nacionalizmin serb as nuk e zinin fare në gojë, kur dihet mirëfilli se çfarë faktori ishte nacionalizmi serb në krahasim me nacionalizmin shqiptar.⁵³³ Por jo të gjitha figurat e larta jugosllave kishin të njëjtin qëndrim. V. Bakariçi, kroat, anëtar i kryesisë së RSFJ-së dhe i kryesisë së KQ-ë të LKJ-së. Në një bisedë me udhëheqësit të LS-së së Kroacisë më 7 korrik të vitit 1981, Bakariçi kritikoi ashpër shkrimet mbi ngjarjet në Kosovë, duke thënë se informatat në një pjesë, u shndërruan në ndërsyerje kundër shqiptarëve.⁵³⁴ Kjo është një dëshmi se prapa propagandës antishqiptare ishin udhëheqësit serbë.

Një politikë atakuuese e shtetit jugosllav nuk është ndalur për asnjë moment, jo vetëm gjatë vitit 1981 por gjatë gjithë viteve të 80-ta. Krejt kjo ofensivë mediatike nga jugosllavët ishte më shumë nga frika se mos po ndërkombëtarizohet çështja e Kosovës, apo mos shteti shqiptar po fiton më shumë terren në arenën ndërkombëtare sidomos në perëndim. Për këtë dëshmon edhe një shkrim me autor Branko Stoshiq në mediumin me ndikim në Beograd "*Tanjug*": *Për këtë arsye na habit qëndrimi i butë i disa qarqeve ndaj Tiranës. Kur fqinji ynë më të gjitha mjetet përpiqet të nxitë ekstremistët nacionalistët në Kosovë për aksione kundër ligjit dhe rendit (me dëshirë që të nxitë angazhimin më të madh ushtarak për neutralizimin e tyre, që të shërbente më vonë si shkas dhe dëshmi se çështja e represionit të parashtrohet në forumet ndërkombëtare), ku pa kurrfarë baze e më pafytyrësi akuzon për qëndrimin negativ ndaj shqiptarëve në Kosovë. Që këtë së fundi ka bërë ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë, Reiz Malile, në Paris.*"⁵³⁵

⁵³² Po aty, fq. 302.

⁵³³ Shih me gjerësisht Kaqusha Jashari, Do ta vendosim kufirin, Prishtinë, 2015

⁵³⁴ AQSh,Fondi:14, viti 16 prill 1981, dosja 28, fq. 122.

⁵³⁵ Gazeta "Rilindja", 31.03.1989, fq.,..

Jo vetëm politikën e vendeve të ndryshme por edhe mediet botërore fillojnë të akuzojnë, apo më mirë të themi të përgatisin për invazionin që do të merrnin mediet e shtetit jugosllav në raport me ngjarjet e vitit 1981.

Për këtë dëshmon po i njëjti artikull : *“Me habi të madhe duhet të pyesim se si dhe kush, veçanërisht gazetarët dhe redaktorët e disa mjeteve të informimit botëror me gjithë përvojën e fituar në paraqitjen e situatave të ngjashme në mbarë planetin, mund të mashtrohen nga kjo propagandë, e cila nga dita në ditë po bëhet gjithnjë më e furishme”*.⁵³⁶

Presioni kryesor u drejtua edhe në drejtim të Universitetit të Prishtinës, sepse ishte e qartë se aty ishte epiqendra e të gjitha zhvillimeve që kishin ndodhur gjatë demonstratave të vitit 1981. Për këtë më 15 tetor të vitit 1981 vizitohet UP-ja nga një delegacion i lartë i KQ-së të LK-së të Jugosllavisë, i përbërë nga Llazar Mojsovi (kryetar i kryesisë së KQ-së të PK-së, dr. Tihomir Vllashkaliqi, kryetar i KQ-së të LK-së të Serbisë dhe shumë të tjerë. Krejt kjo vetëm për të ushtruar presion sa më të madh ndaj udhëheqjes së UP-së dhe gjithë ligjëruesve që të kenë kujdes në të ashtuquajturën indoktrinim të studentëve.⁵³⁷

Por edhe përkundër të gjithave, një fakt nuk mund të mohohet, se të gjitha të dhënat tregojnë se demonstratat ishin organizuar dhe drejtuar me qëllim nga shqiptarët e Kosovës të motivuar politikisht, kryesisht nga studentët. Parullat dhe banderolat ishin qartazi të natyrës irredentiste dhe nacionaliste shqiptare.

Mund të kenë qenë të përfshirë edhe elementë të tjerë të spektrit të majtë dhe të djathtë politik, siç pretendonin zëdhënës të ndryshëm zyrtarë, por shkakun kryesor duhet ta kërkojmë tek nacionalizmi i shqiptarëve të Kosovës. Në të vërtetë, një anëtar drejtues i Komitetit Qendror i Sllovenisë pati thënë, kohët e fundit në lidhje me Kosovën se: “shkaqet kryesore të të gjithë krizave të rënda të Jugosllavisë, deri më sot, duhet të kërkohen të nacionalizmi jo aq shumë te problemet”.⁵³⁸ Ka të ngjarë që këto shkaqe politike të jenë bërë më të dukshme nga ankesat ekonomike dhe sociale. Me gjithë përpjekjet e konsiderueshme për zhvillimin e Kosovës me

⁵³⁶ Po aty.

⁵³⁷ Gazeta “Bota e Re” 15.10.1981, Prishtinë.

⁵³⁸ Gazeta “Rilindja”, vep. e cit., 81.

ndihma nga Fondi Federal për zonat e pazhvilluara, Krahina e Kosovës ka mbetur prapa në çdo aspekt (përveç lindshmërisë fenomenale!).⁵³⁹

Ne edhe më lart kalimthi theksuam disa prej faktorëve që kanë ndikuar në shpërthimin e demonstratave studentore të vitit 1981 në Kosovë. Por sa i përket arsyeve fundamentale se cilët ishin faktorët kryesorë që quan në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981 ka pasur dhe vazhdon të ketë mjaft kontradikta në qarqe të ndryshme shkencore.

Se a ishin faktorët e brendshëm apo faktorët e jashtëm ata të cilët quan në këto ngjarje apo ishin që të dyja si faktor kryesor. Por nëse i shikojmë me vëmendje të gjitha materialet e publikuara lirisht mund të konstatojmë se asnjëra nuk mund të përjashtohet në mënyrë kategorike. Për këtë në vazhdim do të sjellim një nga një, si faktorët e brendshëm edhe ata të jashtëm, që kanë qar deri në shpërthimin e këtyre demonstratave që me të drejtë shumë historianë i kanë cilësuar si fillimin e fundit të Jugosllavisë.

Pse pas protestës fillestare të 11 marsit parullat filluan të jenë më të artikuluar politikisht, këto parulla kishin elemente nacionaliste dhe irredentiste, si: *“Kosova Republikë!”*, *“Ne jemi shqiptarë nuk jemi jugosllavë!”* *“Duam bashkim më Shqipërinë!”* *“ Rroftë Enver Hoxha!”* Shumica e vëzhguesve të huaj në atë kohë kishin konstatuar se kishte fare pak entuziazëm për Shqipërinë e Enver Hoxhës në Kosovë, ndërsa shumica e protestuesve më vonë do të insistojnë se parullat në favor të Enver Hoxhës dhe të marksizëm –leninizmit, ishin brohoritur nga agjentët provokatorë, të cilët punonin për sigurimin shtetëror jugosllav.⁵⁴⁰

Për t’i kuptuar trazirat e vitit 1981 në Kosovë, është e nevojshme që ato të shikohen në kontekstin e situatës së mjerueshme ekonomike të Jugosllavisë, në Kosovë, si dhe në kontekstin e përpjekjeve kosovare që zgjatën për disa dekada për njohjen si komb në njërin anën dhe në anën tjetër në kontekstin e politikës represive e diskriminuese të Serbisë, kundër shqiptarëve të Kosovës, që zgjati deri më 1999, caku i të cilës ishte *“eliminimi përfundimtar”* i shqiptarëve, si *“faktori më i madh pengues”* i idesë serbomadhe.⁵⁴¹

⁵³⁹ Gazeta “Rilindja”, vep. e cit., 81.

⁵⁴⁰ Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 351.

⁵⁴¹ Arben Hajrullahu, vep. e cit.,fq. 65.

Në aspektin ekonomik ish-Jugosllavia kishte dallime të mëdha rajonale, veçanërisht ndërmjet veriut relativisht të zhvilluar dhe pjesëve tjera shumë të prapambetura të vendit.⁵⁴² Për këtë statistikë tregojnë që nga mesi i viteve 1970, popullata sllovene ishte tashmë shtatë herë më e pasur se kosovarët.⁵⁴³

Problemet serioze ekonomike dhe shoqërore nuk u shqyrtuan asnjëherë në mënyrë serioze, statistikë për nivelin e lartë të investimeve nga fondet federative në Kosovë ishin përmendur vazhdimisht, por ishte përhapur mendimi se objektivat kryesore të këtyre fondeve ishin industria primare, prodhimet e së cilës (metalet, prodhimet kimike dhe rryma elektrike) në atë kohë, po furnizonin me çmime shumë të ulëta dhe artificiale industrinë përpunuese të pjesëve tjera të Jugosllavisë.⁵⁴⁴ Kur dihej që shumë uzina jugosllave të mirënjohura në Evropë dhe më gjerë lëndën e parë e merrnin pikërisht nga Kosova. Verërat e Kosovës të prodhuara nga verërat e mrekullueshme të Rrafshit të Dukagjinit ambalazhohej dhe nxirrej në tregun gjerman “Slovin” nga Sllovenia. Të gjitha prodhimet që kishin për bazë, plumbin, zinkun merreshin nga Trepça.⁵⁴⁵

Shkalla e papunësisë në Kosovë ishte më e larta në tërë vendin. Zyrtarisht si të papunë ishin paraqitur vetëm 67.000 veta, por analistët vlerësonin se numri i të papunëve ishte 250.000 veta. Në një popullatë me 1.500.000 banorë, vetëm 178.000 ishin të punësuar në të gjitha llojet e ndërmarrjeve shoqërore, (shërbimet publike, shkolla, spitale, fabrika etj.) dhe ende ekzistonte një pabarazi e konsiderueshme etnike. Serbët dhe malazezët, të cilët përbënin vetëm 15% të popullatës, kishin 30% të vendeve të punës.⁵⁴⁶

Në federatën jugosllave, në krahasim me republikat tjera, Kosova gjithmonë paraqiste një territor të prapambetur. Kjo diskrepancë në zhvillim, midis Kosovës dhe përbërësve të tjerë të federatës, mund të paraqitet si vijon: më 1973 p.sh. të hyrat për frymë banori në Kosovë sipas burimeve zyrtare jugosllave arrinin 500 dollarë amerikanë, ndërsa në Slloveni arrinin 3000 dollarë amerikanë, që paraqiste pra një raport prej 6:1. Më 1947 Jugosllavia në krahasim me

⁵⁴² Uolltër Lakër, Vep e cit, fq,436. Krahaso Craig Nation, WAR IN THE BALKANS, 1991-2002, August, 2003, fq. 223-224, fq. 224.

⁵⁴³ Marie-Janine Calic, *A History of Yugoslavia*, Translated by Dona Geyer, Printed in the United States of America,2019,fq, 241.

⁵⁴⁴ Noel Malcolm, vep. e cit., fq. 351.

⁵⁴⁵ A.Vllasi, vep. e cit., fq. 241.

⁵⁴⁶ Po aty. Ky është një indikator se gjendje ekonomike dhe sociale nuk ishte aspak e mirë në krahasim si e paraqiteshin jugosllavët.

Kosovën gjendej në një shkallë dyfish më të lartë të zhvillimit, kurse relacioni në vitin 1980 ishte 4:1.⁵⁴⁷

E kur dihet se Kosova kishte mjaft resurse nëntokësore dhe mbitokësore, që të ketë një zhvillim normal, politikani Arben Hajrullahu në moszhvillimin ekonomik të Kosovës nën Jugosllavi, duke iu referuar Kraharit, J. Reuter, faktorë kryesorë të prapambetjes ekonomike të Kosovës i përmend këto arsye: “*U investua tepër pak; U investua në pikat e gabuara; U krijuan po ashtu tepër pak vende të punës; Rritja ekonomike qëndronte në një disproporcion të qartë me rritjen e popullsisë*”.⁵⁴⁸

Për këtë Hajrullahu sjell edhe një dëshmi tjetër: “*Më 1957 fillojnë investimet për eksploatimin e rezervave të pasura të qymyrit në pellgun e Kosovës. [...] Paralelisht me këtë zgjerim të nxjerrjes së qymyrit u ndërtuan 5 termocentrale. Këto termocentrale me vetëm një të tretën e prodhimit të tyre mbulojnë nevojën e tërësishme energjetike të Kosovës, dy të tretat e energjisë së prodhuar u furnizoheshin republikat të tjera*”.⁵⁴⁹ Konsumuesit kryesorë ishin Serbia dhe Maqedonia.

Po ashtu gjendja kulturore-arsimore nuk mund të krahasohej me asnjë republikë. Llogaritej si rajoni më i prapambetur në Jugosllavi. Mjafton të përmendet fakti se në vitin 1971 analfabetizmi në Kosovë ishte 34,9 % , në një kohë kur në federatë ishte 15,1% .⁵⁵⁰

Nëse këto shifra nuk janë një ndër faktorët që kanë mundur të ndikojnë në shpërthimin e demonstratave, së paku kanë mundur të përdoren nga organizatorët e demonstratave si argumente në organizimin dhe motivimin e njerëzve për demonstrata. Po ka indikacione të argumentuara, se në një farë forme, arsimit në Kosovë ka qenë deri diku i kontrolluar, sidomos në aspektin e formimit kombëtar të shqiptarëve. Apo më mirë të thuhet është tentuar të kontrollohet. Një argument për këtë është edhe ky se, pas suprimimit të autonomisë së Kosovës më 1989, veprimi i parë ka qenë largimi me dhunë nga objektet shkollore të nxënësve shqiptarë.⁵⁵¹

⁵⁴⁷ Arben Hajrullahu, vep. e cit., fq. 67.

⁵⁴⁸ Po aty, fq. 68.

⁵⁴⁹ Po aty.

⁵⁵⁰ Shaban Braha, Vep e cit, fq. 510.

⁵⁵¹ Shih më gjerësisht: Denisa Kostovicova, Kosovo The politics of identity and space, LONDON AND New York, 2005. Marrë në :

<http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.461.1605&rep=rep1&type=pdf>, më 12.12.2018.

Azem Vllasi⁵⁵² në librin e tij “Kosova një fillim që nuk harrohet” mundohet që të argumentojë të kundërtën e asaj që theksuam më lart për gjendjen ekonomike në Kosovë para shpërthimit të demonstratave studentore 1981. Vllasi për gjendjen ekonomike thekson: “Në fund të viteve të 70-ta gjendja ekonomike nuk ishte aq e mirë por jo edhe aq sa të shpërthenin demonstratat pas vdekjes së Titos”. Dhe në vazhdim nëpërmjet një procesi normal, pa tronditje dramatike, mund të pritëshin ndryshime pozitive dhe progres në Kosovë.⁵⁵³ Por Vllasi bie në kundërshtim me vetveten, kur shpjegon strukturat e të punësuarve në të gjithë sektorët për fillimin e viteve 80-ta, vet e pranon se strukturat e të punësuarve ende nuk ishin në proporcion me përqindjen e popullsisë. Kur e shpjegon këtë gjendje ai si faktor përmend shkollimin e vonuar të shqiptarëve, por edhe politikat diskriminuese ndaj shqiptarëve.⁵⁵⁴

Pra, diskriminimi politik të gjithë e dimë se ka qar shpesh në shpërthimin e pakënaqësive të ndryshme në shumë vende të botës. Duke pasur parasysh se shumica e organizatorëve të demonstratave ishin të rinj. Nuk mund të mos përmendet edhe një fakt tjetër që ka pasur ndikim.

Ngritja e vetëdijes kombëtare e cila kishte ardhur si rezultat i ngritjes arsimore të shqiptarëve të Kosovës, në këtë ngritje të vetëdijes kombëtare patën ndikim të madh, këmbimet arsimore dhe kulturore midis Republikës Socialiste të Shqipërisë dhe Kosovës, përmes propagandës politike, literaturës politike, historike, letërsisë dhe artit shqiptar në përgjithësi, nga Radio Televizioni Shqiptar dhe shtypi shqiptar që në forma të ndryshme depërtonte nga Shqipëria.⁵⁵⁵

Po ashtu nuk qëndron edhe ajo që Oliver Schmitt sjell si argument se “*shkaku më i thellë i trazirave ishte modernizimi i shpejtë dhe i papërfunduar.*”⁵⁵⁶ Së paku unë nuk kam hasur askund që modernizimi i shpejtë dhe i papërfunduar të jetë shkaktari kryesor në shpërthimin e demonstratave të përmasave çfarë ishin demonstratat e vitit 1981. Kjo nuk është as e argumentuar, por edhe logjikisht nuk qëndron sepse këto protesta filluan në qendrën studentore dhe organizatorët ishin pikërisht studentët dhe nuk janë organizuar në ato zona që nuk paska arritur modernizimi.

⁵⁵² Ish funksionar i lartë në ish- Jugosllavi thuj për dy dekada.

⁵⁵³ Azem Vllasi, vep. e cit., fq. 239.

⁵⁵⁴ Po aty, fq. 240.

⁵⁵⁵ Jakup Krasniqi, *Shtypi Shqiptar për zhvillimet në Kosovë 1981-1991*, (Disertacion i Doktoratës, në dorëshkrim), Prishtinë, 2008, fq. 27. në <http://fxm.uni-pr.edu/Punimet-e-Doktoratures/Filozofiku.aspx>; Qasur më 20.01.2018.

⁵⁵⁶ Oliver Schmitt, vep. e cit., fq. 232. Shih edhe Jakup Krasniqi, *Një histori e kontestuar*, Prishtinë, 2013, fq. 84.

Pra, demonstratat e vitit 1981 nuk kanë fare lidhje me modernizim të shpejtë apo mospërfundim të modernizimit, faktorët janë krejt tjerë. Pra, është fakt i pakontestueshëm së ndër faktorët kryesorë në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981 ishin faktorët politikë, ekonomikë dhe socialë. Sepse Kosova vazhdoi të mbetet vendi më e pazhvilluar në Jugosllavi. Kjo prapambetje ishte burim tensionesh midis popullsive etnike.⁵⁵⁷ Asnjëherë duke mos përjashtuar faktorët tjerë, ketë rast as të jashtëm.

Për këtë na dëshmon edhe Stefan Kuks, i cili në evidentimin e shkaqeve të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë numëron disa faktorë: “*ekonomik, social, politik, demografik, psikologjik dhe ndërkombëtar*”.⁵⁵⁸

Për mendimin tim, Shaban Braha është një ndër ata autorë mjaft argumentues për shkaqet që kanë qar në shpërthimin e demonstratave, i cili vinte në dukje: “*Pakënaqësia ishte pakënaqësi kombëtare. Shqiptarët në Jugosllavi, të cilët jetojnë kryesisht në Kosovë, në një krahinë autonome të Serbisë, tani duan të kenë një republikë më vete me statusin e republikave të tjera. Në Jugosllavi më shumë jetojnë shqiptarë se sa malazezë, megjithatë malazezët kanë republikë më vete, ndërsa shqiptarët e Kosovës jo. Unë mendoj se kjo ka qenë më të vërtetë kërkesa kryesore në të gjitha revoltat dhe demonstratat. Kësaj i shtohet edhe kërkesa ekonomike*”.⁵⁵⁹

Një argument tjetër është edhe kjo se papunësia në Kosovë shkonte çdo vit duke u rritur ku arriti në 36.3 % deri në vitin 1987, kundrejt një mesatare jugosllave 14.2 për qind.⁵⁶⁰ Pra një disproporcion i thellë në baza etnike ka ekzistuar sa i përket punësimit edhe pas vitit 1974.

Vlen për të theksuar se udhëheqësit jugosllavë në të njëjtën kohë kur kanë akuzuar Shqipërinë për implikimin e saj direkt në demonstratat e 81-shit, ata akuzuan edhe Bashkimin Sovjetik indirekt, por jo me të njëjtin ton sikur Tiranën zyrtare. Këtë e bënë kur në deklarata publike akuzonin se “këto demonstrata janë nxitur nga nacionalistët, irredentistët dhe informbyroistët”.

Për implikimin, apo më mirë të themi për ndikimin, Moskës në demonstratat është diskutuar edhe në qarqe diplomatike të kohës.

⁵⁵⁷ Jaseminka Udovučki, vep. e cit., fq. 76.

⁵⁵⁸ Sylë Ukshini, vep. e cit., fq. 68.

⁵⁵⁹ Shaban Braha, vep. e cit., fq. 508.

⁵⁶⁰ Howard Clark, vep. e cit., fq. 14.

Sipas një artikulli në *Interntional Herald Tribuna* nga CC. L. Sulzberg thuhet se: “ *Greqia ka informacion të saktë se revolta e pakicës shqiptare të Jugosllavisë në zonën e Kosovës është stimuluar nga Moska dhe ishte shumë më serioze se sa kuptohej në përgjithësi jashtë vendit*”.⁵⁶¹

Një nga argumentet që paraqet për këtë Athina për demonstratat e vitit 1981 janë parullat e përdorura nga demonstruesit, të cilat ishin pro sovjetike dhe jo pro Enver Hoxhës⁵⁶² Konkluzioni i nxjerrë këtu është se Bashkimi Sovjetik po teston Jugosllavinë e pas epokës së Titos, për të parë se çfarë orientimi politik do të marrë.⁵⁶³ Nëse shikohet me vëmendje krejt kjo vërehet qartë se Athina zyrtare më shumë ka frikë se sa që mund të qëndronte argumenti se Moska ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në demonstratat e vitit 1981. Për mosqëndrimin e konstatimeve greke është edhe një fakt tjetër. Greqia kishte edhe një marrëveshje me Jugosllavinë, që nga koha e Titos, që ta ndihmojë në transportin e armëve të SHBA-së, në rast të ndonjë shqetësimi të drejtpërdrejt sovjetik.⁵⁶⁴

Por derisa nuk kemi qasje në dokumente të proveniencës sovjetike të kësaj periudhe nuk mund të merret për bazë vetëm shqetësimet greke si argument që Moska ka pasur ndikim në këto demonstrata. Ajo që mund të thuhet është fakti se rusët ishin duke vëzhguar me vëmendje gjendjen në Kosovë nga distanca.

Interesi afatgjatë i rusëve në këtë rast ishte që të ruajnë marrëdhëniet korrekte me Jugosllavinë, së paku deri kur mosmarrëveshjet të fillojnë të shfaqen në radhët e udhëheqjes jugosllave mbi mënyrën se si do të zgjidhen problemet e vendit.⁵⁶⁵ Nëse shihet më gjerësisht politika ndërkombëtare, Moska nuk ka pasur asnjë interes që të ndërhynte në çështjen e Kosovës. Edhe pse jugosllavët në fillim kishin pasur disa dyshime në involvimin e Moskës. Sepse në fillim të trazirave jugosllavët kur akuzuan informbyroistët aludonin të Moska zyrtare. Por kjo akuzë nuk u mbështet asnjëherë seriozisht dhe gradualisht është heshtur. Kjo dëshmon se jugosllavët nuk kishin asnjë të dhënë serioze për ndërhyrjen e sovjetikëve.⁵⁶⁶

Sa i përket asaj se vet jugosllavët, apo më konkretisht serbët janë nxitësit e demonstratave të vitit 1981, një gjë e tillë nuk është vërtetuar dhe nuk mund të vërtetohet derisa të hapën arkivat serbe, por nuk duhet të hidhet poshtë për dy arsye:

⁵⁶¹ S.Syla, H. Kaba, vep. e cit., fq. 162.

⁵⁶² Po aty.

⁵⁶³ Po aty.

⁵⁶⁴ Po aty.

⁵⁶⁵ Po aty, fq. 165.

⁵⁶⁶ Po aty, fq. 172.

1. Nëse shikojmë në aspektin se kujt i kanë konvnuar më shumë këto trazira, pas shqiptarëve të Kosovës janë serbët ata që iu kanë konvnuar për arsye që kërkonin një shkas për të implementuar politikat e tyre;⁵⁶⁷

2. Për të argumentuar një gjë të tillë na duhet të bëjmë një digresion. Tri ngjarje që kanë ndodhur nga viti 1981 deri në luftën e vitit 1998 dëshmon se deri ku kanë mundur të shkojnë qarqet nacionaliste serbe. Si djegia e Patrikanës Ortodokse serbe në Pejë, ku janë munduar qarqet serbe që fajin t'ua hedhin organizatorëve të demonstratave. Por më vonë më 27 maj të vitit 1981, Prokuroria Publike bëri të ditur se janë kryer të gjitha hetimet zyrtare dhe se deri te zjarri ka ardhur si rezultat i një qarku të shkurtër që rezultoi nga instalimi i keq i rrymës elektrike dhe izolime të pamjaftueshme.⁵⁶⁸

“Rasti Martinoviç” që u shndërrua në një skandal kombëtar serb, në saje të shkrimeve dhe fushatës gazetareske të revistës beogradase “NIN”.⁵⁶⁹ Gjergj Martinoviçi ishte një serb 56 vjeçar nga një fshat i rrethit të Gjilanit, i cili gjoja kishte pasur një sulm jashtëzakonisht të pakëndshëm dhe poshtërues, kinse e kishin rrahur dy shqiptarë dhe këta të fundit e kishin dhunuar seksualisht.⁵⁷⁰

Serbët këtë e përdoren si një mjet se shqiptaret e Kosovës janë duke përdorur dhunë ndaj serbëve që këta të fundit të shpërnguleshin nga Kosova. Krejt kjo është vërtetuar më vonë se kjo ka qenë një orkestrim serb.

Rasti “Panda” më 14 dhjetor 1998, në qytetin e Pejës, ku u vranë shumë disa të rinj serb në kafeterinë "Panda" në mesin e tyre edhe fëmijë. Kjo u përdor si zakonisht shumë nga mediet serbe dhe u bë lajm në të gjitha mediumet me të njohura botërore. Krejt më vonë është vërtetuar se këtë orkestrim e kanë bërë vet serbët.

Por, në interes të kujt ishte kjo që ndodhi, kuptohet në interes të serbëve.⁵⁷¹ Krejt kjo dhunë e paparë që tronditi gjithë opinionin e asaj kohe 15 vite më vonë është vërtetuar se prapa kësaj masakre ishte shteti serb.⁵⁷²

⁵⁶⁷ Një gjë të tillë, është thënë çdo herë edhe gjatë kohës së Titos, se Kosova është pika nevralgjike e Jugosllavisë sa i përket fillimit të trazirave. Për këtë fakt serbët ishin shumë të vetdijshëm se mundësia më e mirë ishte Kosova. Kjo dëshmon se kishte disa vite që serbët kishin filluar të proklamnin “eksodin” e serbëve nga Kosova për në Serbi.

⁵⁶⁸ S.Syla. H.Kaba, vep. e cit., fq. 177.

⁵⁶⁹ Noel Malcilm, vep. e cit., fq. 352.

⁵⁷⁰ Po aty.

⁵⁷¹ Bardhyl Mahmuti, Mashtrimi i Madh, Shkup, 2015, fq. 53-54.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, nuk përjashtohet mundësia se edhe nëse nuk kanë ndikuar qarqe të ndryshme serbët së paku nuk i kanë penguar sepse iu ka konvnuar, duke mos menduar se do jenë pikërisht këto demonstrata që do të jetë fillimi i fundit të Jugosllavisë.

Është interesant fakti se ideja që kanë pasur dorë serbet në organizimin e demonstratave të vitit 1981, nuk e pranojnë as serbët as shqiptarët (sidomos ish organizatorët e këtyre demonstratave).⁵⁷³

3.3 Jehona e demonstratave të vitit 1981 në arenën ndërkombëtare

Është fakt i pamohueshëm, se demonstratat e vitit 1981 në Kosovë kanë pasur një jehonë shumë të madhe, në të gjithë arenën ndërkombëtare. Të gjitha mediet më të rëndësishme të kohës kanë shkruar për këto demonstrata. Të gjitha shtetet që sado pak kanë pasur interes për politikën ndërkombëtare janë interesuar për këto demonstrata dhe kanë tentuar që të marrin informata sa më të sakta në forma të ndryshme.

Kishte shumë artikuj në mediumet botërore që kanë trajtuar demonstratat e vitit 1981. Artikujt kanë pasur jehonë të madhe në botë, të cilat ishin vlerësuar me pasazhe e komente pozitive, qoftë nga shtypi a diplomatë të ndryshëm ndërkombëtarë. Kuptohet që krahas vlerësimeve të tilla, kishte pasur edhe vlerësime tejet denigruese për këtë ngjarje. Por një ndër çështjet, e cila i interesonte opinionit ndërkombëtar, ishte fakti se nëse në ngjarjet në Kosovë kishte dorë Shqipërie.⁵⁷⁴

Ky interesim vjen për disa arsye: arsyeja e parë, se po zhvilloheshin në një vend të bllokut socialist i cili kishte reflektuar një stabilitet politiko –ekonomik që disa dekada; arsyeja e dytë, se bota ishte në fazën e fundit të luftës së ftohtë dhe nuk dihej se si do përfundonte; arsyeja e tretë, Ballkani veçanërisht Jugosllavia çdoherë ka qenë një zonë interesi për fuqitë e mëdha gjatë gjithë shekullit XX, si edhe për shumë arsye tjera.

Vende të ndryshme evropiane dhe botërore, në qëndrimet e tyre të mbajtura kishin opinione të ndara, nëse demonstratat e vitit 1981 në Kosovë ishin të organizuara nga

⁵⁷² <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ja-si-e-kamufloi-serbiavrasjen-e-te-rinjve-serbe-ne-lokalin-panda-ne-peje-dokument-151696/?archive=1>, mar më 16.01.2018.

⁵⁷³ Serbët nuk donin të fajësoheshin si iniciues të rrëzimit të ish-Jugosllavisë, kurse shqiptarët nuk mund të pranojnë se për një ngjarje kaq të madhe dhe me ndikim për shqiptarët të kishin dorë edhe serbët.

⁵⁷⁴ Sabit Sylja, Shteti Shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981, Vep e cit,fq,313-314

Shqipëria.⁵⁷⁵ Kësisoj, u shkruan shumë artikuj, dhanë mendime diplomatë të ndryshëm ndërkombëtarë për demonstratat në Kosovë përveç Shqipërisë, kanë mbështetur teza të ndryshmet rreth organizimit të demonstratave, faktori i brendshëm në Kosovë, nga Beogradi, Bashkimi Sovjetik, Perëndimi, etj..⁵⁷⁶

E gjithë kjo çon në konkludimin e qartë se demonstratat kanë pasur mjaft jehonë në arenën ndërkombëtare, për shkak të efektit që patën në ish-Jugosllavi. Për shtypin botëror një interesim shumë të madh ka shfaqur edhe shteti shqiptar, për këtë dëshmon një raport i Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, dërguar Komitetit Qendror të Partisë. Ku raportohet në detaje për trajtimin i e demonstratave të vitit 1981 në shtypin ndërkombëtar si dhe jehonën e artikullit të “Zërit të Popullit” të 8 prillit 1981.⁵⁷⁷ Ne do të trajtojmë të gjitha ato shtete që kanë shfaqur interesim për këto demonstrata, kuptohet ato shtete që kanë pasur peshë në politikën ndërkombëtare.

Reagime për demonstratat studentore të 11 marsit, e 26 marsit të vitit 1981 ka pasur menjëherë në të gjitha vendet e botës por, pas reagimit të shtetit shqiptar, më 8 prill të vitit 1981, në gazetën “ Zëri i Popullit” mediet botërore i dhanë jehonë edhe më shumë këtyre ngjarjeve.

Shtypi grek i ka pasqyruar gjerësisht ngjarjet në Kosovë. Gazetat e mëdha, si “Akropolis”, “Athens Njuz”, e të tjera kanë botuar shkrime për zhvillimin e ngjarjeve, për qëndrimin jugosllav ndaj tyre dhe janë shmangur komenteve rreth këtyre ngjarjeve, por ka botuar pjesë të shtypit jugosllav edhe të artikullit të “ Zëri i Popullit”.⁵⁷⁸

Por që vlen të ceket një gazetë greke e quajtur “TOVINA” e cila shkruan mjaft interesant për ngjarjet në Kosovë të vitit 1981, e cila shkruan: “ *Nuk duhet të pakësojmë rëndësinë e ngjarjeve që po ndodhin prej shumë javësh në rajonin autonom të Kosovës, në kufi më Shqipërinë edhe në qoftë se kriza mbytet. Pasqyrim të gjerë në shtypin grek pati intervista e Dollancit, sidomos ato pjesë që theksonin se ‘demonstratat janë organizuar në mënyrë të fshehtë nga një grusht njerëzish tradhtarë, të cilët synojnë të vënë në rrezik sistemin socialist vetë-administrues jugosllav, gjithashtu citohen fjalët e Dollancit’ se nuk beson se Shqipëria ka dorë në këto ngjarje*”.⁵⁷⁹

⁵⁷⁵ Po aty.

⁵⁷⁶ Po aty.

⁵⁷⁷ AQSh, Fondi:14, viti 16 prill 1981, dosja 28, fq. 17.

⁵⁷⁸ AQSH, Fondi: 14, viti 16 prill 1981, dosja 28, fq. 18-19.

⁵⁷⁹ Po aty.

Por, edhe për artikullin e “ Zërit të Popullit” të 8 prillit 1981, u shkruan mbi 100 artikuj dhe komente të ndryshme në të gjithë shtypin grek të asaj kohe. Nga shkrimet e botuara shohim se në shtypin grek bëhet një diferencim në qëndrimin ndaj artikullit të “Zërit të Popullit”⁵⁸⁰

Shumica e shtypit proqeveritar si dhe ato të së djathtës si “ *Akropolis*”, “*Vradhini*”, “*Kathemerini*”, “*Eleftheros Kozmos*”, “*Estia*” etj.. Artikullin e gazetë “Zërit i Popullit” e konsiderojnë si një artikull provokues dhe që minon, vë në rrezik marrëdhëniet greko-shqiptare.⁵⁸¹ Ndërsa gazetatat tjera liberale si “*Eleftherotipia*”, “*Ta Nea*”, “*To Vima*” etj., kanë mbajtur një qëndrim më të rezervuar në artikujt dhe komentet e tyre⁵⁸².

Kjo dëshmon se shteti grek edhe pse ishte mjaft i kujdesshëm, grekët e dinë mjaft mirë se ku mund të dërgojnë këto trazira që kishin shpërthyer në Kosovë. Për shfaqjen e një interesimi të madh të shtetit grek dëshmon edhe interesimi i ambasadorit grek në Tiranë, Konstandin Politis, i cili më 24 prill kërkon nga shteti shqiptar informacione të dorës së parë dhe qëndrimin zyrtar për ngjarjet në Kosovë.⁵⁸³

Pra shteti grek ishte mjaft i kujdesshëm në raport me këto ngjarje për disa arsye. Së pari në këtë kohë dy shtetet si Jugosllavinë edhe Shqipërinë i kishte shtete fqinje. Pastaj dihej se shteti turk mbante një qëndrim më pro Shqipërisë. Pastaj ajo edhe pse kishte një lidhje të thellë me shtetet sllave-ortodokse, megjithatë bënte pjesë në sferën perëndimore.⁵⁸⁴

Po ashtu një vëmendje shumë të madhe për demonstratat e vitit 1981 ka shfaqur edhe Turqia, që arsye për një interesim të tillë besoj se është komuniteti mjaft i madh shqiptar në këtë shtet. Gjatë prillit 1981 shtypi turk i ka kushtuar një vëmendje të veçantë problemit të Kosovës dhe situatës së krijuar nga këto ngjarje në Jugosllavi. Tema e Kosovës ka qenë një temë prezente gjatë kësaj kohe në faqet e shtypit turk dhe ato thuajse çdo ditë kanë botuar lajme, komente e artikuj për këtë problem. Thuajse nuk ka mbetur asnjë gazetë turke që nuk ka shkruar për problemin e Kosovës.

Shifrat janë marramendëse të shkrimeve në muajt prill, maj dhe qershor.⁵⁸⁵ Ajo që vlen të theksohet është fakti që nga sasia e shkrimeve të botuara vetëm 20 përqind janë refleksi i versioneve jugosllave dhënë sipas "Tanjug"-ut. Pjesa tjetër janë reportazhet e korrespondentëve

⁵⁸⁰ Po aty, fq. 192.

⁵⁸¹ Po aty.

⁵⁸² Po aty, fq. 193.

⁵⁸³ Jakup Krasniqi, vep. e cit., fq. 56.

⁵⁸⁴ Pra siç thuhet shpesh për Greqinë se “ është gruaja e lindjes e dashnorja e perëndimit” edhe këtë rast ka mbajtur qëndrim thuajse duke u nisur nga ky prizëm.

⁵⁸⁵ Sabit Sylja, Dokumente diplomatike, Prishtinë, 2012, fq. 91.

turq që shkuan në Jugosllavi ditët e para të prillit.⁵⁸⁶ Nga jo që është parë gjatë gjithë kësaj kohe, shtypi turk ka mbajtur në shumicën rasteve pozicion neutral. Por, përmes kanaleve diplomatike kishte shfaqur një qëndrim krejt tjetër dhe kishte kërkuar mjaft informata nga shteti shqiptar për gjendjen në Kosovë.⁵⁸⁷

Po aq sa Greqia dhe Turqia edhe Italia nuk ka qenë hiç më pak indiferente ndaj demonstratave studentore që shpërthyen në Kosovë. Italia çdoherë gjatë gjithë historisë ka shfaqur interesim për këndej Adriatikut. Po ashtu edhe siç dihet Italia ka pasur disa mosmarrëveshje me Jugosllavinë e Titos për Trieshtën. Prandaj edhe ka përcjellë me vëmendje trazirat që shpërthyen në Kosovë. Shtypi italian u ka bërë jehonë relativisht të gjerë ngjarjeve në Kosovë. Kanë botuar njoftime me tituj të tillë si: “*Në Kosovën jugosllave incidente dhe të plagosur*”, “*Ashpërsohen protestat e shqiptarëve*”, “*Ushtria dhe tanket nëpër rrugët e Kosovës përpiqen të shtypin revoltën*”, “*Ndalohen manifestimet në Kosovë*”, etj..⁵⁸⁸ Çka ia vlen të theksohet se shtypi italian paraqet gjendjen në Kosovë mjaft në mënyrë reale. Shtypi italian në njoftimet e tij ka vënë në dukje gjendjen e rëndë ekonomike të Kosovës, prapambetjen e saj në krahasim më atë të pjesëve tjera të Jugosllavisë, Por po ashtu paraqet edhe kërkesën e demonstruesve për bashkim më Shqipërinë.⁵⁸⁹ Por, ajo që më ka befasuar gjatë gjithë shfletimit të këtyre dokumenteve arkivore, për shtypin italian, konkretisht më 13 prill 1981 televizioni italian paraqet tre variante të organizimit të demonstratave në Kosovë.

Varianti i parë i mundshëm ishte nga ana e Shqipërisë;

Varianti i dytë ishte nga ana e BS-së;

Varianti i tretë ishte faktori i brendshëm në Kosovë.⁵⁹⁰

Një vend që edhe gjatë gjithë kohës sa ka qenë Ballkani i pushtuar nga Perandoria Osmane, ka pasur interesim dhe deri diku edhe ndikim mbi Ballkanin, konkretisht për zonën shqiptare, sidomos dyqind vjetët e fundit ka pasur një ndikim dhe interesim të vazhdueshëm pra është fjala për Austrinë.⁵⁹¹

Vjena zyrtare as kësaj radhe nuk ka qëndruar indiferente por ka ndjekur me një interesim mjaft të madh ngjarjet në Kosovë gjatë gjithë vitit 1981. Pra Vjena zyrtare kishte përcjellë me një vëmendje dhe nga afër demonstratat e vitit 1981.⁵⁹² Nga ajo që ne mësojmë për opinionin dhe qëndrimin e shtetit austriak janë dokumentet e ambasadës së Shqipërisë në Vjenë,

⁵⁸⁶ Po aty.

⁵⁸⁷ Po aty, fq. 92.

⁵⁸⁸ AQSH, Fondi: 14, viti 16 prill 1981, dosja 28, fq. 20-21.

⁵⁸⁹ Po aty.

⁵⁹⁰ Po aty, fq. 22.

⁵⁹¹ Shih: Stavro Skendi, Zgjimi Kombëtar Shqiptar 1878-1912, Tiranë, 200.

⁵⁹² Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 89.

të botuara nga Sabit Sylja, si dhe nga dokumentet e shtypit austriak të studiuara dhe publikuara nga Eqerem Zenelaj. Në bazë të këtyre dokumenteve të sjellura nga studuesit e lartcekur del se është mirëpritur nga opinioni i shtetit austriak për qëndrimin e shtetit shqiptar, për demonstratat e vitit 1981 të shfaqur në “Zëri i Popullit”. Këtë qëndrim thuajse e kishin shumica e ambasadorëve të shtetit austriak që ishin të vendosur në rajonin e Ballkanit.⁵⁹³ Jo vetëm Austria, por të gjitha shtetet gjermanofolëse kanë pasur një qëndrim mjaft korrekt për ngjarjet në Kosovë, bile gazeta e famshme gjermane “*Frankfurter Allgemeine Zeitung*” më 9 prill 1981, demaskon mjaft interesant shtetin jugosllav ku me një shkrim në mes tjerash thekson: “*Kur ju vjen uji deri në fyt, diktaturat fashite të Amerikës Latine dhe vetadministrimi jugosllav reagojnë siç duket në mënyrë bukur të ngjashme. Gjëja e parë që bëjnë, është fajësimi armikut të jashtëm*”.⁵⁹⁴

Qarqe të ndryshme në shtetet perëndimore e dinin mirë se demonstratat kishin ardhur kryesisht si rezultat i faktorit të brendshëm dhe po ashtu e dinin se organet e rendit të shtetit jugosllav do të silleshin ndaj demonstruesve në të njëjtën formë, si vendet jodemokratike dhe diktatoriale.

Pothuajse të gjitha vendet e Evropës u morën me shpërthimin e demonstratave studentore në Kosovë. Duke mos u ndal në secilin shtet veç e veç për shkak të mosrelevancës në politikën ndërkombëtare, si Zvicra, Irlanda, Portugalia, Danimarka, Suedia, RFGJ-ja, Belgjika, Rumania, Bullgaria etj..⁵⁹⁵

Ne do t'i paraqesim vetëm qëndrimin e atyre shteteve që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në politikën ndërkombëtare.

Franca është njëra ndër ato shtete që ka pasur dhe ka ndikim në politikën ndërkombëtare. Për ngjarjet në Kosovë dhe gjendjen e krijuar kanë shkruar mbi 50 gazeta dhe revista të ndryshme, qendrore dhe krahinore franceze.

Gazetat më të njohura franceze kanë shkruar si: “Le Mond”, “Le Figaro”, etj..⁵⁹⁶ Ajo që vlen të theksohet që në krye të herës është fakti se shtypi francez ishte mjaft i kujdesshëm dhe objektiv, këtë po e cekim për faktin se Franca është konsideruar si një aleat i ish-Jugosllavisë. Shtypi francez e cilëson Kosovën si krahinë më të varfër në Jugosllavi, megjithëse kjo krahinë është më shumë e pasur me burime minerale, energjetike, me toka mjaft pjellore.

⁵⁹³ Sabit Sylja, Dokumente diplomatike...vep. e cit., fq. 118. Shih edhe Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 103-105.

⁵⁹⁴ Jakup Krasniqi, vep. e cituar, fq. 56-57.

⁵⁹⁵ Po aty, fq. 40-41.

⁵⁹⁶ Po aty, fq. 105.

Mjaft nga qarqet e shtypit arrijnë në konkluzionin se shkak kryesor i shpërthimit të demonstratave të popullsisë së Kosovës ishte gjendja e rëndë ekonomike në gjithë krahinën autonome.⁵⁹⁷ Kjo është një dëshmi më shumë rëndësi për faktin se shteti francez ishte mjaft prezent në Jugosllavi dhe kishte njohuri mjaft.

Më këto konstatime të shtypit francez binte ndesh shteti jugosllav, që ia atribuoi kryekëput faktorit të jashtëm ase sesi faktorit ekonomiko-social shpërthimin e demonstratave si dhe atyre që mbrojnë këto argumente jugosllave.

Autorët e shkrimeve i cilësonin ngjarjet në Kosovë si krizën më të rëndë, pas vdekjes së Titos. Por duhet theksuar edhe një fakt tjetër se ata nuk e fshehin shqetësimin e madh që paraqiste problemi i Kosovës, jo vetëm për Jugosllavinë, por edhe për vet perëndimin dhe për gjithë zonën e Ballkanit.⁵⁹⁸

Kjo dëshmon më së miri ndikimin e demonstratave të vitit 1981 në të gjithë arenën ndërkombëtare. Kjo për shkak të rrethanave që ishin krijuar nga Lufta e Ftohtë, dhe çdo trazirë sado që do të jetë periferike, kishte impakt në qendër. Por, Kosova ishte edhe një rast specifik për të gjitha Fuqitë e Mëdha, sepse e dinin mjaft mirë se vet i kishin krijuar këto probleme, vendimmarrjet e tyre që nga Kongresi i Berlinit 1878, Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1913, Konferenca e Versajes 1919, Konferenca e Jaltës 1945. Për demonstratat e vitit 1981 kanë shkruar edhe vende që nuk kishin kurrfarë lidhje me Kosovën, siç ishte Kina, India, Egjipti etj..

Anglia gjatë gjithë shekullit XX ka pasur një qasje në Ballkan, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, kur Jugosllavia i prishi marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik. Ne kemi theksuar edhe në kapitullin e parë të këtij punimi, se Titoja edhe kur kishte marrëdhënie të mira diplomatike me Stalinin, në të njëjtën kohë ruante raporte të shkëlqyera edhe me Çerçillin. Ajo që dihet mirëfilli tani është edhe fakti se Anglia kishte përcjellë me një vëmendje shumë të madhe demonstratat e vitit 1981. Këtë vëmendje të Anglisë për zhvillimet që ndodhnin në Kosovë në mars-prill të vitit 1981 na pasqyrojnë në mënyrë të shkëlqyeshme dokumentet e autentike të proveniencës angleze të sjella, të shqipëruara nga historianët Sabit Sylja dhe Hamit Kaba: “Demonstratat Kosovës e 1981 në Arkivin Kombëtar të Londrës”.

Ajo që mund të bie në sy çdo studiuesi është fakti se Anglia e dinte saktë se çfarë po ndodhte në Kosovë, por është interesant sa të sakta i kanë analizat për ndikimin që mund të kishin demonstratat e vitit 1981 në qetësinë politike të Jugosllavisë. Për këtë dëshmon një artikull i botuar më 2 tetor 1981, në gazetën prestigjioze angleze “The Economist” me titullin mjaft interesant dhe domethënës “*Fital shpërthyes në Ballkan*”; “*Vazhdoni të vëzhgoni*

⁵⁹⁷ Po aty.

⁵⁹⁸ Sabit Sylja, Dokumente diplomatike...vep. e cit., fq. 106.

*Poloninë, por gjithashtu hidhni një sy të kujdesshëm një zone të quajtur Kosovë, në pjesën tjetër fundore të Evropës komuniste. Kosova është pjesë e Jugosllavisë ku jeton pakica e saj shqiptare, në skaj të Shqipërisë. Gjatë muajve të fundit rreth 300 nga këta shqiptarë janë dënuar me burgim deri në 15 vjet për “aktivitetete kundërrevolucionare”*⁵⁹⁹

Kjo është një dëshmi se si e konsiderojnë Kosovën si një fitil dhe që ka potencial të çonte në shpërthimin e trazirave tjera në mënyrë zinxhirore në të gjithë Jugosllavinë, por edhe më gjerë në Bllokun Lindor.

Sipas këtij mediumi anglez qeveria jugosllave pretendon se janë planifikuar masa të rrepta për të mbrojtur Jugosllavinë nga “armiku” që bën “luftë të veçantë” nga qendrat jashtë vendit.⁶⁰⁰ Ky konstatim nuk është i pakuptimtë për vetë gazetën prestigjioze angleze e cila thekson: “ Kjo nuk ka kuptim. Të mërguarit jugosllavë në Perëndim, të cilët nuk e pëlqejnë qeverinë e Beogradit janë shumë të dobët dhe të përçarë për të qenë një kërcenim serioz për regjimin jugosllav, dhe nuk kanë ndihmën e qeverive perëndimore”.⁶⁰¹

Ky medium anglez përveç analizës se sa mund të kishte ndikim mërgata jugosllave e ndihmuar nga qeveritë perëndimore, ajo arrin edhe në një përfundim shumë interesant, se as Bashkimi Sovjetik nuk ka dorë në këto demonstrata për disa arsye: “ *Bashkimi Sovjetik, i cili mund të ketë interes për destabilizim të Jugosllavisë, por është shumë i zënë për momentin me Poloninë dhe Afganistanin; nuk ka të dhëna se ka organizuar trazira në Kosovë*”.⁶⁰² Nga kjo del që nga jashtë ndikimi në demonstratat e vitit 1981 për të mos e mohuar, ka qenë shumë i vogël, po më mirë të themi nuk ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë.

Pra pretendimet jugosllave se kinse demonstratat studentore të vitit 1981 kanë qenë të organizuara nga faktorë të jashtëm, nuk qëndrojnë fare, ato kanë burimin kryesor të organizimit nga studentët dhe intelektualët shqiptarë të Kosovës.

Se sa ka qenë Anglia e fokusuar në këto zhvillime që për shumë shtete kanë qenë zhvillime periferike, dëshmon raporti thuajse gati çdo ditë i ambasadës britanike në Beograd, në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit 1981.

Ne në vazhdim do të sjellim në mënyrë të perifrazuar disa prej këtyre raporteve të ambasadës britanike në Beograd, dërguar FCO-së (Foreign and Commonwealth Office). Edhe për qëndrimin e shtetit shqiptar është raportuar nga ambasada britanike në Beograd: “*Siç mund*

⁵⁹⁹ Sabit Syla, Hamit Kaba, 1981 Demonstratat e Kosovës në Arkivin Kombëtar të Londrës, Prishtinë, 2017.

⁶⁰⁰ Po aty.

⁶⁰¹ Po aty.

⁶⁰² Po aty.

të jetë pritur, Shqipëria ka kundërshtuar deklaratën e bërë nga udhëheqësit jugosllavë, të cilët ngjarjet e Kosovës ia atribuojnë kryesisht nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, dhe ka reaguar përmes një kryeartikulli kritik në gazetën “Zëri i Popullit”, i datës 8 prill...”.⁶⁰³

Po ashtu ambasada britanike ka raportuar edhe për kundërreagimin jugosllav ndaj qëndrimit të Tiranës zyrtare. Raportimi është bërë në mënyrë shumë korrekte pa ekuivoqe dhe pa ndonjë analizë shtesë për “konfrontimet” shqiptaro- jugosllave në distancë, përmes medimeve të tyre.

Edhe Bashkimi Sovjetik si një nga superfuqitë e kohës, kishte reaguar përmes gazetës së Moskës: “PRAVDA” në lidhje me demonstratat, ku jepte një informacion të shkurtër. Për këtë komentatori politik i *Radio Zagrebit*, Milika Sundiq, kishte vlerësuar me nota negative këtë reagim të Moskës zyrtare, sepse sipas tij, Moska zyrtare askund nuk iu atribuon demonstruesit me epitetin që kishin sipas tij, si: “kundërrevolucionar”, “irredentist”, “separatist”.⁶⁰⁴

Gazetari austriak i gazetës “*Kleine Zeitung*” i cili ishte marrë me këtë analizë, vinte në konkluzion: “Le të kuptohet që Moska luante me dy karta, edhe me Shqipërinë edhe me Jugosllavinë, gjë që Shqipërinë e mban si një kartë rezervë kundër Jugosllavisë”.⁶⁰⁵ Ky konstatim i gazetarit të “*Kleine Zeitung*” sipas mendimit tim është plotësisht i drejtë, sepse dihej mirëfilli që Rusia ka qenë çdoherë në përkrahje të politikave serbe në Ballkan, por kjo ka qenë ndoshta një lëvizje taktike e saj në ato rrethana.

Jehona e demonstratave studentore të vitit 1981 pati reagime edhe atje ku duhej më së shumti që të ketë, pra në ShBA. Kjo nuk ishte befasese për faktin se lobi shqiptar ishte forcuar dhe kishte filluar të kishte ndikim në agjendat politike të shtetit amerikan, si dhe Amerika veç kishte filluar të shfaqte një interesim më të madh për Ballkanin. Gjëja e parë që binte në sy në këto shkrime është jo vetëm numri relativisht i madh i artikujve që janë shkruar por dhe shtrirja e tyre në shumë organe të shtypit e sidomos trajtimi i këtyre ngjarjeve disa herë më radhë në gazetatat më të njohura në Amerikë, deri më 19 qershor.⁶⁰⁶

Shtypi amerikan nuk reagoi menjëherë pas demonstratave të filluara të marsit dhe prillit në Kosovë. Këtë qëndrim qeveria shqiptare e ka konsideruar si një veprim të menduar mirë.⁶⁰⁷ Por ajo që duhet cekur, që të jemi sa më objektiv, shtypi amerikan ka qenë në fillim goxha i ndikuar nga shtypi jugosllav. Janë disa raste kur shtypi amerikan ka qenë keqinformuar

⁶⁰³ Po aty, fq. 65.

⁶⁰⁴ Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 102.

⁶⁰⁵ Po aty.

⁶⁰⁶ AQSh, Fondi: Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, nr. 14, lista37, dosja, nr. 28, fq. 86.

⁶⁰⁷ Po aty, fq. 87.

nga qarqet serbe si në aspektin politik por edhe në aspektin historik. Sepse kanë dominuar tezat e “historiografisë serbe” të trumbetuara nga propaganda jugosllave. Por shumë shpjet shtypi amerikan është informuar mbi ngjarjet, ashtu si ishin pa ndonjë ekuivoke.⁶⁰⁸ Kjo dëshmohet edhe me një artikull të botuar më 27 prill 1981, në të famshmen amerikane “Nju-Jork Tajms” ku shtrohet një pyetje mjaft interesante: “ shteti federal i Jugosllavisë tashmë ka gjashtë republika; çfarë ndryshimi do të sillte edhe një republikë më shumë? Pse Kosova të mos jetë republikë, ku 85% e banorëve të saj (1.5 milion) janë shqiptarë etnikë”.⁶⁰⁹

Ndryshimi i qëndrimit apo më mirë të thuhet informimi real i shtypit amerikan për gjendjen në Kosovë duhet shikuar në shumë aspekte, e para në vet përmasat që morën këto demonstrata pas 1 dhe 2 prillit të vitit 1981.⁶¹⁰ Por edhe informimi nga ana e mërgatës sonë atje për gjendjen reale që mbretëronte në ish-Jugosllavi, duk mos përjashtuar mundësitë e kanaleve operative.

Duke ditur relevancën e shtypit amerikan, ne do të sjellim disa ide dhe mendime kryesore që ka shprehur shtypi amerikan për ngjarjet në Kosovë:

- Në të gjitha shkrimet pranohet se Kosova është krahina më e varfër prej të gjitha krahinave tjera në Jugosllavi dhe se problemet ekonomike janë një nga shkaqet e demonstratave. Po ashtu në shtypin amerikan është thënë se Kosova është një ndër krahinat më të varfra të Ballkanit;⁶¹¹
- Në shumë shkrime të shtypit amerikan quhet e drejtë, e në fakt mbështetet kërkesa e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, për të pasur republikën e tyre në kuadër të federatës Jugosllave. ⁶¹² Kjo ka qenë më shumë se një qëndrim i shtypit amerikan, për lëvizjen studentore dhe lëvizjet e ndryshme ilegale në Kosovë. Sepse u pa qartë se diskursi politik i Amerikës kishte filluar të ndryshonte në raport me ish-Jugosllavinë;
- Në artikujt e shtypit amerikan thuhet se në Kosovë shqiptarët përbëjnë 85% të popullatës. Por akoma vërehet në disa gazeta, janë të ndikuar nga qarqet jugosllave, p.sh në gazetën “Boston Globa” ku shqiptarët i quan minoritet jo nacionalitet,⁶¹³
- Në të gjitha komentet e shtypit amerikan mbi ngjarjet në Kosovë pohohet fakti se Shqipëria nuk ka gisht në demonstratat;⁶¹⁴

⁶⁰⁸ Po aty, fq. 88..

⁶⁰⁹ Po aty, fq. 90-91.

⁶¹⁰ AQSh, Fondi: Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, nr. 14, lista 37, dosja, nr. 28, fq. 89

⁶¹¹ Po aty.

⁶¹² Po aty, fq. 90.

⁶¹³ Po aty, fq. 91.

⁶¹⁴ Po at, fq. 92.

- Në këto shkrime pohohet fakti se në Jugosllavi shqiptarët kanë pasur gjithnjë statusin e “qytetarëve të dorës së dytë”. Jepen po ashtu edhe shifrat pjesëmarrëse në demonstrata, 20 000 herë 10 000;⁶¹⁵
- Në shtypin amerikan flitet për gjendjen e rëndë që vazhdon të ekzistojë në Kosovë si dhe për terrorin e masat shtypëse që po ndërmerren qeveria e Jugosllavisë ndaj shqiptarëve në Kosovë etj..⁶¹⁶

Nga një analizë e thjeshtë e shtypit ndërkombëtar të kohës, del se shtetet perëndimore në përgjithësi, me përjashtim të Francës (e cila ishte më neutrale), iu kishin kundërvënë ish-Jugosllavisë lidhur me problemet themelore që kishin të bëjnë me ngjarjet në Kosovë. Hedhin poshtë pretendimet jugosllave se në ngjarjet e Kosovës ka dorë Shqipëria.⁶¹⁷ Për këtë është i të njëjtit mendim ish-sekretari i Jashtëm i SHBA-së Heig, gjatë një bisede të zhvilluar me ambasadorin jugosllav në Uashington më 15 maj 1981, i kishte thënë : “*SHBA-ja ka marrëdhënie të mira me Jugosllavinë, porse ajo duhet të ndjekë një politikë më të arsyeshme ndaj Shqipërisë, sepse Shqipëria përderisa flet për fakte mbi ngjarjet në Kosovë, do të thotë se e di se çfarë flet, e kjo do të thotë se ajo e njeht mirë situatën atje, në Kosovë*”.⁶¹⁸

Edhe përkundër shumë kontradiktave në politikën dhe mediet botërore rreth demonstratave të vitit 1981, një është e pakontestuar se demonstratat kishin pasur jehonë në çdo skaj të botës, dhe pikërisht janë këto ngjarje që e ndërkombëtarizuan çështjen e Kosovës dhe fillon të futet në agjendat e politikës së bashkësisë ndërkombëtare.

⁶¹⁵ Po aty, fq. 93.

⁶¹⁶ Po aty, fq. 95.

⁶¹⁷ Sabit Syla, Shteti shqiptar dhe ... vep. e cit., fq. 326.

⁶¹⁸ Po aty.

3.4 Goditja e elitës intelektuale dhe kombëtare nga regjimi jugosllav, pas demonstratave të viti 1981

Pas demonstratave të shqiptarëve të vitit 1981, u rishfaq mobilizimi i serbëve të Kosovës dhe u zhvillua kryesisht si përgjigje ndaj ndryshimeve në kontekstin politik dhe brenda një mjedisi që nuk ishte krejtësisht i pafavorshëm për veprimin e grupeve rrënjore nacionaliste serbe. Ky mobilizim i serbëve të Kosovës luajti një rol të rëndësishëm në luftërat politike në ish-Jugosllavinë e vonshme socialiste.⁶¹⁹ Menjëherë filluan dekonspirimin e organizatave të fshehta shqiptare që ishin të shumta edhe ndjekjen e tyre. Një ndër këto ishte Lëvizja për Çlirimin Kombëtar të Kosovës, e udhëhequr nga vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka (të vrarë më 1982 në Gjermani).⁶²⁰

Ndaj demonstruesve të vitit 1981 janë përdorur të gjitha mekanizmat e shtetit, e këta të fundi kanë përdorur një dhunë shumë të ashpër, pa i kursyer edhe nxënësit nën moshën 15 vjeçare. Veprimet e policisë së Serbisë, të ardhura në Kosovë me anë të federatës dhe me vendimet e udhëheqësisë federative ndaj demonstruesve dhe ndaj popullit, ishin vërtet brutale. Brutale ishin sidomos veprimet e njësisë speciale të federatës më 26 mars 1981, kur sulmuan dhe rrahën në konviktet e studentëve shumë të rinj dhe të reja.⁶²¹ Se çfarë brutaliteti dhe mekanizma të dhunës ka përdorur aparati shtetëror jugosllav tregon edhe një fakt tjetër. Në vitin 1986 numri i shqiptarëve të dënuar në burgje kishte arritur rreth 4000 veta.⁶²²

Pushteti jugosllav si dhe disa politikanë të kohës janë munduar në të gjitha format që të krijonin një terr informativ për opinionin publik, si për atë vendor po ashtu edhe atë ndërkombëtar. Një përpjekje të tillë pati bërë ish-funksionari Azem Vllasi, i cili në përpjekje për të minimizuar dhunën e forcave të rendit ndaj demonstruesve pati deklaruar: *“Për shkak të shumë informatave të përhapura në opinion publik lidhur më intervenimin e organeve të sigurimit dhe pasojat për jetën e njerëzve, dëshiroj t’i paraqes këto të dhëna: gjatë trazirave në Prishtinë dhe në vende tjera të Krahinës janë lënduar 75 persona, prej të cilëve 55 të janë të plagosur lehtë dhe rëndë me armë të përdorura nga demonstruesit ose nga qytetarët e tjerë”*.⁶²³

⁶¹⁹ Momčilo Pavlović, vep. e cit., fq. 30.

⁶²⁰ Miranda Vickers, vep. e cit., fq. 250.

⁶²¹ Marr në : <https://telegafi.com/dosja-1981-ngjarjet-qe-ndryshuan-rrjedhen-e-historise-foto/>, me 26.05.2018.

⁶²² Viktor Meire, *Fundi i Jugosllavisë...* vep. e cit., fq. 56.

⁶²³ Gazeta “Rilindja” 14.04.1981, Prishtinë, fq. 4.

Kjo është një deklaratë që aspak nuk përputhet me realitetin. Në vazhdim të deklaramit, Vllasi bëhet mjaft qesharak: *“nga radhët e përfaqësuesve të organeve të sigurimit janë plagosur 4 dhe 127 janë lënduar më lehtë”*.⁶²⁴ Kjo deklaratë mund të quhet vetëm qesharake, asgjë më shumë.

Ashtu siç pritej ashtu edhe vepruan organet e rendit të ish-Jugosllavisë pas demonstratave të pranverës së vitit 1981.

Prandaj edhe kanë të drejtë shumë historianë që thonë se qarqet serbe kanë përdorur si pretekst demonstratat e vitit 1981, për të goditur të gjithë ata që mund të konsideroheshin si armiq. Kjo u dëshmuar gjatë gjithë viteve 80-ta dhe 90-ta. Pra menjëherë filluan arrestime, jo vetëm të organizatorëve dhe pjesëmarrësve, por edhe të atyre që kishin qenë në fokus të UDB-së edhe para demonstratave të vitit 1981, sidomos intelektualët disidentë të ish-Jugosllavisë. Siç ishte rasti i Profesor Ukshin Hotit dhe profesor Muhamet Tërnavës etj.. Për këtë situatë të krijuar pas demonstratave të vitit 1981 dhe arrestimet që pasuan, dëshmon edhe një raport i Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme të vitit 1983: *“ 62 për qind e të akuzuarave për ‘krime politike ishin etnikë shqiptarë të akuzuar për veprimtari irredentiste’ . Në një intervistë që dha në tetor të vitit 1983, prokurori federativ Millosh Bakiçia atribuoi rritjen e krimeve verbale vendosjes së një rregulli më të madh mbas demonstratave të pranverës së vitit 1981 në krahinën e Kosovës.”*⁶²⁵

Pushteti jugosllav–serb në Kosovë thaujse gjatë gjithë periudhës së viteve të 80-ta ka përdorur një metodë interesante dhe mjaft të vrazhdë siç ishte izolimi. Izolimi ishte “kamp përqendrimi”, një lloj holokausti i kohëve moderne.⁶²⁶ Në literaturën juridike shpesh haset dënimet politike, politikisht i dënuar, i ndjekur penalisht, por pak dihet për termin i izoluar politikisht, formë e cila është aplikuar kundër demonstruesve dhe atyre kundër regjimit në Kosovë dhe Jugosllavi. Kjo masë e përkohshme u sigurua me Ligjin për Çështjet e Brendshme të Kosovës.⁶²⁷

Izolimi masiv i njerëzve kryesisht intelektualëve, sipas të dhënave zyrtare të shtetit rreth 250, sipas burimeve shqiptare mbi 500 intelektualë profilesh të ndryshme, me përmasat dhe përzgjedhjen, me brutalitetin, ka qenë më shumë se një kamp përqendrimi i luftës.⁶²⁸

⁶²⁴ Po aty.

⁶²⁵ KOSOVA 41, Prishtinë, 2016, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2016, Hamit Kaba, Të drejtat e njeriut në Jugosllavi 1983, fq. 250.

⁶²⁶ I Izoluar rrëfim nga tuneli i tmerrit, Redaktor Ibrahim Osmani, Botues Koha, Prishtinë, 2009, fq. 16.

⁶²⁷ Haki Kabashi, Isolation – Sanction without a trial for Kosovo’s Albanians (1981-1989), European Journal of Sustainable Development (2016), 5, 2, 41-50, fq. 42. Marr në : <file:///C:/Users/Sedat/Downloads/315-623-1-SM.pdf>, me 07.07.2018.

⁶²⁸ I Izoluari, vep. e cit., fq. 16..

Ky izolim që ishte i rrallë kishte një qëllim themelor: duke ia marrë peng një numër të madh njerëzisht të kalibrave të ndryshëm dhe me një përzgjedhje të posaçme, pushteti serb-jugosllav më këtë popullit shqiptar donte t'i thoshte se ishte i detyruar të dorëzohej.

Ky izolim ishte shantazh ndaj tërë një populli.⁶²⁹ “Izolimet” e viteve 80-ta, padyshim se në kujtesën kolektive jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe të tërë bashkësisë demokratike ndërkombëtare, do të ngelin si një ndër njollat më të zeza.⁶³⁰ Kjo formë e të bërit dhunë dhe represion ishte e papërdorur deri në këtë periudhë kohore. Kjo ishte një metodë jashtëzakonisht e vrazhdë si në aspektin fizik por sidomos në aspektin psikologjik. Kjo metodë ishte kështu: policia kryesisht kur binte errësira fillonte gllabërimin kryesisht të intelektualëve shqiptarë nga shtëpitë e tyre, vendet e tyre të punës, në formën më çnjerëzore dhe pa kurrfarë urdhërese gjyqësore. Askush nuk e dinte se kush i arrestonte (rëndom këtë e bënin njerëzit nga sigurimi shtetëror pa uniforma dhe të përforcuar nga policë të armatosur).⁶³¹

Ajo që vlen të theksohet se për “izolim” kombëtar të shqiptarëve të Kosovës është fakti se shkruanin gazetat dhe raportnin agjencitë botërore të lajmeve, duke demaskuar dhe zbuluar vrazhdësinë e “mbajtjes në vende të caktuara”, të cilat ishin burgjet hetuese kosovare dhe serbe.⁶³² Kjo formë ka vazhduar gjatë gjithë viteve 1981-1982 deri 1988-1989, kjo dëshmon se sa paranoik ishte pushteti serbo-jugosllav, duke arrestuar njerëz pa kurrfarë dëshmie vetëm që kanë pasur ndonjë dyshim në mënyrë hipotetike.

Pra ish-Jugosllavia, apo më mirë të themi serbët nuk ndërmorën politikë qetësuese, por përkundrazi ndoqën një politikë mjaft të ashpër ndëshkuese. Siç kishte ndërmarrë gjatë gjithë kohës që nga viti 1945.

Gjatë viteve 1945 deri më 1990 në ish-Jugosllavi shqiptarët kaluan në burgje 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj burgim.⁶³³ Si vepra të rënda penale politike gjatë kësaj periudhe 1981, pushteti serb i konsideronte demonstrata paqësore, manifestimet politike, kërkesat e drejta të studentëve, të cilët në mënyrë të drejtë dhe të argumentuar kërkonin zgjidhjen e statusit politik të shqiptarëve dhe të Kosovës.⁶³⁴

Është e ditur se dy ditë pas demonstratave të 26 marsit 1981, pikërisht më 28 mars, në kompetencën e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës padrejtësisht ndërhyu Federata dhe Serbia, ndërsa me Kushtetutën e Kosovës së vitit 1974, na e kishin “siguruar

⁶²⁹ Po aty.

⁶³⁰ Po aty, fq. 23.

⁶³¹ Po aty, fq.25.

⁶³² Po aty, fq. 26.

⁶³³ Sabite Kiçmezi-Basha, *Të burgosurit politik shqiptarë në Kosovë 1945-1990*, Prishtinë, 2009, (ballin)

⁶³⁴ Po aty, fq. 94.

autonominë”.⁶³⁵ Kjo është një dëshmi e qartë se serbët kishin pritur këtë moment, për të realizuar qëllimet e tyre nacionaliste. Vetëm në vitin 1981 në Kosovë janë vrarë 13 shqiptar, më këtë rast u burgosën 70 mijë shqiptarë, me kundërvajtje dhe burgim të rëndë u dënuan deri më 15-20 vjet, ndërsa nëpër duar të policisë kanë kaluar mbi 700 mijë veta.⁶³⁶

Këto dënime drakonike nuk ishin asgjë tjetër vetëm dhunë ndaj atyre që kishin përdorur një mjet demokratik siç është demonstrata paqësore. Krejt kjo ndaj gjithë atyre që mund të ishin “armiç” të pushtetit jugosllav. Veprat penale me të cilat janë ngarkuar shumica ishin qesharake.

Për dhunën dhe arrestimet e vazhdueshme që bëheshin në Kosovë, shteti shqiptar kishte përcjellë edhe në mënyrë të vazhdueshme. Burimet shqiptare dëshmojnë edhe për proceset gjyqësore që u zhvilluan në Kosovë.

Sipas drejtorisë së IV, të MPJ-së, datë 14 gusht 1981, lidhur me 7 gjyqet e zhvilluara në Kosovë gjatë periudhës 22 korrik deri më 12 gusht 1981 ishin dënuar 67 veta. Nga këta: 15 punëtorë, 13 arsimtarë, 14 studentë, 15 nxënës, 5 bujq dhe 5 të tjerë. Ndër të dënuarit ishin edhe katër vajza, mosha mesatare e të dënuarve ishte 23 vjeçare.⁶³⁷

Përveç si një informatë me vlerë, kjo është një dëshmi se shteti shqiptar në mënyrë të vazhdueshme ka përcjellë gjendjen në Kosovë, pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981.

3.5 Ndikimi i demonstratave në zgjimin kombëtar të shqiptarëve në ish-Jugosllavi

Nacionalizmi shqiptar në përgjithësi është nacionalizëm më i vonuar në zhvillim, jo në krijim në Ballkan. Nacionalizmi shqiptar si i tillë është përballë kurdoherë me mangësitë e rritjes. Kjo veçori është produkt i kushteve specifike të zhvillimit historik të popullit shqiptar në dy shekujt e fundit. Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për

⁶³⁵ Po aty. Shih edhe Azem Vllasin, vep. e cit., fq. 271.

⁶³⁶ Po aty.

⁶³⁷ Sabit Sylja, Shteti shqiptar, vep. e cit., fq. 260.

shqiptarët në aspektin kombëtar, por fatkeqësisht shumë e vonë në raport me kombet tjera të Ballkanit (duke përfshirë maqedonët dhe boshnjakët). Nacionalizmi si doktrinë, ideologji dhe si lëvizje ishte një fenomen edhe te elita shqiptare gjatë shekullit XIX.⁶³⁸ Njëkohësisht ky proces i nxitur nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878, u përshkua nga vështirësi të mëdha dhe që në disa aspekte mbeti i papërfunduar. Copëtimi i trojeve shqiptare nga Fuqitë e Mëdha, i cili ishte më radikali në Ballkan dhe në Evropë, paaftësia e nacionalizmit shqiptar për t'iu kundërvënë këtij copëtimi me anë të një organizimi gjithëkombëtar dhe me potencialin maksimal të kombit shqiptar, janë një dëshmi tjetër e faktit se ai ende s'e kishte përfunduar procesin e zhvillimit dhe konsolidimit nacionalizmit shqiptar në përgjithësi.

Një fakt që është i pamohueshëm dhe me shumë rëndësi është se një identitet i tillë shqiptar u formua kryesisht me anë të një ideologjie nacionaliste sekulare, duke u bazuar në simbolet kombëtare dhe mitet ekskluzive, dhe jo në përkatësinë fetare.⁶³⁹ Ky është edhe një fakt shtesë që e dallon nga nacionalizmat tjerë në Ballkan.⁶⁴⁰ Në Ballkan ringjallja e nacionalizmave është e lidhur ngushtë me ringjalljen e feve përkatëse. Një argument për këtë është kur më 28 qershor 1989, dita e shenjtë serb, Vidovdan, u festua në Fushë-Kosovë. Dita shënon 500 vjetorin e betejës së Fushë-Kosovës dhe rënien dhe vdekja e Shën Princit Llazar. Millosheviçi foli para atij tubimi të madh, që do të njihej si fjalimi i Gazimestanit, i cili shënoi kthimin e fesë dhe nacionalizmit - dy grupe besimesh dhe praktikash që kishin qenë të marginalizuara për dekada nga autoritetet komuniste në të gjithë Evropën Juglindore.

Kjo shënoi rënien e ideologjisë komuniste dhe fillimin e një epoke të re për kombet dhe kishat në të gjithë Evropën Juglindore.⁶⁴¹

Kurse në Kosovë është edhe më i vonë për shumë arsye, por ajo kryesorja është fakti që në momentin kur filloi të kristalizohet nacionalizmi te shqiptarët,⁶⁴² Kosova dhe shumë vise

⁶³⁸ Enver Hoxhaj, *Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës*, Pejë, 2008, fq. 46.

⁶³⁹ Çfarë ndodhi me shqiptarët e Kosovës: Ndikimi i religjionit në identitetin etnik në periudhën e shtetndërtimit, fq. 23 në: http://www.kipred.org/repository/docs/Çfarë_ndodhi_me_shqiptarët_e_Kosoves_110227.pdf. Qasur më 20. 03. 2019.

⁶⁴⁰ Të gjithë nacionalizmat tjerë në Ballkani, si ai serb, bullgar, grek dhe turk, janë të identifikuar nga fetë përkatëse, të parët me fenë ortodokse, kurse nacionalizmi turk me fenë islame.

⁶⁴¹ Emil Hilton Saggau, University of Copenhagen, Faculty of Theology, New perspectives on the religious revival in South Eastern Europe, fq. 1-2. Marrë në: <http://web.a.ebscohost.com/ehost/pdfviewer/pdfviewer?vid=6&sid=4219a929-2a52-4680-838b-7cda45a7b17a%40sessionmgr4006>; Qasur më 23.01.2019.

⁶⁴² Nacionalizmat gjatë historisë janë shpërfaqur në forma të ndryshme. Vlen të theksohet se nacionalizmi shqiptar asnjëherë nuk është shpërfaqur me elemente ekspansioniste. Jo për atë që shumë studiues mundohen të argumentojnë këtë fakt, kinse shqiptarët kanë qenë më inferiorë në aspektin e fuqisë ushtarake dhe ekonomike në raport me fqinjët. Këtë e dëshmon edhe koha e Skënderbeut kur ne ishim më të organizuar ushtarakisht se fqinjët, por nuk treguam elemente ekspansioniste, përkundrazi

tjera shqiptare mbeten jashtë kufijve të Shqipërisë në fund të vitit 1912. Sikurse jo gjithëherë njëësia e re politike nënkupton edhe formimin e identitetit të ri kombëtar. I tillë ka qenë rasti i kombit shqiptar, një shekull pas pavarësisë dhe vetëvendosjes kombëtare, ai ka qenë në proces të përmbushjes së këtij parimi qenësor për kombet, formimin e shtetit unik kombëtar shqiptar.⁶⁴³

Pjesa tjetër e kombit e cila mbeti jashtë shtetit kombëtar të 1912, natyrisht imponueshëm, u bë pjesë e njësisë të tjera politike-pushtuese, veçanërisht Serbisë-Jugosllavisë. Por të qenurit nën njësi tjetër politike, jo vullnetshëm, nuk do të thotë që identiteti kombëtar duhet t'i përshtatet asaj njësie politike. Në fakt, ky ka qenë synimi i Serbisë në Kosovë, që shqiptarët të formësonin një identitet tjetër kombëtar, sa më të ndryshëm prej atij të Shqipërisë.⁶⁴⁴

Proklamimi i “*identitetit jugosllav*”, përkatësisht dallimi i qëllimshëm që Serbia iu bënte shqiptarëve të Kosovës nga ata të Shqipërisë si “shiptari” për të parët dhe “*albanci*” për të dytët, ka synuar të bëhej për të penguar orientimin politik të shqiptarëve të Kosovës nga Shqipëria, si dhe për të ngjizur farat e një identiteti të ri kombëtar joshqiptar të Kosovës.⁶⁴⁵

Ndjenja kombëtare të shqiptarët e Kosovës që nga viti 1912 kishte filluar të ngritej në një nivel tjetër, vetëm pas demonstratave të vitit 1968. Pra që nga kjo kohë fillon të krijohet identiteti etnonacional shqiptar në mënyrë masive. Derisa modernizimi socio-ekonomik në shumë fusha siç e kemi cekur edhe më lart nuk kaloi nivelin fillestar.

Në fushën e arsimit pati suksese të dukshme, ky zhvillim i arsimit krijoi një shtresë intelektuale shqiptare me lidhje të ngushta me modelet mendore të Republikës Popullore të Shqipërisë, e cila më 1966 i dha fund procesit të nacionalizmit të identitetit të popullsisë shqiptare.⁶⁴⁶

Para vitit 1968 të gjitha simbolet kombëtare ishin të ndaluara në ish- Jugosllavi. Prandaj më të drejtë studiuesi i mirënjohur Muhamedin Kullashi, thekson: “*këtë periudhë si*

ofruam bashkëpunim me fqinjët. Po ashtu nëse shikohet me vëmendje dy memorandumet nacionaliste të fqinjëve tanë "Naçartania" serbe dhe "Megali Idea" greke, fund e krye janë të mbushura me nacionalizëm ekspansionist. Kurse në shikojmë planprogramin politik të rilindasit tonë Sami Frashërt, që njëkohësisht paraqet edhe mendimin e shumicës së rilindasve tanë “Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet”. Askund nuk haset ndonjë element ekspansionist në asnjë formë.

⁶⁴³ Donik Sallova, Çështja e identitetit kosovar, fq. 6, marrë në : [https://aab-](https://aab-edu.net/uploads/docs/thesis/2015/01-2015-shqip/06.%20%C3%87%C3%ABshtja%20e%20identitetit%20kosovar-%20Donik%20Sallova.pdf)

[edu.net/uploads/docs/thesis/2015/01-2015-shqip/06.%20%C3%87%C3%ABshtja%20e%20identitetit%20kosovar-%20Donik%20Sallova.pdf](https://aab-edu.net/uploads/docs/thesis/2015/01-2015-shqip/06.%20%C3%87%C3%ABshtja%20e%20identitetit%20kosovar-%20Donik%20Sallova.pdf);

Qasur më 18.06.2018.

⁶⁴⁴ Po aty.

⁶⁴⁵ Po aty. Shih më gjerësisht Oliver Jens Schmit, vep. e cit.

⁶⁴⁶ Oliver Jens Schmit, vep. e cit., fq. 217.

kohë të pushtimit të kujtesës historike”.⁶⁴⁷ Heqja e ndalesës për studimin e gjuhës dhe historisë së shqiptarëve në Kosovë, nxiti një elan drejt kërkimit të identitetit shqiptar në të kaluarën. Ky përfytyrim mbi identitetin e kishte sharmin e një molle të ndaluar. Ky hulumtim i së kaluarës kërkonte argumente për të prodhuar një identitet të madh e të fortë si graniti, i cili do të mund t’i kundërvihej identitetit serb.⁶⁴⁸

Demonstratat e vitit 1981,⁶⁴⁹ kanë pasur një ndikim të papërshkrueshëm në ndjenjën kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Demonstratat përforcuan ndjenjën kombëtare dhe krijuan distancimin e shqiptarëve të Kosovës nga popujt tjerë sllavë të ish-Jugosllavisë. Demonstratat masive shqiptare të udhëhequra nga studentët në Kosovë në vitin 1981 dhe rëndësia e kërkesave kombëtare shqiptare tregoi një afirmim kombëtar.⁶⁵⁰

Këto demonstratat përcollën mesazhe të qarta të gjitha shtresat, se tani Kosova kishte mjaftueshëm potenciale humane, për të filluar t’i kërkojë të drejtat e saj, në çfarëdo forme dhe çfarëdo çmimi.

Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë filluan shumë veprime me karakter kombëtar të organizuar në mënyrë kolektive por edhe në mënyrë individuale.

Tiparet kryesore të nacionalizmit shqiptar të Kosovës gjatë kësaj kohe u karakterizuan me një orientim pro-perëndimor dhe me një unifikim të përgjithshëm të shqiptarëve pavarësisht prej sfondit shoqëror apo fetar.⁶⁵¹

Ajo që duhet të theksohet është fakti se, ashtu si nacionalizmi në përgjithësi ashtu edhe nacionalizmi i shqiptarëve në ish-Jugosllavi në veçanti, nuk kishte asnjë element ekspansionizmi.

⁶⁴⁷ IDENTITETI EVROPIAN I KOSOVËS Simpozium ndërkombëtar, i mbajtur më 26 dhe 27 qershor 2007, në Prishtinë, Nëntor 2007, marrë në: <https://shtjello.files.wordpress.com/2011/05/identiteti21.pdf>

⁶⁴⁸ Po aty, fq. 8.

⁶⁴⁹ Krijimi i një identiteti të tillë etnonacional shqiptar në Kosovë, mund të thuhet se ishte në kufi të vonesës. Krejt kjo për arsye se siç e dihet botërisht shumë shqiptarë filluan të identifikohen me kombësi tjera sidomos me atë turke, bullgare etj.. Kjo është bërë kryesisht t’i shpëtonin presioneve të aparatit shtetëror jugosllav-serb.

⁶⁵⁰ Denisa Kostovicova, Kosovo The politics of identity and space, First published 2005, First published 2005 by Routledge 2 Park Square, Milton Park, Abingdon, Oxon OX14 4RN Simultaneously published in the USA and Canada by Routledge 270 Madison Ave, New York, NY 10016, fq. 52.

⁶⁵¹ Çfarë ndodhi me shqiptarët e Kosovës: Ndikimi i religjionit në identitetin etnik në periudhën e shtetërdërtimit, Përgatitur nga: Agon Demjaha dhe Lulzim Peci, fq. 4. Marrë në: http://www.kipred.org/repository/docs/Cfare_ndodhi_me_shqiptaret_e_Kosoves_110227.pdf, me 26.05.1981.

Demonstratat e vitit 1981 fuqizuan unitetin e popullit që të bashkuar të ecin drejt fitores, u ngrit një mobilizim i ri jo vetëm politik, shpirtëror i masave të gjera të popullit tonë.

Shteti jugosllav, e kuptoi se populli i Kosovës kurrë nuk do t'i nënshtrohet sundimit serb-jugosllav.

Jehona politike, kombëtare e demonstratave të vitit 1981 ishte strumbullari kryesor i fuqizimit të rezistencës kombëtare e cila në vitet e 80-ta fitoi përmasa të reja, e cila rezistencë kombëtare, në vitet e 90-ta kulmoi me themelimin e UÇK-së dhe fitoren e saj në luftën e armatosur kundër pushtuesit serb.

3.6 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1981-1989

Dihet botërisht se Kosova ka patur një rol kyç në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në fund të shekullit XX. Deri me shpërthimin e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, Tirana zyrtare apo më mirë të themi Enver Hoxha, zgjidhjen e çështjes së Kosovës e ka shikuar vetëm nga prizmi ideologjik. Nga viti 1981 ky diskurs politik ndryshon, sidomos pas reagimit të shteti shqiptar në gazetën *“Zëri i Popullit”* me 8 prill 1981 për dhunën e përdorur nga organet e rendit jugosllav ndaj demonstruesve shqiptarë.

Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë si dhe pas përplasjeve në mes të Jugosllavisë dhe shtetit shqiptar, rreth këtyre demonstratave, raportet diplomatike ishin shumë të tendosura. Në politikën e jashtme të Shqipërisë marrëdhëniet me Jugosllavinë vazhduan të ishin shumë të komplikuara gjatë gjithë viteve të 80-ta.⁶⁵²

Pra marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave arritën një nivel shumë të ulët menjëherë pas akuzave të ndërsjellta që i bënin njëra-tjetrës në mediet e tyre, thuajse gjatë gjithë vitit 1981. Enver Hoxha i bëri thirrje Jugosllavisë që të plotësonte kërkesat e Kosovës për krijimin e republikës. Ai pati deklaruar se Shqipëria nuk kishte asnjë pretendim territorial ndaj Jugosllavisë, por ishte e interesuar në zhvillimin e

⁶⁵² Lisen Bashkurti, *Diplomacia e vetizolimit... vep. e cit., fq. 592.*

marrëdhënieve të mira me Beogradin, por kjo do të varej nga trajtimi që Jugosllavia do t'u bënte shqiptarëve. Jugosllavët u përgjigjen me një notë proteste ku Shqipëria akuzohej se po ndërhynte në punët e brendshme të shtetit jugosllav.⁶⁵³

Beogradi e pati paralajmëruar Tiranën se qëndrimi i saj në lidhje me Kosovën kërcënonte rezultatet e arritura në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave që ishin arritur nga viti 1971, duke shtuar se një gjë e tillë mund të kishte pasoja të rënda për stabilitetin e tërë rajonit të Ballkanit dhe mund t'i hapte dyert interesave dhe ndërhyrjeve ndërkombëtare në rajon.

Se çfarë qëndrimi kishte planifikuar të mbante shteti shqiptar pas demonstratave të vitit 1981, dëshmon një shkrim analizë që i paraqitet Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë më 20 mars 1981.

Në mesin e shumë gjërave krejt në fund të kësaj analize parashihen tri objektiva që duhet të ndiqte shteti shqiptar në raport me shqiptarët në ish-Jugosllavi. Tri objektivat ishin:

1. Objektivat tona ideopolitike për marrëdhëniet dhe politikën tonë ndaj viseve shqiptare për vitin në vazhdim mbeten të drejta, duhet forcuar vigjilenca jonë dhe efikasiteti i veprimeve për realizimin e tyre;
2. Edhe plani që parashikon shkëmbimet në këto vise, mbetet i drejtë në përgjithësi. Duhet mobilizim më i mirë për zbatimin e tij me efektivitet sa më të lartë;
3. Ngjarjeve që lidhen më këtë çështje u duhet kushtuar vëmendja e nevojshme, për t'i ndjekur, pasqyruar dhe analizuar në kohën e duhur, në funksion të masave për veprim sipas nevojës.⁶⁵⁴

Edhe pas vdekjes së Enver Hoxhës shteti shqiptar ka ndjekur një politikë shumë të kujdesshme në raport me Jugosllavinë. Por, kanë përcjellë me një vigjilencë shumë të madhe zhvillimet politike në Jugosllavi, konkretisht në Kosovë. Kjo thuhet ishte e ditur sepse pas vdekjes së E. Hoxhës, në krye të shtetit shqiptar erdhi Ramiz Alia, i cili ishte njeriu më i besuar i Hoxhës, pra Alia ishte një besnik i linjës politike të Hoxhës.⁶⁵⁵

Por edhe përkundër që shteti shqiptar kishte ndjekur një politikë mjaft të kujdesshme edhe pas vdekjes së Enver Hoxhës, shteti jugosllav kishte dyshime të mëdha se Shqipëria është duke punuar në ndërkombëtarizimin e çështje së Kosovës. Për këtë dëshmojnë dokumentet e Komitetit Qendror i Lidhjes Komuniste të vitit 1987, kur thuhet: “... po bëhet edhe një përpjekje

⁶⁵³ ENVER HOXHA, Kosova është Shqipëri, nga Ditari Politik, vep. e cit., fq. 99.

⁶⁵⁴ AQSH, Fondi: 14, dosja, nr. 28, fq. 10.

⁶⁵⁵ Peter Bartl, vep. e cit., fq. 250.

*për të ndërkombëtarizuar problemet e Kosovës me shembullin e fundit të veprimit të një grupi drejtuesish të shtetit shqiptar me senatorë amerikanë...*⁶⁵⁶Për këto dyshime që kishte shteti jugosllav ndaj Shqipërisë në raport me Kosovën, Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste parasheh edhe disa masa preventive.

a. Është e nevojshme të krijohet një koordinim shumë më i mirë i punës dhe veprimtarive të përgjithshme propagandistike, si në Shqipëri ashtu edhe në botë, dhe selia e tij duhet të jetë në Sekretariatit Federativ për Informim, duke mbuluar të gjithë aktorët përkatës krahinorë, republikanë dhe federativë, veçanërisht grupin për Shqipërinë;⁶⁵⁷

b. Duke pasur parasysh ekspozimin e lartë të punëtorëve tanë jashtë vendit ndaj presioneve të ndryshme anti-Jugosllave, duhet të organizojmë vizita të aktivistëve tanë në vende specifike, veçanërisht aty ku kemi një problem të theksuar (Norvegjia, Suedia, Zvicra etj.). Dhe në mënyrë që t'i parandalojmë ato veprime, si dhe zhvlerësimi dhe parandalimi i ndikimeve ekzistuese të propagandës së armikut;⁶⁵⁸

c. Në aspektin politik, diplomatik dhe propagandistik, duhet të bëhen përpjekje për të kundërshtuar në mënyrë më efektive përpjekjet e propagandës shqiptare dhe veprimet konkrete që synojnë ndërkombëtarizimin e problemit të Kosovës, i cili tashmë është i pranishëm në të gjithë botën, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara;⁶⁵⁹

ç. Puna për ndërtimin dhe përgatitjen e transmetuesve televizivë me të cilët programi televiziv jugosllav do të jetë në gjendje të shtrihet në të gjithë territorin e Shqipërisë, duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe mbi këtë bazë, të përfundojë dhe harmonizojë të gjithë programin që duhet të rezultojë nga prodhimi i radiotelevizionit jugosllav;⁶⁶⁰

d. Kur miratimi i programit jugosllav për parandalimin e dëbimit të serbëve dhe malazezëve nga Kosova, autoritetet shtetërore kompetente duhet të shtjellojnë dimensionin e tij informativ-propagandues në mënyrë që të interpretojnë vlerat jashtë vendit në një mënyrë të nevojshme. Thelbi i programit (intervistë me gazetarë të huaj, botime të caktuara, etj);⁶⁶¹

⁶⁵⁶ Arhiv Republike Slovenije, fondi: Централни комитет Комунистичке лиге, Škatla(kutia) 872-KOSOVO, Predsednistvima CK i PK SK i Komitetu organizacije SKJ, fq 1-10.

⁶⁵⁷ Po aty.

⁶⁵⁸ Po aty.

⁶⁵⁹ Po aty.

⁶⁶⁰ Po aty.

⁶⁶¹ Po aty.

dh. Depërtimi më i gjerë i pikëpamjeve tona jashtë vendit në marrëdhëniet jugosllave-shqiptare dhe situata në Kosovë duhet të përdoret në mënyrë fyese nga bashkëpunimi i rregullt ndërkombëtar i SKJ-së, SSRNJ-së dhe organizatave tjera me parti dhe lëvizje të përparuara në botë. Kjo temë duhet të marrë trajtim politik kur diskutohet me partnerët e huaj, dhe interpretimet e politikave tona dhe shpjegimi i çështjeve aktuale të ngritura duhet të jenë specifike dhe argumentuese;⁶⁶²

e. Mediet publike, të cilat kanë një rol të domosdoshëm dhe si një burim i rëndësishëm informacioni për publikun ndërkombëtar, duhet të japin një kontribut domethënës në krijimin e një klime të re që nuk do të krijohet në kontekstin e veprimeve të ndërmarra për të ndryshuar situatën dhe marrëdhëniet në shoqëri, dhe në veçanti në Kosovë. Me më shumë kujdes dhe ndjeshmëri, ata duhet t'i drejtohen sukseseve, vështirësive dhe dështimeve, duke pohuar rezultatet, pasi shenjat e ndryshimit për mirë do të vëreheshin në kohën e duhur dhe duke tërhequr vëmendjen;⁶⁶³

ë. Përveç faktit se është e vështirë të prodhohet një propagandë bindëse në një situatë të pafavorshme socio-ekonomike dhe politike, ne duhet, përmes këndvështrimit tonë për Kosovën dhe marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, të jemi pak a shumë të pranishëm në botë me këndvështrimet tona, për të pohuar rezultatet që arrijmë, vlerat tona, politika parimore kombëtare, të drejtat e qytetarëve etj.. Përmes misionëve tona diplomatike dhe konsullore të qendrave të informacionit kulturor, gazetave në gjuhë të huaj, të gjitha institucioneve dhe potencialeve tona të minimizojmë çështjen e Kosovës etj..⁶⁶⁴

Pra, është e qartë se sa rëndësi shteti jugosllav iu ka dhënë marrëdhënieve me Shqipërinë dhe çështjes së Kosovës edhe pas vdekjes së E. Hoxhës, duke përdorur gjithë mekanizmat e vet shtetëror, sidomos atë të propagandës.

Duke pasur parasysh propagandën serbe, është e pamundur të mos tërheq vëmendjen një detaj, se çfarë hapa parasheh për të ndërmarrë propaganda jugosllave jashtë vendit. “...po punohet për të përkthyer librin e Sinan Hasanit ‘Kosova - të vërtetat dhe keqkuptimet’ në anglisht, duke pasur parasysh nevojën dhe aftësinë për të angazhuar një nga botuesit më të spikatur atje në SHBA...”⁶⁶⁵

⁶⁶² Po aty.

⁶⁶³ Po aty.

⁶⁶⁴ Po aty.

⁶⁶⁵ Po aty.

Thujse gjatë gjithë viteve të 80-ta raportet jugosllave-shqiptare, nuk e mbërritën kurrë atë nivel çfarë e kishin para vitit 1981.

3.7 Suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe qëndrimi i shtetit shqiptar

E gjithë periudha e viteve të 80-ta në Kosovë karakterizohet me një dinamizëm të madh të ngjarjeve të njëpasnjëshme, që kryesisht ishin në shërbim të politikës serbe, që kishin si qëllim kryesor suprimimin e autonomisë së Kosovës. Në funksion të kësaj kauze serbe ishte Akademia e Shkencave Serbe dhe kisha serbe. Figura qendrore në ringjalljen nacionaliste serbe ishte Dobrica Qosiç, shkrimtar kryesor i Serbisë.⁶⁶⁶ Por politika jugosllave post-titiste është mbështetur kryesisht në trekëndëshin e famshëm Parti-Polici-Ushtri.⁶⁶⁷

Akademia e Shkencave të Serbisë, më 24 shtator 1986 në një gazetë të Beogradit botoi memorandumën e famshëm, i cili nuk mund të quhet ndryshe vetëm si mitologji politike.⁶⁶⁸ Si mund të konsiderohet ndryshe ky lloj dokumenti, ku në të theksohet: *“Gjenocidi fizik, politik, ligjor dhe kulturor kundër popullatës serbe në Kosovë e Metohi është disfatë serioze e Serbisë”*.⁶⁶⁹

Apo absurditeti tjetër ku thuhet *“Pos në kohë luftime, serbët e Kroacisë kurrë nuk kanë qenë më të kërcënuar sesa sot”*.⁶⁷⁰ Kur dihet se çfarë pozicioni kishin serbët në ish-Jugosllavi.

Ky memorandum do të jetë pikë reference e politikës së Millosheviqit, kjo ishte baza për suprimim e autonomisë së Kosovës e më pas edhe nisjen e luftërave në Slloveni, Kroaci, Bosnja e Hercegovinë dhe më në fund në Kosovë.⁶⁷¹ Memorandum i serb i vitit 1986 i ka paraprirë edhe

⁶⁶⁶ Tom Gallagher, vep. e cit., fq. 246.

⁶⁶⁷ Viktor Meier, vep. e cit., fq. 15.

⁶⁶⁸ Enver Hoxhaj, Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës, Pejë, 2008, fq. 89. Shih Misha Glenny, Historia e Ballkanit 1804-1999, nacionalizmat, luftërat dhe fuqitë e mëdha, Tiranë, 2007, fq. 625. Krahaso Viktor, Meier, Yugoslavia A History of its Demise, London and New York, First published in English 1999.

⁶⁶⁹ E.Hoxhaj, vep. e cit., fq. 83.

⁶⁷⁰ Po aty.

⁶⁷¹ Politika serbomadhe prej Garashaninit deri te Akademia, Flaka Surroi, Redaktore, Koha, Prishtinë, maj 2019, fq. 145-146.

një vepër e historianit serb Dimitrije Bogdanoviçi "*Historia e Kosovës*" i cili e mbështet një tezë që ishte abstrakte. Ku popullata shqiptare e Kosovës, përmes një lloj "*gjenocidi biologjik*", po e rrezikon popullatën e atyshme serbe.⁶⁷² Kjo ishte dëshmia më e madhe se deri ku ishte instrumentalizuar elita serbe nga nacionalizmi serb. Ose siç thuhet shpesh se pikërisht këta intelektualë serbë që e rizgjuan fuqishëm nacionalizmin serb.

Duhet shikuar edhe nga një prizëm tjetër, këto tendenca të serbëve në fund të viteve 80-ta, pra ishin edhe përpjekje për të faktorizuar vetën si element me rëndësi për stabilizim në rajon, sepse tani pas rënies së Murit të Berlinit, Jugosllavia veç e kishte humbur pozicionin e saj strategjik në konceptin e politikës së sigurisë të Perëndimit, si dhe përkrahjen e madhe ekonomike.⁶⁷³

Në prill të vitit 1982, priftërinjtë serbë iu drejtuan Sinodit të Shenjtë se shqiptarët e Kosovës po kryenin një politikë sistematike të planifikuar të "*gjenocidit*" kundër serbëve. Në vitin 1984, një libër i teologut Atanasije Jevtic, ku u ankua për përdhunimin e vajzave dhe grave të vjetra në fshatrat e banuara me serbë" dhe për emigrimin e 200,000 serbëve dhe malazezëve në 15 vitet e fundit.⁶⁷⁴

Prandaj të gjitha ngjarjet apo fenomenet që kishin ndodhur dhe ndodhnin në Kosovë, qarqet serbe i shndërruan në shërbim të politikës së tyre hegjemoniste dhe centraliste. Për shumicën e këtyre rasteve kemi folur edhe më lart, por ne do të ndalemi vetëm në ato që më të vërtetë u benë pjesë të platformës së tyre politike. Një ndër ato ishte çështja e shpërnguljes së serbëve nga krahina dhe e tkurrjes së pakicës serbe në Kosovë, të drejtat e tyre në "*tokën e shenjtë serbe*" u konsideruan si përbërës shumë të rëndësishëm të strategjisë nacionaliste të udhëheqjes serbe. Drejtuesit republikanë serbë e bënë "statusin e tkurrur" të serbëve në Kosovë pjesë të politikës zyrtare jugosllave dhe e shndërruan në kryeagjendë të propagandës partiake dhe shtetërore në mediet përkatëse.⁶⁷⁵

Një fakt që ia vlen të theksohet është se një gjë e tillë nuk i kishte ikur Tiranës zyrtare por as shtypit shqiptar. Sipas mjeteve shqiptare të informimit, dukuria e migrimit të serbo-malazezëve nga Kosova, pas ngjarjeve të vitit 1981, ishte venë në funksion të synimeve nacionaliste të një klani të caktuar dhe po përdorej si levë politike për të shtuar presionin ndaj shqiptarëve, për të kufizuar praninë e tyre në vetëqeverisjen e krahinës dhe kësaj të arrihej deri

⁶⁷² E.Hoxhaj vep. e cit., fq. 87-88.

⁶⁷³ Sylë Ukshini, vep. e cit., fq. 67.

⁶⁷⁴ Howard Clark, vep. e cit., fq. 17.

⁶⁷⁵ Aferdita Sokolaj, vep. e cit., fq. 51.

te likuidimi i autonomisë së krahinës.⁶⁷⁶ Bumi demografik shqiptar dhe filozofia e shumëzimit të interpretuar në funksion të një “Kosove etnikisht të pastër dhe të albanizuar” u vunë në fokus të medias serbe. Shfaqja e nacionalizmit të hapur serb ka ndodhur në demonstratën e parë publike e masës së reagimit serb kishte qenë në funeralin e Aleksandër Rankoviçit 'në gusht të vitit 1983. Në 17 vite që nga pastrimi i tij, Rankoviçi nuk kishte marrë pjesë në jetën publike për një kohë. Por funerali i tij në Beograd tërhoqi dhjetëra mijëra serbë, sikur të ishte për të thënë “Kush mund të na mbrojë tani?”⁶⁷⁷

Por përmasat e instrumentalizmit të shtimit natyror të popullsisë shqiptare në Kosovë ishin aq të mëdha dhe poshtëruese sa degraduan në parulla të pastra nacionaliste kundër shqiptarëve. Në kundërvënie të kësaj ideologjie nacionaliste, gazeta kryesore zyrtare kosovare vërente se “*Kosova etnikisht e pastër është e konstruktuar dhe e rrejshme, ngase nuk ofron asnjë argument shkencor*”⁶⁷⁸ Kjo nuk mund të quhet ndryshe vetëm një politikë gjenocidiale, jo befasuese, sepse serbët kaheerë kanë ndjekur një politikë të tillë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Kjo çështje delikate dhe mjaft e politizuar është analizuar gjerësisht nga Branka Megas, që shpjegon se për të gjetur të vërtetën, problemi i migrimit sllav nga Kosova duhet parë mbi të gjitha në një kontekst gjithë-jugosllav që të kuptohet domethënia e tij..⁶⁷⁹ Sepse statistikave jugosllave tregonin ekzistencën e një prirjeje të përgjithshme për migrim të brendshëm duke u orientuar drejt qendrave kombëtare më të zhvilluara si: serbët nga Bosnja prireshin të lëviznin për në Serbi, kroatët nga Bosnja për në Kroaci, shqiptarët nga Maqedonia dhe Mali i Zi për në Kosovë.⁶⁸⁰

Pra, këto prirje më shumë ishin me motive ekonomike dhe kjo dëshmon se jo të gjitha trevat në ish-Jugosllavi ishin të zhvilluara në mënyrë të barabartë. Pra këtu nuk ka të bëjë fare për motive tjera ashtu si i paraqisnin mediat serbe. Edhe logjikisht si ka mundësi që të mund t’u bëjnë presion shqiptarët kur dihet mirëfilli se çfarë primati kishin serbët në Kosovë gjatë gjithë kohës para dhe pas LDB-së.

⁶⁷⁶ Po aty.

⁶⁷⁷ Howard Clark ,Civil Resistance in Kosovo, Pluto PPress LONDON • STERLING, VIRGINIA , First published 2000 by Pluto Press, fq. 16.

⁶⁷⁸ Po aty.

⁶⁷⁹ Miranda Vickers, vep. e cit., fq. 269.

⁶⁸⁰ Po aty, fq. 270.

Edhe për kundër kësaj kishte akoma të atillë që mendonin me kokë ftohur edhe në mënyrë racionale, se një politikë e tillë nacionaliste dhe serbocentriste e stimuluar nga Akademia Shkencave dhe Arteve e Serbisë dhe Kishës Serbe do të dërgonte në një rrugë qorre.

Disa autoritete të larta komuniste e dënuan këtë memorandum me ashpërsi. Ivan Stamboliq, ish-kreu i Partisë Serbe, e quajti “ nekrologjitë e Jugosllavisë”, duke i paralajmëruar akademikët serbë se po vepronin kundër interesave të serbëve, sepse Jugosllavia është e vetmja zgjidhje e çështjes së serbëve. Pa Jugosllavinë, kombi serb është i dënuar të copëtohet.⁶⁸¹

Ivan Stamboliqi, në mesin e viteve 1980, pohoi se: “*rritja e nacionalizmit po drejtohej nga një grup i nivelit të lartë intelektual në Beograd. Përveç një numri në rritje të librave dhe artikuj nga pikëpamja nacionaliste, ka pasur dy manifestime për qëllime të ngritjes së nacionalizmit*”.⁶⁸²

Duke marr shkas nga botimi i memorandumit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Beogradit, elita komuniste e Serbisë u nda gradualisht.⁶⁸³ Rëndësia e këtij dokumenti që kishte bërë Akademia, qëndron në përshkrimin dramatik të disavantazheve, kërcënimeve dhe vajtimet për tradhtinë, komplotin dhe humbjet që serbët kishin pësuar, të paraqitura në imazhe nxitëse emocionale. Në një prezantim të përmbledhur, teksti përfshinte të gjitha çështjet emocionale, provokuese dhe të diskutueshme për të cilat nxori nacionalizmi i ri serb.

Ky memorandum pasqyrore më së miri gjendjen shpirtërore të intelektualëve nacionalistë serb, të cilët po zhyteshin gjithnjë e më thellë në vetëkënaqësi.⁶⁸⁴ Elita komuniste serbe u përça përballë qëndrimit që duhej të mbante ndaj nacionalizmit serb.⁶⁸⁵

Stamboliqi vetë kishte kërkuar një vit më parë që të fillonin reformat politike dhe ekonomike, por nuk pati suksese sepse tani më politika serbe kishte marrë një kahje krejt tjetër më atë që imagjinonte Stamboliqi. Dhe implementuesi i kësaj politike nacionaliste dhe serbocentriste që nuk i pëlqente Stamboliqit ishte pikërisht dishepulli i tij dhe aleati i tij më i ngushtë Sllobodan Millosheviçi.* Sllobodan Millosheviçi ishte zgjedhur kryetar i Lidhjes

⁶⁸¹ Po aty, fq. 626.

⁶⁸² Howard Clark, vep. e cit., fq. 16.

⁶⁸³ Gjon Boriçi, Lufta për paqen në ish-Jugosllavi 1987-1999, Tiranë, 2008, fq. 39.

⁶⁸⁴ Marie-Janine Calic, *A History of Yugoslavia*, Translated by Dona Geyer, Printed in the United States of America, 2019, fq. 262.

⁶⁸⁵ Gjon Boriçi, Vep e cit, fq. 41.

* Sllobodan Millosheviqi, i lindur në një familje serbësh të Malit të Zi më 20 gusht 1941, Millosheviqi u bë ekonomist e bankier, ndërkohë që ngjiste shkallët e Partisë Komuniste Jugosllave. Më 1986 u bë

Komuniste të Serbisë (me kërkesën e Stamboliçit),⁶⁸⁶ në maj të vitit 1986.⁶⁸⁷ Pavarësisht një miqësie të ngushtë në mes të Stamboliçit dhe Millosheviçit, dolën në pah dallimet substanciale në politikën e tyre. I pari ishte i prirur për një politikë më liberale kurse i dyti për një politikë nacionaliste dhe konservative.⁶⁸⁸

Më 24 prill 1987 Millosheviçi zhvilloi një vizitë mjaft domethënëse në Kosovë, që shënoi një pikë kthese në politikën e tij në veçanti dhe në politikën jugosllave në përgjithësi.⁶⁸⁹ Këtu në Fushë-Kosovë del vet dhe i flet turmës serbe që ishin mbledhur për të takuar atë, dhe në momentin kur ndërhyjnë policia për të shpërndarë, ai reagon duke shqiptuar atë frazën e famshme “ *askush nuk do t’ju godas më*”.⁶⁹⁰

Prandaj është plotësisht e drejtë kur thuhet nga shumë studiues se gjithçka filloi në Kosovë. Millosheviçi si një politikan instiktiv arriti shumë shpejt të kapte faktin se për të ecur me hapa rapid drejt majave të politikës dhe për të realizuar objektivat e politikës së tij të sponsorizuar nga qarqe të ndryshme serbe, duhej të përdoren dy karta, nacionalizmin në përgjithësi dhe serbët e Kosovës në veçanti.

Howard Clark ka një konstatim të drejtë për nacionalizmin dhe Slllobodan Millosheviçin: “*Millosheviçi nuk e krijoi valën e nacionalizmit në Serbi, por ai vendosi ta ngasë atë dhe ta kthejë atë në forcë të tij politike*”.⁶⁹¹

Po ashtu një konstatim të ngjashëm me Howard Clark kishte Zimmermann, konstatimi i të cili qëndron plotësisht se “nacionalizmi ishte shigjeta që vrau Jugosllavinë, Millosheviçi ishte harku kryesor”.⁶⁹²

Slllobodan Millosheviçi ishte një lider i cili më të drejtë konsiderohet në literaturën perëndimore si një udhëheqës me prirje kriminale, krejt ky konstatim bëhet për faktin se ai ishte nxitësi i

kryetar i komunistëve të Beogradit, ndërsa në vitin 1987 kreu i Partisë Komuniste të Serbisë. Përqendrimi i tij mbi nacionalizmin serb e ndihmoi të katapultohej në presidencën e Serbisë më 1988 dhe atë të Jugosllavisë më 1997. Pas një sërë luftërash të pasuksesshme, ai u mposht në vitin 2000-2001 u transferuar drejt Hagës për t’u përballur me akuzën për krime lufte, ku edhe vdiq më 2006. Shih më gjerësisht Leonard J. Cohen, Millosheviçi Misteri i Pushtetit, Tiranë, 2010.

⁶⁸⁶ Pikërisht Slllobodan Millosheviçi do të jetë ai që do të organizojë vrasjen e Stamboliçit në gusht të vitit 2000.

⁶⁸⁷ Misha Glenny, vep. e cit., fq. 626.

⁶⁸⁸ M. Vickers, vep. e cit., fq. 276.

⁶⁸⁹ Po aty. Shih edhe Marc Weller, Shtetësia e Kontestuar administrimi ndërkombëtar I Luftës së Kosovës për pavarësi, Prishtinë, 2009, fq. 85.

⁶⁹⁰ Gjon Boriçi, vep. e cit., fq. 41.

⁶⁹¹ Howard Clark, vep. e cit., fq. 18.

⁶⁹² WARREN Zimmermann, vep. e cit., fq. 212 .

shpërbërjes së Jugosllavisë dhe dora udhëheqëse prapa luftërave të përgjakshme që ndodhen në ish-Jugosllavi.⁶⁹³

Është e qartë se në literaturë ekziston një konsensus i gjerë se Millosheviçi ishte më së shumti përgjegjës për vdekjen e Jugosllavisë dhe luftërat që pasuan. Pyetje që mbetet pa përgjigje, megjithatë, është arsyeja pse ai ishte më përgjegjësi.⁶⁹⁴ Ja disa prej atyre arsyeve që ia kanë dhënë këtë atribut më të drejt Millosheviçit. Ai nxiti nacionalizmin serb të kërcënonte popujt tjerë në Jugosllavi, duke detyruar kështu republikat e tjera të shkëputen. Pastaj Millosheviçi aktivizoi një plan për një Serbi të Madhe, duke pushtuar Kroacinë, pastaj Bosnjën, Kosovën.⁶⁹⁵

Këtë na dëshmon edhe një fjalim i Slobodan Millosheviçit mbajtur para parlamentit serb në vitin 1991. “ *Gjithmonë është i forti ai që dikton se si duhet të jenë kufijtë, kurrë i dobëti. Prandaj, ne duhet të jemi të fortë*”.⁶⁹⁶

Pas vitit 1987, ndërsa Slobodan Millosheviçi mori mundësinë për të manipuluar ngjarjet politike, aleatët e tij në media nxitën urrejtje ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe e mitizuan atë si hero të ri serb.⁶⁹⁷

Procesi i eliminimit të autonomisë së Kosovës nisi menjëherë pas shtypjes së dhunshme të demonstratave të pranverës së vitit 1981 dhe u përmbyll me miratimin e kushtetutës së re serbe nga Kuvendi Federativ më 1 janar të vitit 1990.⁶⁹⁸ Që mos të them më herët, por që nga vitit 1981 hapur ishte shfaqur nga qarqet e ndryshme serbe. Suprimimi i autonomisë së Kosovës ishte kulminacioni i një politike nacionaliste me objektiva të qarta serbocentriste.

Se çfarë ndikimi pati suprimimi i autonomisë së Kosovës, dëshmon ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Hans Ditrh Gensher:“...vendimet e fundit të viteve të 80-ta që ndërmori Beogradi

⁶⁹³ Janine Natalya Clark, LLB, MA , Slobodan Milosevic; A Case-Study of the Criminal Leader, Thesis submitted to the University of Nottingham for the degree of Doctor of Philosophy, December 2005, (libër elektronik), fq. 38.

⁶⁹⁴ Po aty, fq. 39.

⁶⁹⁵ Po aty.

⁶⁹⁶ Enver Hoxhaj, vep. e cit.,fq. 278.

⁶⁹⁷ Howard Clark, vep. e cit, fq. 8.

⁶⁹⁸ Aferdita Sakolaj, vep. e cit., fq. 38.

*si suprimimin i autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës, ndikuan drejtpërdrejt si mjete shpërthyes në shpërbërjen e Jugosllavisë...”*⁶⁹⁹

Sipas Arbën Xhaferrit "strategjia propagandistike serbe për ndryshim të pozitës dhe raporteve brendapërbrenda Jugosllavisë u zhvillua në tri faza:

Faza e parë, zgjati prej vitit 1981-1987, pra prej demonstratave të Kosovës e deri te mbledhja e tetë, ajo e famshmja e KQLK-së së Serbisë (e mbajtur më 23-25 shtator të vitit 1987). Kjo fazë karakterizohet me ndryshimin e trashëgimisë së Titos dhe përfundoi me zgjedhjen e Millosheviçit si realizues i projektit për ripërkufizim të pozicioneve;

Faza e dytë, zgjati prej vitit 1987 e deri në vitin 1990. Propaganda ishte në funksion të arsyetimit të ndryshimeve strukturore, pra ndryshimit të statusit të krahinave autonome të atëhershme, të Kosovës dhe Vojvodinës;

Faza e tretë, është e përshkuar me arsyeime për mbrojtje të tezës “Serbia e fortë Jugosllavia e fortë” ose shpërbërja e saj që serbët e quanin si zgjidhje e madhe dhe kapërcimi në idenë e zgjidhjes së vogël, krijimit të Serbisë së Madhe”.⁷⁰⁰ Kjo dëshmon qartë se sa rëndësi i kanë dhënë çështjes së Kosovës qarqet serbe.

Edhe vet objektivi i kësaj teme është Kosova nga viti 1974 deri më 1989, çka do të thotë se e gjitha ajo e fituar me Kushtetutën e vitit 1974, nuk ka reshtur se përpjekuri nga qarqet nacionaliste serbe në forma të ndryshme me çdo kusht ta zhbënin autonominë, që nga ajo kohë e deri në vitin 1989 kur edhe suprimohet autonomia e Kosovës.

Objektivi më i afërt i serbëve për realizimin e synimeve të tyre për hegjemoni, unitarizëm dhe centralizëm mbi kombet e kombësitë në Jugosllavi ishte ndryshimi gradual dhe eliminimi i statusit kushtetues të krahinave. Anulimin me forcë të statusit të autonomisë së dy krahinave, Kosovës dhe Vojvodinës, Serbia e kishte perceptuar si një proces të ligjshëm, relativisht jo të vështirë dhe të shkurtër në kohë.⁷⁰¹

⁶⁹⁹ Sylë Ukshini, vep. e cit., fq. 68.

⁷⁰⁰ Po aty.

⁷⁰¹ Po aty.

Nëpërmjet këtij procesi do t'i jepej fund ankesave serbe për "padrejtësitë" që i ishin bërë Serbisë, veçanërisht me Kushtetutën e vitit 1974, e cila sipas tyre e kishte ndarë Serbinë në tri pjesë, republikën dhe dy krahinat autonome.⁷⁰²

Pra, suprimimi i autonomisë ishte si një shenjë triumfi i politikës serbe ndaj Kosovës por edhe një mesazh dhënie për republikat tjera se gjendja politika në Jugosllavi ka ndryshuar tani më në krye të Slllobodan Millosheviçin.

Serbia besonte se kishte të drejtën të fliste në emër të të gjithë popujve jugosllavë dhe të ndikonte në mënyrë arbitrare formën e shtetit në përputhje me interesat kombëtare serbe.⁷⁰³ Këto veprime politike të Millosheviçit do kenë pasoja të pariparueshme.

Ka plotësisht të drejtë filozofi francez Alen Finkelkroti kur thekson: *"Lufta e Kosovës filloi në vitin 1989, atëherë kur Slllobodan Millosheviqi, duke nisur fushatën e tërbuar të ekzaltimit nacionalist serb, që i dha pushtet absolut (dhe në të njëjtën kohë, përshpejtoi shpërbërjen e Federatës Jugosllave), shfuqizoi statusin e autonomisë së Kosovës, ua ndaloi kosovarëve shqiptarë shkollat e tyre dhe çdo përfaqësim publik dhe, megjithëse përbënin 90% të popullsisë së Kosovës, i kthej në qytetarë të dorës së dytë në raport me 10 % e mbetur (minoriteti serb)".*⁷⁰⁴

Refuzimi i udhëheqjes partiake në Kosovë paraqet edhe fillimin e fundit të Kosovës jugosllave. Për një gjë të tillë që ishte rreziku për vet ekzistencë, reagoi popullata shqiptare në të gjitha format e mundshme.⁷⁰⁵ Për këtë Slllobodan Millosheviqi kishte marrë masa politike paraprake që në krye të herës, duke "eliminuar" udhëheqësit si Azem Vllasin dhe Kaqusha Jasharin, duke i zëvendësuar me figura të dirigjuara të tij. Si Rraman Morinën, Hysamedin Azemin, Ali Shukrinë etj..

Për eliminimin politik të figurave të lartcekura pati shumë demonstrata nga shqiptarët, por ajo më e fuqishme ishte marshimi i minatorëve nga Mitrovica në Prishtinë. Po ashtu vlen të theksohet se edhe intelektualët shqiptarë nuk qëndruan në heshtje por ata ngritën zërin, duke nënshkruar një peticion 215 intelektualë të cilët i bënë thirrje Kuvendit të Serbisë që të mos suprimohej autonomia e Kosovës.

⁷⁰² Po aty.

⁷⁰³ Vesna Pestic, Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis, UNITED STATES INSTITUTE OF PEACE, fq. 5.

⁷⁰⁴ Mario Vargas Llosa, Çështja e Kosovës, Përktheu nga spanjishtja, Orjela Stafasani, Tiranë, 2019, fq. 28.

⁷⁰⁵ Oliver Schmitt, vep. e cit., fq. 242.

Por jehonë më së shumti patën greva e 4000 minatorëve shqiptarë që u futën në grevë urie në minierën e Trepçës. Shumë shpejt Trepça u bë simboli i rezistencës së shqiptarëve të Kosovës. Greva e minatorëve bëri jehonë në të gjithë Jugosllavinë e sidomos në Slloveni.⁷⁰⁶

Më 20-28 shkurt 1989, nisi greva e minatorëve të Trepçës, të cilët dolën në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovë, që kërcënohej nga Serbia. Lëvizja e minatorëve të Trepçës dhe e minatorëve në përgjithësi ishte provokuar por nuk ishte spontane. Ajo ishte organizuar mirë dhe si e tillë ishte e suksesshme, pavarësisht epilogut të saj.⁷⁰⁷

Mendoj që ka të drejtë Burhan Kavaja,⁷⁰⁸ kur thotë se: *“Greva e minatorëve por edhe e gjithë shqiptarëve të Kosovës e detyroi regjimin serb e jugosllav që ndërrimin e pozitës së Kosovës dhe heqjen e autonomisë së saj ta bënë me përdorimin e forcës brutale ushtarake – policore dhe të paraqiten para botës me fytyrën e tyre të vërtetë”*.⁷⁰⁹ Për këtë dëshmon që jo një herë, por disa herë armata jugosllave gjatë asaj kohe kishte demonstruar forcën e vet, si mesazh se ne edhe me anë të forcës do të ngulfasim trazirat e shkaktuar nga shqiptarët në Kosovë.⁷¹⁰

Greva e minatorëve synonte të ndërkombëtarizonte çështjen e Kosovës, prandaj kërkesat e minatorëve ishin mjaft mirë të artikuluar, ja disa prej tyre të perifrazuara.

Të mbrohet autonomia e Kosovës, e garantuar me Kushtetutën e vitit 1974;

Të largohen nga funksionet politike që mbanin Rahman Morina, Ali Shukriu, Hysamedin Azemi;

Të vijë sa më parë në minierën e “Trepçës” udhëheqësit më të lartë të Jugosllavisë;

Të ndërpritet politika shoviniste dhe hegjemoniste ndaj popullit shqiptar të Kosovës; Nuk ka organizator po ne jemi të gjithë organizatorë (kjo ishte për të mos i rënë barrë vetëm disa personave, që më pastaj të merreshin nga organet e hetuesisë);

Në Organizatën e Kombeve të Bashkuara të shqyrtohet pozita e shqiptarëve të Kosovës etj..⁷¹¹

⁷⁰⁶ Po aty.

⁷⁰⁷ Ibrahim Gashi, *Kosova rruga tek pavarësia*, Prishtinë, 2012, fq. 65.

⁷⁰⁸ Burhan Kavaja, ish –Drejtor i minierës “Trepça” gjatë vitit 1989.

⁷⁰⁹ Eqerem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë...*, vep. e cit., fq. 220.

⁷¹⁰ Po aty, fq. 206.

⁷¹¹ Po aty, fq. 225.

Ajo që është me interes është se greva e minatorëve gjeti mbështetje në shumë republika të ish-Jugosllavisë. Në Slloveni dhe në Kroaci ka patur demonstrata të mbështetjes publike të minatorëve në grevë. Në ndryshimet e afërt të statusit të Kosovës që ishte duke u proklamuar, shoqata të ndryshme të intelektualëve sllovenë kërkuan një miting të madh në Ljubljana për të demonstruar solidaritet me kosovarët. Demonstruesit mbanin ngjitës me një Yll të Davidit dhe me fjalët "*Kosova, atdheu im*".⁷¹²

Paralelet e tërhequra me Holokaustin përmes këtij veprimi zemëruan publikun serb dhe brenda njëzet e katër orësh një milion njerëz ishin mbledhur para ndërtesës së parlamentit federal në Beograd. Ata brohorisnin "*Sllovenia gënjeshtër!*" dhe "*Sllovenia është tradhtar!*" Turma drejtoi gjithë urrejtjen e saj kundër shqiptarëve dhe sponsorëve të tyre slloven.⁷¹³

Në gazetën austriake "*Kleine Zeitung*" më 1 mars të vitit 1989, për ngjarjet në Kosovë, boton një artikull mjaft interesant "*Sllovenët në konfliktin e Kosovës kundër serbëve dhe pro shqiptarëve*" në brendi të këtij artikulli jepen shpjegime më të detajuara se pse janë kundër serbëve sllovenët.⁷¹⁴ Ky artikull të lë të kuptosh se greva e minatorëve kishte filluar të fitojë territor në arenën ndërkombëtare, sidomos në botën perëndimore.

Veprimin e nacionalizmit serb dhe përpjekjet e Beogradit për të dominuar mbi sistemin kushtetues të RSFJ-së shkaktuan veprimet mbrojtëse të entiteteve të tjera brenda shtetit jugosllav. Sllovenia dhe Kroacia kërkonin revidimin e Kushtetutës së Jugosllavisë, të vitit 1974, në mënyrë që të forconin garancinë për pozitat e tyre.⁷¹⁵

Këtë përkrahje të minatorëve dhe të drejtën e shqiptarëve në përgjithësi në republikat kryesore në ish-Jugosllavi, Millosheviçi iu kundërvu me një tubim shumë të madh në Beograd. Lëvizja e minatorëve të Trepçës në mbrojtje të autonomisë së Kosovës, si pjesë të lëvizjes së rezistencës, në mënyrë të drejtpërdrejt apo kontekstuale është trajtuar nga shumë studiues dhe analistë të huaj.⁷¹⁶ Krejt kjo si rezultat i jehonës së rezidencës së minatorëve. Një interesim kaq i madh i studiuesve të ndryshëm na bënë të kuptojmë edhe rëndësinë që kishte greva e minatorëve, jo vetëm për mbrojtjen e autonomisë së Kosovës por edhe mesazhin e përciellur, si brenda dhe jashtë ish-Jugosllavisë, në fund të Luftës së Ftohtë.

⁷¹² Marie-Janine Calic, *A History of Yugoslavia*, Vep e cit, fq, 285.

⁷¹³ Po aty.

⁷¹⁴ Eqerem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë...*, vep. e cit , fq. 185.

⁷¹⁵ Marc Weller, *Shtetësia e Kontestuar*, Prishtinë, 2009, fq. 93.

⁷¹⁶ Ibrahim Gashi, vep. e cit., fq. 63.

Shikuar nga perspektiva e tanishme greva e minatorëve të Trepçës paraqet një ngjarje të veçantë për nga rëndësia në kuadrin e lëvizjes së joviencës.⁷¹⁷ Greva e minatorëve të Kosovës 1989, në një farë forme ia pati arritur qëllimin kryesor, sepse ata arritën të sensibilizonin çështjen e shqiptarëve të Kosovës, jo vetëm te popullata shqiptare, apo vetëm në Jugosllavi por edhe në mbarë botën, për 8 ditë aq sa zgjati kjo greva të gjitha mediat botërore ishin të fokusuara në Kosovë.⁷¹⁸

Më 23 mars 1989 në Prishtinë u mbledh parlamenti kosovar për të votuar mbi plotësimin e kushtetutës serbe dhe asaj kosovare, të cilat faktikisht suprimonin autonominë. Me makina të blinduara dhe tanke jashtë, helikopterë në krye dhe anëtarë të policisë së sigurisë dhe zyrtarë serbë, kjo ka hyrë në opinionin kosovare si “Kushtetuta e Tankeve”.⁷¹⁹

Pikërisht kjo ngjarje në rrjedhën e saj shpalos paralele me një nënshtrim tjetër. Njëjtë sikurse me rastin e miratimit të ligjit autorizues, më të cilin Adolf Hitleri mori pushtetin absolut në vitin 1933, edhe në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës më 23 mars 1989 në sallë ishin të pranishëm një numër masiv i policisë dhe shërbimi sekret, ku bënë presion të vazhdueshme, sa që vetëm 10 delegatë shqiptarë morën guximin të votonin “ kundër”.⁷²⁰

Më 28 mars 1989, në Beograd festohej me pompozitet shfuqizimi i autonomisë së Kosovës dhe shpallej “unifikimi” i Serbisë, derisa në Kosovë vazhdonte edhe më tej torturimi, burgosja dhe vrasja e shqiptarëve, të cilët atëbotë manifestonin në mënyrë paqësore kundër shfuqizimit të drejtave të tyre nga regjimi i Millosheviçit.

⁷¹⁷ Po aty, fq. 65.

⁷¹⁸ Eqerem Zenelaj, vep. e cit., fq. 224.

⁷¹⁹ Howard Clark, vep. e cit., fq. 52.

⁷²⁰ Po aty, fq. 243.

PËRFUNDIMET

Në këtë studim, “**Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1974-1989**”, kemi qenë të fokusuar të nxjerrim përfundime sa më empirike për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave për periudhën 1974-1989 dhe ngjarjet që kanë karakterizuar këto marrëdhënie, gjatë periudhës në fjalë. Kur dihet se këtë periudhë kohore që kemi marrë për studim, 1974-1989, kanë kulmuar disa ngjarje me rëndësi të madhe për shqiptarët e Kosovës. Si Kushtetuta e Kosovës 1974, këmbimet kulturore midis Shqipërisë dhe Kosovës 1970-1981, shpërthimi i demonstratave studentore në Kosovës 1981 dhe suprimimi i Autonomisë së Kosovës etj.. Duke pasur parasysh lidhshmërinë e këtyre ngjarjeve me ngjarjet tjera më thellë në histori, trajtimin e kemi bërë duke filluar nga e përgjithshmeja te e veçanta.

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe shtetit jugosllav kanë qenë çdo herë specifike, që nga viti 1912, sidomos pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, kur shteti jugosllav njihej si Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene (SKS), krejt kjo kur dihej mirëfilli se gati gjysma e territorit shqiptar mbeti nën ombrellën politike të shtetit jugosllav. Ne siç kemi theksuar edhe në brendi të punimit se shteti shqiptar çdo herë ka pasur një interesim për popullatën shqiptare në ish-Jugosllavi, kuptohet herë më shumë e herë më pak, politika e shtetit shqiptar në raport me Kosovën është determinuar edhe nga zhvillimet e politikës ndërkombëtare.

Përkundër një repretaljeje të madhe që përjetoj populli shqiptar, në kuadër të shtetit jugosllav, konkretisht në Kosovë 1912-1939, me fillimin e Luftës së Dytë Botërore është shpresuar shumë se Kosova do të vetëvendoste për fatin e vet dhe do t'i bashkohej shtetit amë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore 1939-1945. Për këtë dëshmon edhe Konferenca e Bujanit, 31 dhjetor 1943-deri më 2 janar 1944, e cila parashihte konkretisht të sipërthënë.

Një iluzion të tillë, komunistët shqiptarë e kishin krijuar edhe nga fakti që iu besonin symbyllurazi demagogjisë së udhëheqësve të PKJ-së. Por një gjë e tillë shpejt u dëshmuar, se jo që nuk ndodhi bashkimi i Kosovës me shtetin amë, por përkundrazi, shteti jugosllav menjëherë pas përfundimit të LDB-së e instaloi administratën ushtarake në Kosovë dhe përdori të gjithë mekanizmat kundër shqiptarëve që ishin kundër këtij ripushtimi. Pastaj udhëheqësit komunistë jugosllavë edhe në mënyrë formale e aneksuan Kosovën më 10 qershor 1945, në Kuvendin e

Prizrenit. Kosova edhe pas Luftës së Dytë Botërore mbeti “pjesë përbërëse” e Serbisë, pra në kuadër të ish-Jugosllavisë.

Kosova dhe gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi, pas këtij aneksimi të dhunshëm përjetuan disa prej politikave me të ashpra të organeve shtetërore jugosllave të ideuara nga Titoja e të implementuara me përpikmëri dhe me një vrazhdësi tejet të ashpër nga Aleksandër Rankoviçi. Gjatë periudhës 1945-1966 ndaj Kosovës janë përdorur metoda brutale, me qëllimin e vetëm që shqiptarët e Kosovës të lëshonin tokat e tyre dhe të emigronin në vende tjera kryesisht në Turqi, ku për një gjë të tillë kishte pasur edhe disa marrëveshje të kahershme midis shtetit turk dhe atij jugosllav. Pra metodat që ka përdorur shteti jugosllav në krye me Aleksandër Rankoviçin ndaj shqiptarëve të Kosovës ishin "Aksioni i Tepricave" 1947-1949 dhe "Aksioni i Armëve" 1955-1956.

E mekanizmi i parë kishte filluar me pretekstin se kishte nevoja imediate ushtria jugosllave për ushqime dhe duhej të mblidheshin tepricat në të gjithë shtetin jugosllav, por krejt kjo ishte një kamuflazh, sepse ky aksion ishte implementuar vetëm ndaj popullatës shqiptare të Kosovës, me qëllimin e vetëm që të detyroheshin të emigronin. Pasojat nga ky aksion ishin të rënda për popullatën shqiptare të Kosovës, sepse nuk ishin konfiskuar tepricat, por rezervat e fundit ushqimore, ku si rezultat i këtij aksioni u shfaq në shumë zona edhe zija e bukës.

Po ashtu edhe Aksioni i Armëve 1955-1956, kishte filluar ekskluzivisht vetëm në territorin e Kosovës ndaj popullatës shqiptare, kinse për të penguar organizmin e një kryengritje të armatosur të shqiptarëve kundër shteti jugosllav. Ku mijëra shqiptarë kishin kaluar nëpër duart e UDB-së ku kishin përjetuar tortura më mizore. Krejt kjo ishte për të bërë sa më shumë presion mbi popullatën shqiptare të Kosovë që të lëshonin tokat e tyre. Duke pasur parasysh ato se çka kishin përjetuar shqiptarët gjatë kësaj periudhe, nuk është e rastit që rënia e Aleksandër Rankoviçit, 1966, merret si fillim i një etape tjetër të historisë më të re të Kosovës.

Pra historia e marrëdhënieve midis shtetit shqiptar dhe ish-Jugosllavisë siç e kemi cekur edhe më lart, çdoherë është karakterizuar me acarime dhe afrime. Por periudhën historike të cilën e kemi marrë për studim 1974-1989, marrëdhëniet midis këtyre dy vendeve avancojnë në një nivel tjetër, por edhe arrijnë pikën më të ulët (pas vitit 1981). Një afrim midis dy vendeve fillon që më rënien e A. Rankoviçit, 1966, kur avancojnë sidomos në fillim të viteve të '70-ta.

Vitet e '70-ta ishin një etapë më shumë rëndësi për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi konkretisht në Kosovë, për arsye se gjatë kësaj kohe formësohet dhe kristalizohet çështja shqiptare në ish-Jugosllavi. Pra, siç dihet botërisht, pikërisht në këtë periudhë Kosova me kushtetutën e vitit 1974, u ngrit në element të federatës jugosllave, duke krijuar kështu jo vetëm një lidhje të drejtpërdrejtë me bashkësinë jugosllave, por duke e ngritur Kosovën në një entitet të fortë juridik, ku aprovohet Statuti i Krahinës Autonome të Kosovës. Por duhet të theksohet fakti se Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974 nuk është pritur mirë nga shumë qarqe serbe. Serbët pas rënies së Rankoviçit kishin filluar të ndihen si të pambrojtur, kjo frikë iu shtua sidomos pas miratimit të kushtetutës jugosllave të vitit 1974, e cila iu dha pushtet më të madh republikave konstituive dhe i bëri më të vërtetë krahina autonome të Kosovës dhe Vojvodinës. Këto kundërshtime do të vijnë e do të shtohen në mënyrë të vazhdueshme, por do të shfaqen hapur dhe me agresivitet pas vdekjes së Titos.

Por duhet të pranohet fakti se avancimi juridiko-kushtetues i Kosovës krijoi një mundësi të mirë për shqiptarët në ish-Jugosllavi që të avanconin në shumë fusha, duke përfshirë arsimin, kulturën, shkencën etj.. Por për një avancim të tillë ishin krijuar edhe rrethanat politike, sepse raportet midis shtetit shqiptar dhe ish-Jugosllavisë kishin filluar të relaksohen. Vitet e '70-a ishte një periudhë kur shteti shqiptar shfaq interesim më të madh për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi. Periudha në fjalë ishte mjaft dinamike në aspektin e bashkëpunimit midis dy vendeve, dhe jashtëzakonisht e rëndësishme për popullin shqiptar në Kosovë. I gjithë bashkëpunimi midis Kosovës dhe Shqipërisë është zhvilluar në kuadër të marrëdhënieve midis ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Pra, fillimi i bashkëpunimit midis shtetit shqiptar dhe Kosovës është fillimi i viteve të '70-a. Më 6 shkurt 1971, Shqipëria dhe Jugosllavia njoftuan se kishin vendosur që t'i avanconin misionet e tyre diplomatike në statusin e ambasadave, duke shënuar kështu një hap të ri në marrëdhëniet midis tyre. Në maj të vitit 1971 u nënshkrua për herë të parë marrëveshja për shkëmbimin e mallrave për vitet 1971-1975. Është e pakontestueshme se hapja e Shqipërisë ndaj Kosovës gjatë gjithë viteve të '70-a ka ndikuar në ngritjen kulturore, intelektuale dhe arsimore të popullatës shqiptare në Kosovë. Edhe përkundër se ky lloj komunikimi ndodhi nën mbikëqyrjen e pushtetit komunist, si në Shqipëri ashtu edhe në Jugosllavi.

Ky bashkëpunim ka ngjallur edhe shumë më shumë ndërgjegjen kombëtare në Kosovë. U krijua një brez i intelektualëve që do t'u prinin shumë proceseve në fusha të ndryshme. Po ashtu është e pakontestuar, se janë pikërisht këto vite që kanë qenë bazament për të gjitha

zhvillimet e fuqishme që kanë ndodhur në vitet në vazhdim si 1981, 1989, 1998-1999. Çdoherë duke u bazuar në dokumentet autentike arkivore, por edhe në rrjedhën e ngjarjeve të mëvonshme, lirisht mund të vijmë në konkludimin se nuk do të kishin ndodhur ngjarjet e vitit 1981, po të mos kishte ndodhur ky bashkëpunim bilateral në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Nuk do të kishte vlerën e vetë as rënia e Aleksandër Rankoviçit sikur të mos kishte ndodhur ky bashkëpunim për një dekadë midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Edhe pse periudha e viteve 1970-1981, është trajtuar nga shumë studiues të huaj dhe vendorë, por jo nga këndi që kemi trajtuar ne në këtë studim. Studimi është fokusuar në trajtimin sa më empirik të këtyre bashkëpunimeve midis shtetit shqiptar dhe atij jugosllav. Kryesisht duke u mbështetur në burime arkivore të proveniencës shqiptare, por edhe atyre jugosllave. Prandaj mund të themi se këmbimet kulturore dhe arsimore midis Kosovës dhe shtetit shqiptar 1970-1981 kemi arritur t'i prezantojmë në mënyrë mjaft të faktuar dhe argumentuese.

Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur gjatë gjithë viteve të '70-a, në veçanti këmbimet midis shtetit shqiptar dhe Kosovës, por edhe rezultatet e mëvonshme të këtyre zhvillimeve, ne kemi konstatuar se kjo periudhë ka qenë shumë me rëndësi për shqiptarët si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Kjo etapë historike pra vitet e '70-a të shek. XX që karakterizohen me avancimet kushtetuese të Kosovës dhe me këmbimet kulturore, arsimore, shkencore dhe sportive me shtetin shqiptar u ndërpre në shpërthimin e demonstratave të fuqishme studentore në mars-prill të vitit 1981.

Por duhet të theksohet edhe një fakt tjetër, që ka qenë determinues në ngjarjet e mëvonshme në ish-Jugosllavi vdekja e Titos në vitin 1980. Vdekja e Titos nuk ishte vdekje vetëm e një lideri, që mund të zëvendësohet me një tjetër pa u vërejtur kriza politike. Sepse Titoja ishte vet ai i cili kishte krijuar Jugosllavinë komuniste dhe kishte qeverisur me të në mënyrë arbitrare afër 40 vjet. Për këtë ishte paraparë nga shumë analistë të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe gjeostrategjike po ashtu edhe shumë shërbime të inteligjencës, si ato perëndimore dhe lindore, se pas vdekjes së Titos, Jugosllavia ka shumë gjasa të shkojë drejt shkatërrimit.

Shpërthimi i demonstratave studentore në Kosovë në vitin 1981 ishin shumë të fuqishme dhe të parat për nga përmasat në ish-Jugosllavi që nga pas Lufta e Dytë Botërore.

Historianë të ndryshëm numërojnë me dhjetëra faktorë që kanë ndikuar në shpërthimin e këtyre demonstratave, por ato më relevante ishin kushtet e vështira ekonomike të shqiptarëve të Kosovës, në raport me popujt tjerë që përbënin ish-Jugosllavinë, si dhe avancimi i organizatave ilegale shqiptare, ngritja e vetëdijes kombëtare të rinia kosovare, sidomos pas atyre marrëdhënieve të bashkëpunimit që kishin pasur Kosova me Shqipërinë. Edhe pse demonstratat e vitit 1981 u shuan me dhunë, të përdorur nga aparati shtetëror jugosllav, për Kosovën lirisht mund t'i quajmë, për nga pesha dhe ndikimi që kishin, si ngjarja më e rëndësishme pas Lidhjes së Prizrenit 1878.

Se sa kishin demonstratat studentore ndikim në afirmimin e çështjes shqiptare, tregon jehona e tyre në arenën ndërkombëtare. Të gjitha mediat më të rëndësishme të kohës kanë shkruar për këto demonstrata. Të gjitha shtetet që sado pak kanë pasur interes për politikën ndërkombëtare janë interesuar për këto demonstrata dhe kanë tentuar që të marrin informata sa më të sakta në forma të ndryshme. Kishte shumë artikuj në mediumet botërore që kanë trajtuar demonstratat e vitit 1981, artikujt kanë pasur jehonë të madhe në botë, të cilat ishin vlerësuar me pasazhe e komente pozitive, qoftë nga shtypi a diplomatë të ndryshëm ndërkombëtare.

Gjatë trajtimit të demonstratave të vitit 1981 në këtë studim, ne kemi trajtuar nga shumë kënde, pra si nga ai jugosllav, ndërkombëtar, kosovar dhe nga këndi i shtetit shqiptar. Çdo herë duke ballafaquar shumëllojshmërinë e studimeve për këto demonstrata. Por duke mos lënë anash dokumentet arkivore që kemi arritur t'i sigurojmë në arkivat e Shqipërisë dhe të Kosovës, edhe pse kemi arritur shumë segmente të demonstratave 1981 t'i trajtojmë në mënyrë sa më argumentuese. Ne nuk kemi arritur të argumentojmë 100% faktin se a ka patur shteti shqiptar ndikim të drejtpërdrejtë në shpërthimin e demonstratave studentore të vitit 1981 në Kosovë. Edhe pas analizimit të dokumentacioneve të ndryshme, kujtimeve të personaliteteve, që ishin protagonistë të politikës së kohës, si dhe analizimi i shumë studimeve për këto demonstrata, arrijmë në një konkludim për këtë element shumë të rëndësishëm të demonstratave të vitit 1981 se as nuk mund të mohohet, por as të pohohet, se a kishte shteti shqiptar drejtpërdrejt ndikim në shpërthimin e këtyre demonstratave. Pra këtë ngjarje me rëndësi të madhe historike vlen ajo thënia mbi objektivitetin e historisë: *“Ka dy anë për çdo histori dhe e vërteta zakonisht qëndron diku në mes.”*

Këto demonstrata përcollën mesazhe të qarta të të gjitha shtresat, se tani Kosova kishte mjaftueshëm potenciale humane për të filluar të kërkonte të drejtat e saj në çfarëdo forme dhe çfarëdo çmimi. Pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë filluan shumë veprime me karakter

kombëtar të organizuar në mënyrë kolektive, por demonstratat e vitit 1981 e fuqizuan unitetin e popullit shqiptar që të bashkuar të ecin drejt fitores; u ngrit mobilizim i ri, jo vetëm politik, shpirtëror i masave të gjera të popullit tonë. Shteti jugosllav, e kuptoi se populli i Kosovës kurrë nuk do t'i nënshtrohet sundimit serb-jugosllav. Jehona politike, kombëtare e demonstratave të vitit 1981 ishte strumbullari kryesor i fuqizimit të rezistencës kombëtare e cila në vitet e '80-ta fitoi përmasa të reja.

Të gjitha veprimet politike gjatë viteve të '80-ta të shtetit jugosllav, ishin nën afektin e demonstratave studentore të vitit 1981. Këto demonstrata serbët filluan t'i shfrytëzonin në maksimum për realizimin e qëllimeve të ndryshme politike, si për supremaci, serbocentrizëm etj.. Për këtë dëshmon memorandumi i Akademisë së Shkencave të Serbisë më 1986, djegia e Patrikanës së Pejës, rasti i Martinoviçit etj.. Krejt këto veprime politike të serbëve kurorëzohen me suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Edhe pse ishin bërë shumë përpjekje nga shqiptarët që të pengonin një gjë të tillë, përmes shumë demonstratave, dhe formave tjera, ku në vazhden e këtyre përpjekjeve ishte edhe greva e minatorëve në Trepçë. Por edhe përkundër të gjitha këtyre veprimeve nga pala kosovare, nuk arritën që ta pengonin suprimimin e autonomisë. Arsyeja kryesore se pse serbët ishin kaq këmbëngulës për ta suprimuar autonominë e Kosovës, ishte fakti se serbët donin të kishin më shumë argumente kundër Kosovës në arenën ndërkombëtare, autonomia ishte një pengesë juridike në këtë drejtim. Për këtë dëshmon, kur pala serbe paraqet si argument para Komisionit të Badinterit në vitin 1991.

Suprimimi i autonomisë së Kosovës është një nga ato ngjarjet e mëdha historike, që kanë karakterizuar Kosovën në fundin e shekullit XX. Për këtë arsye edhe ne kemi marrë si kufi kronologjik për temën që kemi për studim, pikërisht miratimin e Kushtetutës së Kosovës në vitin 1974 dhe suprimimin e saj 1989. Me këtë ngjarje përfundon ajo që kishte filluar më 1974 dhe fillon një etapë tjetër për Kosovën. Me suprimimin e autonomisë, Kosova hyn në periudhën e aparteidit.

Si përfundim mund të konstatojmë se ky punim disertacioni ka shënuar disa të arritura sa i përket studimit, analizimit të ngjarjeve më shumë rëndësi për Kosovën dhe për Shqipërinë gjatë periudhës 1974-1989. Si të këmbimeve kulturore dhe arsimore midis Kosovës dhe Shqipërisë, Kushtetutën e Kosovës 1974 dhe efektet e saj, demonstratat studentore 1981 në Kosovë dhe ndikimi i shtetit shqiptar në shpërthimin e tyre, gjendja politike, ekonomike e Kosovës 1981-1989, si dhe suprimimi e autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë.

Krejt kjo duke krahasuar dhe analizuar dokumentacionin autentik arkivor të papublikuar, dokumentet arkivore të botuara, gamën e gjerë të literaturës së shfrytëzuar, ditarët e personaliteteve të kohës, si dhe shtypin e kohës etj., e gjithë kjo shumëllojshmëri e materialeve ka të bëjë me historinë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, me Kosovën në qendër 1974-1989. Duke pasur parasysh të gjitha këto të sipërthëna besoj se ky studim është një kontribut modest në ndriçimin e kësaj periudhe historike me shumë rëndësi për shqiptarët, sidomos për shqiptarët që jetuan në ish-Jugosllavi.

BURIME DHE LITERATURA

I- BURIMET ARKIVORE TË PABOTUARA

- **Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)**

Fondi:14, viti 1981, dosja 28;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 168, viti 1970;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 180, viti 1971;

Fondi:Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 234, viti 1972;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 203, viti 1973;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 198,viti 1975;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 242, viti 1978;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 246, viti 1979;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 272, viti 1980;

Fondi: Ministria e Arsimit dhe Kulturës, dosja nr. 158, viti 1981.

- **Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (AMPJ)**

Dosja nr, 1229, viti 1981.

Dosja nr, 1220, viti 1981.

Dosja nr, 1195, viti 1980.

Dosja nr, 1292,viti 1981.

Dosja nr, 1252, viti 1978.

Dosja nr, 1220, viti 1979.

Dosja nr, 1234, viti 1981.

- **Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK)**

Fondi: Komiteti Krahinor i Kosovës, Viti 1981, Kutia 66, Lënda:83.

Fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhëniet me Botën e Jashtëm, viti 1968-1991, nr lëndës. 1-200, nr i kutisë 7.

Fondi: Sekretariati Krahinor për Marrëdhëniet me Botën e Jashtëm, viti 1979-1988, Nr i lëndës:36, Numri i Kutisë:3.

- **Arhiv Republike Slovenija (ARS)**

Fondi: Централни комитет Комунистичке лиге, Škatla 872-KOSOVO.

II- BURIMET ARKIVORE TË BOTUARA

- Sylja, Sabit dhe Kaba, Hamit 1981 Demonstratat e Kosovës në Arkivin Kombëtar të Londrës, Prishtinë, 2017.
- Dokumentet Diplomatike të Qeverisë Shqiptare për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, Hulumtoi dhe përgatiti për shtyp Sabit Sylja, Prishtinë, 2012.
- Zenelaj, Eqerem, Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989, Prishtinë, 2011.
- Dokumentet kryesore të Partisë së Punës për Shqipërinë, Instituti i Studimeve Marksiste – Leniniste pranë KQ-së të PPSH-së, dokumentet kryesore të PPSH-së Vëllimi VIII, viti 1980-1985, shtëpia botuese 8 NËNTORI, Tiranë, 1986.
- Çeku, Ethem, Demonstratat e vitit 1968 në Arkivin e Kosovës, Përktheu nga serbishtja Merxhan Avdyli, Prishtinë, 2009.
- Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, dokumente, Tiranë, 1996.

III- LITERATURA

1. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, KOSOVA vështrim monografik, Prishtinë, 2011.
2. Anzuloviç, Branimir, Serbia Hyjnore nga miti te gjenocidi, Prishtinë, 2017.
3. Bajrami, Arsim, Historia e Konstitucionalizmit shqiptar 1912-2012, Prishtinë, 2014.
4. Baptista, Jean-Duroselle Andre Kaspi, Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Vllimi i II, Nga viti 1945 deri në ditët e sotme, Tiranë, 2011.
5. Bartl, Peter, Shqipëria nga mesjeta deri sot, Përktheu nga gjermanishtja: Shkumbin Brestovci, Prizren, 1999.
6. Bashkurti, Lisen , Diplomacia e Shqipërisë në Fillimet e Luftës së Ftohet, Tiranë, 2003.
7. Berisha, Ibrahim, Vdekja e Kolonisë, Prishtinë, 2016.
8. Boriçi Gjon, Lufta për paqen në ish-Jugosllavi 1987-1999, Tiranë, 2008.
9. Braha Shaban, Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990, Tiranë, 1992.
10. Buda Aleks, Studime Historike, Prishtinë, 2006.
11. Butka Uran, Mukja shansi i bashkimit peng i tradhtisë, Tiranë, 2007.
12. Buxhovi Jusuf, KOSOVA nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar, Prishtinë, 2012.
13. Calic, Marie-Janine, A History of Yugoslavia, Translated by Dona Geyer, Printed in the United States of America, 2019.
14. Castellan Georges, Historia e Ballkanit, Tiranë,
15. Clark , Howard ,Civil Resistance in Kosovo, Pluto PPress LONDON • STERLING, VIRGINIA, First published 2000 by Pluto Press.
16. Çeku, Ethem , Kosova në sfondin e Diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981, Tezë doktrate(në Dorëshkrim).
17. Çeku, Mr. Ethem, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981, (Brezi'81, Prishtinë, 2004).

18. Denisa Kostovicova, Kosovo The politics of identity and space, First published 2005, First published 2005 by Routledge 2 Park Square, Milton Park, Abingdon, Oxon OX14 4RN Simultaneously published in the USA and Canada by Routledge 270 Madison Ave, New York, NY.
19. Dinaj Shefqet, Statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës në vitet 1945-1966, Tiranë, 2018, Akademia e Studimeve Albanologjike (tezë e doktoraturës e pabotuar).
20. Duka Prof. Dr.Valentina: Historia e Shqipërisë 1912- 2000, Tiranë, 2007.
21. Feraj Hysamedin, Skicë e mendimit politik shqiptar, Tiranë, 2006.
22. Fevziu Blendi, Enver Hoxha, Botimi i katër, Tiranë, 2011.
23. Fjalori Politik i Oxfordit, botimi i ri i përditësuar, Mclean, Iaim dhe Mcmillan, Alistar, Tiranë, 2011.
24. Gaddis, John Lewis. The Cold War: A New History, New York, 2005.
25. Gallagher, Tom, Outcast Europe The Balkans, 1789–1989 From the ottomans to Milosevic, London and New York, 2001.
26. Gashi Ibrahim, Kosova rruga tek pavarësia, Prishtinë, 2012.
27. Geci Faruk, Tirana kryeqytet i gjeopolitikës së shqiptarëve, Projekt studimor, Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Tiranë, 2014 .
28. Geci, Faruk, Tirana kryeqyteti i gjeopolitikës së shqiptarëve, PROJEKT STUDIMOR QENDRA KOMBËTARE E SIGURISË DHE MBROJTJES, Tiranë, 2014.
29. Geert Hinrich Ahrens, Diplomacia mbi tehun e thikës, pengimi i konfliktit etnike dhe grupi i punës për minoritetet i konferencave për Jugosllavi, Tiranë, 2010.
30. Gleny Misha, Historia e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmat, Luftërat dhe Fuqitë e Mëdha , Tiranë, 2007.
31. Grup autorësh, Fadil Hoxha një jetë në shërbim të atdheut, Prishtinë, 2007.
32. Grup autorësh, HISTORIA E POPULLIT SHQIPETAR V . Botuar Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Historisë, Tiranë, 2002.
33. Gjilas Milovan, Biseda me Stalinin, Tiranë, 2000.
34. Gjinaj Agustin dhe Lila Fejzli, Lidërshtipi shqiptar përmes histories së ushtrisë, GEER, 2012.
35. Gjoshaj Mehmet, Aksioni i “Tepricave” ne Kosovë...
36. Gjoshaj Mehmet, Aksioni i armëve në Kosovë më 1955-1956, Prishtinë, 2012.
37. Hajdin Azem, -Xani, Masakra e Tivarit, Prishtinë, 1998.
38. Hajrizi Mehmet, Historia e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Botimi Toena, Tiranë, 2008.
39. Hajrullahu Arben, Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integritimit në BE, Përkthyes nga gjermanishtja në shqip: Rexhep Bajrami, Botuar në Prishtinë, 2015.

40. Hasani Xhevat, Një jetë në shërbim të lirisë kushtuar Naser Hanit, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë, 2013.
41. Hasani Enver, Gashi Shkëlzen dhe Buçaj Enver, Mendimet e Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë, shpërbërja, Vetëvendosje dhe trashëgimi i shteteve, Prishtinë, 2006.
42. Hibert, Reginald, Fitorja e Hidhur, lufta nacional çlirimtare e Shqipërisë, Londër, 1991, përktheu Xhevat Lloshi.
43. Historia e Popullit Shqiptar IV, shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990, Botimet Toena, Tiranë, 2008.
44. Horvat, Branko, Kosovsko Pitanje, Glob, Zagreb, 1989.
45. HOTI Ukshin, Filozofia Politike e çështjes shqiptare, Tiranë 1995.
46. Hoxhaj Enver, Ngritja e një shteti, politika e jashtme e Kosovës, Tiranë, 2016.
47. Hoxhaj Enver, Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës, Dukagjini, Pejë, 2008.
48. Hoxhaj Enver, Politika etnike dhe shtetndërtimi i Kosovës, Dukagjini, Pejë, 2008.
49. I Izoluari, Rrëfime nga Tuneli i Tmerit...
50. Identiteti Evropian i Kosovës Simpozium ndërkombëtar, i mbajtur më 26 dhe 27 Qershor Prishtinë, 2007, Nëntor, 2007, Prishtinë.
51. Islami Hivzi, STUDIME DEMOGRAFIKE 100 VJET TË ZHVILLIMIT DEMOGRAFIK TË KOSOVËS, Botimi i dytë i plotësuar, Redaktor: Ekrem Murtezai, AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS, Prishtinë, 2008.
52. J. Fischer Bernd, Diktatorët e Ballkanit, Tiranë, 2008.
53. JAMES S. O'DONNELL, A COMING OF AGE ALBANIA UNDER ENVER HOXHA, EAST EUROPEAN MONOGRAPHS, BOULDER DISTRIBUTED BY COLUMBIA UNIVERSITY PRESS, NEW YORK 1999.
54. Jashari Kaqusha, Do ta vendosim kufirin 1988-1989, Koha, Prishtinë, 2015.
55. Judt, Tony, Postwar A HISTORY OF EUROPE SINCE 1945, THE PENGUIN PRESS, New York, 2005.
56. Keçmezi Basha, Sabile, Kosova 1945-1990, vështrim historiko-politik, Prishtinë, 2017.
57. Keçmezi, Sabile-Basha, Të burgosurit politik Shqiptarë në Kosovë 1945-1990, Prishtinë, 2009.
58. Keçmezi-Basha, Sabile, Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, Prishtinë, 2013.
59. Kissinger Henry, Diplomacia, Tiranë, 1999.
60. Konflikt apo dialog, Marrëdhëniet shqiptaro-serbe dhe integrimi i Ballkanit, (përmbledhje punimesh), Pejë, 1995.
61. Kostovicova, Denisa, Kosovo The politics of identity and space, LONDON AND New York, 2005.

62. Krasniqi Jakup, Një histori e kontestuar, Prishtinë, 2013.
63. Krasniqi Jakup, Pranvera e Lirisë '81, Prishtinë, 2011.
64. Krasniqi Jakup, Shtypi shqiptar për zhvillimet në Kosovë 1981-1991, Desirtaicon i doktoratës, (Në dorëshkrim).
65. Krasniqi Memli, Matoshi Hysen, Kujtesa Kolektive: Dëshmi dhe Ngjarje 1944-1966, Prishtinë, 2016.
66. Kuçi Ruzhdi , Mendimi ushtarak strategjik dhe organizimi I forcave të armatosura të shtetit shqiptar 1945-1990, Tiranë, 2017, Tezë e doktoraturës (në dorëshkrim).
67. Lakër Uolltër, Evropa në kohën tonë histori e viteve 1945-1992, përkthyer nga Gëzim Arapi, shtëpia Botues Dituria, Tiranë, 1996.
68. Lalaj Ana, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981, Tiranë, 2000.
69. Leter Nasi, “Eightmonths in the historyof the Albanianpopulation in Yugoslavia”, *The Truth on Kosova*, The AcademyofSciencesofRepublicofAlbania, EncyclopediaPublishingHouse, Tirana, 1993.
70. Lisen Bashkurti, Diplomacia e vetizolimit rasti i Shqipërisë 1961-1989, 2005?, Tiranë.
71. Lory Bernard, Europa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona, Tiranë, 2007.
72. Mahmuti Bardhyl, Mashtrim i Madh, Shkupt, 2015.
73. Malcolm Noel, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë-Tiranë, 2001.
74. Mario Vargas Llosa, Çështja e Kosovës, Përktheu nga Spanjishtja Orjela Stafasani, Tiranë, 2019.
75. Mary Metesi, Kosova Preludi i Luftës 1966-1999, Prishtinë, 2017.
76. Mclean Iain dhe Mcmillan, Alistar, Fjalor Politik, Oxford, Tiranë, 2011.
77. Meier Viktor, Fundi i Jugosllavisë Goditja në Kosovë,Shtëpia botuese”Liria” Lubjanë, 2006.
78. Meier Viktor, Yugoslavia A History of its Demise, London and New York , First published in English 1999.
79. Mesiq Stipe, Si është shkatërruar Jugosllavia, Zagreb, 1994?.
80. Milković Valentina, Aleksandar Ranković i djelovanje Uprave državne bezbjednosti (UDB-e) od 1944. do 1966, Sveučilište Josipa Jurja Strossmayera u Osijeku Filozofski fakultet Osijek, Osijek, 2016.
81. Molla Ylli, Plani Sekret për Kosovën dhe histori tjera, Tiranë, 2006.
82. MUSAJ Endrit, Marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike (1949 – 1961) Tiranë , 2017
83. Natalya Clark, Janine, LLB, MA , Slobodan Milosevic; A Case-Study of the Criminal Leader, Thesis submitted to the University of Nottingham for the degree of Doctor of Philosophy, December 2005.

84. Nation Craig, WAR IN THE BALKANS, 1991-2002, August, 2003.
85. Novosella Selatin , 75 Kosova, Procesi politik i Prishtinës, Prishtinë, 2012.
86. Novosella Selatin, Demonstratat e Gjashtëdhjetë e tetës 3, Prishtinë, 2008.
87. Nushi Pajazit, Bashkëpunimi në mes të Universitetit të Prishtinës e Universitetit të Tiranës, Prishtinë, 1977.
88. Obradović Milovan, Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 2005.
89. Osmani Jusuf, Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptareve nga Kosova 1918-1941,1.2.3, dokumente: kolonizimi, Prishtinë, 2016.
90. Partosh Gabriel, Bota që erdhi prej të ftohtit, Tiranë, 2002.
91. Pesic Vesna, Serbian Nationalism and the Origins of the Yugoslav Crisis, UNITED STATES INSTITUTE OF PEACE.
92. Petranović, Branko, ISTORIJA JUGOSLAVIJE 1918 - 1988 ,TREĆA KNJIGA SOCIJALISTIČKA JUGOSLAVIJA 1945—1988, NOLIT, BEOGRAD.
93. Pierre Cabanes (ky libër ishte nën drejtimin), Oliver Chaline, Bernard Doumerc, Alain Duceller, Michell Sivignon, Historia e Adriatikut, Tiranë, 2005.
94. Politika serbomadhe prej Garashaninit deri te Akademia, Flaka Surroi, Redaktore, Koha, Prishtinë, maj 2019.
95. Prifti Kristaq, Gjenocidi dhe komplotet antishqiptare të serbomëdhenjve. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2017.
96. Qeriqi Ahmet, Lufta e NDSH-së 1944-1950, Prishtinë, 2005.
97. Ramosaj Fitnete, Organizatat ekstremiste serbe në Kosovë, Prishtinë, 2013.
98. Reka Blerim, Kosova në dokumentet e Kongresit Amerikan 1986-1995, Prishtinë, 1995.
99. Rizaj Gazmend , Shqipëria e Sipërme 1800- 1913, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011.
100. Schmitt Jens Oliver, Kosova historia e shkurtër e një treve qendrore ballkanike, Prishtinë, nëntor 2012.
101. Skendi Stavro, Zgjimi Kombëtar Shqiptar, Tiranë, 2000.
102. Sokolaj Afërditë, Çështja e Kosovës dhe media shqiptare (1981 – 2000), Tiranë, 2014, (tezë doktrate në dorëshkrim).
103. Stavileci Esat dhe Nushi, Pajaziti, Të vërtetat për Kosovën, Prishtinë, 2000.
104. Stavileci Esat, Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit, Prishtinë,1997.
105. Stefan Karastojanov, Kosova , një analizë gjeostrategjike, Shkup, 2007.
106. Surroji, Veton, Fadil Hoxha në vetën e parë...
107. Sylja Sabit, Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981, Prishtinë, 2012.

108. Shatri Muhamet, Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945, Toena, Tiranë, 1997.
109. Todorova Maria , Ballkani imagjinar, Ballkani si altar i Europës, Tiranë, 2006.
110. Thiesse Ana-Maria, Krijim i identiteteve kombëtare Evropa e shekujve XVIII-XX, përktheu nga frëngjishtja Etleva Shiroka, Dukagjin, Pejë, 2004.
111. Ukshini Sylë, Kosova në Politikën e Jashtme të Be-së 1991-2007, Prishtinë, 2008.
112. Verli Marenglen, Reforma agrare kolonizuese në Kosovë, Tiranë, 1992.
113. VERLI Marenglen, Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirote, vëllimi II, Botinex, Tiranë 2007.
114. Vickers Miranda, Midis serbëve dhe shqiptarëve një histori e Kosovës, Tiranë, 2004.
115. Vllasi Azem, Kosova: Fillimi që nuk harrohet, Prishtinë, shkurt 2017.
116. Wachtel, Baruch Andrew, Ballkani në Historinë Botërore, Tiranë, 2012.
117. Weller, Marc, Shtetësia e kontestuar, administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi, Prishtinë, 2009.
118. Yugoslavia from a Historical Perspective, Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, Belgrade, 2017.
119. ZIMMERMANN, WARREN , ORIGINS of a CATASTROPHE YUGOSLAVIA AND ITS DESTROYERS.
120. Zogaj Agim, Marrëdhëniet Shqiptaro-jugosllave 1945-1948, tezë e doktoraturës, (në dorëshkrim).
121. Димитрије Богдановић, КЊИГА О КОСОВУ, СРПСКА АКАДЕМИЈА НАУКА И УМЕТНОСТИ ПОСЕБНА ИЗДАЊА, Уредник: академик АНТОНИЈЕ ИСАКОВИЋ, БЕОГРАД, 1986.

IV- PERIODIKU

a) Revistat:

- VJETARI, Arkivi Shtetëror i Kosovës, 41-42, Prishtinë, 2009.
- KOSOVA 43, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2018.
- KOSSOVA 41, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2016.
- STUDIME HISTORIKE, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2018(3-4) viti LXXII (LV), Tiranë, 2019.

- Srbija i Albanci, Pregled politike Srbije prema Albancima od 1944 do 1989 knjiga treća, casopis kritiko znanosti, Maribor, 1989.
- Çeku Ethem: Kosovoduring the tensesrelationsbetweenAlbaniaandYugoslaviaduringsixtiesandseventiesof the twentiethcentury, *InternationalRelationsQuarterly*, Vol. 5, No. 2 (Summer 2014).

b) Gazeta

- Zëri i Popullit 1970-1989. Organ i KQ-së të PPSH-së, Tiranë.
- Rilindja 1981-1989. Organ i Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Kosovës, Prishtinë.

V- KUJTIME TË PERSONALITETEVE TË NDRYSHME

- Hoxha Enver, Titistët, Shënime historike, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ-së të PPSH-së, SHTEPIA BOTUESE -8 NËNTORI, Tiranë, 1982.
- Hoxha, Nexhmije, JETA IME ME ENVERIN, Kujtime, Botuar nga Enti Botues "LIRA" Tiranë 1998.
- Alia Ramiz, Jeta Ime, Kujtime, Botimet Toena, Tiranë, 2010.
- Qosja Rexhep: Dëshmitar në kohë historike, (1982- 1983), Ditari I:II:III: IV, Botimet Toena, Tiranë, 2014.

- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (1970-1971) 6, Tiranë, 1983.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (1972-1974) 7, Tiranë, 1983.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (1975-1976) 8, Tiranë 1984.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE(1977) 9, Tiranë, 1981.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (janar 1978-qershor 1978) 10, Tiranë, 1984.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (korrik 1978- nëntor 1978)11, Tiranë, 1984.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NDËRKOMBËTARE (1979) 12, Tiranë, 1985.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NURKOMBËTARE (1980 - 1981) 13, Tiranë, 1985.
- Hoxha Enver, DITAR PËR ÇËSHITJE NURKOMBËTARE (1977-1980) 14, Tiranë, 1981.

VI- BURIMET NGA INTERNETI

- Adviser: Professor Maria Todorova, THE 1981 KOSOVAR UPRISING: NATION AND FACEWORK, Urbana, Illinois. Marr në https://www.ideals.illinois.edu/bitstream/handle/2142/44144/Zachariah_Claybaugh.pdf?sequence=1
- СЛОБОДАН МИЛОШЕВИЋ , ГОДИНЕ РАСПЛЕТА, ЧЕТВРТО ИЗДАЊЕ , БЕОГРАДСКИ ИЗДАВАЧКО-ГРАФИЧКИ ЗАВОД, www.skripta.info .
- Emil Hilton Saggau, University of Copenhagen, Faculty of Theology, New perspectives on the religious revival in South Eastern Europe, fq. 1-2. Marrë në: <http://web.a.ebscohost.com/ehost/pdfviewer/pdfviewer?vid=6&sid=4219a929-2a52-4680-838b-7cda45a7b17a%40sessionmgr4006>.
- Dr. Dragan BOGETIĆ, JUGOSLAVIJA I SVETSKO TRŽIŠTE KAPITALA. Američka finansijska podrška jugoslovenskim razvojnim programima krajem 50-tih godina, fq, 91. Marrë në: https://www.inisbgd.co.rs/celo/2010_3.pdf, 03.04.2019.
- Momčilo Pavlović , KOSOVO UNDER AUTONOMY 1974-1990, Viti dhe vendi ?, marr në: <https://www.cla.purdue.edu/si/Team1Reporte.pdf>.
- <https://drive.google.com/file/d/1P46ODu8Krc1QxN8zKTiNihHFFKADMdmk/view>,
- <http://www.voalonline.ch/index.php?mod=article&cat=INTERVIST%3%8BPRESS&article=49588>
- <https://espressostalinist.files.wordpress.com/2010/12/a-coming-of-age.pdf>.
- http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wpcontent/uploads/2018/02/Endrit_Musaj.pdf.
- <https://www.scribd.com/document/64957263/Zimmerman-Origins-of-a-Catastrophe-Yugoslavia-and-Its-Destroyers-1999>
- <http://fxm.uni-pr.edu/Punimet-e-Doktoratures/Filozofiku.aspx>
- <https://www.cla.purdue.edu/si/Team1Reporte.pdf>
- <http://plisi.org/shtetligj/gjitha-kushtetutat-kosoves/>
- https://www.ideals.illinois.edu/bitstream/handle/2142/44144/Zachariah_Claybaugh.pdf?sequence=1,
- http://novi.uciteljneznalica.org/PDF/arhiva%20autora/475_Horvat%20Branko%20Kosovsko%20pitanje%20%20Globus%201989.pdf

- <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ja-si-e-kamufloi-serbiavrasjen-e-te-rinjve-serbe-ne-lokalin-panda-ne-peje-dokument-151696/?archive=1>
- http://ciml.250x.com/archive/hoxha/albanian/enver_hoxha_kosova-eshte-shqiperi.pdf
- <https://telegrafi.com/dosja-1981-ngjarjet-qe-ndryshuan-rrjedhen-e-historise-foto/>
- <http://www.gazetama.net/2019/03/30/testamenti-i-titos-per-shqiptaret/?fbclid=IwAR0EC8OMYwLqvNfswgblc-throriTEMt4v6aTFIrgkME5F34x51g0hQrrhg>
- http://www.kipred.org/repository/docs/Cfare_ndodhi_me_shqiptaret_e_Kosoves_110227.pdf,
- Abetarja e Pushtetit, Libërth mbi politiken, njerëzit dhe partitë politike në Kosovë, dhjetor, 2011, Marrë në : <http://iksweb.org/wp-content/uploads/2011/12/Abetarja-e-Pushtetit-Liberth-mbi-Politiken-Njerezit-dhe-Pushtetin-ne-Kosove.pdf>.